KOSOVA
DHE
MEDIAT

SEENPM

Ky libër botohet në suazat e Rrjetit të Evropës Juglindore për Profesionalizimin e Medias (SEENPM)
www.seenpm.org

Kosova

dhe

mediat

MACEDONIAN INSTITUTE FOR MEDIA

Instituti Maqedonas për Media
Shkup
Maqedoni

Kosova dhe mediat

Botues: Instituti Maqedonas për Media

Për botuesin: Mihajllo Llahtov

Redaktorë të botimit: Marko Troshanovski dhe Tome Smilevski

Disejni: Jane Stefanov

Shtypur në: Vinsent Grafika – Shkup

Përkthyes: Geron Kamberi

Tirazhi: 350 copë

www.mim.org.mk

www.seenpm.org

CIP - Каталогизација во публикација
Народна и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

316.774(4-14):323(497.115) “2008”
316.776.3:316.658

KOSOVA dhe mediat / [Redaktorë të botimit Marko Troshanovski dhe Tome Smilevski]. - Skopje : Instituti Maqedonas për Media, 2008. - 256 стр. : граф. прикази; 23 см

Фусноти кон текстот. - Библиографија кон трудовите

ISBN 978-9989-158-07-0

а) Медиуми - Југоисточна Европа - Косово - Политички прилики - 2008
б) Медиуми и јавно мислење
COBISS.MK-ID 73818122

Kosova

dhe

mediat

Përmbajtja

KËNDVËSHTRIM RAJONAL 9

SHQIPËRIA 29

BOSNJA DHE HERCEGOVINA 47

BULLGARIA 59

KROACIA 75

HUNGARIA 93

MAQEDONIA 105

MOLDAVIA 121

MALI I ZI 135

RUMANIA 151

SERBIA 163

SLLOVENIA 185

TRANSKRIPTIM I KONFERENCËS NDËRKOMBËTARE
TË MBULIMIT NGA MEDIAT TË SITUATËS NË KOSOVË 213

Parathënia e Botuesit

Ky libër është rezultat i një projekti të emërtuar Mbulimi nga Media i Situatës në Kosovë – Krijimi i një Forumi për Profesionistët e Medias në Evropën Juglindore, i cili u realizua në 2008 nga Instituti Maqedonas i Medias(MIM) në emër të Rrjetit të Evropës Juglindore për Profesionalizmin e Medias (SEENPM). Në projekt u përfshinë 11 studiues nga 11 vende të EJL (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Hungaria, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Rumania, Serbia dhe Sllovenia). Detyra e tyre kryesore ishte përqendrimi mbi analizat e shtypit të vendeve të mësipërme ashtu si edhe përgatitja e raporteve duke nxjerrë në pah karakteristikat kryesore të mbulimit nga ana e medias të situatës në Kosovë.

Ndërkohë MIM dhe SEENPM organizuan në Shkup një Konferencë Ndërkombëtare nga data 16-17 maj 2008 e cila u emërtua me të njëjtën emër si projekti, Mbulimi nga Media i Situatës në Kosovë. Në këtë konferencë një sërë gazetarësh, analistësh politikë e ekspertë të medias nga e gjithë Evropa shqyrtuan mbulimin e çështjes së Kosovës nga mediat në Serbi, Kosovë e rajonin e Evropës Juglindore dhe Perëndimore. Konkluzionet përfundimtare të këtyre analizave ishin tepër të rëndësishme e paraqitën një këndvështrim cilësor rreth kësaj çështje ashtu sikurse shërbyen për diskutime të pafundme përgjatë konferencës.

Organizimi i një Konference për Kosovën përbënte një çështje me rëndësi të madhe dhe në të njëjtën kohë edhe sfidë për të gjitha palët e përfshira. Jo për shkak se ne besonim se ajo do të mund të zgjidhte problemin e ndërlikuar të Kosovës, por sepse ne ishim pozitivë se pjesë e zgjidhjes duhej të shihej nëpërmjet dialogu të hapur e të vazhdueshëm. Një dialog i cili nuk do të përcaktonte vetëm meritat dhe dobësitë e mbulimit të medias, por në të njëjtën kohë do të shërbente për të ringjallur më vonë ide dhe koncepte lidhur me hapat të tjerë dhe aktivitete të mëtejshme të suksesshme.

Ky libër përmban elementët më interesantë të këtij debati që u zhvillua në Konferencën e Shkupit ashtu si edhe 11 raporte nga vende të ndry-

shme të shoqëruara me një këndvështrim rajonal të përgatitur prej botuesit Marko Troshanovski. Kjo përmbledhje e kërkimeve, analizave dhe opinioneve dëshmon sfidën me të cilën u përball media gjatë raportimit të situatës në Kosovë, jo vetëm në këtë vend dhe në Serbi, por në të gjithë rajonin e Evropës Juglindore. Unë shpresoj se ne kemi dhënë një kontribut të vogël drejt një mbulimi më të mirë nga ana e medias në të ardhmen, veçanërisht për tema që zgjojnë një interes të madh për lexuesit e dëgjuesit tanë.

Në fund, do të dëshiroja të shprehja mirënjohjen tonë ndaj organizatës që mbështeti këtë projekt: Misionin e OSBE –së në Kosovë, Balkan Trust for Democracy, Fondacionin Konrad Adenauer në Sofje dhe Ambasadën e Zvicrës në Republikën e Maqedonisë. Njëkohësisht do të doja të shfrytëzoja këtë mundësi për të falënderuar të gjithë anëtarët e SEENPM për përfshirjen dhe pjesëmarrjen e tyre në këtë projekt, të gjithë pjesëmarrësit, folësit dhe moderatorët në Konferencë, autorët dhe botuesit e këtij libri si edhe të gjithë bashkëpunëtorët që u përfshinë në realizimin e këtij projekti.

Mihajlo Lahtov

Instituti Maqedonas për Media



KËNDVËSHTRIM RAJONAL

Marko Troshanovski

KËNDVËSHTRIM RAJONAL

Çdo realitet e ngjarje që kalon nëpërmjet medias është tredimensionale. Mjedisi ynë i pashmangshëm i medias ka tri shtrirje: objektive, të krijuar dhe subjektive[1]. E para është realiteti në vetvete, e dyta realiteti si e perceptojmë dhe i fundit është ai që formësohet prej medias. Aftësia depërtuese analitike ndaj të këtyre 3 aspekteve, brendësisë, strukturës e ndikimeve të tyre, do të na mundësojnë që të kemi një pamje më të plotë rreth asaj që na rrethon. Ky botim është kryesisht një përpjekje për të shkokolepsur realitetin objektiv e atë të ndërtuar prej nesh(konstruktiv) të cilat janë përcaktuesit bazë të eksperiencës sonë subjektive.

Duke e përqendruar vëmendjen e tij mbi ngjarjet në Kosovë dhe mënyrën e mbulimit të tyre nga ana e medias, ky botim ofron një sfidë për të kuptuar një ngjarje të ndërlikuar në një mjedis mediatik "jokonvencional" edhe më të ndërlikuar. Shqyrtimi i kryer në këtë rast prej Rrjetit të Evropës Juglindore për Profesionalizmin e Medias (SEENPM) përpiqet të tregojë disa histori rreth asaj sesi shkroi media rreth Kosovës e për t'iu përgjigjur pyetjes se ku dhe si u treguan këto histori e cila ishte pasoja. Në këtë mënyrë ajo përgjithësisht paraqet një kuadër konceptual të përbërë nga një pyetje kërkimore, kontekstin brenda së cilës është dhënë domethënia në tekst dhe përfundimet që kanë patur për qëllim t'i përgjigjen çështjes së kërkimit duke marrë në konsideratë kontekstin.[2]

Tema e parë e secilës prej 2 çështjeve të shtjelluar në raportin çdo vendi të përfshirë në këtë botim, i kushtohet kontekstit politik e mediatik, e ka për qëllim të rrethojë e përshkruajë përbërësit objektiv të realiteteve në Kosovë. Ajo përfshin ngjarjet politike dhe fazat politike të elitës lokale. Nga ana tjetër konteksti i medias paraqet drejtimet e sistemeve mediatike që prodhojnë përmbajtjen (struktura e pronësisë së medias, ndikimet e mundshme politike, kapacitet e burimeve njerëzore, etj). Këto dy aspekte krijojnë qasjen episte-

1 Orljevi, T (1988).Komunikacija I vlast, Beograd: NIRO Mladost

2 Perberesit conceptual jane huazuar nga Krippendorff, K(2004).Content Analyses: An introduction to its Methodology, 2nd ed. Thousand Oaks, CA: SAGE Publication, Inc.29-31

mologjik nëpërmjet së cilës mund të analizohet përmbajtja e medias. Një nga parimet e çdo analize teksti është se domethënia (kuptimi) nuk është i brendshëm për tekstin, kështu që konkluzionet nga kjo pjesë do të krijohen hap pas hapi me analizën e rezultateve të kërkimit.

Në fund, qëllimi i kësaj përpjekje kërkimi është ti përgjigjemi pyetjes e cila lidhet me faktin sesi rasti i Kosovës është mbuluar nga media në rajonin e Evropës Juglindore[3]. Si media ka formësuar e ka ofruar të dhëna rreth ngjarjeve e nëse ato e kanë informuar, edukuar apo manipuluar lexuesin. Secili prej raporteve nuk është përfundimtar por të gjithë së bashku kontribuojnë drejt mundësisë për të arritur një konkluzion të tillë. Komunikimi masiv është ndoshta vlera më e fortë e shoqërizimit në botën e sotme moderne dhe në mënyrë të pashmangshme njohuritë tona përbëhen prej asaj që ne lexojmë, dëgjojmë apo shikojmë. Ai na jep mundësinë e kontrollit demokratik, integrim të të gjithë segmenteve të shoqërisë e çfarë është më e rëndësishmja përbën pasurinë kulturore të qytetarisë.[4]

Rëndësia e këtij kërkimi është se ai kontribuon për të kuptuar dhe përmirësuar mënyrat e krijimit të përmbajtjes mediatike. Në fund, raportet flasin vetë, por mund të përmbledhim këtu disa prej dukurive më të shpeshta që ndeshen tek ato.

KOSOVA-ASPEKTET POLITIKE TË RËNDËSISË SË SAJ RAJONALE

Fillimi i vitit 2008, i cili përkonte me periudhën kur u zhvilluan kërkimet për këtë botim, ishte mes të tjerave edhe koha kur çështja e statusit të ardhshëm të Kosovës u vendos në qendër të vëmendjes së publikut botëror. Në këtë kontekst ky kërkim vetëm pohon më tej faktin se zgjidhja e statusit të ardhshëm të Kosovës u ndoq në mënyrë e të pashmangshme e të vazhdueshme nga mediat e përditshme të rajonit. Përgjatë periudhës së mbulimit të zgjidhjes së çështjes së Kosovës, gazetat e përfshira në këtë projekt rajonal elaboruan pozicionin e faktorëve të tyre politikë në lidhje me pavarësinë e Kosovës. Temat më të shpeshta që u përdorën nga media gjatë kësaj periudhe ishin zgjidhja e statusit të ardhshëm të Kosovës, dita (data) e shpalljes së pavarësisë dhe ndikimet e mundshme prej këtij veprimi në rajonin e Ballkanit, çështja e minoriteteve, reagimet e mundshme të Beogradit zyrtar, arg umente"pro"dhe"kundër"pavarësisë ashtu si edhe qëndrimet e SHBA, BE dhe Rusisë të cilat kishin ndikimin më të madh në rezultatin përfundimtar të rastit të Kosovës. Akti i shpalljes së Pavarësisë së Kosovës ishte ngjarja më e më rëndësishme mediatike në botë në atë kohë. Kjo u vërtetua prej faktit se"lindja e një shteti të ri"u transmetua në mënyrë të drejtpërdrejtë nga shumë media rajonale e botërore dhe u shndërrua në kryeartikull të faqes së parë për mjaft nga gazetat në rajon e në botë.

3 SEE perdoret per South East European.

4 Radojkoviic, M dhe Stojkovic, B (2004) Informaciono-Komunikacioni sistemi, Beograd: CLIO

Ndërmjet shtetit "të porsalindur" dhe shpërbërjes të Serbisë

Pas krijimit të Misionit të OKB në Kosovë në bazë të parimeve të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244[5], statusi i ardhshëm i Kosovës u vendos në një "proces politik" të papërcaktuar qoftë në kohë apo në përmbajtje. Duke pasuar krijimin e UNMIK, komuniteti ndërkombëtar iu qas kësaj çështje në mënyrë shumë të kujdesshme duke u përqendruar tek formula "standartet para statusit". Por trazirat e dhunshme të marsit 2005 në Kosovë çuan në një rishikim të këtij këndvështrimi për shkak të kërcënimeve serioze të destabilizimit të Kosovës dhe përhapjes së mundshme të konfliktit në rajon. Në maj të vitit 2005[6] SHBA ndërmorën një proces të ri me anësi e përpjekje të njohura drejt një zgjidhje më të shpejtë për statusin e Kosovës. Në bazë të një rivlerësim i të plotë të situatës në Kosovë që iu paraqit Këshillit të Sigurimit nga Kai Eide i dërguari i posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB, në tetor 2005, u krijuan parakushtet formale për të shpallur procesin e përcaktimit të statusit të ardhshëm të Kosovës. Ky proces i ri tashmë do të vazhdonte nën drejtimin e OKB nëpërmjet emërimit nga ana e saj –së të dërguarit të posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB, z. Marti Ahtisari. Megjithatë ky proces politik që përfshiu në negociata të drejtpërdrejta Beogradin dhe Prishtinën rezultoi në një përfundim të ditur ku nuk u arrit asnjë kompromis mes të dy vendeve. Beogradi dhe Prishtina qëndruan në pozicionet e tyre e nuk treguan asnjë shenjë se mund të arrinin ndonjë kompromis të mundshëm. Gjatë negociatave, Beogradi tregoi vullnetin për të bërë ndonjë kompromisi duke përfshirë edhe një autonomi më të lartë për Kosovën por pala tjetër mbeti e palëkundur në qëndrimin e tyre duke argumentuar se Kosova duhet të ketë pavarësinë e saj.

Në raportin e paraqitur në Këshillin e Sigurimit më 26 mars 2007[7], Ahtisari vlerësonte se të dyja palët nuk dëshmuan vullnetin e mjaftueshëm për të arritur një kompromis e për këtë arsye të gjitha mundësitë për diçka të tillë tashmë ishin kapërcyer. Propozimi i Ahtisarit përmbante konkluzionin se "i vetmi opsion i mundshëm është një pavarësi e mbikëqyrur nga komuniteti ndërkombëtar". Për më tepër plani i Ahtisarit vërente se pavarësia e Kosovës nuk buron e nuk përbën ndonjë precedent, kështu që shembulli i saj nuk do të jetë i tillë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tjera të këtij lloji në nivel ndërkombëtar[8]. Në këtë drejtim SHBA dhe vendet kryesore të BE ishin të pritura ta paraqisnin pavarësinë e Kosovës si një shembull "unik" e që nuk mund të përdorej për rajone të tjera në botë. Nga ana tjetër Rusia u mbështet në mënyrë të fuqishme nga Serbia në përpjekjet e saj për të dëshmuar se pa-

5 Gjwndet http://daccessdds.un.org/doc/UNDOC/GEN/N99/172/89/PDF/N9917289.PDF?OpenElement [07.07.2008]

6 Gjendet ne http://www.unosek.org/docref/KaiEidereport.pdf[07.07.2008]

7 Raporti i te Derguarit te Posacem te Sekretarit te Pergjithshem te OKB-se mbi statusin e ardhshem te Kosoves.Gjendet ne http://www.unosek.org/docref/report-english.pdf [07.07.2008]

8 Propozimi i plote per Zgjidhjen e Statusit te Kosoves, Gjendet ne http://www.unosek.org/docref/Comprehensive_proposal-english.pdf [07.07.2008]

varësia e Kosovës përbënte një dhunim të plotë të së drejtës ndërkombëtare dhe se ky precedent do të zbatohej në mënyrë të menjëhershme në shtete e rajone të tjera të botës. Kjo nënkuptonte se shpallja e pavarësisë së Kosovës pavarësisht kundërshtimit të Beogradit do të shkaktonte një reagim zinxhir në rajon, duke provokuar një sërë pretendimesh për pavarësi nga shqiptarët në Maqedoni dhe Serbinë Jugore si edhe shkëputjen e Republikës Srpska nga Bosnja dhe Hercegovina.

Mbështetësit kryesorë të pavarësisë, SHBA dhe vendet kryesore të BE po nxitonin drejt një zgjidhje sa më të shpejte dhe ishin kundër çdo zgjatje të mëtejshme të procesit, pasi ata argumentonin se kjo mund të shpinte drejt një radikalizimi të kërkesave për pavarësi e në këtë kuptim sillte destabilizim të rajonit. Por pavarësisht nga ky arsyetim, Rusia kërcënonte se do të përdorte veton ndaj çdo rezolute të paraqitur në Këshillin e Sigurimit të OKB për të cilën Beogradi nuk ishte dakord. Në vijim të këtij qëndrimi Rusia kundërshtoi projekt-rezolutën e paraqitur në maj 2007 nga SHBA e BE në Këshillin e Sigurimit të OKB-së e cila ishte në favor të planit Ahtisari dhe hapte rrugën për pavarësinë e Kosovës.

Përballë kësaj këmbëngulje të Rusisë, SHBA e BE ranë dakord që të zgjasin negociatat mes Prishtinës e Beogradit por vetëm për një afat të kufizuar kohor prej 120 ditësh. Duke gjykuar sesi kishin rrjedhur ngjarjet që në fillim ishte më se e qartë se dyja palët nuk prisnin ndonjë kompromis apo zgjidhje të dyanshme. Paralajmërimi i Rusisë se do të përdorte të drejtën e saj të vetos në Këshillin e Sigurimit çoi tek nocioni se do të kishte një shpallje të njëanshme të pavarësisë në bashkëveprim me SHBA e BE. Kjo nënkuptonte se pas deklaratës për shpalljen e pavarësisë, Kosova do të vazhdonte më tej e do të kërkonte një njohje të njëanshme të pavarësisë nga shtetet e tjera.

Më 17 shkurt 2008, Kosova shpallë pavarësinë. Pavarësia e Kosovës, duke përfshirë edhe njohjen e saj, mendohet se shënon fundin e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë dhe garanton një stabilitet afatgjatë e hap rrugën drejt integrimit Euro-Atlantik të gjithë rajonit të Ballkanit Perëndimor. Pritet që BE të përpiqet që ta bëjë të qëndrueshme klimën politike në rajon duke pasuar pavarësinë e Kosovës, por gjithashtu ato do të përpiqen të me merren me pakënaqësinë në rritje të Serbisë e të bëjnë përpjekje serioze në drejtim të forcimit të perspektivës Evropiane të rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Lidhjet e rrezikshme- shqetësimet rajonale për Kosovën

Vendet e përfshira në këtë hulumtim ishin në një pozitë shumë delikate për sa i përket njohjes së pavarësisë së Kosovës. Së pari, për shkak të prirjes që të përputheshin me pozicionin e SHBA e BE i cili nënkuptonte njohje të pavarësisë. Së dyti ruajtja e marrëdhënieve të mira me Serbinë duke patur parasysh se Serbia kishte kërcënuar me masa diplomatike kundër çdokujt që do të njihte pavarësinë e Kosovës. Ndërkohë një problem shtesë për vendet në rajon (Shtetet anëtare të BE apo vendet kandidate për në BE) përbënte fakti se

BE nuk arriti të garantonte një qëndrim të unifikuar në lidhje me njohjen e pavarësisë së Kosovës. Një pakicë shtetesh të BE kundërshtuan haptazi pavarësinë, duke u mbështetur në argumente ligjore të së drejtës ndërkombëtare për këtë veprim. Për shkak të këtyre arsyeve, BE rekomandoi që çdo vend duhet të vendoste në mënyrë individuale mbi këtë çështje. Në këtë mënyrë,vendet e përfshira në këtë studim mund të ndahen në 3 grupe.

Grupi i parë përbëhet nga vende që morën një rol aktiv e ishin drejtpërdrejt të përfshira në zgjidhjen e statusit të Kosovës të tilla si Serbia, Shqipëria dhe Sllovenia. Vende të tilla si Rumania, Moldavia, Bosnja dhe Hercegovina që ishin drejtpërdrejt të shqetësuara për zgjidhjen e çështjes së Kosovës për shkak të pranisë së minoritete në vendet e tyre bëjnë pjesë në grupin e dytë. Në këto vende ekzistonte frika se njohja e pavarësisë së Kosovës mund të shkaktonte një precedent në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe mund të rrezikonte sovranitetin e integritetin e tyre territorial. Rumania e Moldavia në planin e brendshëm politik karakterizoheshin nga një qëndrim i fortë kundër njohjes së pavarësisë së Kosovës duke theksuar se duhet të respektoheshin parimet e së drejtës ndërkombëtare ndërsa në Bosnje dhe Hercegovinë kjo çështje praktikisht u bllokua për shkak të grupimit politik serb. Në grupin e tretë ndodheshin Bullgari, Hungari, Kroacia, Maqedonia dhe Mali i Zi, vende të cilat ishin mbështetëse të përmbajtura të pavarësisë së Kosovës. Këto vende nuk ishin drejtpërdrejt të përfshira në procesin e zgjidhjes së çështjes së Kosovës dhe nuk ishin drejtpërdrejt të interesuara për këtë problem. Duke qenë se ishin të kujdesshëm në lidhje me marrëdhëniet me Serbinë ato nuk ndërmorën një qëndrim kategorik për sa i përket zgjidhjes së statusit përfundimtar të Kosovës. Megjithatë përkrahja e tyre implicite mbështetej në pranimin e planit Ahtisari si një model unik realist për zgjidhjen e statusit të Kosovës ashtu si edhe të bashkërendimit të politikës së tyre të jashtme me BE dhe SHBA.

Përmbledhje e qëndrimeve politike rajonale drejt Kosovës

Në procesin e zgjidhjes së statusit të ardhshëm të Kosovë, Serbia e ka ndërtuar qëndrimin e saj mbi faktin e njohur të shpalljes së pashmangshme të pavarësisë së Kosovës por edhe me mbështetjen e palëkundur të Rusisë në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. I vetëdijshëm për hapësirën e kufizuar që të manovronte, Beogradi u përpoq me të gjitha mënyrat që të zgjaste më tej negociatat. Në këtë kuadër, Beogradi përdori të gjitha mekanizmat e mundshëm duke përfshirë miratimin e Kushtetutës së re në 2006, zgjedhjet e parakohshme parlamentare në 2007, zgjedhjet presidenciale në janar 2008 ashtu si edhe miratimin e pak rezolutave parlamentare për të ruajtur deri në fund sovranitetin shtetëror dhe integritetin territorial. Në këtë drejtim Beogradi dëshmoi unitetin më të fortë politik kundër pavarësisë së Kosovës.

Komuniteti ndërkombëtar duke u përpjekur të ndalonte fuqizimin e radikalëve dhe trazirave të brendshme politike, të nxitura nga një vendim i mundshëm që nuk shkonte në favor të tyre, e shtyu disa herë vendimin përfundimtar me qëllim të ndihmonte në krijimin e qeverie pro-evropiane e të

qëndrueshme në Serbi. Siç pritej, Beogradi e kundërshtoi menjëherë vendimin "e paligjshëm" për shpalljen e njëanshme të pavarësisë së Kosovës. Pas shpalljes së pavarësisë, një ndër aktivitetet kryesore diplomatike të Serbisë ishte parandalimi i njohjes ndërkombëtare të shtetit të ri të Kosovës. Në vijim të këtij synimi, Beogradi vazhdoi në mënyrë intensive aktivitetin e tij diplomatik për të ndalur në çdo mënyrë të mundshme njohjen e mëtejshme nga komuniteti ndërkombëtar të pavarësisë së Kosovës. Përgjatë gjithë këtij procesi, Shqipëria e mbështeti në mënyrë të fortë e të vazhdueshme pavarësinë e Kosovës. Menjëherë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, Shqipëria e njohu atë dhe vendosi marrëdhëniet diplomatike me Kosovës duke theksuar njëkohësisht se nuk do të kishte asnjë bashkim mes Shqipërisë dhe Kosovës. Kjo pakësoi shqetësimet se pavarësia e Kosovës do të çonte në krijimin e "Shqipërisë së Madhe". Nga ana tjetër Tirana zyrtare theksoi se është në interesin e saj ruajtja e marrëdhënieve të mira me Serbinë nën frymën e miqësisë dhe marrëdhënieve të mira rajonale.

Në këtë periudhë, Slloveni u shndërruar në një ndërmjetës aktiv të negociatave mbi Kosovë. Ky rol i veçantë i Sllovenisë buronte prej pozicionit të saj brena BE teksa ishte në krye të presidencës së radhës të këtij organizimi por edhe për shkak të afërsive gjeografike e lidhjeve politiko-historike me çështjen e Kosovës. Menjëherë pas shpalljes së pavarësisë, Sllovenia ishte ndër vendet e para të ish – Jugosllavisë që e njohu atë.

Rumania ndërmori një qëndrim të qartë kundër pavarësisë së Kosovës. Ky qëndrim buronte nga frika e një zbatimi të mundshëm të rastit të Kosovës në Transilvaninë Rumune ku jeton një numër i konsiderueshëm i minoritetit hungarez, ashtu si edhe për shkak të lidhjeve të mira tradicionale mes Rumanisë e Serbisë. Ky pozicion u përforcua në mënyrë të qarë kur Parlamenti rumun miratoi një deklaratë kundër shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës. Përmbajtja e këtij dokumenti e vlerësonte këtë akt si një precedent në nivel rajonal e ndërkombëtar.

Gjithashtu edhe Moldavia mori një qëndrim kundër njohjes së pavarësisë së Kosovës për shkak të frikës që ndjente se rasti i Kosovës mund të përdorej për të zgjidhur probleme të ngjashme në Republikën e kontestuar të Transdnistrias. Njëkohësisht autoritetet moldaviane shprehnin shqetësimin e tyre të thellë rreth mbështetjes nga shumë shtete anëtare të OKB-së lidhur me aktin e shpalljen së pavarësisë. Moldavia megjithëse pranonte se çështja e Kosova ishte një rast i veçantë e konsideronte një dhunim arbitrar të integritetit të Serbisë dhe një faktor serioz për destabilizimin e Evropës dhe nxitës të rrezikshëm për lëvizjet separatiste në zonat në konflikt. Qëndrimi i ardhshëm i Moldavisë lidhur me Kosovën varet nga ai i Serbisë, dispozitat e Kartës së Helsinkit, Karta e OKB-së dhe nga të gjitha parimet e tjera të së drejtës ndërkombëtare.

Bosnja dhe Hercegovina ndodhet në një pozicion shumë të ndërlikuar për sa i përket njohjes së pavarësisë së Kosovës, për shkak se një vendim i tillë mund të ketë ndikim mbi stabilitetin e saj të brendshëm politik. Bosnje

dhe Hercegovina është e ndarë mes blloqeve politikë e territoriale boshnjak e kroat që mbështesin pavarësinë e Kosovës nga njëra anë dhe ato serbe që mbrojnë me vendosmëri mosnjohjen e pavarësisë së Kosovës. Duke patur parasysh se Bosnja dhe Hercegovina nuk mund të ndërmarrë një vendim për të njohur pavarësinë e Kosovës pa konsensusin e domosdoshëm mes 3 palëve politike në vend, është e pritshme që Bosnja do të qëndrojë për një kohë të gjatë e ndrydhur lidhur me këtë çështje.

Ndërkohë Bullgaria shprehu mbështetje të fortë ndaj planit Ahtisari si një model për zgjidhjen e statusit të Kosovës e cila gjithashtu nënkuptonte një përkrahje për pavarësinë e ardhshme si një status përfundimtar. Por Bullgaria theksoi mes të tjerave se është e rëndësishme për të qenë të kujdesshëm e për të mos ndërmarrë hapa të parakohshëm në procesin e zgjidhjes së statusit të Kosovës e shprehu edhe mbështetjen e saj për integrimin e Serbisë në BE

Hungaria dëshmoi një konsensus në planin e brendshëm politik lidhur me njohjen e pavarësisë së Kosovës dhe është për një integrim akoma më të shpejtë të Serbisë në strukturat Euro-Atlantike si edhe për vazhdimin e marrëdhënieve të mira dypalëshe.

Mali i Zi ka deklaruar se në lidhje me njohjen e pavarësisë së Kosovës ai do të ndjekë interesat e tij kombëtare dhe qëndrimin e BE. Duke patur parasysh se opozita pro-serbe në Malit të Zi është kundër vendimit për njohjen e pavarësisë si edhe ndikimit të fortë të kapitalit Rus në këtë vend, është e pritshme që qeveria e Malit të Zi do të luajë në mënyrë taktike në lidhje me këtë çështje.

Nga ana e saj Kroacia ka deklaruar se do të ndjekë pozicionin e shumë vendeve anëtare ë BE në lidhje me Kosovën. Në të njëjtën kohë, faktorët politikë në Kroaci janë duke u përpjekur ta paraqesin këtë veprim jo në mënyrë të domosdoshme si diçka kundër Serbisë e që nuk nënkupton armiqësi mes tyre. Menjëherë pas njohjes së pavarësisë, Zagrebi zyrtar vendosi regjimin e vizave për qytetarët e Kosovës.

Pozicioni i Maqedonisë lidhur me njohjen e pavarësisë së Kosovës mbështetet në qëndrimet e BE dhe SHBA por duke marrë në konsideratë edhe interesat e saj kombëtare. Duke patur parasysh se ky lloj qëndrimi gëzon në një unitet politik në planin e brendshëm, njohja e pavarësisë së Kosovës nuk duhet të ketë një ndikim negativ në marrëdhëniet shumetnike në Maqedoni. Megjithatë çështja e përcaktimit të vijës së kufirit shtetëror mes të dy vendeve është vlerësuar si një parakusht e për këtë arsye është përfshirë edhe në Planin Ahtisari. Tashmë është e ditur se pas formimit të qeverisë së re në Maqedoni, ky vend do të marrë një vendim lidhur me njohjen e pavarësisë së Kosovës. Nga ana tjetër mund të pritet që ky veprim të shoqërohet nga një deklaratë të cilën njohja e pavarësisë së Kosovës nuk konsiderohet si një akt kundër Serbisë dhe se Maqedonia i shikon me një përparësi të madhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë me Serbinë.

SISTEMET E MEDIAS NË VENDET ANËTARE TË SEENPM (Rrjeti i Europës Juglindore për Profesionalizmin e Medias)

Ndërmjet oksigjenit të demokracisë, gazit qeshës të dëfrimit dhe shfrytëzimit komercial[9]

Këto dy realitete formësojnë pejsazhin e medias në vendet e EJL dhe përmbledhin pritshmërinë dhe rezultatin e tranzicionit të saj. Në dekadat e fundit, mediat kanë kaluar përmes shumë ndryshimeve strukturore. Jakubowicz identifikon 8 procese (të cilat plotësojnë dhe vijnë në kundërshti me njëra tjetrën) ndryshimi në sistemet e mediave të tyre: çmonopolizimin dhe (pjesërisht) rimonopolizimin, komercializimin e medias, ndryshim për sa i përket lirisë dhe pavarësisë së medias, demokratizim, pluralizëm dhe diversitet, profesionalizmin e gazetarëve, zhvillimin e shërbimit të transmetim publik dhe ndërkombëtarizimin.[10]

Për sa u përket këtyre proceseve sistemet e mediave në EJL kryesisht ndajnë të njëjtin fat. Nga një anë media palët kundërshtare politike duke iu bashkuar këtyre aleancave nga lidhjet tradicionale prej sistemeve të mëparshme politike. Nga ana tjetër ato janë të përfshira në një rrjedhë post –transitore politiko-ekonomike mes (kryesisht) kapitalit të huaj dhe interesave politike. Sa më shumë ecën përpara shndërrimi i saj aq më shumë sfera e medias ndikohet nga forcat komerciale.

Në të dyja mënyrat ndeshen probleme të shumta. Së pari është problemi mbizotërues që lidhet me pronësinë e medias dhe pavarësinë e saj. Standartet profesionale të gazetarisë deklarohen shpesh si të domosdoshme nga pronarët e medias por kapaciteti i medias përdoret si një mjet kundër ose për presion politik me qëllim që të përfitohen rezultate "jo-media". Për ketë arsye, shteti, organizatat politike dhe qendrat ekonomike të pushtetit në mënyrë të vazhdueshme konkurrojnë mes tyre për të shtrirë ndikimin në fushën e medias. Së dyti, tregjet e medias janë të "mbipopulluara" dhe përballen me një konkurrencë të lartë për të ardhurat nga reklamat që e zvogëlon pjesën e tyre në treg. Si rrjedhojë kapaciteti i tyre financiar zvogëlohet dhe kjo pasohet me pakësim të burimeve njerëzore, bjerrje të parimeve profesionale të gazetarisë, rrezikim të drejtave të punës në fushën e medias[11], si edhe autonomi të korruptuar editoriale etj. Ashtu sikurse pohon Edward Herman "redaksitë po përfshihen gjithnjë e më shumë në perandoritë e korporatave ndërkombëtare, me buxhet të shkurtuar dhe me një entuziazëm gjithnjë e më të pakët për gazetarinë hulumtuese që duhet të sfidojë strukturën e pushtetit. Me një fjalë, autonomia profesionale e gazetarëve po zvogëlohet"[12]. Sistemet e tjera të medias janë subjekt (pjesërisht) i rimonopolizimit ku pronësia e mediave më të suksesshme është e përqendruar kryesisht në duart e kapitalit të

9 Fjale hyrese ne vepren e Karol Jakubowicz"Post-Communist Development Media in Perspective"qe gjendet ne http://library.fes.de/pdf-files/id/02841.pdf[08/06/2008]

10 *Ibid*.p.6

11 LABOR RELATIONS AND MEDIA: Analyzing patterns of labour relations in the media of SEENPM member countries. Gjendet ne: http://www.ijc.md/eng/index2.php?option=com-content&do_pdf=1&id=157[8.07.2008]

12 Herman, E.S(2002) The Propaganda Model: A Retrospective. In D.Mcquail(Ed). Mcquail's reader in Mass Communication Theory(pp.61-67),London: Sage Publications

huaj. Në të dyja rastet presioni për sukses ekonomik, interesat e reklamuesve dhe shpenzimet e mëdha që kërkon gazetaria hulumtuese çojnë drejt mbizotërimit të senzacionalizmit (bujshmërisë) dhe informacionit "të sheqerosur". Këto procese hapin një pasqyrim negativ mbi gazetarinë informative dhe po krijohen në praktikën e medias rajonale tashmë si rregull e jo si përjashtim.

Paralelizmi i medias është një problem tjetër më të cilët po ndeshen sistemet e mediave. E mbështetur në barrierat gjuhësore e etnike ajo krijon thyerje të realiteteve të ndërtuar nga media dhe fut stereotipat dhe paragjykimet në debatin publik. Për sa i përket faktit se dimensioni shumëkulturor e etnik i rajonit përhap shumë procese çintegruese, ky aspekt i praktikës së medias është me shumë rëndësi. Relevanca e kësaj çështje buron më së shumti prej qasjes së përbashkët të medias së rajonit drejt përmirësimit të shumësisë etnik e kulturor duke krijuar më shumë një përmbajtje mediatike më tepër përjashtuese sesa përfshirëse që thekson vetëm identitetet etnike.[13] Për këtë qëllim ndaj këtyre faktorëve nevojitet një përgjigje serioze.

Të gjitha këto tendenca ndikojnë thellësisht qoftë në prodhimin formal apo edhe në përmbajtjen e teksteve të medias. Megjithëse janë arritur përmirësime të ndjeshme në fushën e profesionalizmit të medias duket sikurse në vallet folklorike të rajonit hidhet një hap para e dy hapa mbrapa.

KONKLUZIONE TË STUDIMIT

Hyrje në metodologji.

Metodologjia bazë e përdorur në këtë studim është një analizë sasiore e artikujve të shkruar në gazeta përgjatë periudhës të deklarimit të pavarësisë së Kosovës. Elementët e kësaj metode ofrojnë rezultate që dëshmojnë kryesisht tiparet formale të artikujve. Ndryshorët e analizës i referohen vendndodhjes së tekstit, llojit të tij, autorit, llojit të burimit, përmbajtjes rastësisë në test dhe përqindjes ndërmjet elementëve të pasqyrimit të lajmit dhe përmbajtjes së artikullit. Kjo qasje përqendrohet mbi teknikat e produktit gazetaresk, politikën editoriale dhe rezultatin e përcaktimit të axhendës. Në vartësi të parapëlqimeve analitike individuale, konkluzionet e studimit janë pasuruar me metoda shtesë duke përfshirë aspekte të ndryshme të mbulimit nga media të kësaj ngjarje dhe duke plotësuar aspektin cilësor të kërkimit.

Metoda sasiore e analizës së përmbajtjes u përzgjidhe për arsye se bënte të mundur krahasimin në mënyrë empirike të rezultateve nga raporte të ndryshme. Zbatimi i analizës së përmbajtjes, në rastin e mbulimit nga media të një ngjarjeje, ofron bazat për identifikimin dhe vlerësimin e standarteve për produktin gazetaresk Kufizimet e kësaj metode janë kapërcyer nga përdorimi i metodave të tjera të tilla si imagjinata krijuese, analiza e ligjërimet, etj.

13 Hrvatin S., Thompson M and Jusiç T(eds)(2008) RAZJEDINJENI PROPADAJU Javni radio-televizjski servisi u multiethnickim drzavama, Sarajevo: Mediacentra,pp.27

Përzgjedhja e kritereve për analizën gazetave përfshinte aspekte të ndryshme të tilla si afria politike apo etnike e gazetës, politika editoriale, qarkullimi i përditshëm dhe ndikimi mbi lexuesin. Fakti që këto kritere janë ndërthurur tek raportet e ndryshme që kanë paraqitur raste studimi na mundëson një këndvështrim të larmishëm për të kuptuar tekstin e analizuar.

Interesi i medias në Kosovë

Në përgjithësi çështja e Kosovës tërhoqi vëmendjen e duhur sipas domethënies së saj politike. Denduria e mbulimit të kësaj ngjarje nga ana e medias u pasua nga kronologjia e ngjarjeve duke arritur kulmin në ditët kur u shpall pavarësia. Është e kuptueshme që më tej interesi i medias të vendeve në fjalë filloi të bjerë gradualisht për këtë çështje. Si rrjedhojë në vendet fqinjë me Kosovë u evidentua një mesatare domethënëse prej 15 artikujsh për edicion ndërkohë që vendet e tjera të rajonit kjo shifër ishte disa herë më e vogël.

Megjithatë ky konkluzion ka disa veçori që duhen vënë në dukje. Kryesisht ka patur një ndarje për sa i përket vëmendjes së medias lidhur me këtë ngjarje që është përcaktuar nga dy elementë: sfondi etnik i lexuesit (shpesh i lidhur me një bindje politike) dhe klima politike (qëndrimet e autoriteteve shtetërore). P.sh në Serbi analizat u përqendruan në dy të përditshme, njëra me tirazhin më të madh në vend, dhe një e përditshme e minoritetit Hungarez. Gazeta e parë ka një lexues i cili karakterizohet nga ndjenja të forta tradicionale e kulturore ndaj Kosovës ndërsa për sa i përket gazetës tjetër lexuesit e saj nuk kanë ndonjë identitet lidhur me pretendimet ndaj kësaj çështje. Duke patur parasysh se kishte shumë artikuj që flisnin për Kosovën[14], sai përket i tekstit të lajmit në faqe të parë (rreth periudhës kur po shpallej pavarësia) Kosova përmendej rëndom, ndërkohë që lidhur me këtë çështje iu dha prioritet pothuajse rreth 20% të artikujve në rubrikat e lajmeve të së përditshmeve Hungareze PS ato fillonin apo edhe titujt e gazetave në faqe të parë ishin të lidhura me këtë ngjarje.

Kjo situatë ishte pranishme edhe në raste të tjera ku çështja e minoriteteve ishte e ndjeshme. Nga ana tjetër, për sa i përket qëndrimeve politike, ndërkohë që çështja mbahej e fshehtë në Serbi, media shqiptare në mënyrë të vazhdueshme vinte theksin tek aspekte të ndryshme të situatës në Kosovë. Përballë zgjedhjeve presidenciale në Serbi dhe traumës kolektive të kombit, Kosova u la mënjanë si një ndër temat kryesore të debatit publik. A përbënte Kosova një çështje të nxehtë që të vendosej në zjarrin e debatit elektoral dhe të përcaktohej si një prioritet i pritshëm i votuesve ?

Qëndrimi politik shqiptar në drejtim të Kosovës,megjithëse i analizuar si"pragmatik dhe vetë-përmbajtës", ishte e pamundur që të mbetej indiferent. Si rrjedhojë media i dha një rëndësi shumë të madhe rastit të Kosovës në të dyja aspektet: paraqitjen si lajm në faqe të parë dhe mbulim të gjithan-

14 381 artikuj u botuan ne gazetem Dnevnik Daily qe trajton ceshtje te lidhura me Kosoven perkunder 138 artikujve qe u evidentuan ne te perditshmen e minoritetit hungarez.

shëm nga ana e saj. A ishte simpatia etnike e politike dhe shoqërisë civile shqiptare që nxiti një mbulim kaq të gjerë? Nga ana tjetër, në Mal të Zi interesi i lartë i medias ishte i pranishëm vetëm tek të përditshmet pro-serbe të cilat synonin shumicën e konsiderueshme serbe që jeton në këtë vend si edhe në të njëjtën kohë nuk ishin të ndrydhur nga kalendari politik. Përqindja ndërmjet numrit të artikujve dhe lajmeve në faqe të parë dëshmon në mënyrë të dukshme, ndikimin e përcaktorëve të sipërpërmendur në të dyja rastet (minoritetet etnike dhe qëndrimet zyrtare politike). Gjithashtu kahje të ngjashme janë të pranishme edhe për vendet e tjera fqinje. Në Maqedoni përqindja e numrit të artikujve që raportonin mbi Kosovën është 4 herë më e ulët në raport me të përditshmet në gjuhën Maqedonase. Këtu hendeku ishte i dukshëm jo vetëm në nivelin e përcaktimit të axhendës, por në interesin e përgjithshëm të medias për këtë rast, megjithëse ai kishte një rëndësi të madhe politike për vendin. Sërish, qëndrim politik i kujdesshëm dhe i tërhequr i zyrtarëve maqedonas përputhet me qasjen e ndrydhur editoriale në mediat maqedonase. Nga ana tjetër situate në median në gjuhën shqipe në Maqedoni është krejtësisht e kundërt.

Ndërsa qëllimi i këtij studimi lëviz nga Kosova dhe fqinjët e saj të afërm, përcaktuesit e mbulimit nga media të kësaj ngjarje nisin të ndryshojnë. Në rrethanën e re të krijuar nga mungesa e afërsisë etnike të lexuesit si edhe ndikimi jo i drejtpërdrejtë politik, numri i artikujve rreth kësaj çështje fillon të zvogëlohet në secilin prej shteteve i cili është marrë në shqyrtim. Kjo nuk do të thotë se politika editoriale në këto gazeta shmangu qasjet profesionale e të gjithanshme rreth kësaj çështje por në mënyrë të qartë vërehet shkalla e interesit dhe lidhja e saj me domethënien politike të Kosovës.

Zhanret- viktima të kërkesave të pamjaftueshme të produktit apo praktikë e medias të çlirët

Dallimi në shpërndarjen mujore të artikujve dëshmon se këto të përditshme duke përdorur më shumë llojet e zgjeruara dhe analitike të shkrimit e mbuluan situatën në Kosovë me një shkallë të vazhdueshme interesi përgjatë periudhës që u realizua ky studim. Nga ana tjetër gazetat për sa i përket anës së bujshme u përqendruan dhe intensifikuan vëmendjen e tyre në Ditën e Pavarësisë. Ky aspekt i fundit e formësoi çështjen e Kosovës në 3 pika: shpallja e pavarësisë, dita e mëpasme dhe protestat e dhunshme në Serbi.

Llojet më të shumta e të zakonta që u ndeshën gjatë këtij vëzhgimi e përbënin lajmet dhe lajmet e zgjeruara ndërkohë që analizat dhe raportet ishin shumë të rralla. Gjithashtu, komentet, kryeartikujt dhe editorialet nuk u përdorën në mënyrë të shpeshtë, me përjashtim të të përditshmeve shqiptare ku bëheshin të dituar që në faqen e parë. Llojet më të zgjeruara u vërejtën dhe janë karakteristike në periudhën kur çështja e Kosovës arriti kulmin dhe kryesisht duke u përqendruar në reagimin diplomatik të vendeve të tjera. Përdorimi i gjerë i deklaratave ishte një tipar i përbashkët i të gjithë gazetave që u analizuan përgjatë këtij studimi. Me përjashtim të pak të përditshmeve,

intervistat me opinionbërës (intelektualë, ekspertë, etj) u realizuan shumë rrallë. Ky nocion nxjerr në pah një aspekt shumë të rëndësishëm të mbulimit nga media të një ngjarje të caktuar dhe kjo është mungesa e debatit publik në Kosovë. Vetëm në disa raste të pakta politika editoriale ia arriti të realizojë një mbulim tërësor dhe nga këndvështrime të ndryshme duke botuar forma të larmishme shkrimesh të zhanrit të gazetarisë. Komercializimi i medias dhe reduktimi i kostove të produktit, ndikon tek shfaqja e formave të shkurtra, sensacionale e thjesht informative të lajmit që nuk kërkojnë shumë shpenzime, infrastrukturë e burime njerëzore e intelektuale. Nga ana tjetër është kërkesa e tregut për artikuj sa më të përmbledhur e të lexueshëm që përkrahin format e shkurtra e jo –gazetareske të shkrimit të lajmit. Për më tepër, agjencitë e lajmeve dhe deklaratat nga diplomatë dhe politikanë bëjnë të mundur përpunimin e shpejtë, të rrjedhshëm e pa shumë shpenzime të informacionit, e cila përbën një domosdoshmëri në raport me dinamikën e mbulimit të ngjarjeve nga media e sotme.

Rregulli i agjencisë së lajmeve!

Një nga elementët që dëshmon instrumentalizimin dhe keqpërdorimin e medias janë autorësia e panjohur dhe burimet e paidentifikuara. Në këtë drejtim numrat nga raportet janë shumë të keqorientuar e mund të japin një përshtypje të amatorizmi serioz gazetaresk. Nëse marrim në konsideratë praktikën e zakonshme të departamenteve e redaksive të lajmeve për të botuar përmbledhje të agjencive të lajmeve apo artikuj të ribotuar, përshtypja ndryshon në mënyrë rrënjësore. Megjithatë mund të themi se standartet profesionale të gazetarisë sa i përket autorësisë vërtetojnë "kundër-argumentin". Nëse ne i konsiderojmë këto fakte, atëherë ky aspekt i mbulimit të medias ishte në përputhje me standartet e praktikës së një media të mirë, për sa kohë shumica e artikujve citohet apo interpretohen në mënyrë të saktë burimet dhe mundësohen këndvështrime të ndryshme mbi çështjet. Së pari kjo larmi vjen në kundërshtim me politikën e ndryshuar editoriale të përmendur më sipër, por është mungesa e autorëve nga fusha të ndryshme të jetës publike që prodhojnë këndvështrime të thjeshtuara apo të njëanshme dhe jo numri i burimeve brenda tekstit. Një praktikë shumë e morë por e rrallë nga ana e medias është realizuar nga gazeta e përditshme serbe "Blic" kur botoi të plotë të gjithë dokumentin e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës. Nëpërmjet kësaj mënyre botuesit e kësaj gazete kaluan përtej interpretimeve të ngurta, të trashëguara e të njëanshme të pseudo-ngjarjeve dhe i ofruan lexuesit një pamje të qartë të realitetit në rajon. Konkluzioni i përgjithshëm në këtë rast tregon se ndërsa gazetarët kanë dëshmuar profesionalizëm kanë qenë kryesisht botuesit përgjegjës për njëtrajtshmërinë e llojeve të shkrimeve të botuara dhe përzgjedhjen e ngushtë të autorëve.

Në përgjithësi Kosova u portretizua nga media kryesisht nëpërmjet këndvështrimeve të lajmeve të mediave të huaja dhe deklaratave politike zyrtare. Informacioni i ofruar prej këtyre burimeve ishte dhe është i paplotë, i shkurtër dhe i jo i gjithanshëm. Për më tepër, për shkak të ndjeshmërisë

së kësaj çështje, përveç ligjërimeve politike mbizotëruese (pro dhe kundër) shumë interpretime të tjera u debatuan fare pak. Shtetet, zyrtarët, përfaqësuesit ndërkombëtarë etj ishin të tërhequr e të kujdesshëm për të mos prekur ndonjë çështje shumë delikate. Kjo situatë e zvogëloi praninë e burimeve të reja të cilat u reduktuan në pseudo-ngjarje politike. Nëpërmjet këtij veprimi, mbulimi nga ana e medias i kësaj çështje anashkaloi shumë ngjarje të përditshme sociale, histori të spikatura dhe këndvështrimin nga brenda të Kosovës dhe kosovarëve në përgjithësi.

Mbizotërimi i pseudo-ngjarjes

Mbizotërimi i burimeve joautentike të lajmeve, mungesa e korrespondentëve dhe reporterëve, qëndrimet e rezervuara politike dhe llojet e shkrimeve të shkurtra jo-gazetareske, sollën si rrjedhojë tabuizimin e sferës së brendshme të Kosovës për ngjarjet. Shumë artikuj mbuluan ngjarje të vërteta, por një numër domethënës prej tyre iu referuan pseudo-ngjarjeve. Gazetat aktualisht përmbanin reportazhe mbi ngjarjet, gjëra që kishin ndodhur, e që nuk ishin bërë për tu mbuluar nga media. Pseudo-ngjarje janë saktësisht ato– një ngjarje apo aktivitet që ekziston për qëllimin e vetëm që të zgjojë publicitetin e medias dhe i shërben pak apo nuk ka asnjë funksion në jetën e përditshme.[15] Konferencat e shtypit, njoftimet për shtyp, deklaratat janë shembuj të qartë të këtij lloji të ngjarjeve. Mesazhi që ato përcjellin përfaqëson interesat e autorit të pseudo ngjarjes(organizata politike, individi, etj). Bërthama e saj informative është lehtësisht e kuptueshme dhe krijon iluzionin ndërmjet lexuesit për një kuptim të plotë të situatës. Duke patur parasysh se ajo përdoret lehtësisht për të forcuar më tej reputacionin, publicitetin apo për të nxjerrë në pah versionin e dëshiruar të ngjarjes politike, mund të arrimë në përfundimin se ndikimi i vazhdueshëm politik ishte i pranishëm në mbulimin nga media.

Titujt janë elementi bazë i çdo artikulli. Ato zënë një vend të rëndësishëm në metodën e analizës së përmbajtjes pasi që përmbledhin mesazhin e artikullit: ato bëjnë thirrje nga pikëpamja emocionale dhe nga ajo informative janë orientues. Mesazhi që fton lexuesin drejt tekstit mund të prodhojë një lexues të paqartë të manipuluar me padije totale e njohuri shumë të mangëta. Prandaj përqindja mes transmetimit të lajmit dhe tekstit ishte subjekt i analizës. Të gjitha ndërhyrjet pasqyrojnë ndërveprimin e ekuilibruar e logjik mes titullit, nëntitullit dhe paragrafit ashtu si edhe marrëdhëniet informuese ndonjëherë duke nxjerrë në pah marrëdhëniet me artikujt. Funksioni i vendosjes, shpalljes, identifikimit, shpjegimit u përdorën në mënyrën e duhur sa i përket formës së zhanrit.

Elementi pamor

Përdorimi i reklamave pamore –grafike është i kënaqshëm. Zhvillimi i ngjarjeve u ndoq prej përdorimi mbizotërues të fotografisë.Në shumë artikuj që i

15 Boorsti J.Daniel(1992) *The Image: A Guide to Pseudo-Events in America*, 1st Vintage Book:New York

kushtoheshin ngjarjeve të ardhshme, lëvizjeve diplomatike që po aviteshin apo interpretimit të deklaratave apo agjencive të lajmeve, fotografia është formale dhe përfaqëson burimin. Në rastin e gazetave të përditshme serbe, u përdorëm shumë pak ilustrime duke ndjekur një politikën editoriale me profil të ulët lidhur me paraqitjen e lajmeve për "Kosovën". Ndërsa dinamika e ngjarjeve u përshpejtua dhe po afrohej Dita e Pavarësisë, ilustrimi u bë më dramatik e më sensacional. Ato vizatuan ngjarjet dhe ishin të pasuar sa i përket informacionit pamor duke nxjerrë shpesh në pah përmbajtjen e artikujve. Megjithatë si përfundimi reklamat pamore ishin të drejtpërdrejta, asnjanëse dhe jo të dykuptimta dhe rrallëherë kontradiktore.

Kosova nga jashtë vs Kosova nga brenda

Tiparet formale të artikujve të përmendura më sipër pa dyshim nënkuptonin se mbulimi i çështjes së Kosovës nga ana e medias ishte bërë duke anashkaluar realitetin e saj të vërtetë.Kosova u shikua, u raportua dhe interpretua nga këndvështrime të jashtme të burimeve të pakta mbizotëruese të informacionit, ku asnjëra prej të cilave nuk ishte mirëfilli nga Kosova. Ndërkohë kjo qasje është pjesërisht e arsyeshme në vendet që nuk janë prekur drejtpërdrejt nga situata në Kosovë, por ndërkohë është shqetësuese se e njëjta praktikë ndeshet edhe në vendet që janë fqinj me të. Në grupin e vendeve të para, ishin ngjarje të tjera ato që ishin trajtuar përmes lajmeve me vlerë (skandalet e korrupsionit, kundërshtitë e brendshme politike) sesa rasti i Kosovës. Më së shumti, Kosova u trajtua si pjesë e Serbisë duke e lidhur atë shpesh me zgjedhjet që po zhvilloheshin ndërkohë në këtë vend. Ajo çfarë mbizotëronte ishin subjektet politike dhe një numër shumë i pakët artikujsh që ofronin këndvështrime të thella sociale apo ekonomike, qasje historike dhe analiza kulturore apo të rastësishme të ngjarjeve të përditshme. Mbulimi nga media i marrëdhënie ndëretnike ishte pa njohuri apo shumë i njëanshëm. Rrallëherë, artikujt ofronin një pamje me të dy anët rreth këtyre ngjarjeve ndërkohë që edhe kur vendet e tjera raportonin, ato e bënin këtë nga pikëpamja e së drejtës për vetëvendosje e ndikimin e mundshëm të saj mbi minoritetet e tyre. Në mënyrë të përmbledhur, përmbajtja e përgjegjshme sociale e medias ishte shumë e rrallë dhe temat sa i përket sundimit të ligjit apo aspekteve të tjera ligjore në Kosovë përbënin një përjashtim. Nga jeta e përditshme ishin të mbuluara prej medias vetëm krimet për shkak të vlerës së tyre sensacionale. Si përfundim, ndikimi tërësor i medias ishte realiteti i padallueshëm social i Kosovës.

"INFORMACIONI SI MALL" - një përmbyllje e studimit

"Ndryshimi strukturor i sferës publike qëndron në themel të konsumit masiv dhe kapitalizmit korporativ."[16] Për më tepër, ai ndikoi thellësisht të dyja nënproceset e sferës së medias, prodhimin mediatik dhe "konsumin/receptimin" mediatik. Ndërkohë që ky ndryshim filloi në vendet perëndimore më shumë se 2 shekuj më parë, në vendet e EJL sapo kanë përfunduar fazat e

16 Habermas, Jurgen(1991). *The Structural Transformation of the Public Sphere, Cambridge, Massachusetts*: The MIT Press

tij fillestare. Ndërsa, media, botuesit dhe gazetarët në shoqëritë e tregut të "vjetër" që u përshtatën gradualisht me kërkesat e tregut, shndërrimi i shpejtë i"ish-bllokut kundërshtar" e përshtati këtë segment të prodhimit të medias në një mënyrë të përzier. Këto vende u përballën me sfidën për të zhvilluar politika sistematike të medias me qëllim që të riformësonin sistemet e medias. Jakubowitz zhvilloi pak modele të orientimit të sistemit të medias duke filluar që nga ai "mimetik" dhe "materialist" e deri tek ai "atavist". Këtu, si zakonisht, realiteti ishte një përzierje e transplantimit literal të modelit perëndimor (mimetik), privatizim të plotë e të menjëhershëm të medias (materialist) apo reminishenca të sistemeve të medias të ish-shtetit të mëparshëm (atavist)[17]. Mbi të gjitha, momenti thelbësor i "metamorfozës" ishte shndërrimi i nocionit të informacionit nga "zvogëlim i të pasigurtës" në një komoditet.

Kjo ndarje tek kuptimet buron nga procesi i pashmangshëm i "bashkëpërshtatjes", tepër i brendshëm për kulturën e konsumit ku çdo vlerë është rezultat i mallit dhe ndërveprimit të kërkesës. Në këtë ndryshim të madh, parapëlqimet individuale për informacion bëhen standarte për prodhimin e medias. Në "modelin e propagandës"[18], i cili gjen plotësisht zbatim në këtë rrethanë, interesi i reklamuesve dhe pronarëve të medias vepron si një përzgjedhës i informacionit realist e autentik. Në vendet e Evropës Juglindore censura e realizuar prej ministrive të informacionit dhe komiteteve të partisë tashmë ka marrë forma të reja më të stërholluara. Struktura e informacionit dhe përzgjedhja e përmbajtjes tashmë realizohen nëpërmjet burimeve të reja.

Miti i Shpellës

Kjo alegori e famshme u përdor nga Platoni[19] për të përshkruar situatën ku e vërteta "reale" është e prekshme vetëm nëse ne arrimë dhe kuptojmë iluzionet që na rrethojnë dhe e nxjerrim nga shpella që e mban të fshehur atë. Sa i përket rezultateve tërësore nga ky projekt, na duket me vend të zbatojmë këtë alegori në rastin e mbulimit nga media të rastit të Kosovës. Drita nga "dielli" (realiteti objektiv i ngjarjeve në Kosovë) është pakësuar dhe rishpërndarë nga shumë faktorë (agjencitë e lajmeve, departamentet e lajmeve, politikanët, diplomatët etj) dhe në fund ajo çfarë ne shikojmë (lexojmë) në fund të shpellës (realiteti i ndërtuar prej medias) janë disa hije të zbehta të botës së jashtme.

Me një fjalë, përfundimi mbizotërues nga analiza e përmbajtjes ishte se kryesisht mbizotëruan llojet e shkurtra e të përmbledhura të shkrimit gazetaresk përgjatë mbulimit nga shtypi të ngjarjeve të Kosovës. Ato buruan prej agjencive të lajmeve dhe iu referuan lëvizjeve diplomatike, deklaratave, njoftimeve për shtyp duke informuar rreth pseudo ngjarjeve. Këto dukuri

17 Jakubowicz,Karol "Post Communist Development Media in Perspective" gjendet tek http://libarry/fes.de/pdf-files/id/02841.pdf pg[6.08.2008]

18 Herman Edward and Chomsky Noam(19880 A Propaganda Model in Meenakashi Gigi Durham and Douglas M. Kellner(Eds) Media and Cultural Studies(2001) Blackwell Publishing Oxford (280-318)

19 Plato(1992) *Republic* 2ed.Indianapolis: Hacket Publishing Company

të prodhimit të medias u reduktuan në shfaqje të rendit të tretë të sferës së ngjarjeve. Së pari informacion rreth ngjarjeve u formësua dhe u përpunua nga shërbimet profesioniste të zyrave të deklaratave për shtyp. Një rezultat i brendshëm i këtij lloji për prodhimin e përmbajtjes është duke vënë në pah pikëpamjet e opinionet e veçanta për ngjarje më shumë sesa aspektet e saj. Së dyti informacioni u përpunua më tej në agjencitë e lajmeve ku u përmblodh kjo përmbajtje e reduktuar. Së fundi niveli i tretë i shfaqjeve të ngjarjes së vërtetë janë ndërhyrjet gazetareske e editoriale. Kjo metodë e prodhimit të lajmeve është shumë e zakonshme veçanërisht në situatën e rrjeti të paplotë korrespondentësh dhe raporteve të ngadalta hulumtuese. Problemi qëndron se shpesh kjo përbën metodën e vetme dhe në kombinim me llojet e shkurtra e jo-gazetareske krijon një sërë shqetësimesh lidhur me mbulimin nga media të një ngjarje të caktuar.

Rezultatet e studimit dëshmuan se një numër i vogël gazetarësh raportuan nga Kosova para mesit të shkurtit. Vëmendja e mbulimit nga media u përqendrua në 3 çështje: Deklarata e Pavarësisë, festimet dhe trazirat që pasuan në Serbi dhe reagimet diplomatike. Media kryesisht raportoi rreth deklaratave të zyrtarëve serbë dhe përfaqësuesve të OKB-së, BE dhe NATO-s por ato më së shumti u cituan në vend që të analizoheshin. Format e ndërlikuara, analitike e të zgjeruara gazetareske që kërkojnë më shumë burime ishin tepër të rralla në këtë rast dhe pothuajse përbëheshin tërësisht nga ribotime artikujsh të autorëve dhe burimeve të huaja. Ajo çfarë vërehet prej rezultatit të studimit është mungesa e llojeve "personale" të shkrimit siç janë intervistat apo shkrimet e opinionistëve kryesorë vendas, si dhe kolumnet të cilat jo çdoherë ofronin argumente gjithëpërfshirëse. Kjo qasje del më shumë në pah tek mediat që kanë një lexues të përcaktuar nga ana etike. Një tjetër lloj që ndeshet shumë rrallë por që nuk është më pak i rëndësishëm ishte kryeartikulli. Të shkruara më së shumti rreth datës 15 shkurt, ata dështuan që të ndjekin zhvillimin e çështjes së Kosovës prej periudhës kur lindi e deri tek zgjidhja.[20] Nëse marrim në konsideratë se ato përfaqësojnë në mënyrë të përmbledhur politikën editoriale mbi një çështje të caktuar, vërtetohet përsëri pohimi i mësipërm se mbulimi i kësaj ngjarje nga ana e gazetave ishte përzgjedhës dhe i pjesshëm. Qasja editoriale nga ky këndvështrim nuk arriti të jetë parashikuese, përshkruese apo analitike pasi që ajo u përqendrua vetëm në kulmin e ngjarjes dhe anashkaloi fazat e tjera të zhvillimit të saj.

Përveç kësaj, mbulimi nga ana e medias i çështjes së Kosovës ushqeu kryesisht ligjërimin politik për të. Tiparet e jetës së përditshme munguan dhe çështje të tilla si krimi, dhuna dhe varfëria u prekën shumë rrallë. Këndvështrimet kulturore, ekonomike apo sociologjike për Kosovën munguan pothuajse tërësisht. Kjo u kompensua me historitë e vetëvendosjes, kryesisht nën dritën e minoritetit serb apo çështjeve të minoritetit brenda shteteve fqinj me Kosovën. Këto artikuj nuk merreshin me dimension shumetnik të Kosovës për shkak të atij vetë, por për arsye se rrjedhoja nga zgjidhja e këtij konflikti etnik

20 Ne i referohemi periudhes pas shpalljes se pavaresise. Duhet te theksohet se zgjidhja eshte akoma nje proces ne vazhdim dhe te gjitha pasojat nuk jane ende te dukshme.

mund të pasqyrohej në problemet e tyre të brendshme. Ky kërcënim i mundshëm nga Kosova është kriteri mbizotërues për përzgjedhjen e "lajmeve jopolitike". Trafikimi i qenieve njerëzore, emigrimi për shkaqe ekonomike apo etnike si edhe trafiku i drogës dhe i armëve u trajtuan jo si probleme të Kosovës që pasqyronin mosfunksionimin e brendshëm të sistemit, por si një kërcënim i jashtëm.

Një problem tjetër që u vërejt ishte dualizmi në ligjërimet e mbështetura mbi baza etnike. Kjo situatë ishte e pranishme në Maqedoni, Bosnje, Mal të Zi ku për shkak të sfondit etnik të pronarëve të mediave të përditshme apo të lexuesve ato u ndanë, shpesh duke kundërshtuar dhe duke i rënë ndesh këndvështrimeve mbi situatën. Përveç pengesës së gjuhës që ishte e dukshme vetëm në fushën e medias maqedonase, të përditshmet e tjera nga këto vende prodhuan përmbajtje të lajmeve me anësi etnike dhe të përzgjedhura. Ky përcaktim i ngatërruar i axhendës dështoi që të përmbushë qëllimin edukativ e informues, pasi që përforcoi steriotipat, paragjykimet dhe ishte i thyeshëm ndaj ndikimit politik. Me fjalë të tjera, sa më shumë që ngjitej çështja e Kosovës në axhendën politike etnike, aq më i zakonshëm ishte instrumentalizimi politik i mediave.

Kultura e pjesëmarrjes politike është një ndër vlerat bazë të një demokracie funksionale, ashtu si edhe një qytetar i informuar dhe kritik është një parakusht i domosdoshëm për kontrollin politik dhe angazhimin civil, veçanërisht në rrethanën e re të pavarësisë së Kosovë. Mbulimi nga ana e medias e çështjes së Kosovës duhet të vlerësohen e analizohet nën dritën e këtyre parimeve. Si rrjedhojë praktika gazetareske dhe cilësia e artikujve duhet të shqyrtohet sipas kapacitetit të tyre për të përmbushur standartet e gazetarisë informative e edukuese. Mënyra e vetme për të kapërcyer pengesat strukturore në fushën e medias është që të marrë në konsideratë dimensionin e saj etnik, duke vlerësuar këndvështrimin e brendshëm mbi gjërat e duke e harmonizuar këtë tipar me qasjen analitike. Gara mes autorit të artikujve dhe agjencisë së lajmeve si burime informacioni, duhet të përfundojë në dobi të të parit. Realiteti nuk duhet të reduktohet në logjikën e informacionit të shkurtër dhe që merret në mënyrë të lehtë. Këto sfida janë të arritshme dhe duhet të përcaktohen si një domosdoshmëri për sistemet e medias rajonale. Fatkeqësisht deri më tani është disi e vështirë të argumentohet se gazetat e përditshme të marra në shqyrtim bëjnë pjesë mes atyre mediave që zotërojnë në mënyrë të plotë vlerat e një gazetari profesioniste.

BIBLIOGRAFIA

Boorstin J.Daniel (1992) The Image: A Guide to Pseudo –Events in America, 1st Vintage Book: New York

Douglas M.Kellner(Eds). Media and Cultural Studies(2001) Blackwell Publishing, Oxford (280-318)

Habermas, Jurgen (1991) The Structural Transformation of the Public Sphere, Cambridge, Massachusetts: The MIT Pres

Hermna Eduawrds and Chomsky Noam (1988) A Propaganda Model in Meenakashi Gigi Durham in Douglas M.Kellner (Eds). Media and Cultural Studies(2001) Blackwell Publishing, Oxford (280-318)

Herman, E.S.(2002). The Propaganda Model: A retrospective in D.Mcquail(Ed) Macquail's reader in Mass Communication Theory (pp 61-67). London: Sage Publications

Hrvatin S.Thompson M and Husiç T..(eds)(2008) RAZJEDINJENI PROP-DAJU Javni radio-televizijski servisi u multiethnicknim drzavama, Sarajevo: Mediacentar,pp.27

Krippendorff, K (2004). Content Analyses: A introduction to its Methodology, 2nd ed. Thousand Oaks, CA: SAGE Publication, Inc 29-31

Plato(1992) Republic 2ed, Indianapolis: Hackett Publishing Company

Radojkoviic, M and Stojkovic, B (2004) Informaciono-komunikacioni sistemi, Beograd: CLIO

Orljevi, T (1988). Komunikacija i vlast, Beograd: NIRO Mladost

Burime elektronike

http://daccessdds.un.org/doc/UNDOC/GEN/N99/172/89/PDF/N9917289.pdf?OpenElement[07.07.2008]

http://www.unosek.org/docref/KaiEidereport.pdf[07.07.2008]

Raporti i të Dërguarit Special të Sekretarit të Përgjithshëm mbi statusin e ardhshëm të Kosovës

http://www.unosek.org/docref/report-english.pdf[07.07.2008]

Propozimi i plotë për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës

http://www.unosek.org/docref/Comprehensive_proposal-english.pdf[07.07.2008]

Parathënia tek Karol Jakubowicz"Zhvillimi i Medias Post-komuniste në të Ardhmen"http://library.fes.de/pdf-files/id/02841.pdf[08.06.2008]

"MARREDHENIET E PUNES DHE MEDIA: Duke analizuar kahjet e marrëdhënieve të punës në median e vendeve anëtare të SEENPM"

http://www.ijc.md/eng/index2.php?option=com_content&do_pdf=1&id=157[8.07.2008]



SHQIPËRIA

Ilda Londo



VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Analiza e këtushme përqendrohet mbi mbulimin nga ana e medias të pavarësisë së Kosovës, ngjarjet që e paraprinë dhe e pasuan atë. Për këtë u zgjodhën për shqyrtim dy gazeta të përditshme: Panorama dhe Gazeta Shqiptare. Të dyja pretendojë se janë të pavarura, ndër mediat kryesore e më të shiturat në treg. Në mungesë të të dhënave zyrtare të besueshme për tirazhin e tyre, përzgjedhja është realizuar në bazë të perceptimit të përgjithshëm mbi shitjet dhe tirazhin. Gazeta Shqiptare është një e përditshme me 32 faqe ndërsa Panorama ka 24 faqe, duke përjashtuar suplementët e secilës gazetë. Të dyja janë të ngjashme në stil, tematikë dhe mbulimin e ngjarjeve ashtu sikurse edhe për ngjarjen e Kosovës, si do ta vërejmë në vijim.

Çdo temë e lidhur me Kosovën dhe pavarësinë e saj u mbulua nga këto gazeta përgjatë një periudhe janar dhe shkurt 2008 edhe në ato raste kur artikujt nuk përqendroheshin mbi Kosovën apo nuk bënin fjalë rreth kësaj çështje. Në fakt,në këtë rast, përbënin një domethënie të rëndësishme ngjarjet në Serbi, qoftë në periudhën e fushatës elektorale ashtu edhe pas shpalljes së pavarësisë. Kishte shumë të ngjarë që, këto artikuj nuk lidheshin aq shumë me interesin e drejtpërdrejtë për Serbinë dhe zhvillimet atje, përsa kohë në periudha të tjera ato nuk ishin të pranishëm në median shqiptare. Për më tepër, prania e artikujve mbi zgjedhjet në Serbi dhe reagimet ndaj zhvillimeve në Kosovë mund të shpjegohen më mirë me anë të interesit që ngjallnin ato lidhur me ndikimin e zhvillimeve në këtë vend, jo vetëm mbi Kosovë por në të gjithë rajonin.

I. RRETHANAT POLITIKE (QENDRIMET POLITIKE VENDASE NË DREJTIM TË KOSOVËS)

Shqipëria është një demokraci parlamentare. Në vend ushtrojnë veprimtarinë e tyre një numër jo i vogël partish politike. Dy partitë kryesore, Partia Demokratike dhe Partia Socialiste ndryshojnë më së shumti nga personalitetet e udhëheqësve të tyre respektivë sesa prej platformave politike apo ideologjia.

Përveç kësaj mes partive apo faktorëve politike dhe qëndrimeve të tyre nuk ka dallime lidhur me çështjen e Kosovës. Qeveria shqiptare e ka njohur pavarësinë e Kosovës që nga shpallja e saj prej qeverisë –hije të këtij vendi në 1991. Megjithatë për shkak të presionit ndërkombëtar në kontekstin e stabilitetit në rajon, qeveria dhe partitë shqiptare kanë patur pak a shumë një qëndrim të përbashkët e të vetë-përmbajtur lidhur me këtë çështje. Ky qëndrim ka qenë një përpjekje që synonte nga njëra anë të arrinte një ekuilibër mes mbrojtjes së të drejtës së Kosovës e nga ana tjetër të ruante stabilitetin në rajon.

Në këtë kontekst, megjithëse qeveria dhe politikanët shqiptarë kanë qenë në kontakt të vazhdueshëm me politikanët dhe aktivistët shqiptarë në Kosovë, lëvizjet diplomatike në këtë drejtim kanë qenë mëse të kujdesshme. Në mënyrë fare të thjeshtë, qëllimi i politikës së jashtme shqiptare ka qenë të nxisë Shqipërinë si faktor paqeje e stabiliteti në rajon. Megjithëse politika shqiptare nuk ka qenë kurrë indiferente ndaj ngjarjeve në Kosovë, ka mbizotëruar një qasje pragmatike dhe e vetë-përmbajtur.

II. KARAKTERISTIKAT E SISTEMIT TË MEDIAS-KONTEKSTI I MEDIAS

Liria e shtypit dhe e shprehjes përbëjnë ndoshta arritje më të dukshme e më të qartë të demokracisë së re shqiptare. Roli i medias në jetë shqiptare ka ardhur duke u bërë gjithnjë e më i fuqishëm dhe media po vepron gjithnjë e më shumë si një mbikëqyrës i qeverisë.

Pavarësisht fakti se media shqiptare ka shënuar arritje domethënëse në fushën e lirisë së shprehjes, enden mbeten një realitet shqetësimet rreth një media të lirë e të pavarur dhe aktualisht ato shfaqen në mënyra të ndryshme. Ndërkohë që disa vjet më parë kishte raste të larmishme të presionit të drejtpërdrejtë madje edhe dhunë ndaj medias prej sistemit politik, tashmë ai ushtrohet në mënyrë jo të drejtpërdrejtë kryesisht nëpërmjet formave të presionit financiar.

Tashmë media përballet me "kahjet kapitaliste e presionin financiar" të tilla si shpërndarja, transparenca e financimit, pronësia, marrëdhëniet e punës e deri tek korrupsioni në media. Botuesit dhe pronarët e medias synojnë të diktojnë politikën editoriale të mbështetur mbi lidhjet politike e ekonomike, të cilat së bashku me pasigurinë e punësimit me të cilat përballen gazetarët, ndikojnë mbi perspektivën për të arritur pavarësinë editoriale.

III. ANALIZA E KONKLUZIONE TË STUDIMIT

Artikujt u vëzhguan qoftë nga pikëpamja sasiore apo cilësore duke patur parasysh ndryshorë të tillë si mënyra e vendosjes në gazetë, lloji i shkrimit dhe autori i tekstit, burimi i informacionit, ngjarja në artikull, titulli vs përmbajtjes, ilustrimet dhe përqindja e përmbajtjes, temat që u mbuluan

etj. Gjatë periudhës janar –shkurt 2008 të dy gazetat kishin një tërësi prej 517 zërash mbi Kosovën, me rreth 301 artikuj të botuar nga Gazeta Panorama dhe 216 nga Gazeta Shqiptare. Analiza e mëposhtme është një shqyrtim i ndryshorëve të mësipërm dhe secili prej tyre është analizuar veçmas në bazë të përqindjeve.

Analiza Sasiore

Faqosja e tekstit

Një nga ndryshorët e analizuar përgjatë periudhës së vëzhgimit ishte vendosja e tekstit në gazeta, e cila duhet të dëshmonte rëndësinë apo vlerësimin e temës për publikun dhe medias. Në fund të periudhës së vëzhgimit, u vërejt se afro 79% e artikujve nuk ishin në faqe të parë dhe nuk përmendeshin në faqen e parë. Vetëm 5% e artikujve të vëzhguar mbi Kosovë, fillonin në faqen e parë, ndërkohë që rreth 16% u përmendej titulli në këtë faqe. Shifrat përkatëse për Gazetën Shqiptare janë: 77% e artikujve fillon në një faqe tjetër nga faqja e parë, 19% e artikujve u përmendej titulli në këtë faqe dhe vetëm 4% e tyre fillonin në faqen e parë. Ndërsa të dhënat për gazetën Panorama janë: 80% e artikujve fillonin në faqe të tjera, 13% e tyre e kishin titullin në faqen e parë dhe vetëm 7% fillonin në këtë faqe. Për të dyja gazetat, ato artikuj që fillonin në faqen e parë ishin më së shumti editorialet, komentet apo analizat nga ekspertë, intelektualë, apo diplomatë shqiptarë dhe të huaj. Përjashtim në këtë rast ndodhi vetëm në ditët përpara dhe menjëherë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, ku artikujt rreth kësaj teme qëndruan në faqen e parë për rreth 1 javë.

Llojet e tekstit, autorët dhe burimet

Një tjetër ndryshor shumë i rëndësishëm për të mbikëqyrur artikujt e botuar ishte edhe lloji i shkrimit gazetaresk që kishin përdoruar artikullshkruesit me këtë rast. Në një pamje të përgjithshme, përqindjet janë si më poshtë: 41% u kushtohen lajmeve, 32% deklaratave, 10% intervistave, 5% njoftimeve për shtyp, 3% për komente, analiza dhe lajme të zgjeruara, 2% për raporte dhe 1% për editoriale. Në këtë drejtim ashtu si edhe në ato të tjera dallimet në përqindjes mes dy gazetave janë jo të qenësishme çka dëshmon njëtrajtshmërinë e mediave shqiptare sa i përket mbulimit të kësaj ngjarje nga ana e tyre.

I njëjti fenomen, psh, vërehet edhe kur hedhim vështrimin mbi autorët e teksteve mbi Kosovën. Kështu tekstet që nuk kanë emër në fund lëvizin nga 56% në Gazetën Panorama tek 60% për Gazetën Shqiptare. Dallimi kryesor është për artikujt e ribotuar (26% për Gazetën Shqiptare krahasuar me 19% për Panorama) dhe tekstet që mbajnë në fund emrin e gazetarëve përbëjnë (16% nga Gazeta Shqiptare krahasuar me 8% nga Panorama). Në tërësi, përqindja e autorëve të teksteve është si më poshtë: 21% janë nga agjencitë e lajmeve apo të artikujve të ribotuar, 12% nga gazetarë, 3% nga

redaksia, 4% nga personalitete publike, 4% nga politikanë, 3% nga të tjerë dhe 53% e artikujve nuk mbajnë emrin e ndokujt.

Megjithëse më shumë se gjysma e artikujve nuk kanë në fund emra të autorëve, kjo është një shifër që i përgjigjet kryesisht artikujve të ribotuar apo informacionit të marrë prej agjencive të lajmeve dhe nuk është cituar si i tillë. Në fakt, kjo varet nga praktika e secilit departament të lajmeve sesi e citojnë këtë lloj informacioni. Megjithatë, është diçka e zakonshme në redaksitë e lajmeve të mediave shqiptare mbështetja tek media e huaj dhe agjencitë e lajmeve lidhur me lajmet nga jashtë e në këtë drejtim nuk përbën përjashtim edhe rasti për Kosovën. Sa i përket llojit të burimeve të informacionit që janë përdorur në artikujt për Kosovë, 75% e artikujve të botuar citonin burime të sakta, 4% burime jo të sakta, 5% burime të paqarta, vetëm 1% përdornin gazetarët si burim informacioni ndërsa 15% e tyre nuk përmendte asnjë burim. Të dyja gazetat e sipërpërmendura janë shumë të ngjashme në këtë drejtim: të dyja përmendin burimet shtetërore të informacionit në afro 75% të artikujve të botuar për Kosovën, nuk citonin asnjë burim në 15% të pjesës tjetër dhe së fundmi përdorin gazetarët si burim informacioni vetëm në 1% të artikujve. Dallimi lidhur me kategoritë e tjera është pothuajse i papërfillshëm: Panorama përdor 4% të burimeve të paqarta të informacionit në krahasim me 6% të përdorur prej Gazetës Shqiptare; Gazeta Shqiptare përdor 3% të burimeve të pasakta krahasuar me 5% të Panoramës.

Këto përqindje janë domethënëse nën dritën e burimeve të përdorura dhe për ecurinë e medias shqiptare lidhur me raportimin e çështjeve ndërkombëtare edhe në këtë rast që mund të konsiderohet më afër "shtëpisë" se çdo lajm tjetër i jashtëm. Më konkretisht, si do të tregojmë në vijim, përqindja e lartë e burimeve të cituara në mënyrë të saktë, e kombinuar me artikujt që nuk përmendin burime (një total prej 90% e shkrimeve të medias që kanë mbuluar ngjarjen e Kosovës qoftë në tërësinë apo edhe për secilën gazetë më vete) rrjedh prej përdorimit shumë të dendur të artikujve që përfaqësojnë deklarata nga diplomatë dhe politikanë të cilat janë më shpeshta se ato që nuk janë marrë nga media e huaj apo agjencitë e lajmeve. Kjo kahje vërtetohet kur hedhim një vështrim të mëtejshëm në numrin e burimeve të cituara në secilin artikull. Tërësia e tyre dëshmon se 62% e artikujve përdorin vetëm një burim, 15% dy burime, 15% nuk përmendin asnjë burim ndërsa 8% e tyre përdorin tre apo më shumë të tilla. Nëse shqyrtojmë secilën gazetë më vete përqindjet janë si më poshtë: Panorama përdori vetëm 1% në 62% të artikujve ndërkohë që tek Gazeta Shqiptare kjo ndeshet tek 59% e tyre; Gazeta Shqiptare përdori 2 burime në 17% të temave të trajtuara rreth ngjarjes së Kosovës ndërsa tek Panorama kjo shifër përbën 14%. Nga ana tjetër Gazeta Shqiptare në rreth 9% të artikujve përdori 3 apo më shumë burime ndërsa tek Panorama kjo vërehet tek 8% e tyre. Në të njëjtën kohë tek 15% e artikujve të Gazetës Shqiptare nuk përmendet asnjë burim krahasuar me 10% ku kjo dukuri ndeshet tek gazeta Panorama.

Të dhënat tregojnë qartazi si të dyja gazetat ndoqën pothuajse të njëjtën kahje në këto drejtime çka nxjerr në pah se burimet e të tyre të informacionit dhe trajtimi i artikujve janë shumë të ngjashëm.

Ilustrimet e përdorura

Gazetat ndryshojnë disi më shumë lidhur me përdorimin e ilustrimeve megjithëse jo mënyrë shumë thelbësore. Në tërësi rreth 75% e artikujve që janë marrë në shqyrtim janë të ilustruar nga fotot, 2% përmbanin një hartë apo plan, 23% nuk paraqesin asnjë ilustrim ndërsa mungonte thuajse krejtësisht përdorimi i grafikëve. Më konkretisht Gazeta Shqiptare përdori foto në 83% të artikujve të saj të botuar me këtë rast krahasuar me 70% të Panoramës ndërkohë që nuk përdori asnjë të tillë tek 17% e artikujve përkundër 28% të artikujve nga gazeta Panorama. Megjithatë ky ndryshim mes këtyre dy mediave u ndikua edhe për shkak të numrit më të madh të artikujve në gazetën Panorama lidhur me çështjen e Kosovës (301-Panorama ; 216 Gazeta Shqiptare). Por pavarësisht kësaj, dallimi mes të dy gazetave në këtë drejtim ishte sërish i papërfillshëm.

Kjo mungese e dallimeve mes tyre bëhet edhe më e dukshme kur shqyrtojmë ilustrimet e përdorura me këtë rast. Mund të pohohet pa asnjë mëdyshje se vërehet një përsëritje e vazhdueshme e fotove të njëjta në të dyja gazetat. Fotot e përdorura mund të konsiderohen si "protokollare" teksa vihen re ato politikanëve në secilin artikull të korrespondentëve, deklaratë apo citim. Kjo është një qasje mbizotëruese për të dy gazetat e duket sikur ndryshon fare lehtë në ditët përpara, ishin gjatë dhe pas shpalljes së pavarësisë. Edhe atëherë kur fotot e përdorura ishin më të gjalla dhe pasqyronin ngjarjet, ato ishin shumë të zbehta në krahasim me imazhet non –stop që stacionet televizive shqiptare transmetuan Ditën e Pavarësisë e më pas.

Për shkak të karakterit pothuajse të njëtrajtshëm të fotove e ilustrimeve të përdorur edhe raporti i ilustrimit ndaj përmbajtjes ishte pothuajse i njëjtë për të dyja gazetat. Kështu në tërësinë e tyre 85% e ilustrimeve ishin në përputhje me përmbajtjen ndërsa 15% e vinin atë më në pah. Në këtë rast fotot që mund të klasifikohen si nënvizuese të përmbajtjes janë të lidhura me periudhën menjëherë para, gjatë dhe pas Ditës së Pavarësisë ku shkalla e veprimit ishte më e madhe qoftë nga gëzimi apo dhuna. Për të njëjtën arsye nuk vërejmë ndonjë dallim të dukshëm në këtë aspekt kur krahasojmë të dy gazetat. Në artikujt e gazetës Panorama 87% e përmbajtjes përputhej me mesazhin ilustrues ndërsa 13% e nxirrte atë më në pah.Ndërkohë tek Gazeta Shqiptare ky raport qëndronte në nivelin 81% me 13% (në këto shifra duhet të marrim sërish parasysh numrin më të vogël të artikujve të botuar në Gazetën Shqiptare për çështjen e Kosovës krahasuar me Panoramën) ndërkohë që vetëm 1% e ilustrimeve shtrembëronin përmbajtjen apo nuk përputheshin me të. Në fakt, prania shumë e ulët kësaj dukurie është diçka që duhet patur parasysh përgjatë vlerësimit tërësor të sjelljes profesionale të medias së bashku me aspekte të tjera të pazbuluara.

Përmbajtja: tema, vendi, rastet dhe titujt

Një nga aspektet më rëndësishme të analizës së artikujve që trajton ngjarjen e Kosovës, ishte shqyrtimi i përmbajtjes. Nga pikëpamja sasiore, përmbajtja u analizua në lidhje me temat që u mbuluan prej medias, paraqitjes së veprimit në tekst, ngjarja për të cilin është shkruar artikulli dhe raportin e titullit ndaj vetë përmbajtjes së shkrimit.

Më konkretisht kur analizojmë përmbajtjen nëpërmjet temave që ka mbuluar media në këtë rast, përqindja më e madhe e shkrimeve i kushtohet lëvizjeve diplomatike nga vendet e tjera të cilat përbëjnë 35% të tërësisë së artikujve, të ndjekura nga afër prej atyre që ishin të lidhura me të drejtën e vetëvendosjes/pavarësisë me afro 31%. Nga ana tjetër lëvizjet diplomatike brenda vendit zinin 14% të gjithë artikujve të ndjekur nga ato mbi dhunën me 8% ndërkohë që shkrimet mbi tensionet etnike dhe përpjekjet për zbatimin e ligjit përbënin secila nga 6% të artikujve të botuar. Mbizotërimi i lëvizjeve diplomatike, të cilat kur kombinoheshin ishin pothuajse sa gjysma e të gjithë hapësirës së mbuluar nga media rreth kësaj ngjarje, dëshmonte qasjen e sipërpërmendur për një përdorim të bollshëm nga gazetat të deklaratave, njoftime për shtyp, aktiviteteve politike e diplomatike si edhe të takimeve e konferencave. Kjo kahje e përmbajtjes përforcohet më tej edhe kur krahasojmë mbulimin e temave prej gazetave që janë marrë në shqyrtim: lëvizjet diplomatike nga vendet përbënin 39% të shkrimeve tek Gazeta Panorama dhe 32% në Gazetën Shqiptarë, ndërsa lëvizjet diplomatike brenda vendit zinin përkatësisht 13% dhe 15% në Panorama dhe Gazeta Shqiptare. E drejta për vetëvendosje/pavarësia u trajtuan nga 32% e artikujve në gazetën Panorama dhe 30% të tyre në Gazetën Shqiptare ndërsa lidhur me tensionet etnike tërësia e shkrimeve në gazetën Panorama përbënte 5% ndërsa tek Gazeta Shqiptare 7%. Ndërkohë nuk vihet re ndonjë dallim i dukshëm lidhur me ato artikuj që trajtonin përpjekjet për zbatimin e ligjit ku 5% e artikujve në Gazetën Panorama u përgjigjeshin shifra prej 6% në Gazetën Shqiptare ndërkohë që dhuna u paraqit në 6% të shkrimeve të Gazetës Panorama përkundër atyre prej 0% të Gazetës Shqiptare.

Ndoshta dallimi më i madh ndërmjet këtyre dy gazetave sa i përket mbulimit të kësaj ngjarje prej tyre vërehet tek vendndodhja e ngjarjeve që paraqitet në tekstin e shkrimeve. Kështu tek artikujt e Gazetës Shqiptare 41% e veprimit zhvillohet në Kosovë krahasuara me 34% të gazetës Panorama; 17% e shkrimeve të gazetës Panorama e zhvendosin veprimin në Tiranë përkundër 21% të atyre të Gazetës Shqiptare ndërkohë që 49% e veprimit në Gazetën Panorama zhvillohet në vende të tjera nga Kosova dhe Shqipëria krahasuar me 38% të artikujve në Gazetën Shqiptare.

Është disi e vështirë që të shpjegosh dallimin në përqindje sa i përket vendit ku zhvillohen ngjarjet duke patur parasysh ndryshimin mes numrit të artikujve në secilën gazetë. Duket sikur gazeta Panorama ai ka lënë më shumë hapësirë artikujve për atë çfarë ndodhte në Serbi, Rusi, SHBA e Gjer-

mania e shumë lojtarëve të tjerë kryesorë të përfshirë në këtë rast përmes deklaratave diplomatike mbi Kosovën. Megjithatë ky ndryshim duhet të merre me rezervë, për shkak të numrit më të madh të artikujve që janë botuar në gazetën Panorama.

Në tërësi kahja për vendin e teksteve dëshmon përdorimin e dendur në artikuj të deklaratave diplomatike dhe të lajmeve lidhur me aktivitetin diplomatik: 19% e veprimit në këtë rast zhvillohet në Shqipëri, 37% në Kosovë dhe 44% në vende të tjera.

Dinamika e mbulimit të çështjes së Kosovës në këta muaj shpjegohet më tej nëse i hedhim një vështrim përqindjeve të rasteve kur janë shkruar artikujt. Kështu 17% e tërë artikujve janë shkruar për rastet e ngjarjeve të pritshme, 16% në rastet e pseudongjarjeve (konferenca, shtypi, deklaratat etj) duke përbërë 1/3 e tërë artikujve që kanë mbuluar zhvillimet e kësaj ngjarje. Përveç kësaj, ndonëse ngjarjet e vërtetat të përditësuar përbënin 47% të shkrimeve, është e vështirë të vëreje këtu ndonjë dallim ndërmjet ngjarjeve të vërteta dhe pseudongjarjeve për shkak të përhapjes së lajmeve që buronin nga takimet, intervista, deklaratat etj. Kështu që një ndarje e ngushtë e të dy llojeve të ngjarjeve do të anonte përfundimisht në favor të ashtuquajturave pseudo-ngjarje. Ngjarjet që erdhën më pas (kryesisht shpallja e pavarësisë) zinin 18% ndërkohë që vetëm 2% iu kushtua ngjarjeve më të hershme më së shumti intervistave, editoriale/komenteve e analizave.

Krahasimi ndërmjet gazetave në këtë drejtim dëshmon sërish qasjen e ndjekjes në mënyrë besnik e të pandryshueshme të ngjarjeve, lëvizjeve e deklaratave diplomatike: ngjarjet e mëpasme u mbuluan në masën 17% në gazetën Panorama dhe 18% në Gazetën Shqiptare, ndërsa ngjarjet e pritshme zunë 14% të hapësirës në Gazetën Panorama krahasuar me 21% në Gazetën Shqiptare., ngjarjet reale të përditësuara përbënin 50% të shkrimeve në gazetën Panorama krahasuar me 43% në Gazetën Shqiptare, ngjarjet më të hershme në kohë zinin 1% tek Panorama dhe 3% në Gazetën Shqiptare ndërsa pseudo-ngjarjet ishin 18% e artikujve të Panoramës në krahasim me 15% të vendit që zinin në artikujt e Gazetës Shqiptare. Si rrjedhojë, dallimet e pakta mes të dy gazetave në këtë drejtim në përgjithësi përforcojnë konkluzionin mbi dinamikën e mbulimit të lajmeve nga media rreth çështjes së Kosovës.

Megjithatë gazetat ndryshojnë në mënyrë të ndjeshme shumë të ndryshëm lidhur me raportin e titujve me përmbajtjen e shkrimit. Ndërkohë që Gazeta Shqiptare duket sikur ka një qasje më të paanshme, vërehet më shumë entuziazëm në disa prej titujve të artikujve të botuar në Gazetën Panorama: kështu 44% e titujve në gazetën Panorama nxjerrin në dukje temën kryesore të përmbajtjes së artikullit ndërkohë që tek Gazeta Shqiptare ky rast vërehet për 17% të tyre. Anasjelltas, 81% e titujve në Gazetën Shqiptare paraqesin në mënyrë të përmbledhur temën kryesore që është trajtuar nëpërmjet një fjalori asnjanës, ndërkohë që kjo shifër tek Panorama

ndeshet tek 54% e artikujve. Megjithatë dallimi mes këtyre dy aspekteve është shumë vështirë të vihet re dhe ka vetëm një ndryshim të lehtë sa i përket titujve kur krahasohen të dy gazetat.

Aspektin më të rëndësishëm lidhur me mbulimin profesional të lajmeve për Kosovën nga këto dy media e përbën fakti që vetë, 1% e artikujve në gazetën Panorama përmbajnë mesazh pjesërisht që shtrembëron temën e trajtuar ndërkohë që raste të tilla nuk ndeshen tek Gazeta Shqiptare. Të dhënat sa i përket mbulimit tërësor të ngjarjes nga të dy gazetat janë si më poshtë: përmbledhja e temës kryesore me një fjalor asnjanës përbën 65% të titujve, 32% e tyre përmbajnë një mesazh që nxjerr në pah temën kryesore, 2% e vënë theksin pjesërisht tek tema e trajtuar dhe vetëm 1% e shtrembërojnë pjesërisht këtë temë. Në tërësi mund të pohohet se raporti i titujve ndaj përmbajtjes është shumë i kënaqshëm në këto artikuj, diçka që nuk mund ta ndeshësh aq shpesh në gazetat shqiptare.

Analiza cilësore

Kur flasim rreth analizës cilësore na shfaqet një dallim i qartë në shqyrtimin e artikujve përgjatë periudhës para, gjatë dhe pas Ditës së Pavarësisë. Me fjalë të tjera, periudha nga janari deri më 14 shkurt apo më tej, është e ndryshme për të dyja gazetat nga ajo që pasoi në ditët në vijim. Këto dy periudha ndryshojnë nga njëra –tjetra qoftë sa i përket gjatësisë së artikujve, hapësirës së kushtuar atyre në secilën gazetë, fotove të përdorura, autorëve ashtu si edhe ngjyrave apo emocioneve. Pjesa e mëposhtme përshkruan kahjet kryesore që u vërejtën në çdo periudhë.

Periudha nga janari deri në mes të shkurtit

Në periudhën e parë pothuajse të gjithë artikujt për Kosovën u vendosën në faqet e pasme të gazetave zakonisht në rubrikat "Nga rajoni", "nga bota" apo "marrëdhëniet ndërkombëtare". Pjesa më e madhe e tyre ishin shumë të shkurtra, zakonisht vetëm deklarata të bëra nga diplomatë apo politikanë të ndryshëm, dhe çdo gazetë i kushtonte deri 2 faqe kësaj çështje. Sa më shumë që afrohej data e shpalljes së pavarësisë aq më të gjata ishin artikujt dhe vendosja e tyre ishte gjithnjë e më afër faqes së parë. Vendosja e artikujve në faqet e gazetës dhe gjatësia e tyre janë ndër treguesit e parë që dëshmuan një shndërrim të medias lidhur me mbulimin prej saj të ngjarjeve në Kosovë. Megjithëse këto ishin më të dukshmet ato nuk përbënin treguesit e vetëm.

Më konkretisht, periudha e parë e shqyrtimit mund të përshkruhet pa dyshim si e nxjerrë nga agjencitë e huaja të lajmeve. Artikujt shin mozaikë të deklaratave nga politikanë të ndryshëm të Kosovës, Serbisë, Shqipërisë, SHBA, Rusisë si edhe të diplomatë apo strukturave të tjera me rëndësi që ishin të përfshira në këtë çështje. Në fakt, mund të pohojmë pas asnjë mëdyshje se të dyja gazeta ofruan një panoramë të qartë të të dyja kampeve, për-

katësisht Serbisë dhe Rusisë dhe shteteve të tjera që nuk do të njihnin pavarësinë e Kosovës dhe të pjesës tjetër që do të ndërmerrte aktin e njohjes së saj. Nuk ishte e lehtë të bëje një dallim lidhur me këto dy kampe sa i përket rëndësisë që të dy gazetat u kushtuan atyre: në fakt, në vartësi të ditës dhe numrit të deklaratave, kishte raste ku më shumë hapësirë i kushtohej deklaratave kundër Kosovës. Ky raport dëshmon një nivel të lartë të profesionalizmit dhe objektivitetit nga të dy gazetat, i trashëguar prej burimeve të tyre, përkatësisht agjencive të huaja të lajmeve.

Nga një analizë e mëtejshme e kësaj periudhe të bie në sy diçka tjetër që lidhet me burimet e përdorura në këto artikuj dhe sesi ato janë shkruar. Nëse vëren autorët e këtyre shkrimeve, një përqindje të lartë e përbëjnë artikujt e ribotuar apo lajmet e marra nga media apo agjenci të huaja lajmesh. Edhe nëse hedhim një vështrim tek artikujt që nuk kanë në fund emra autorësh, stili i të shkruarit është i njëjtë.

Ndërkohë që kjo situatë ka nxitur një pasqyrim të saktë, objektiv e të kujdesshëm të ngjarjeve politike e diplomatike, në një drejtim tjetër ajo paraqet edhe mangësi të dukshme: historitë me interes për njerëzit. Kështu që nuk gjendet as edhe një artikull i cili përshkruan sfidat e përditshme, problemet dhe vështirësitë që njerëzit në Kosovë përballen dhe sesi pavarësia do ti ndryshojë ato apo jo. Mbulimi prej tyre është kufizuar vetëm raportimet protokollare dhe asnjë prej gazetave nuk shkon përtej tyre. E vetmja histori me interes për njerëzit u botua në gazetën Panorama ku shfaqet në një intervistë babai i kryeministrit të Kosovës Hashim Thaçi, i cili paraqet këndvështrim e tij mbi këtë ngjarje historike dhe faktin se i biri i tij do të shpallë pavarësinë.[1] Ajo çfarë është interesante në këtë rast lidhet me faktin se edhe ky "përjashtim" ishte një artikull i ribotuar nga media e huaj.

Mbulimi nga media përgjatë dhe pas pavarësisë

Si e përmendëm edhe më sipër, sa më shumë që afrohej dita e shpalljes së pavarësisë aq më të gjata shkruheshin artikujt dhe vendi i tyre në gazetë ishte gjithnjë e më afër faqes kryesore. Në fakt, më 18 shkurt 2008, një ditë pas shpalljes së pavarësisë, gjysma e parë e secilës prej gazetave (11 faqe në Gazeta Shqiptare dhe 12 faqe në gazetën Panorama) iu kushtua tërësisht kësaj ngjarje. Kjo kahje u ndoq për një javë e më shumë dhe Kosova ruajti prioritetin e saj ndër lajmet e medias deri në fund të shkurtit, në të dy gazetat e sipërpërmendura.

Përveç hapësirës dhe prioritete, një tjetër element i dobishëm për të vlerësuar nivelet profesionale në këtë drejtim e përbën analizave e qasjeve kryesore sesi u përshkruan ngjarjet në këtë rast. Në këtë drejtim analiza u përqendrua rreth dy çështjeve kryesore: balancës/objektivitetit lidhur me mbulimin e ngjarjeve në Serbi dhe tonet, temat dhe ngjyresat e përdorura përgjatë mbulimit të ngjarjeve në rastin e Kosovës.

1 Haxhi Thaci "Une jam krenar qe im bir do te shpalle pavaresine", Panorama, 10.02.2008, faq.14

Në përgjithësi mund të thuhet se gazetat ruajtjen objektivitetin dhe tërësinë e mbulimit nga ana e tyre teksa përfshinë të gjitha palët e përfshira. Është e vështirë të gjesh një ditë në të cilën nuk janë përfshirë në gazetë problemet e deklaratave serbe sa i përket pavarësisë së Kosovës. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për aleatët e tyre ashtu si edhe për shtetet që ngurronin lidhur me çështjen e Kosovës. P.sh më 16 shkurt, një ditë para shpalljes së pavarësisë së Kosovës, në të njëjtën faqe u botuan një artikull rreth komunave serbe në Kosovë që shpallnin synimin e tyre për të krijuar struktura paralele, një deklaratë nga presidenti serb që pohonte se ai kurrë nuk do ta dorëzonte Kosovën, një deklaratë prej MPJ të Federatës Ruse që pohonte se ata do të njihnin pavarësinë e Osetisë e Abkhazisë e së fundmi një deklaratë nga Greqia, e cila theksonte se shikonte ndonjë arsye për tu nxituar ndaj njohjes së pavarësisë së Kosovës si edhe kërkonte garanci se ky rast nuk do të krijonte një precedent. I gjithë ky mozaik pikëpamjesh ishte vendosur krahas një faqe tjetër gazete e cila raportonte mbi zhvillimet në Kosovë, përgatitjet për Ditën e Pavarësisë, deklaratat me informacionin praktik nga politikanët shqiptarë etj. Ky lloj mbulimi nga ana e medias për ngjarjet në Kosovë nuk përbënte ndonjë përjashtim nga të gjithë artikujt e shqyrtuar mbi Kosovën: në fakt çdo ditë ishte e njëjtë në këtë drejtim, megjithëse disa informacione ishin më të zgjeruara se të tjerat.

Ashtu si e përmendëm më sipër, karakteristika kryesore e mbulimit të çështjes së Kosovës nga ana e medias, në fakt mbulimi në përgjithësi prej tyre i çështjeve ndërkombëtare, përbëhej nga artikujve të ribotuar apo informacionit të botuar nga mediat e agjencitë e huaja të lajmeve edhe në rastin kur tashmë bëhej fjalë për një vend që ishte shumë afër. Në këtë drejtim, mund të konsiderohet se raportimi I lajmeve është më I sigurt lidhur me objektivitetin dhe kriteret kryesore të gazetarisë.

Në këto rrethana, do të ishte me interes të analizonin sjelljen e medias në lloje të tjera shkrimesh "më pak të sigurta" që realizohen prej gazetarëve të tilla si editorialet, analizat, opinionet dhe komentet. Duke u përqendruar mbi këto përjashtime më shumë sesa mbi mbulimin prej agjencive të huaja që është tashmë një normë, mund të ofrojmë një pamje të plotë e në thellësi të mbulimit të ngjarjeve në Kosovë prej medias shqiptare.

Në fakt, ditë përpara dhe menjëherë pas shpalljes së pavarësisë ofrojnë një material të pasur në këtë drejtim: të dyja gazetat e sipërpërmendura e në fakt e gjithë media kryesore në vend, dërguan korrespondentët e tyre për të mbuluar ngjarjet në Kosovë gjatë kësaj periudhe. Këto ditë përbëjnë njëkohësisht edhe burimin kryesor të emocioneve, ngjyrimeve, historive me interes për njerëzit të cilat u shfaqën përgjatë mbulimit të ngjarjeve në Kosovë në këto dy muaj.

Më konkretisht, nëse do ti hidhnim një sy artikujve të gazetës Panorama të datës 17 shkurt, vihet re qartë një atmosferë e gëzueshme dhe titujt të bindin rreth festimeve që ishin duke ndodhur në Shqipëri dhe Kosovë. Disa

nga titujt përfshin fjalë të tilla: "Pavarësia po vjen… flamuj, valle e këngë në Prishtinë"; "Torta e pavarësisë është gati: 25m²"; "Flamur gjiganti në ndeshjen me Ukrainën "mbuloi" Prishtinën"; "Vlorë, rikthehet Pavarësia"; "Festimet për Pavarësinë: Bllokohen rrugët dhe vendparkimet në Tiranë", etj.

Megjithatë pavarësisht të gjithë ilustrimeve pamore të emocioneve e entuziazmit, duhet të jetë e qartë se kjo kahje ishte vetëm në një drejtim: atë të entuziazmit e gëzimit rreth asaj çfarë konsiderohej si një fillim i ri prej disave dhe si një shpagim historik prej të tjerëve. Në asnjë rast dhe për asnjë mënyrë nuk u ndesh ndonjë artikull që i kushtohej pakënaqësisë së serbëve lidhur me këtë çështje. Ngjarjet në Mitrovicë dhe Beograd u paraqitën si lajme me një domethënie jo të veçantë dhe që i përkisnin informacionit të përditshëm. Në këtë mënyrë ndërsa historitë e shumta e të larmishme që erdhën nga Kosova, nuk u përballën me të tjera që vinin nga Serbia, asnjë prej tyre nuk e shtrinte gjykimin mbi serbët.

Në këtë rast, ndoshta të vetmit artikuj që morën anën e dikujt ishin editorialet, komentet dhe analizat. Në fakt kjo periudhë është e pasur me editoriale, shumica e të cila janë drejtpërdrejt të lidhura me të ardhmen e Kosovës, të rajonit e veçanërisht perspektivën e Shqipërisë sa i përket aspekteve ekonomike në këtë drejtim. Duke patur parasysh pozicionin e veçantë të Shqipërisë në rajon përballë pavarësisë së Kosovës, do të ishte me interes dhe rëndësi të analizonim këto editoriale në dy drejtime kyç: lidhur me qëndrimin përballë serbëve dhe zhvillimet e atjeshme dhe në qëndrimin karshi këndvështrimeve rajonale apo së ashtu-quajturës çështja Shqiptare.

Editorialet përballë Serbisë

Asnjë prej editorialeve nuk shfaq ndonjë shqetësim rreth asaj se çfarë po ndodhte në Serbi dhe nuk shpreh asnjë opinion në këtë drejtim, kur kjo çështje të mos ekzistonte. Ndoshta në këtë drejtim mund të veçohet vetëm njëri prej artikujve, një editorial nga Martin Leka.[2] Artikulli përqendrohet tek kritika që artikullshkruesi ka ndaj serbëve por kundër politikanëve serbë me mentalitet të vjetër duke i referuar kryesisht Koshtunicës, duke përdorur terma të tillë si "çlirimi nga skllavërimi serb" dhe "zgjyrë që ekziston akoma ujërave të zeza të Beogradit". Këto janë fjalë shumë të forta dhe në fakt u kushtohen vetëm zhvillimeve në Beograd; ky rast i veçuar është edhe më shumë i tillë teksa vërejmë se ai ka për synim vetëm Koshtunicën dhe klasën e politikanëve që përfaqëson. Në fakt, përmes këtij artikulli, autori është shumë i interesuar të tregoje se ai drejton zemërimin e tij vetëm kundër politikës e jo kundër vetë popullit.

Një editorial tjetër përmend serbët lidhur me një aspekt që i përket krahasimit të nacionalizmit të tyre me atë shqiptar:

> *"Nacionalizmi shqiptar këto ditë shfaqi të njëjtat tipare si çdo nacionalizëm tjetër agresiv në Ballkan. Ai përdori të njëjtin*

2 Martin Leka "Bravo 'druze' Koshtunica", Panorama,18.02.2008, p.1

ligjërim dhe koncepte të nacionalizmit serb, megjithëse e kundërshtoi atë. Të njëjtën logjikë, gjuhë e koncepte të përdorura sot prej shqiptarëve u përdorën dje prej serbëve për të kryer gjenocidin dhe pastrimin etnik kundër shqiptarëve"[3]

Ky artikull ishte i vetmi, i cili vuri në pikëpyetje valën e entuziazmit që kaploi shqiptarët në Kosovë, në Shqipëri dhe vende të tjera. Ai ishte i vetmi zë ndryshe që kështilloi kujdes në këtë drejtim qoftë për serbët dhe shqiptarët, duke shpresuar për një të ardhme ndryshe mes të dy popujve: "Një nacionalizëm ndryshe është ende i mundshëm dhe ai është më i vërtetë se nacionalizmi shtetëror i të drejtave historike që merret aq shumë me të kaluarën dhe harron plotësisht të ardhmen." Në këtë mënyrë, duke hedhur vështrimin tek përjashtimet që përmbajnë të dy editorialet, mund të arrimë në përfundimin se çdo shenjë në shtyp e nacionalizimit ishte mjaft anësore dhe e kufizuar dhe trajtimi i tij ishte me shumë kujdes.

Çështja shqiptare dhe media shqiptare

Një nga shqetësimet kryesore dhe aspektet më interesante gjatë monitorimit të kryer mbi mbulimin prej medias të pavarësisë së Kosovës, ishte edhe diskutimi mbi Shqipërinë e Madhe apo mundësia e tashmë e dukshme që të flitej rreth kësaj çështje. Mesazhi i përcjellë prej politikanëve, intelektualëve, historianëve e të tjerëve rreth kësaj çështje ishte i njëjtësuar: nuk ekziston diçka e tillë e ajo nuk do të ndodhë kurrë.

Më konkretisht, më 17 shkurt gazetat botuan një deklaratë nga kryeministri shqiptar që pohonte se nuk ka ndonjë mundësi për një bashkim të Kosovës me Shqipërinë, duke vënë në dukje se "se të dyja shtetet do të jenë së bashku kur të anëtarësohen në BE"[4]. Dy ditë më vonë njëra nga gazetat botoi një intervistë të ish-kryeministrit Ilir Meta dhe një prej liderëve të opozitës, i cili theksonte se shtetet komb janë diçka që i përket së kaluarës në Evropë. "Unë nuk mendoj se prioriteti ynë është që të krijojmë një shtet komb pasi që këto përpjekje shkojnë kundër frymës së integrimit evropian. Qëllimi ynë është arritja e integrimit të Shqipërisë e Kosovë në BE"[5]

Ndërkohë që politikanët shpejtuan që t'i drejtojnë deklaratat e tyre më shumë për nga integrimi në BE sesa tek nacionalizmi, intervista e analiza të tjera përcollën idenë se nuk ekziston një çështje shqiptare. Në fakt, tek shumë intervista me shkrimtarë e historianë të njohur mbizotëroi teza se kjo ishte një trillim i përdorur për një kohë të gjatë që të pengohej më tej pavarësia e Kosovës.

Kështu, Kristo Frashëri, një historian shqiptar, në një artikull të gjatë, plot me argumente historikë e të botuar në dy pjesë, përpiqet t'i japë përgjigje pyetjes nëse ekziston Shqipëria e Madhe. "Termi Shqipëria e Madhe është

3 Blendi Kajsiu, "Pavaresia e Kosoves, nje shans i humbur", Panorama, 21.02.2008, p.1

4 Tedi Blushi "Berisha: Nuk do te kete bashkim me Kosove, vete, ne BE", Gazeta Shqiptare, 17.02.2008, p.5

5 "Meta: Nuk ka hapesire per shtetet-kombe", Panorama,19.02.2008, p.2

tërësisht një trillim i qarqeve nacionaliste serbe e krijuar thjesht për qëllime të propagandës anti-shqiptare".[6] Nëpërmjet periudhave e ngjarjeve të shumta historike, autori përforcon tezën e tij me argumentet të ndryshëm duke ardhur deri në ditët e sotme teksa thekson se e ardhmja nuk i ofron ndonjë perspektivë Shqipërisë së Madhe "Të dyja vendet Republika e Shqipërisë dhe e Kosovës, e cila pritet të shpallet këto ditë.,, do të jenë dy shtete demokratike, dy republika që synojnë t'i bashkohen BE dhe mes të dyjave tashmë nuk do të ketë më mure, kundërshti politike, por kufij të hapur dhe mundësi të barabarta për të qenë së bashku krah për krah"[7]

Në mënyrë të ngjashme, shkrimtari i mirënjohur shqiptar Ismail Kadare, ndan të njëjtën pikëpamje përmes një interviste të gjatë të botuar rreth kësaj çështje një ditë pas shpalljes së pavarësisë. "Shqipëria e Madhe është një legjendë e fryrë e cila është ndërtuar prej vitesh që ta pengoje Kosovën të bëhet e lirë"[8]

Gjithashtu shkrimtari e përcakton integrimin në BE si qëllimin kryesor të Kosovës dhe Shqipërisë më shumë sesa bashkimin në një shtet komb: "Bota, hapësira dhe universi shqiptar në një Evropë të bashkuar i heq vetvetiu kufijtë dhe e zvogëlon rëndësinë e tyre… Fati më i madh i kombit shqiptar në ditët e sotme është se ideja shqiptare përputhet me idenë Evropiane e nuk i vjen ndesh asaj"[9]. Në këtë mënyrë vërehet një qëndrim i njëjësuar në të gjitha editorialet, të cilat e shikojnë anëtarësimin në BE të Shqipërisë e Kosovës si qëllimin përfundimtar dhe të vetmen fushë në të cilën duhet qe të punojnë së bashku, duke kundërshtuar Shqipërinë e Madhe, çështjen shqiptare dhe çdo formë tjetër që do të përfshinte ndryshimin e kufijve.

Në fakt, pjesa tjetër e editorialeve theksojnë pak a shumë të njëjtën ide dhe i qasen asaj në drejtime shumë konkrete. Pjesa më e madhe e tyre theksojnë pak a shumë përqendrohen tek politikat pragmatike që dihet të ndjekin në të ardhmen e afërt qeveritë e Kosovës e të Shqipërisë në fusha të ndryshme, kryesisht ekonomi, infrastrukturë, zbatimin e ligjit, dhe infrastrukturë. Kështu, ish-presidenti i Republikës z. Rexhep Mejdani shkruan një editorial me titullin "Për një lexim më realist të zhvillimeve"[10], duke lidhur zgjedhjet në Serbi me zhvillimet ekonomike e politike në rajon. Në të njëjtën ditë ish-ministri i financave z.Anastas Angjeli shkruan një analizë të ngjashme rreth një plan mbi zhvillimet ekonomike në Kosovë dhe sesi do të ndikojë mbi Shqipërinë.[11] Një artikull tjetër lidhur me këtë çështje i kushtohet rrugës së shumë diskutuar që do të lidh Durrësin, qytetin më të madh bregdetar të Shqipërisë dhe më të afërtin me kryeqytetin, me një nga pikat

6 Kristo Farsheri, "Teza Serbe e "Shqiperise se Madhe" dhe ribashkimi ne trungun etnik", Gazeta Shqiptare, 16.02.2008, p24-25

7 ibid.

8 "Ne jemi me fat, tashme nuk duhet te frikesohemi me", Panorama, 18.02.2008, p.10

9 ibid

10 Rexhep Mejdani, "Per nje lexim sa me realist te mundshem te ngjarjeve", Panorama,07.02.2008,p.1

11 Anastas Angjeli "Post-pavaresia dhe integrimi ekonomik i Kosoves",Panorama,07.02.2008,p.1

e kalimit të kufirit me Kosovën.[12] Më konkretisht, artikulli përqendrohet në përfitimet e kësaj rruge për të dy vendet nga pikëpamja ekonomike, pas përfundimit të saj.

Njëkohësisht, analistët shqiptarë u shprehën rreth zhvillimit të ardhshëm të aspekte të tjera në këtë shtet të porsaformuar. Kështu, njëri prej tyre analizon në një editorial ardhmërinë e sfidat e zbatimit të ligjit në Kosovë duke e krahasuar me arritjet e Shqipërisë në këtë drejtim.[13] Në të njëjtën ditë, një tjetër analist botoi një editorial që i kërkonte qeverisë shqiptare të fillonte të mendonte në mënyrë pragmatike rreth marrëdhënieve mes shtetit të Kosovës e atij shqiptar:

> *"Ka ardhur koha që politikanët të shmangin retorikën patriotike boshe e të fillojnë të mendojnë me kujdes sesi këto dy pjesë të kombit të nisin e të shkëmbejnë mes tyre njerëz, mallra dhe ide. Nuk duhet të harrohet se kufiri shtetëror mes Shqipërisë dhe Kosovës vazhdon të jetë një ndër më të pakalueshmit në Ballkan., duke patur mangësi të mëdha në infrastrukturë dhe mundësi të tjera komunikimi"*[14]

Si vihet re, në të gjitha editorialet ndeshet një kahje e qartë lidhur me çështjen e Kosovës: duke u marrë me aspektet e ndryshme ato të gjitha kanë një qasje shumë realiste, pragmatike e të orientuar kah e ardhmja. Asnjëra prej tyre nuk e kthen vështrimin mbrapa në të shkuarën apo të përfshijë mosmarrëveshjet historike. Ndërkohë që mohohet në mënyrë të dukshme ideja e Shqipërisë së Madhe, nga ana tjetër mbizotëron ideja se pavarësia e Kosovës duhet të shihet si një mundësi për të dy vendet e rajon që të përshpejtojë integrimin drejt BE.

IV. KONKLUZIONE

Në tërësi mund të pohojmë se mbulimi i ngjarjeve në Kosovë nga të dy gazetat për periudhën janar – shkurt 2008 ishte më së shumti i një dhe nuk ofroi ndonjë të papritur. Të dyja mediat u mbështetën gjerësisht në burimet e jashtme të informacionit (të tilla si mediat apo agjencitë e huaja të lajmeve) për të përcjellë zhvillimet kryesore në Kosovë, Serbi dhe vende të tjera të përfshira në pavarësinë e këtij vendi. Deklaratat nga politikë e diplomatë pushtuan faqet e gazetave në këto raste, duke sjellë një raportim në trajtë protokolli e të besueshëm. Ndërkohë ky lloj raporti ishte sigurisht i drejtë, i saktë dhe objektiv lidhur me të gjitha palët e përfshira, por i mungonte analiza dhe historitë njerëzore mbi problemet e sfidat e përditshme të Kosovës.

Edhe raportimi mbi Ditën e Pavarësisë dhe në ditët e mëpasme nuk

12 Bashkim Kopliku, "Pavaresia e Kosoves, rruga fitimprurese", Gazeta Shqiptare,20.02.2008,p.1

13 Sotiraq Hroni, "Nje rajon i ri, po Shqiperia?", Panorama, 20/02/2008, p.19

14 Skender Minxhozi "Me duar te lira", Panorama, 20/02/2008

kishte ndonjë qasje të ndryshme, megjithëse gazetat kishin dërguar reporterët e tyre për të ndjekur nga afër ngjarjet. Raportimi u përqendrua vetëm në përshkrimin e atmosferës dhe iu kushtua përcjelljes së festimeve pa ndërmarrës asnjë hap që analizonte domethënien e këtij veprimi dhe si do të ndikonte mbi njerëzit në Kosovë dhe në rajon. Editorialet, kryeartikujt, analizat e disa shkrime të botuara në mediat e huaj përbënin të vetmet analiza në këtë drejtim mbi këtë çështje.

Në këtë aspekt është me interes të vërejmë se editorialet nga mediat e huaja të ribotuara në median shqiptare përfshinin edhe ato shkrime që vinin në pikëpyetje apo kundërshtonin pavarësinë e Kosovës. Shumë prej këtyre artikujve të medias së huaj të cilat i kushtoheshin kësaj çështje vërenin nëse kjo lëvizje do të krijonte një precedent për raste dhe probleme të tjera e ndërkohë ato botoheshin pa problem krahas shkrimeve të tjera nga autorë të huaj që argumentonin pavarësinë e Kosovës.

Megjithatë në median shqiptare nuk u vërejt asnjë artikull sado i rrallë kundër pavarësisë së Kosovës prej gazetarëve apo editorialistëve shqiptarë. Qoftë gazetarët apo politikanët kishin pak a shumë të njëjtin qëndrim: Pavarësia e Kosovës pritej të ndodhte herët a vonë dhe drejtësia e saj nuk vihej në diskutim. Pa ndonjë përjashtim të veçantë, të gjithë artikujt në këtë drejtim ishin në mendje lidhur me të drejtën e Kosovës për të gëzuar më në fund të drejtën për pavarësi, por ndërkohë parapëlqenin të përqendroheshin më shumë tek aspektet pragmatike të së ardhmes së afërt apo të largët sesa të merreshin aspektin nacionalist të kësaj çështje.

Në këto rrethana, është e rëndësishme të vërejmë se megjithëse analistët shqiptarë shkruanin mbi çështje të ndryshme, pajtoheshin në qasjen e tyre. Asnjë prej tyre nuk u përqendrua tek aspektet e së shkuarës apo ato me karakter historik, ashtu si edhe nuk shfaqën ndonjë interes për tezën e Shqipërisë së Madhe; ata të gjithë përshtatën një qasje pragmatike duke u përqendruar tek përfitimet afatshkurtra e afatmesme që rridhnin prej pavarësisë qoftë për të dyja vendet apo dhe rajonin në tërësi. Mund të pohojmë me siguri se frika që ekzistonte për ndjenja nacionaliste që mund buronin prej editorialeve u zëvendësua pa mëdyshje me retorikën se Kosova dhe Shqipëria duhet të bashkoheshin nëpërmjet integrimit në BE, e kjo duhet të përbënte shqetësimin e tyre kryesor.

BIBLIOGRAFIA

Angjeli, Anastas "Post-pavaresia dhe integrimi ekonomik i Kosovës", Panorama,07.02.2008,p.1

Blushi, Tedi "Berisha. Nuk do te ketë bashkim me Kosoven, vetem me BE" Gazeta Shqiptare, 17.02.2008, p.5

Frasheri, Kristo, "Teza Serbe e" Shqipërisë së Madhe" dhe bashkimi me trungun etnik", Gazeta Shqiptare, 16.02.2008, p.24-25

"Haxhi Thaçi: Unë jam krenar qe vendi im do te shpalle pavaresine", Panorama, 10.02.2008, p.14

Hroni, Sotiraq. "Nje rajon i ri, po Shqipëria", Panorama, 20.02.2008, p.19

Kajsiu, Blendi. "Pavaresia e Kosoves, një shans i humbur", Panorama, 21.02.2008, p.1

Kopliku, Bashkim. "Pavaresia e Kosoves, rruga efektive", Gazeta Shqiptare, 20.02.2008, p.1

Leka, Martin. "Bravo,"druze Koshtunica", Panorama, 18.02.2008, p.1

Meidani, Rexhep "Per nje lexim realist sa me te mundeshem te ngjarjeve", Panorama, 07.02.2008, p.1

Meta: "Nuk ka me vend per shtetet –komb", Panorama, 19.02.2008, p.2

Minxhozi, Skender. "Me duar te lira", Panorama, 20.02.2008, p.19

"Ne ishim me fat, tashme nuk duhet te kemi me frike", Panorama, 18.02.2008, p.10



BOSNJA DHE HERCEGOVINA

Amer Dzihana



VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Në kuadër të projektit studimor rajonal, Qendra e Medias në Sarajevë (Mediacentar) realizoi një analizë sasiore e cilësore të mbulimit të ngjarjeve në Kosovë prej medias boshnjake menjëherë para dhe pas periudhës së shpalljes së pavarësisë. Për këtë qëllim u përzgjodhën dy gazeta të përditshme në këtë vend – Dnevni Avaz dhe Nezavisne Novine – dhe u analizuan mënyrat sesa ato përmes botimit të shkrimeve të tyre raportuan rreth ngjarjeve në Kosovë.

Pjesa e analizës sasiore të këtij studimi u realizua duke përdorur metodologjinë e përbashkët të hartuar për nevojat e këtij projekti nga grupi kërkimor i Institutit Maqedonas për Media. Kërkesa kryesore ishte që të pasqyroheshin të gjithë artikujt ku shfaqej fjala Kosovë apo Kosmet përgjatë periudhës nga 1 janari 2008 deri me 29 shkurt 2008. Në fund u evidentuar rreth 854 artikuj- 440 në gazetën Nezavisne Novine dhe 414 në Dnevni Avaz. Në këtë proces nuk u përfshi përmbajtja e artikujve që bënin pjesë tek rubrikat e biznesit apo seksioneve të tjera të gazetës që nuk lidheshin me çështjet aktuale. Lidhur me aspektin cilësor të analizës ajo u krye lidhur me mbulimin prej gazetave Avaz dhe Nezavisne Novine të demonstrative që u zhvilluan në Beograd dhe Banja Llukë në prag dhe menjëherë pas deklaratës së pavarësisë së Kosovës. Në periudhën mes 17-19 shkurtit 2008 u botuan 10 artikuj në gazetat e sipërpërmendura. Një vëmendje e veçantë iu kushtua titujve të artikujve, fjalëve të përdorura për të përshkuar ngjarjet dhe protagonistët, strukturës së artikujve dhe ngjarjeve nuk u përmendën. Qëllimi i kësaj analize ishte që të tregonte se çfarë strategjish përdorën gazetat përgjatë mbulimit prej tyre të kësaj ngjarje si dhe marrëdhënia e këtij procesi me pozicionin e përgjithshëm të shprehur nga strukturat politike boshnjake dhe serbo-boshnjake sa i përket interpretimit të saj.

I. RRETHANAT POLITIKE(QËNDRIMET POLITIKE VENDASE NË DREJTIM TË KOSOVËS)

Strukturat politike të Bosnjës dhe Hercegovinës nuk paraqitën një qëndrim të njëjtësuar lidhur me pavarësinë e Kosovës. Nga njëra anë partitë politike kroate e boshnjake e shikonin deklaratën e pavarësisë si aktin përfundimtar në shpërbërjen e përgjakshme të Jugosllavisë. Megjithatë shqetësimi i tyre kryesor përgjatë ngjarjeve që lidhshin me deklaratën e pavarësisë së Kosovës, ishte që të parandalonin një kapërcim të krizës së Kosovës në Bosnjë dhe Hercegovinë. Haris Silajxhiq, anëtari boshnjak i Presidencës së Bosnjës dhe Hercegovinës deklaronte se "Kjo është një çështje e një shteti tjetër dhe e komunitetit ndërkombëtar. Nëse Beogradi zyrtar kërcënon integritetin dhe sovranitetin e Bosnjës dhe Hercegovinës, atëherë ajo shndërrohet edhe çështja jonë. Fatkeqësisht kështu ndodhi në të shkuarën, …B-H ka nevojë për stabilitet, rregull paqe dhe jo trazira" (Fena, 2008).

Nga ana tjetër, partitë politike serbe e shikonin deklaratën e pavarësisë si një tjetër formë të padrejtësisë që po ushtrohej mbi serbët me mbështetjen e komunitetit ndërkombëtar. Deklarata e njëanshme e shpalljes së pavarësisë së Kosovës u shikua prej Nebojsha Radmanoviq, anëtar serb i Presidencës së B-H, si një shkelje e rregullit për të zgjidhur me marrëveshje situatat që përmbanin konflikt "Dikush e shkel në mënyrë të njëanshme atë dhe u dërgon në këtë mënyrë mesazhin B-H, Presidencës së saj dhe popullit në këtë vend se është e mundur që çështja e Kosovës të zgjidhet me mënyrë tjetër nga marrëveshja" (Beta, 2008)

II. KARAKTERISTIKAT E SISTEMIT TË MEDIAS- KONTEKSTI I MEDIAS

Bosnja dhe Hercegovina u gjend në fund të luftës me tre sisteme medias të ndara etnikisht. Me kalimin e viteve, media filloi ti kushtohej paqes duke miratuar norma të ndryshme profesionale. Si rezultat I reformës legjislative në fushën e medias, gazetat tashme nuk janë subjekt i rregullimeve ligjore për politikën editoriale dhe përmbajtjen. Struktura më e lartë vet-kontrolluese e ngarkuar me zbatimin e Kodit të Shtypit është Këshilli i Shtypit, një organizatë e pavarur joqeveritare. Këshilli i Shtypit u krijua më fund të vitit 2000 dhe filloi të funksiononte në 2001 si struktura e parë vet-rregullatore në rajon (Haliloviq, 2007).

Të gjitha organet e shtypit të shkruar në Bosnjë dhe Hercegovinë janë private. Sot në këtë vend janë 11 gazeta të përditshme por një pakicë e tyre ka një qarkullim të përditshëm domethënës (VZS 2008). Ndërkohë, pavarësisht një numri reformash, pikëpamja etnocentrike është ende mbizotëruese në mënyrën e raportimit prej gazetave. Për më tej, të dhënat e studimit dëshmojnë se edhe lexuesi është i ndarë etnikisht. (GFK B-H, 2006). Si shkruan Ceco "Megjithëse media është rikthyer paqes, pikëpamja e tyre etnocentrike është ënde e pranishme, dhe megjithëse gjuha e urrejtjes mund të duket në shikim

të parë shumë e largët, ndikimi i saj ende vazhdon ; ajo nuk është harruar"(Ceco 2007).

Dnevni Avaz është deri tani gazeta më e lexuar në Bosnje dhe Hercegovinë. Studimi tregon se përqindja e lexuesve të gazetës në nivelin e B-H, më shumë se ajo e konkurrentes së saj të parë, gazetës Blic të Serbisë e cila rendit në një nivel prej 10%.

Ndërkohë edhe Dnevni Avaz është më e lexuara mes popullsisë boshnjake. Studimet reagojnë se pothuajse 70% e lexuesve të Dnevni Avaz vijnë nga komunitetet me shumicë boshnjake (GfK B-H 2006). Në të njëjtën kohë, kjo gazetë pak a shumë dëshmon haptazi se ky është lexuesi tek i cili ajo përqendrohet më shumti. Ky aspekt është i dukshëm teksa vërejmë se ajo mbulon kryesisht ngjarje që i përkasin komuniteteve ku banojnë boshnjakë, pjesë e popullsisë së B-H, apo të rikthyerit në Republikën Srpska. Nga ana tjetër kjo gazetë i kushton në mënyrë të rregullt një vend të veçantë liderit kryesor të Bashkësisë Islame në B-H qoftë duke ndjekur rregullisht aktivitetet e tij apo edhe duke paraprirë lutjet e të përjavshme (hutba) me anë të një reklame kryesore në këtë media.

Gazeta Nezavisne Novine filloi nga aktiviteti më 1996 dhe nuk ka qenë një projekt kaq i suksesshëm sa Avaz. Megjithatë ajo është shumë e suksesshme në Republikën Srpska dhe mund të jetë i pritshëm një ndikim e zhvillim i saj i mëtejshëm në tregun e medias, veçanërisht duke patur parasysh se në vitin 2008 ia kaloi konkurrentit të saj kryesor nga Republika Srpska, gazetës Glas Srspke. Sipas të dhënave të studimit lexuesit e Nezavisne Novine përbëjnë rreth 2% të numrit të përgjithshëm në shkallë vendi. Megjithëse kjo gazetë ka një politikë editoriale që përpiqet ta bëjë tërheqëse atë, në të gjithë territorin e B-H, lexuesit e saj më së shumti gjenden në zonat e populluara prej serbëve. Në këtë mënyrë, përqindja e lexuesve të Nezavisne Novine mes kësaj popullsie është 6% (GfK, B-H, 2006). Kjo gazetë është ndër të parat në Republikën Srpska që ngriti çështjen e krimeve të luftës të kryera nga boshnjakët dhe kroatët. Si rrjedhojë pronarin e saj Zheljko Kopanja u përpoqën që ta vrisnin dhe ai i mbijetoi atentatit me vështirësi duke pësuar një sërë plagësh të rënda. Megjithatë, në periudhën e fundit gazeta Nezavisne Novine është lidhur mjaft fort me partinë qeverisëse në Republikën Srpska, Bashkimin e Social-Demokratëve të Pavarur (SNDS). Kjo lidhje e ka dëmtuar imazhin e saj për shkak se SNDS përdor një retorikë të hapur nacionaliste për të arritur qëllimet e saj.

III. ANALIZA E REZULTATEVE TË STUDIMIT

Të dyja gazetat, përgjatë periudhës kur raportonin për Kosovën përdorën shumë shpesh lajme dhe lajme të zgjeruara si një ndër llojet e shkrimit gazetaresk. Në të njëjtën kohë, edhe Dnevni Avaz e Nezavisne Novine botuan gjerësisht edhe njoftimet për shtyp e deklaratat. Nga ana tjetër dallimet mes këtyre dy gazetave bëhen më të dukshme, kur krahasojmë përdorimin e formave sa më të stërholluara të shkrimit. Kështu Dnevni Avaz botoi më shumë korrespodenca/analiza/intervista dhe ofroi mbulim më të gjerë të

ngjarjes sesa Nezavisne Novine. Këto të dhëna lidhen me nivelin e përgjithshëm të cilësisë së këtyre gazetave. Përkatësisht, Dnevni Avaz dërgoi korrespondent e saj në Prishtinë e Beograd gjatë kohës kur shpalli pavarësinë Kosova, ndërkohë që Nezavisne Novine u mbështet tek agjencitë e lajmeve.



Grafik 1: Lloji i tekstit

Përdorimi i ilustrimeve që shoqëronin tekstin, gjithashtu vërteton pohimin e sipërpërmendur rreth cilësisë së këtyre gazetave. Dnevni Avaz përdori më shpesh fotografi sesa Nezavisne Novine.



Grafik 2: Ilustrimi- Tipi

Megjithatë niveli i përgjithshëm i profesionalizmit tek të dy gazetat është ende i ulët dhe kjo shfaqet veçanërisht në rastin e Dnevni Avaz për shkak se 2/3 e shkrimeve në këtë gazetë nuk kanë emër në fund dhe e ke të pamundur të pohosh se cili është autori i artikullit.



Grafik 3: Autori i tekstit

Përveç çështjes së cilësisë e profesionalizmit është me rëndësi të kuptojmë edhe strategjinë e këtyre gazetave kur paraqesin ngjarjet që lidhen me pavarësinë e Kosovës. Me qëllim që të kuptojmë më mirë mënyrën sesi Dnevni Avaz dhe Nezavisne Novine raportuan mbi Kosovën ne do të hedhim një vështrim më nga afër lidhur me mbulimin prej tyre të demonstrative që u zhvilluan në Beograd dhe Banja Llukë, në prag dhe menjëherë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Dnevni Avaz

Qëndrimi i përgjithshëm i shkrimeve, nëpërmjet të cilave u interpretua konflikti i gjatë i Kosovës duke përfshirë edhe shpalljen e pavarësisë, në këtë gazetë u paraqiteshin kryesisht duke bërë përgjegjës politikën e Sllobodan Milosheviqit i cili e thelloi krizën ekzistuese në Kosovë dhe u përpoq ta zgjidhte me mjete ushtarake. Në një artikull analitik të titulluar "Shqiptarët vuajtën derdhën gjak dhe luftuan për vendin e tyre" në një mbishkrim të vendosur mbi titull, lexojmë "Si filloi e gjitha kjo: Kosova që nga ardhja e Sllobodan Milosheviqit e deri më sot". Nga ana tjetër, pakënaqësia e grupeve të ndryshme shoqërore në Kosovë, Serbi dhe pjesë të B-H u paraqit

përmes shpërthimit të dukshëm të emocioneve të grupeve nacionaliste që nuk pajtoheshin me vlerat bashkëkohore të jetës. Në artikujt që do të analizojmë, ne do të tregojmë saktësisht sesi u vu në dukje kjo karakteristikë e demonstratave. Në të dëshmohet se grupet e pakënaqura nuk janë luftëtarë për të mbrojtur të drejtën ndërkombëtare, por protestues që nuk do përmbaheshin nga përsëritja e masakrave jo thjesht në Kosovë por edhe në pjesë të tjera të Jugosllavisë. Është me rëndësi që të vërejmë se ky lloj interpretimi përputhet me atë të politikanëve kroatë e boshnjakë. Por ata, veçanërisht politikanët boshnjakë nuk e vënë në pah këtë interpretim por më së shumti përpiqen të deklarojnë se kriza nga Kosova nuk duhet të kalojë në B-H.

Dnevni Avaz, në periudhën nga 17-19 shkurt 2008 botoi 3 artikuj mbi protestat në Beograd dhe 2 të tillë mbi demostratat në Banja Llukë. Nga shumë prej titujve të shkrimeve ishte mëse e qartë se ato ishin manifestimeve nacionaliste që dolën pjesërisht jashtë kontrollit. Kjo është e dukshme në të dy titujt e korrespondencave mbi protestat në Beograd ku lexojmë "Vritini, therini, kështu nuk do të ketë më shiptarë[1]" (Huremoviq 2008); "Kaos në Beograd" (Huremoviq 2008); "Djordjevic: Do të luftojmë sërish në Kosovë"(Huremoviq 2008) ashtu si edhe tek ato shkrime që pasqyronin protestat në Banja Llukë. "Në sheshin Krajina digjet flamuri shqiptar" (V.S.2008) "Ambasadat e huaja sulmohen me gurë" (Spaseviq 2008). Përgjatë këtyre titujve artikujt nuk harronin të përmendin këngët e kënduara që u kushtoheshin çetnikëve dhe parullat e ndryshme nacionaliste që hidheshin prej protestuesve të tilla: "Ai që nuk jeton është shqiptar" dhe "Vritini, therini shqiptarët që të mos jenë më" (Huremoviq 2008) ; ndërkohë që protestuesit përdornin përshëndetje nacionaliste e mbanin në duar simbole karakteristike çetnike.

Në të gjithë artikujt e botuar nga Avaz mbi marshimet e protestës, karakteri i dhunshëm e plot incidente ishte vendosur në fillim, ndërkohë që qëllimet e shprehura prej organizatorëve të protestës, sipas të cilave ato po protestonin në shenjë të mbështetjes së serbëve të Kosovës e studentëve, p.sh duke shprehur pakënaqësinë ndaj dhunimit të së drejtës ndërkombëtare, qëndronin në sfond të artikullit.

Karakteri dramatik i këtyre ngjarjeve u vu në pah nëpërmjet përdorimit të ndajfoljeve dhe mbiemrave. Kështu demonstruesit "u përleshën egërsisht" me "forcat e rrepta të policisë", u dëgjuan shumë "shpërthime të forta" (Huremoviq, 2008). Demonstruesit e Banja Llukës u përshkruan si "masa të zemëruara dhe agresive" të cilat thërrisnin "Jashtë" dhe "Ustasha" si dhe përdhosnin flamurin e B-H.

Një mënyrë tjetër, me anë të së cilës u përforcua më tej karakteri dramatik i marshimeve të protestës, u shpreh përmes përshkrimit me hollësi të incidenteve. Arsenali i pazakontë i mjeteve të përdorura prej demonstruesve gjatë sulmeve të tyre, u përshkrua me detaje. "Demonstruesit iu përgjigjën

1 shiptar - fjalë tejet fyese për shqiptarët në gjuhët sllave

kordonit të policisë me gurë, shkopinj metali e druri dhe objekte të tjera që mbanin në duar. Ndërkohë ata përdorën edhe shenjat e shkulura të trafikut e kazanët e mbeturinave" (Huremoviq, 2008).

Gjithashtu u evidentuan të gjitha rastet e sjelljeve të dhunshme, duke i mundësuar lexuesit që të kuptonte në mënyrë sa më të plotë karakterin e demonstratave të Beogradit. Kështu "qindra demonstrues shpërthyen kordonin e policisë duke thyer dyer, dritare e shkatërruan fasadën e grisën flamujt e Sllovenisë e BE" (Huremoviq, 2008). Reporter i Dnevni Avaz teksa interpretonte marshimet e protestës në Beograd i referohej një analisti të paidentifikuar në këtë qytet që deklaronte se "Serbia ka humbur një betejë tjetër mediatike para syve të komunitetit ndërkombëtar. Përkatësisht, ndërsa po dërgoheshin nga Prishtina pamjet e festimit të qytetëruar me tingujt e "Odes së Gëzimit", prej Beogradit vinin pamjet e nacionalistëve shkatërrimtarë që u kishin dhënë hov instiktive të tyre".

Nezavisne Novine

Përgjatë periudhës së mbulimit të ngjarjeve në Kosovë, Nezavisne Novine ndoqi politikën zyrtare të Republikës Srpska e cila theksonte se qytetarët e kësaj republike duhet të shprehnin pakënaqësinë e tyre mbi deklaratën e pavarësisë së Kosovës, por duhet ta bënin këtë në mënyrë të qytetëruar për të mos dëmtuar interesat e Republikës Srpska. Një deklaratë e përbashkët mes Presidentit, Kryetarit të Parlamentit e Kryeministrit të kësaj Republike deklarohej se "Qytetarët e Republikës Srpska kanë të drejtën legjitime të shprehin në mënyrë paqësore e dinjitoze pakënaqësinë e mosmiratimin e tyre me deklarimin e njëanshëm të pavarësisë së Kosovës e Metohisë" dhe më pas theksonin se "çdo incident, provokacion apo veprim i dhunshëm vetëm do të dëmtojë Republikën Srpska, vullnetin e stabilitetin e saj politik si dhe do të përbëjnë akte të qëllimshme kundër interesave të kësaj Republike" (Popovic, 2008). Në raportimin e protestave të Banja Llukës kundër pavarësisë së Kosovës, Nezavisne Novine nxjerr në pah justifikimin e tyre e në të njëjtën kohë theksonte karakterin e tyre të qytetëruar. Incidentet u mbuluan në mënyrë shumë të pakët në një përpjekje për të zvogëluar domethënien e tyre. Titujt e artikujve mbi demonstrate mund të klasifikohen në dy grupe. Në grupin e parë janë titujt asnjanës: Protesta në Beograd (Nezavisne Novine,2008) apo Përleshje në Beograd (Beta, 2008) e në grupin e dytë janë titujt që përcjellin mesazhe politike të tilla si: "Kosova, pjesë e Serbisë" (Agencije, 2008), "Ne nuk e japim Kosovën" (Mlinareviq 2008) apo që vënë në pha karakterin paqësor të marshimeve të protestës: "Protestë paqësore në Banja Llukë" (M.M, 2008)

Praktikisht mund të vërehet e njëjta kahje edhe tek artikujt. Nga njëra anë shumë korrespondenca janë plot me fakte sa i përket marshimeve të protestës e pa i cilësuar ata që morën pjesë në demonstrime. Nga ana tjetër u është dhënë hapësirë atyre shpjegimeve për ngjarjet të cilat theksojnë mospranimin e shkeljes së rregullave të të drejtës ndërkombëtare. P.sh rek-

tori i universitetit të Beogradit Branko Kovaçeviq u citua teksa u deklaronte protestuesve të mbledhur në shesh "Ju jeni këtu përsëri për tu kundërvënë ndaj padrejtësisë që është bërë një vendi sovran. Ju jeni këtu me plot të drejtë (Agencije, 2008). Rektori i Universitetit të Banja Llukës u citua teksa u pohonte demonstruesve në këtë qytet se "deklarata e pavarësisë së Kosovës e Metohisë ishte forma më e qartë e dhunimit të së drejtës ndërkombëtare" dhe se "studentët tanë ashtu si edhe profesorët e asistentët ofrojnë pa mëdyshje mbështetjen për të luftuar për të drejtën ndërkombëtare e cila është lufta për sundimin e ligjit në marrëdhëniet mes shteteve në Europë dhe Botë" (Mlinareviq, 2008)

Qëllimi kryesor i Nezavisne Novine është krijimi i një panorame me marshime proteste paqësore e dinjitoze, veçanërisht në Banja Lluka kryeqyteti i Republikës Srpska. Përdhosja në rrugët e Banja Llukës të flamujve shqiptarë e të B-H ashtu si edhe thirrjet luftënxitëse në marshimin e protestës për të cilat raportoi Dnevni Avaz, sipas gazetës Nezavisne Novine nuk ndodhën.

Për më tepër, megjithëse një reporter i Nezavisne Nove ishte në terren së bashku me protestuesit, në fund të rubrikës së lajmit ai deklaronte "Si bëri të ditur CJB (Qendra për Sigurinë Publike e Banja Llukës, dita e djeshme ishte shumë e qetë" (M.M,), duke nënvizuar kështu përmes këtij pohimi karakterin paqësor të marshimit të protestës.

Në ditën e dytë të protestave kur u qëlluan me gurë godinat e konsullatave të huaja, Nezavisne Novine e mbuloi këtë incident në mënyrë krejt kronologjike, duke i kushtuar fillimisht hapësirën e saj vetë marshimit të protestës dhe mesazheve të tij e vetëm më tej incidenteve të papëlqyeshme që pasuan. Ndërkohë vihet re se organizatorët e protestës kishin deklaruar se incidentet ndodhën pasi kishte mbaruar demonstrimi prej tyre. Kjo nënkuptonte se qytetarët kishin lëvizur drejt godinës së konsullatës së SHBA në mënyrë rastësore "Forca të shumta policie i ndaluan ata që t'i afroheshin godinës së konsullatës çka i egërsoi demonstruesit që e qëlluan atë me gurë e vezë duke thërritur "Ju keni tradhtuar shtetin"; "Ju na keni tradhtuar ne" (Mlinareviq 2008). Korrespondenca mbi këtë ngjarje nënvizon veçanërisht se vetëm një numër i vogël demonstruesish arritën t'i shmangen policisë e të arrijnë godinën e Konsullatës së SHBA nëpërmjet rrugëve anësore. Megjithatë, si shkruan edhe Nezavisne Novine, atje po i prisnin policë civilë të cilët i ndaluan që të mos shkaktonin ndonjë incident.

IV. KONKLUZIONE

Dallimet mes dy gazetave lidhur me paraqitjen e ngjarjeve të sipërpërmendura janë shumë të dukshme. Nëse lexuesit detyrohen që të krijojnë një përfytyrim të protestave në Beograd e Banja Llukë me rastin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës,vetëm në bazë të këtyre dy gazetave, nuk ka asnjë dyshim se ato do të gjendeshin para një dileme rreth asaj se çfarë ka ndodhur

në të vërtetë. A e shprehën në përgjithësi në mënyrë paqësore protestuesit pakënaqësinë e tyre ndaj dhunimit të së drejtës ndërkombëtare, me pak incidente si mëton gazeta Nezavisne Novine apo te këto protesta demonstruesit e përfshirë në to kundër pavarësisë së Kosovës ishin qëllimisht në rrugë për të dërguar mesazhe luftënxitëse si i portretizon Dnevni Avaz.

Megjithatë është e qartë se dallimet mes të dy gazetave, sa i përket ngjarjes së Kosovës, përputhen me ato të strukturave politike të Bosnjës dhe Hercegovinës lidhur me këtë çështje. Boshnjakët dhe kroatët nga njëra anë të cilët e shikojnë deklaratën e pavarësisë së Kosovës si aktin përfundimtar të shpërbërjes së përgjakshme të ish-Jugosllavisë dhe të serbëve nga ana tjetër që e shohin si një formë padrejtësie ndaj tyre me mbështetjen e komunitetit ndërkombëtar. Tashmë është e njohur se ekziston një përputhje e plotë mes qëndrimit zyrtar të strukturave qeverisëse në Republikën Srpska dhe mënyrës sesi i mbuloi protestat gazeta Nezavisne Novine, veçanërisht demonstrimet në Banja Llukë. Nga ana tjetër gazeta Dnevni Avaz përgjatë mbulimit të kësaj ngjarje i shmanget pjesërisht qëndrimit zyrtar të politikës boshnjake e cila ka nxjerrë një pah si përparësi të saj mosndërhyrjen në rastin e Kosovës duke u përpjekur ta izolojë atë prej rastit të Bosnjës dhe Hercegovinës. Por ndërkohë ai përputhet plotësisht me qëndrimin e shumicës së partive politike boshnjake sipas të cilit zgjidhja e krizës së Kosovës duhet të shihet kryesisht përmes këndvështrimit të politikës që ndoqi Sllobodan Millosheviqi.

Studimi i realizuar me këtë rast nuk mund tu japë përgjigje pyetjeve që i takojnë thelbit të lidhjeve mes elitës politike e gazetave që kryejnë mbulimin e ngjarjes, megjithëse është e qartë se qëndrimet e gazetarëve e politikanëve janë të njëjta. Por nga analiza e kryer mund të arrihet në përfundimin se nuk ekziston një kuadër i vetëm i mënyrës së të shkruarit në gazetat e B-H prej të cilit buron paraqitja e ngjarjeve që shkaktoi pavarësia e Kosovës. Në vend të saj gjenden konsensuse të karakterit etno-nacional të elitave politike, të njerëzve që jetojnë në B-H (boshnjakë, serbë, kroatë) dhe ato përbëjnë kuadrin fillestar për të interpretuar ngjarjet e analizuara.

Më tej, analiza e strategjive të këtyre dy gazetave, që portretizuan marshimet e protestës në Beograd e Banja Llukë, tregon se vënia në pah e aspekteve të caktuar të ngjarjeve që kanë mbuluar – përmes përzgjedhjes së titujve, krijimit të një strukture përparësish brenda artikujve, zgjedhjes së mjeteve gjuhësore për të përshkruar ngjarjet e protagonistët- ashtu si edhe dështimi për të mos përmendur aspekte të tjera të tyre që nuk i shkonin për shtat një modeli të paracaktuar informimi, janë ndër mekanizmat kryesorë për të krijuar pamjen e parapëlqyer për një ngjarje kundërvënëse.

BIBLIOGRAFI

Agencije 2008, 'Kosovo dio Srbije', Nezavisne novine, 19 Feb 2008, p. 3

Beta, 2008, 'Radmanović: Proglašenje nezavisnosti dovešće do krize u regionu', viewed 2nd July 2008, <http://www.mfa.gov.yu/Srpski/Bilteni/Srpski/b160208_s.html>

Beta, 2008 a, 'Neredi u Beogradu, Nezavisne novine, 18 Feb, p. 2

Čečo, I 2007, 'Bosnia and Herzegovina' in Media Development Centar, Sofia (ed.), Freedom of Speech in South East Europe: Media Independence and Self-Regulation, pp- 394-423, viewed 2nd July 2008, < http://www.mediacenterbg.org/documents/Biblioteka/SEENPM_book_new.pdf >

Dnevni Avaz 2008, 'Albanci su patili, krvarili i borili se za svoju državu', Dnevni avaz, 17 Feb, p.10

Fena, 2008, Silajdžić: Nadležne institucije u B-H spremne odgovoriti zadatku, viewed 2nd July 2008, <http://bosnjaci.net/prilog.php?pid=23170>

GfK B-H 2006, 'Daily newspapers in B-H', viewed 7th June 2008, <http://www.gfk.ba/PR/2006/GfK%20PR%2002-2006%20-%20dnevne%20novine.pdf>

Halilović, M 2007, 'Bosnia and Herzegovina' in Media Development Centar, Sofia (ed.), Freedom of Speech in South East Europe: Media Independence and Self-Regulation, pp- 64-94, viewed 2nd July 2008, <http://www.mediacenterbg.org/documents/Biblioteka/SEENPM_book_new.pdf >

Huremović, E 2008, 'Ubij, zakolji da Šiptar ne postoji', Dnevni avaz, 17 Feb, p. 9

Huremović, E 2008 a, 'Haos u Beogradu', Dnevni avaz, 18 Feb, p. 9

Huremović, E 2008 b, 'Haos u Beogradu', Dnevni avaz, 19 Feb, p. 9

Mlinarević, M 2008, 'Ne damo Kosovo', Nezavisne novine, 19 Feb, p. 4

M.M 2008, 'Miran protest u Banjaluci', Nezvisne novine, 18 Feb, p. 4

Nezavisne Novine 2008, 'U Beogradu protesti', 17 Feb, p. 3

Popović, V 2008, 'Neprihvatljiv akt razbijanja Srbije', Nezavisne novine, 18th February, p.4

Spasenić, B 2008, 'Kamenovani uredi stranih ambasada', 19 Feb, p. 11

V.S. 2008, 'Na Trgu Krajine zapaljena albanska zastava', Dnevni avaz, 18th February, p.9



BULLGARIA

Yana Pelovska



VËSHTRIMI I PËRGJITHSHËM

Kjo pjesë e studimit përfshin aspekte të shumta lidhur me situatën në Kosovë, e secila prej tyre hedh dritë nga një kënd i ndryshëm shikimi duke na çuar drejt përfundimeve konkrete, sa i përket mbulimit të kësaj çështje nga media në Bullgari.

Këndvështrimi i përgjithshëm mbi rrethanat politike përbën një bazë të rëndësishme për të shpjeguar reagimin përkatës të medias ashtu si edhe përmbledhja mbi karakteristikat e sistemit të saj në Bullgari, na ndihmon që të kuptojmë më qartë rezultatet e vëzhgimit. Rezultatet e veçanta të studimit, të ndara në kategori konkrete më vete, në përputhje me kuadrin e përgjithshëm metodologjik, marrin në shqyrtim aspektet e ndryshme editoriale të mbulimit prej medias të ngjarjes së Kosovës. Shkurtimisht mund të pohojmë se shumica e artikujve të marrë në shqyrtim për këtë qëllim, fillojnë në një faqe tjetër prej faqes së parë: në më të shumtën e rasteve ato përfshihen në llojin e lajmeve të zgjeruara me autor departamentin e lajmeve duke përdorur në pjesën më të madhe të tyre më shumë se një burim të saktë të cituar dhe rasti për të cilën shkruajnë është një situatë deri në momentin e ngjarjes së vërtetë; raporti mes titullit/nëntitull më së shumti më së shumti përmban një mesazh që vë në pah pjesërisht temën për të cilën është realizuar shkrimi dhe raporti ilustrimeve ndaj përmbajtjes i përgjigjet në pjesën më të madhe vetë mesazhit; në pothuajse gjysmën e artikujve, veprimi në artikullin e shkruar nuk ndodh në Bullgari dhe i referohet lëvizjeve diplomatike me jashtë. Rezultatet e studimit shoqërohen e dëshmohen me citime nga artikujt e marrë në shqyrtim. Të gjitha këto këndvështrime të ndryshme të mbulimit prej medias në Bullgari të çështjes së Kosovës, diskutohen më në hollësi në pjesën e analizës së thelluar të raportimit dhe pasohen prej konkluzioneve të veçanta që janë në mënyrë të përmbledhur rezultatet e studimit.

I. RRETHANAT POLITIKE(QËNDRIMI I POLITIKËS VENDASE NË DREJTIM TË KOSOVËS)

Më 19 mars 2008, në një deklaratë të përbashkët, Bullgari, Kroacia dhe Hungaria shpallën zyrtarisht se do të njohin pavarësinë e Kosovës "Deklarata e Kosovës për pavarësinë pason të gjithë përpjekjet e dështuar të komunitetit ndërkombëtar për të gjetur një marrëveshje të përbashkët mes Beogradit e Prishtinës lidhur me statusin e Kosovës. Në këto rrethana ishte e pashmangshme ndryshimi i status-quosë së pafundme", citonte mes të tjerave kjo deklaratë.

Në këtë deklaratë të përbashkët, botuar njëkohësisht në Sofje, Zagreb, Budapest, të 3 shtetet kufitare me Serbinë pohonin se ata mbështesnin forcimin e marrëdhënieve me Serbinë e BE e se prisnin që të vazhdonin marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë me Serbinë e lidhjet e forta tradicionale me popullin e saj. "Bullgaria vendosi ta njihte Kosovën sepse Beogradi dhe Prishtina nuk mundën të arrinin një marrëveshje mbi statusin e rajonit dhe situatën e përkeqësuar…" deklaronte ministri i punëve të jashtme ë Bullgarisë Ivaylo Kalfin. Kryeministri bullgar Sergi Stanishev pohonte se Bullgaria do të vendosë marrëdhënie diplomatike me Kosovën sa më shpejt që të hapen ambasadat. Deri më 19 mars 2008, republikën e Kosovës të dalë nga Deklarata e Pavarësisë e 17 shkurtit e kishin njohur 30 shtete. Shumë njerëz në Bullgari nuk ishin të lumtur për këtë lëvizje duke e quajtur Kosovën një shtet kriminal. Ata deklaronin se duke e njohur Kosovën si shtet, ajo do të ishte një bombë me sahat për sigurinë kombëtare.

Një sondazhi i opinionit mbi pavarësinë e Kosovës i realizuar nga Qendra Kombëtare për Kërkime të Opinionit Publik[1](www.parliament.bg) dhe i botuar në 28 shkurt 2008 në TRUD, tregonte se 2/3 e bullgarëve nuk ishin në gjendje të vlerësonin apo komentonin qëndrimin zyrtar të Bullgarisë në këtë çështje, përkatësisht se Bullgaria duhet ta njihte Kosovën por jo menjëherë dhe vetëm sipas disa kushteve të caktuara. Kjo përqindje e lartë është domethënëse edhe për faktin se media nuk i kishte mjaft qartë publikut aspektet e ndryshme, përparësitë e jo përparësitë e ngjarjeve që lidheshin me Kosovën. 61% e bullgarëve ishin të shqetësuar se mos pavarësia e Kosovës do të cënonte stabilitetin e Serbisë ndërkohë që 52% shprehnin shqetësimin se ajo do të bënte të mundur përshkallëzimin e tensioneve etnike në Maqedoni.

Gjysma e personave që iu përgjigjën pyetjeve ishin të frikësuar se mos njohja prej Bullgarisë e Kosovës do të nxiste probleme në të ardhmen lidhur me marrëdhëniet e fqinjësisë me Serbinë. Nga ana tjetër 42% deklaronin se Kosova mund të ishte një kërcënim i mundshëm për sigurinë kombëtare të Bullgarisë ashtu si edhe për stabilitetin e vendeve të tjera në rajon.

1 Qendra Kombetare per Studimin e Opinionit Publik, http://www.parliament.bg

II. KARAKTERISTIKA E SISTEMIT TË MEDIAS- KONTEKSTI I MEDIAS

Raporti i këtushëm paraqet rezultatet e vëzhgimit përgjatë periudhës janar –shkurt 2008, të dy prej gazetave kryesore të përditshme në Bullgari, duke u përqendruar në mbulimin prej tyre të ngjarjeve që lidhen me Kosovën. Dy gazetat e përzgjedhura për të realizuar këtë vëzhgim ishin Trud Daily dhe Dnevnik Daily.

Zgjedhja e tyre u mbështet mbi idenë e analizës së dy gazetave të kundërta bullgare, në lidhje me pronësinë, politikën editoriale, llojin (cilësore vs tabloid/hybrid tabloid, etj., duke arritur kështu një panoramë mesatarisht të përafërt mbi median shkruar bullgare lidhur me ngjarjet e Kosovës. Një ndër aspektet e tjera që u mor në konsideratë gjatë përzgjedhjes së tyre është edhe tirazhi dhe lexuesi i tyre. Të dyja u përzgjodhën duke patur parasysh ndikimin e tyre të lartë tek lexuesi e opinioni i përgjithshëm.

Në Bullgari ekzistojnë rreth 440 gazeta ku në mbarë vendin janë 60 të përditshme dhe 180 të përjavshme. Gazetat në Bulgari u kushtohen kryesisht tabloidëve shumica prej të cilave janë të përditshme apo të përjavshme(të dielave). Ndërmjet gazetave të përditshme që kanë lexues të shumtë përfshihet edhe Trud Daily teksa ta ende parapëlqejnë informacionin tabloid megjithëse vërehet një rritje sa i përket konsumit të atyre pjesëve të informacionit që lidhen me stilin e jetesës dhe ekonominë. Formati më i parapëlqyer i shtypit është ai që harmonizon informacion serioz apo edhe argëtues nga të gjitha llojet e temave të jetës publike- që nga politika, sporti e deri tek mënyra e shëndetshme e të jetuarit. Botuesi i gazetës Trud Daily është Media Holding (WAZ), çmimi saj është 0.80 BGN[2], tirazhi i përditshëm është 105 000 kopje (arrin deri në 145000 të dielave) si dhe përfaqëson një format tabloid. Sa i përket politikës së saj editoriale, ajo paraqet një kahje më të fortë nga politika sesa biznesi. Ajo del nga e hëna deri të dielën. Numri i faqeve ndryshon nga 32 në 48 në ditë të ndryshme të javës.

Dnevnik Daily (e botuar nga Ekonomedia) është një gazetë e përditshme biznesi në Bullgari. Çmimi i saj është 0.70 BGN dhe përfaqëson stilin e natyrën e informacioneve të biznesit. Ajo është një gazetë cilësore e karakterit ekonomik me orientim politik të djathtë (konservator dhe liberal). Del çdo ditë nga e hëna deri të premten duke patur si tipar dallues tërësinë e sektorit të biznesit: ajo i kushton 16 faqe rubrikës "Kompanitë e Financat". Siç deklarohet çdo ditë prej botuesit të saj, tirazhi i saj i përditshëm është nga 12000-15000 kopje. Dnevnik Daily është gazeta e përditshme që ka numrin më të madh të parapaguesve nga korporatat duke arritur në një shifër prej 9000 kompanish që janë të abonuara tek kjo gazetë. Lexuesin e saj e përbëjnë individë që ushtrojnë një aktivitet të gjallë ekonomik e numri i tyre mendohet se arrin 51000 vetë çdo ditë. Gazeta ka afro 6000 parapagues me pagesë dhe afro 5000 kopje dërgohen çdo ditë në këndet e shitjes së gazetave.

2 I BGN = 0.51 Euro

Dnevnik ka një mesatare prej 5 lexues për kopje gazete. Ajo shtypet në një format me fletë të mëdha e të gjera, e njëjtë për nga cilësia me botime të tilla të ngjashme në botë. Që nga viti 2005, Dnevnik botohet në një format të lidhur me rreth 40 faqe (32 të premten). Në nëntor të këtij viti, kompania botuese Ekonomedia përfshiu në këtë gazetë suplementin e ri të përjavshëm për rajonin e Detit të Zi- "Morski Dnevnik". Ky suplement del me gazetën çdo të premte. Dnevnik ka edhe një version on-line ku mundësia për t'u konsultuar me një pjesë të përmbajtjes së artikujve është e mundur kundrejt pagesës. Përveç riprodhimit në variantin e shtypur, faqja e saj web www.dnevnik.bg përditësohet në mënyrë të rregullt me lajmet më të fundit.

Tabela e mëposhtme tregon se në çfarë raporti qëndrojnë të dy gazetat brenda tregut të medias së shkruar bullgare. Trud Daily është e përditshmja që udhëheq lidhur me tirazhin ndërsa Dnevnik zë vendin e 10-të.[3]

Lidhur me ediconet on-line të gazetave në Bullgari vihet re një kahje e qartë që tregon rritjen e përdorimit të internetit prej medias dhe konsumit mediatik të gazetave në Internet. Për vitin 2007 ky aspekt është dyfishuar. Afërsisht 60% e gazetave që janë zyrtarisht të regjistruara në këtë vend –kombëtare/rajonale/lokale, të përditshme apo javore, kanë faqe ueb dhe botim on-line[4]. Shumica e tyre mund të shihen falas por megjithatë disa nuk ofrojnë një përmbajtje të plotë të artikujve në internet. Nga ana tjetër, disa nga ato kryesisht gazeta e përditshme kombëtare të biznesit dhe ato të përjavshmet mund të lexohen në internet kundrejt abonimit. Disa prej zyrave që janë të rregullta në abonimin e shtypit të shkruar dhe ata individë që kryejnë atë në shtëpi, përfitojnë edhe bonus falas për abonimin on-line. Tashmë është një dukuri dhe kahje e qartë në këtë drejtim pasi po rritet numri i gazetave që po investojnë në faqet e tyre ueb.

Botimet e shumta të tipit "bulevardesk" mbajnë një çmim shumë të ulët dhe nuk mbështesin daljen e tyre në internet përmes një faqe të caktuar. Shumica e përmbajtjes së artikujve të botuar në Internet janë falas: një pakicë e mediave e kanë zakon të shfaqin on-line një përzierje të artikujve falas e kundrejt pagesës.

Trud Daily i ofron materialet e saj në version elektronik (www.trud.bg) kundrejt abonimit elektronik. Nuk ka ende ndonjë të dhënë zyrtare rreth lexuesve të saj on-line. Edhe për gazetën Dnevnik Daily ndodh e njëjta gjë ndërkohë që ajo vetë deklaron se faqen e saj e vizituan 698 612 persona gjate vitit 2007.

III. ANALIZA E REZULTATEVE TË STUDIMIT

Periudha e marrë në shqyrtim përfshiu 177 materiale, përkatësisht 86 të botuara në Trud Daily dhe 91 tek Dnevnik Daily. Nga ana tjetër janë marrë në shqyrtim tek të dyja gazetat, vetëm materialet e botuara në variantin e

3 Raporti i Shoqates Boterore te Gazetave(WAN) http://www.wan-press.org/article/17265.html

4 Instituti Kombetar i Statistikave http://www.nsi.bg/Index_en.html

shtypur. Lajmet në version on-line që lidheshin me çështjen e Kosovës ishin të shumta, p.sh në faqen ueb të gazetës Dnevnik kishte rreth 200 artikuj (më shumë sesa dyfishi i atyre që u botuan në variantin e shtypur të njërës preh gazetave të sipërpërmendura). Nga rreth 177 materiale mbi këtë temë, 51 u botuan në janar dhe 126 më shkurt që dëshmon se gazetat e kanë ndjekur çështjen që lidhet me Kosovën edhe para shpalljes së pavarësisë. Ndërkohë nuk është e papritur që interesi i medias është rritur në mënyrë të ndjeshme në shkurt, e veçanërisht në javën e 3-të të muajit, rreth datës së shpalljes së pavarësisë.



Tabela 2: Shpërndarja mujore e artikujve

Të dyja gazetat kanë departamente shumë të afta lidhur me çështjet ndërkombëtare. E veçantë e mënyrës së formateve të përmbajtjes së artikujve (Dnevnik i boton të gjatë dhe analitikë ndërkohë që Trud i parapëlqen më të vegjël dhe synon më shumë kah sensacioni lidhur me përmbajtjen) pasqyron shpërndarjen e numrit të temave për çdo muaj. Dnevnik botoi në janar 2008 rreth 32 materiale mbi këtë çështje dhe 59 në shkurt ndërkohë që dallimi sa i përket sasisë mujore të artikujve të botuar të Trud është edhe më domethënës – 19 në janar dhe 67 në shkurt. Kjo lidhet m faktin se Trud i kushton më tepër vëmendje lajmeve të përditshme sesa informacionit të ekuilibruar, të drejtë e të thelluar ndërkohë që Dnevnik në këtë drejtim është më i qëndrueshëm.

Sa i përket paraqitjes së artikujve në faqe të parë, përqindja më e lartë e lajmeve lidhur me çështjen e Kosovës fillon në faqen që vjen pas saj- 79%

tek Dnevnik dhe 89% tek Trud. Vetëm në 9% të rasteve të vëzhguara titulli i shkrimit është përfshirë në faqe të parë e dhe në 7% të rasteve kjo ka ndodhur për pjesë të tekstit.

Një shembull shkrimi i botuar në faqen e parë është p.sh: "Kosova, 10 ditë deri tek Pavarësia" (Trud Daily, 7 shkurt). Kjo mund të shpjegohet me ngjarjet e brendshme të ndezura në Bullgari në atë periudhë- përgatitja për një votë-mosbesimi ndaj qeverisë në Parlament, shumë skandale korrupsioni, etj.



Tabela 3: Shkrim i vendosur në faqe të parë

Llojin më të zakontë të shkrimit në të dy gazetat e përbëjnë lajmet e zgjeruara- ato përfaqësojnë pothuajse 1/3 e artikujve të marra në shqyrtim. 22% e materialeve janë korrespondenca dhe 12% lajme. Vetëm 6% e artikujve janë analiza ndërkohë që 4% e përbëjnë mbulimet e drejtpërdrejt të ngjarjes. Artikujt me lajme të zgjeruara janë botuar më së shumti në ditët e para dhe pas atyre që pasuan shpalljen e pavarësisë. Ato janë të përqendruara kryesisht mbi vetë ngjarjen dhe reagimet diplomatike të vendeve të tjera pas kësaj ngjarje.

Kjo dëshmon për një mungesë informacioni të thelluar social e ekonomik lidhur me situatën në Kosovë. Vetëm një pakicë artikujsh pasqyrojnë sesi jetojnë njerëzit në Kosovë, cila është situate ekonomike e klima e biznesit atje, etj. P.sh në gazetën Dnevnik është një artikull i datës 19 shkurt që titullohet "Kosova ndikoi në Bursën Serbe" në të cilën analizohet aspekti ekonomik i situatës në Kosovë. Ndërkohë u evidentuan vetëm një numër shumë i vogël artikujsh që iu kushtuan historive njerëzore. Në të dy gazetat gjenden disa këndvështrime të përgjithshme e analiza që përshkruajnë procesin historik të ndarjes së dy kombeve – serbëve dhe shqiptarëve.- të cilat çuan në pavarësinë e Kosovës. Përqindjet e komenteve e editorialeve ishin edhe më të vogla – përkatësisht 3% e 4% për secilën gazetë. Kjo dëshmon sërish në mënyrë të qartë mungesën e analizës vendase dhe të rubrikave që i kushtohen situatës në Kosovë dhe zhvillimit të pamjaftueshëm të debatit të brendshëm publik lidhur me ngjarjet e Kosovës. Të dyja gazetat kanë një

përqindje të përshtatshme të intervistave me bashkëbiseduesit e ndryshëm, të huaj apo vendas- ekspertë, politikanë, intelektualë etj sa i përket çështjes së Kosovës: 9% e artikujve tek Dnevnik dhe 10% tek Trud. Kjo tregon qartë se në të dyja rastet politika editoriale është përpjekur të japë këndvështrime të ndryshme, të diskutojë shumë çështje si dhe tu japë hapësirë sa më shumë pikëpamjeve rreth kësaj çështje. Disa prej bashkëbiseduesve të intervistuar përfshijnë: Arbër Xhaferri, ish –lider i Partisë Demokratike të Shqiptarëve në Maqedoni (Dnevnik, 13 shkurt); Shenoll Muharremi, kryetar i Grupit për Strategji dhe Zhvillim në Kosovë (Dnevnik, 15 shkurt), Danilo Vuçetiq, ambasador i Serbisë në Bullgari (Trud, 6 shkurt), Krasimir Karakaçanov lideri i partisë VMRO në Bullgari (Trud, 6 shkurt), Lulëzim Peci, Drejtor Ekzekutiv i Institutit për Zhvillim e Kërkime Politike (Trud, 13 shkurt), Andrey Pantev, anëtar i Parlamentit Bullgar i Koalicionit për Bullgarinë (Trud, 18 shkurt), Misha Glenny, gazetar dhe specialist britanik për Europën Juglindore (Trud, 19 shkurt), Ivaylo Kalfin, Ministër i Punëve të Jashtme të Bullgarisë (Trud 19 shkurt) dhe Dr. Svetozar Stojanoviq, filozof serb (Trud, 20 shkurt)



Tabela 4: Lloji i tekstit

50% e artikujve mbajnë në fund emrin e redaksisë së lajmeve dhe 34% atë të gazetarëve. Agjencitë e lajmeve u treguan si burime të para informacioni vetëm në 6% të rasteve, atëherë kur artikujt ripërsërisnin se çfarë kishin shkruar agjencitë ndërkombëtare të lajmeve e media e huaj.

Duhet të theksojmë se megjithëse shumica e artikujve ishin të redaksisë së lajmeve, ato përdornin si burim informacioni atë që vinte kryesisht prej

agjencive të lajmeve. Sa i përket materialeve që mbanin në fund emrat e gazetarëve vihet re një dallim i dukshëm mes të dy gazetave, jo sa i përket përqindjes, por lidhur me reporterët e korrespondentët që raportonin nga vendi i ngjarjeve. Gazeta Trud Daily pati gazetarë që raportuan nga Prishtina, Kosova, Mitrovica, Serbia Jugore dhe Beogradi para dhe pas 17 shkurtit, e në këtë periudhë botoi çdo ditë një sërë korrespondencash ndërkohë që Dnevnik kishte më pak shkrime të tilla, përkatësisht nga Prishtina e Beogradi. Ndoshta ky dallim vërehet për shkak të faktit se gazeta Trud Daily e WAZ zotëron më shumë burime njerëzore e financiare se Dnevnik.

16% e materialeve ishin të shkruara prej politikanëve, ekspertëve, intelektualëve, përfaqësuesve të shoqërisë civile, historianëve, figurave publike etj. Të dyja gazetat u dhanë hapësirë pikëpamjeve të ndryshme me qëllim që të garantonin praninë e opinioneve e qëndrimeve të larmishme lidhur me situatën në Kosovë.



Tabela 5: Autori i tekstit

Lidhur me burimet e informacionit në 90% të rasteve ato janë cituara saktë (95% e artikujve nga Trud e 85% nga Dnevnik) ndërkohë që 5% e artikujve kanë gazetarin si burim informacioni. Vetëm një 5% prej tyre citojnë burime të panjohura apo nuk e bëjnë fare këtë gjë. Në përgjithësi kjo dëshmon se të dy gazetat kanë raportuar me përgjegjësi para opinionit publik dhe kanë ndjekur standarte profesionale.

Përkatësisht në 41% të artikujve janë 1 ose më shumë burime informacioni të cituara. Duhet të theksojmë se në shumicën e rasteve kur nuk njihen burimet e informacionit, kjo lidhet me faktin se ato janë komente dhe

tekste të autorëve që shprehin opinionin e tyre mbi situatën në Kosovë e nuk mund të shpjegohen domosdoshmërisht me mungesën e trajtimit profesional të editorialit.



Tabela 6: Burimi i informacionit. Lloji.



Tabela 7: Burimet e paraqitura

Sa i përket rastit për të cilin jepet informacioni në shkrim, 48% e artikujve u përkasin ngjarjeve në kohë reale (deri në ditën e shpalljes së pavarë-

sisë). Dy nga ngjarjet kryesore rreth të cilave përqendrohet informacioni, janë zgjedhjet në Serbi dhe deklarata e pavarësisë së Kosovës. 30% e materialeve mund të përkufizohen si të mbështetura tek pseudo-ngjarjet dhe ato janë të mbuluara kryesisht prej llojeve të tilla të shkrimit si raportimi dhe analizat. Nuk ka asnjë edhe një material të vetëm i cili mbështet tek njoftimet zyrtare për shtyp, çka dëshmon se në përgjithësi të dyja gazeta nuk botojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë komunikatat për shtyp që vijnë nga autoritetet shtetërore. Nga ana tjetër kjo mund të shpjegohet edhe me faktin se autoritetet bullgare nuk shprehen ndonjë qëndrim të qartë mbi pavarësinë e Kosovës ashtu si edhe as media e as publiku i përgjithshëm nuk ishin në dijeni për qëndrimin zyrtar të qeverisë bullgare mbi këtë çështje deri më 19 mars 2008, kur u bë e ditur deklarata e përbashkët e nënshkruar nga Bullgaria, Kroacia e Hungaria.

Në përgjithësi asnjë prej përfaqësuesve të qeverisë nuk u përpoq të shpjegonte në mënyrë të mjaftueshme përparësitë e mangësitë e politikës bullgare në drejtim të situatës në Kosovë e përkatësisht kjo solli një informacionit të papërpunuar plotësisht prej medias. Në këtë mënyrë, në tërësi debati i brendshëm publik u zhvillua në mënyrë të pamjaftueshme, 20% e artikujve janë shkrime që lidhen me ngjarjet që erdhën më pas, pra afrimi i shpalljes së pavarësisë së Kosovës (artikujt e botuar para 17 shkurtit) dhe pritshmëritë e publikut ndaj deklarimit e reagimit zyrtar të qeverisë bullgare (artikujt e botuar pas 17 Shkurtit).



Tabela 8: Rasti që ka shërbyer si shkas për artikullin

Përsa i përket raportit të titullit/nëntitullit, pothuajse 2/3 e materialeve (57% për TRUD dhe 65% për Dnevnik) përmbajnë një mesazh që nxjerr në pah temën kryesore të shkrimit. P.sh në numrin e 14 shkurtit 2008 të gazetës Trud Daily është botuar një artikull nën titullin kryesor: Pavarësia e Kosovës –gëzim apo frikë për Ballkanin dhe Botën?". Në të njëjtën gazetë është botuar kryeartikulli që thotë: "Mitrovica e Kosovës: Rusia, ndihmë". Në 29% të rasteve përmbajtja e titullit/nëntitullit përputhet me përmbajtjen e shkrimit që vjen më pas, por në përgjithësi ai jep në mënyrë të përmbledhur e të paanshme temën kryesore, p.sh: në numrin e datës 18 shkurt 2008, të gazetës Dnevnik vërejmë një artikull me titull: "Kosova shpalli pavarësinë" dhe nëntitulli është: "Shqiptarët triumfuan, askush nuk po nxiton të njohë shtetin e porsalindur". Këto artikuj (kryesisht lajme apo lajme të zgjeruara) në përgjithësi kanë një ngjyrim asnjanës dhe janë në thelb më së shumti të karakterit informues dhe parashikues, ndërsa funksioni i tyre edukues është anashkaluar për shkak të mungesës së formave gjithëpërfshirëse të shkrimit me natyrë analitike e rrëfimtare.

Në të dy gazetat nuk gjenden tituj/nëntituj që përmbajnë një mesazh të shtrembëruar apo që shtrembërojnë pjesërisht temën kryesore të shkrimit. Në këtë drejtim, mediat në përgjithësi ka ndjekur standartet profesionale dhe nuk i ka keqinformuar lexuesit e tyre.

Nga tërësia e lajmeve të paraqitura në këtë rast, më shumë se gjysma e tyre (58%) përmbajnë një ilustrim apo një kombinim të ilustrimeve të ndryshme (fotografi dhe harta/skica është kombinimi më i zakontë). Në gazetën Dnevnik, shumë artikuj përmbajnë nga një karikaturë si ilustrim të tekstit, por në tabelat e mëposhtme kjo nuk është konsideruar si mundësi ilustrimi sa kohë nuk është përfshirë në pyetësorin lidhur me llojet e lustrimit. Më tepër se 40% e materialeve të shqyrtuara janë lajme me foto apo shkrimi mbulohet përmes fotove, çka dëshmon një paraqitje në mënyrë të ekuilibruar prej gazetave të përmbajtjes duke mos qenë as shumë pamore apo tekstuale. Fotografia është lloji më mbizotërues i ilustrimit i përdorur prej gazetave dhe shumica e tyre janë të fotografëve të AFP dhe Rojterit. Vetëm 7 artikuj përfshijnë harta/skica ndërsa 2 prej tyre përmbajnë grafikë. Sa i përket raportit të ilustrimit me përmbajtjen nuk gjendet as edhe një rast i vetëm në të dyja gazeta ku dicitura poshtë ilustrimit të ketë një kuptim kundërt me semiotikën e tij. Në 66% të rasteve dicitura të drejton në mënyrë të drejtpërdrejtë, asnjanëse e të pamëdyshtë tek vetë mesazhi. Këto janë të gjitha portretet, fotografi të takimeve, ngjarjeve me karakter zyrtar etj. 34% e diciturave poshtë ilustrimeve kanë elementë me ngjyrim emocional. Në gazetën Dnevnik të 17 shkurtit 2008, dicitura poshtë fotografisë së kosovarëve që mbanin në duar flamuj shqiptarë e amerikanë thotë: "Falemnderit Amerikë ishte ndër sloganet më të zakonshme në Prishtinën e atyre ditëve."



Tabela 9: Ilustrimi – Lloji

Sa i përket përmbajtjes së shkrimeve gazetareske ekziston një qasje për të bërë një krahasim mes të dy gazetave. Numri i materialeve të shkruara rreth dhunës së ndodhur në Beograd është më i madh tek gazeta Trud- 7% ndërsa tek Dnevnik 2%: ja një shembull nga gazeta Trud Daily ku në numrin e datës 20 mars 2008 në faqen 31 u botua një artikull me titull "Gaz lotsjellës dhe bomba në "kufirin e ri". Megjithatë duhet të theksojmë se në përgjithësi, aspektet i dhunës është mbuluar më pak në të dy gazetat, sa i përket ngjarjeve që lidhen me Kosovën. Ai përfaqësohet me vetëm 5% të shkrimeve që janë marrë në shqyrtim. E njëjta dukuri vërehet edhe lidhur me mbulimin e tensioneve etnike- Dnevnik nuk ka botuar asnjë artikull rreth kësaj çështje ndërkohë që ky aspekt zë afro 8% të artikujve në gazetën Trud Daily.

Dallimi më domethënës i të dhënave në këtë rast, i përket artikujve që u kushtohen lëvizjeve diplomatike nga vende të tjera. Këto materiale përbëjnë 25% të shkrimeve në gazetën Trud dhe 54% tek Dnevnik. Trud shfaq më tepër interes lidhur me mbulimin e çështjeve që i përkasin së drejtës për vetëvendosje dhe pavarësi. Sërish kjo qasje mbështetet tek prirja drejt sensacionit dhe një përmbajtje me karakter popullor që mund të vërehet tek materialet e botuara prej saj. Ndërkohë që politika editoriale e Dnevnik i kushton më shumë vëmendje reagimit të botës lidhur me ngjarjet qe po ndodhnin, si ato do të preknin vendet e tjera të rajonit të Evropës Juglindore e veçanërisht se çfarë ndikimi do të kishin mbi Serbinë dhe Maqedoninë. Ngjarjet që lidheshin me Kosovën u mbuluan prej mediave si pjesë e lajmeve që lidheshin me Serbinë. P.sh, shumica e materialeve të botuar

në janar i kushtoheshin zgjedhjeve në Serbi dhe gazetat e lidhnin çështjen e Kosovës me to. Të dyja gazetat shfaqën të njëjtin interes lidhur me qëndrimin e shtetit bullgar ndaj ngjarjeve që lidheshin me Kosovën si dhe për lëvizjet diplomatike të Bullgarisë – kjo përbënte 25% të artikujve tek Trud dhe 24% tek Dnevnik. Në këtë mënyrë arrimë në përfundimin se ligjërimi politik në shkrimet e medias mbizotëroi në kurriz të një përmbajtje sociale më të përgjegjshme prej tyre. Asnjë prej gazetave nuk preku aspekte që lidheshin me përpjekjet për sundimin e ligjit, çka dëshmon mungesë informacioni të thelluar mbi probleme të tilla si p.sh baza institucionale e legjislative e Kosovës.



Tabela 10: Përmbajtja e shkrimit gazetaresk

Të dhënat e tabelës së mëposhtme janë një ilustrim i përfundimit të sipërpërmendur se situata në Kosovë është mbuluar prej medias bullgare, kryesisht si pjesë e lajmeve që lidheshin me Serbinë dhe është raportuar në shumicën e rasteve nën dritën e këndvështrimit serb dhe në veçanti të marrëdhënieve të Bullgarisë me shtetin e saj fqinj-Serbinë.

Në 47% të rasteve, vendveprimi i ngjarjeve në shkrimin përkatës është në një vend tjetër (por jo në Kosovë) dhe në këtë drejtim mbizotëron Serbia. Gazeta Trud tregon një interes më të ekuilibruar mbi këtë çështje qoftë mbi reagimin e diplomacisë së huaj ashtu edhe asaj vendase, ndërkohë që vërehet një numër i barabartë i shkrimeve të botuara në këtë media ku veprimet në tekst zhvillohen si në një vend tjetër ashtu edhe në Bullgari. Në këtë aspekt gazeta Dnevnik ofron një raport shumë të ndryshëm ku në 57% të rasteve veprimi në tekstin e artikullit zhvillohet në një vend tjetër dhe vetëm 26% në Bullgari. Në 21% të të gjithë materialeve të sipërpërmen-

dura, veprimi zhvillohet në Kosovë dhe sërish vërehet një dallim mes të dy gazetave- tek Trud kjo ndodh në afro 25% të artikujve ndërsa tek Dnevnik në 16% të tyre. Ky ndryshim është i lidhur ngushtë me faktin tashmë të njohur se Trud kishte në Kosovë korrespondentë për një periudhë kohe më të gjatë se Dnevnik ashtu sikurse mbuloi një hapësirë më të madhe gjeografike në Kosovë e jo vetëm kryeqytetin e Prishtinës.

IV. PËRFUNDIME

Si rrjedhojë e këtij monitorimi të shtypit mund të nxirren konkluzionet e mëposhtme:

- Gazeta bullgare diskutuan rreth temave që lidheshin me Kosovën duke ndjekur kalendarin politik (vendas dhe atë ndërkombëtar)
- Ligjërimi politik në shkrimet e medias mbizotëroi në kurriz të një përmbajtje sociale më të përgjegjshme prej tyre si edhe ndaj informacioni më të hollësishëm mbi bazën ekonomike, politike institucionale e legjislative e Kosovës
- Debati i brendshëm publik u zhvillua në mënyrë të pamjaftueshme – u evidentua një mungesë e analizave të thelluara prej vendasve si dhe rubrika që i kushtoheshin situatës në Kosovë.
- Situata në Kosovë u mbulua prej medias më së shumti si pjesë e lajmeve që lidheshin me Serbinë dhe në shumicën e rasteve u raportua nën dritën e pikëpamjes serbe dhe në veçanti të marrëdhënieve të Bullgarisë me vendin e saj fqinj – Serbinë.
- Mbulimi prej medias solli edhe këndvështrime të ndryshme ku u botuan shumë intervista) dhe u diskutuan shumë pikëpamje.
- Agjencitë e lajmeve dhe mediat e huaja mund të konsiderohen si burimet e para të informacionit.
- Artikujt e zgjeruar u botuan më së shumti në ditët që pasuan deklaratën e pavarësisë dhe u përqendruan kryesisht tek vetë ngjarjet dhe reagimet diplomatike e vendeve të tjera pas saj.
- Në përgjithësi mbulimi i situatës në Kosovë prej medias bullgare ishte i ekuilibruar dhe përmbajtja e shkrimeve të saj nuk mund të përshkruhet si diçka ku mbizotëron më shumë ana pamore apo tekstuale.
- Nuk vërehen tituj që shtrembërojnë përmbajtjen apo dicitura të tilla poshtë ilustrimeve.



KROACIA

Veljka Spinçiq – Rajko

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Në përgjithësi shoqëria kroate është ende shumë e ndjeshme kur vjen fjala për ndonjë çështje që lidhet me luftën e shkuar në ish-Jugosllavi dhe një numër qytetarësh të saj e konsiderojnë konfliktin e tejzgjatur e të përshkallëzuar mes popullsisë serbe e shqiptare në Kosovë si bërthamën e luftës që pasoi më vonë. Kjo ndjeshmëri rreth periudhës së luftës së kaluar, perceptimi i serbëve si fajtorë të saj dhe roli prej "lideri rajonal" që ka përshtatur Kroacia- të gjitha këto të mbledhura së bashku, sollën në fund si rrjedhojë, mbështetjen e përgjithshme nga publiku kroat për pavarësinë e Kosovës (sipas disa sondazheve, pothuajse 90%)

Mbulimi prej medias së këtij vendi të kësaj ngjarje thjesht nxjerr më në pah këtë aspekt e kjo është diçka me rëndësi të veçantë duke patur parasysh se Kroacia ka sot një nga përqindjet më të larta të leximit në Evropë - gazetat e përditshme kroate kanë më shumë se 2.33 milion lexues –apo 63% të numrit të përgjithshëm të qytetarëve kroatë.

Analiza e mëposhtme e mbulimit të ngjarjeve në dhe rreth Kosovës prej medias kroate, përcillet përmes dy gazetave të përditshme të shtypit të shkruar kroat – "Novi List" dhe "Vjesnik", të cilat përgjatë periudhës janar – shkurt 2008 nuk ka patur ditë që mos kenë shkruar ndonjë artikull rreth Kosovës. Por ajo çfarë vërehet është fakti si 2/3 e artikujve përcaktojnë Serbinë e Beogradin si vendveprimin e ngjarjeve e jo vetë Kosovën. Arsyeja në këtë rast duket se qëndron në faktin se përgjatë periudhës të këtij studimi, Serbia zhvillonte zgjedhjet e saj presidenciale dhe pavarësia e Kosovës ishte një element i pashmangshëm në retorikën e fushatës nga shumica e zyrtarëve serbë dhe kandidatët presidencialë. Në këto rrethana, media kroate ishte më së shumti interpretuese e këtyre deklaratave duke marrë në konsideratë ndikimin e tyre mbi situatën politike e të sigurisë në rajon.

I. RRETHANAT POLITIKE (QËNDRIMET E POLITIKËS VENDASE NË DREJTIM TË KOSOVËS)

Megjithëse studime të ndryshme vendase e të huaja kanë dëshmuar se që nga viti 1990, Kroacia ka arritur shumë përparime në fushën e forcimit të

stabilitetit demokratik, shtetit ligjor dhe shoqërisë civile së bashku me rritjen ekonomike e përmirësimin e situatës sociale, "mbetjet" e luftës janë ende përreth. Kjo mund të mos jetë aq e dukshme nëse e shohim në kontekstin "evropian", nën dritën e anëtarësimit të ardhshëm në BE (sipas sondazheve, me ndonjë luhatje të vogël, më shumë se 50% e qytetarëve mbështesin anëtarësimin në BE), por situate ndryshon krejtësisht kur vijmë tek vendet e rajonit veçanërisht tek Serbia por edhe tek Bosnja dhe Hercegovina e Kosova.

P.sh, Freedom House përllogarit çdo "rezultatin të demokracisë" si një mesatare e vlerësimit e renditjes për procesin elektoral (EP), shoqërinë civile (CS), median e pavarur (IM), qeverisjen demokratike qendrore (NGOV); qeverisjen demokratike lokale (LGOV), gjyqësorin dhe pavarësinë (JFI) dhe korrupsionin (CO). Renditja mbështetet në një përshkallëzim numerik nga 1 deri tek 7 ku 1 përfaqëson shkallën më të lartë të demokracisë dhe 7 më të ulëtin. "rezultati i demokracisë" për Kroacinë tregon kahje pozitive duke rënë drejt vlerës që tregon shkallën më të lartë të saj: nga 4.46 në 199 në 3.64 në 2008.[1]

Disa analiza të tjera tregojnë rezultate të ngjashme, pavarësisht nga treguesit e zgjedhur me këtë rast.

Përparimi i demokratizimit në shoqërinë kroate është një fakt i pamohueshëm, por megjithatë ai është ende larg nga niveli i duhur. Në përgjithësi shoqëria kroate është shumë e ndjeshme kur vjen fjala për çështje që lidhen me periudhën e luftës së kaluar në ish-Jugosllavi dhe pothuajse çdo përmendje e Serbisë, Bosnjës dhe Hercegovinës e Kosovës mund të shihet si një rikujtim i saj. Në mendjen e publikut kroat nuk ndonjë mëdyshje se në cilën anë qëndron fajtori- shumica e qytetarëve të këtij vendi do të përgjigjeshin pa u menduar dy herë se faji qëndron në anën serbe. Kjo është një ndër çështjet e rralla që bashkon edhe kundërshtarët politikë në Kroaci: partinë qeverisëse Unioni Demokrat Kroat(HDZ) dhe rivalët e tyre kryesorë Partinë Social Demokrate (SDP). Përgjigja do të ishte e njëjtë edhe nga kundërshtarë të tjerë të qeverisë e kritikë të saj, pavarësisht orientimit të tyre politik- një shumica që bie dakord se Serbia (ose të paktën liderët serbë) mbajnë peshën e fajit.

Një numër qytetarësh i konsiderojnë konfliktet e stërzgjatura e të përshkallëzuara si dhe përleshjet mes popullsisë serbe e shqiptare në Kosovë (veçanërisht në vitet 80) si bërthamën e luftës së mëpasme në Kroaci e Bosnje. Duke patur parasysh këtë shumica e popullsisë kroate krijoi bindjen se çdokush, përfshirë edhe Kosovën, do të ishte më mirë që të ndahej nga Serbia.

Në të njëjtën kohë, stabiliteti ekonomik e politik, i përftuar prej Kroacisë, ka krijuar një rol të ri për këtë vend- rolin e "liderit progresiv" në rajon (të paktën duke marrë parasysh vendet e ish-Jugosllavisë me përjashtim të Sllovenisë). Dhe ishte ky "rol prej lideri" (imagjinar apo jo) që e bëri publikun

1 Qendra per Studime te Shkences Politike-sektori i download "Kombet ne Tranzicion 2008" Freedom House "Rezultati per Demokracine-Kroaci,http://www.cpi.hr/download/html/hr/11597.pdf

kroat të distancohej madje ta vinte veten deri në njëfarë niveli edhe mbi situatën në rajon. Kur erdhi fjala për Kosovën, çështjet e diskutueshme u orientuan më pak në drejtim të pasojave që do të kishte mbi popullsinë e Kosovës deklarata e pavarësisë e incidentet e lidhura me të. Për më tepër ishte shumë e rëndësishme të dihej nëse dhe si këto elementë do ta cënonin situatën në rajonin, a pritej një përshkallëzim i konflikteve, a do të kishte ndonjë veprim ushtarak ndërkombëtar, si do ta prekte kjo ngjarje industrinë kroate të turizmit e pyetje të tilla të ngjashme.

Për ta përmbledhur me pak fjalë-perceptimi i fajësisë serbe dhe roli i "liderit rajonal" u përzjenë së bashku për të krijuar një përvijim të caktuar e për të vlerësuar qëndrimin e publikut kroat në drejtim të Kosovës.

Një numër i madh agjencish të mediave dhe të studimeve mbi publikun realizuan gjatë muajit shkurt-mars 2008 disa lloj sondazhesh për të parë sesi çfarë ndjesish kishin qytetarët kroatë rreth pavarësisë së Kosovës. Të gjitha faqet e internetit me një orientim të caktuar politik realizuan mini-sondazhe për çështjen e Kosovës, por shumica e tyre nuk ofronin rezultate me vlerë (ishin të vogla e grupet e përzgjedhura ishin në mënyre te njëjte të orientuara politikisht). Duke marrë në konsideratë nivelin e përfaqësimit të të dhënave të mbledhura, ia vlen të përmendet studimi i kryer nga "PULS, një agjenci e pavarur për marketing e kërkimet mbi opinionin publik.

Në fund të shkurtit 2008 rezultatet tregonin se shumica e qytetarëve kroatë e mbështesnin pavarësinë e Kosovës dhe nuk i trembeshin një destabilizimi të mëtejshëm në rajon.



Tabela 1. A duhet Kroacia ta njohë pavarësinë e Kosovës?[2]

2 Poslovni dnevnik, Research, Agency "Puls", http://www.poslovni.hr/73965.aspx

38% e të pyeturve në këtë sondazh prisnin që tensionet etnike do të përshkallëzoheshin pas deklaratës së pavarësisë e 56% deklaronin se situate do të ishte e qetë e nuk do të kishte dhunë apo protesta të mëdha. 56% e konsideronin një mundësi fare të vogël luftimet e armatosura në rajon si rezultat i shpalljes së pavarësisë, ndërkohë që vetëm 14% e quanin të mundshëm një rrezik të vërtetë prej kësaj ngjarje. Qytetarët në moshë të re (nën 25 vjeç) dëshmonin një nivel më të lartë pasigurie duke marrë parasysh situatën në rajon, por ata më së shumti nuk prisnin ndonjë destabilizim serioz në Bosnjë dhe Hercegovinë, si rezultat i ndonjë iniciative të mundshme për të shpallur pavarësinë Republika Srpska. 11% e të pyeturve besonin se kishte shumë mundësi që komuniteti i serbëve të Bosnjës të deklaronte pavarësinë, ndërkohë që 60% nuk e konsideronin këtë si diçka të mundshme. Rezultatet u karakterizuan si pozitive për shkak se ngjarjet pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës nuk shkaktuan ndonjë ndjenjë ankthi apo edhe frikë mes shumicës së qytetarëve kroatë. "ajo çfarë mund të kishte ndikime të mundshme negative në sjelljet e tyre merrte parasysh konsumin, kursimet dhe investimet".

79% e personave të pyetur mbështesnin gjithashtu njohjen e shtetit të ri të Kosovës por ndërsa 28% mendonin se ky hap duhej hedhur pa vonesë, pjesa tjetër prej 51% vlerësonin se do të ishte më mirë për Kroacinë të priste një moment të përshtatshëm. Rreth 12% e të pyeturve deklaronin se Kroacia nuk duhet ta njihte pavarësinë e Kosovës derisa Serbia e Kosova të arrinin një marrëveshje rreth kësaj çështje e kjo mund të interpretohej edhe si kundërvënie ndaj shpalljes së "njëanshme të pavarësisë".

II. KARAKTERISTIKAT E SISTEMIT TË MEDIAS- KONTEKSTI I MEDIAS

Pa hedhur një vështrim të duhur mbi tregun kroat të medias, një vëzhgues pa përvojë mund të krijonte përshtypjen se situate është përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme përgjatë dy dekadave të fundit- mediat po fitojnë pavarësinë dhe po lindin vazhdimisht një numër i ri gazetash, radiosh e stacionesh televizive. Është fakt që kahjet, sa i përket pavarësisë së medias, janë pozitive. Megjithatë studimet e kryera prej profesionistëve të medias zbulojnë "anën tjetër të medaljes- ndikimin gjithnjë e më të madh të kapitalit (pronarëve të medias dhe reklamave) mbi përmbajtjen e medias, një rënie serioze të besueshmërisë e etikës së media e një rënie të cilësisë së medias në përgjithësi.

Faktkeqësisht këto elementë nuk i përkasin vetëm tregut kroat të medias pasi ato mund të gjenden edhe në tregjet e mediave me përvojë në Evropën Perëndimore e SHBA.

Sipas studimit të botuar së fundmi "MEDIAPuls"[3], realizuar nga agjencia

3 SEEbiz.eu,Tvrtke-Mediji,http://www.seebiz.eu/hr/tvrtke/mediji/mediapuls-celiki-rost-citanosti-hrvatski-tiskovina,14869.html)

për marketing e kërkime mbi opinion publik "PULS", gazetat e përditshme kroate kanë çdo ditë më shumë se 2.33 milion lexues (63% të numrit të përgjithshëm të qytetarëve kroatë) ndërsa revistat lexohen rregullisht prej mëse 2.15 milion njerëz (59%). Kahjet shumë pozitive për botuesit sepse 72% e qytetarëve kroatë në moshë të re (mosha 15-19 vjeç) lexojnë çdo ditë gazeta. Tregu i medias kroate po zhvillohet më me shpejtësi se në çdo vend tjetër në Europë ku popullsia e lexuesve deri më tani nuk ka njohur ndonjë rritje. Të dhënat duhet të konsiderohen të besueshme duke patur parasysh reputacionin e agjencisë, por pyetja kryesore që shtrohet është sesi mund t'i interpretojmë këto shifra, kur ne përpiqemi t'i vendosim ato në kontekstin e studimeve që lidhen me besueshmërinë e këtyre gazetave.

Çdo ditë shiten rreth 750000 kopje gazeta të përditshme (rreth 200 milion në vit). Por në përpjesëtim me rritjen e numrit të kopjeve të shituar të gazetës rritet edhe mosbesimi mes lexuesve dhe mungesa e besueshmërisë së medias. Vërtetësia, saktësia, objektiviteti, integriteti, ekuilibri, përpikëria –bazat e gazetarisë profesioniste përcillen gjithnjë e më pak tek lexuesit kështu që artikujt e medias së shkruar janë më pak të besueshëm. Një ndër studimet kryesore të kohëve të fundit lidhur me besueshmërinë e gazetave të përditshme, u realizua nga shkencëtarët dhe profesionistët e medias të Universitetit të Zagrebit e Dubrovnikut si pjesë, si pjesë e një projekti të madh për besueshmërinë e gazetave kryesore të përditshme në Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë e Mal të Zi së bashku me profesionistë të medias nga universitetet e Tuzllës e të Podgoricës. Studimi u krye si pjesë e projektit "Arsimi i gazetarisë në Kroaci" (JETIC), i mbështetur nga BE dhe Programi TEMPUS. Artikujt e ndryshëm të këtij studimi u botuan në një libër të botuar nga ICEJ[4].

"Pas një dekade begatie në median kroate që çoi në shkrirjen e përqendrimin e mediave, investitorët e rinj,ndryshimet sa i përket formës dhe përmbajtjes së gazetave të përditshme, si dhe forcimit të rolit të reklamuesve, ky studim vërejti disa dobësi serioze dhe madje rrezikim të standarte profesionale në këtë fushë". Shumica e studimeve të kryera gjatë pesë viteve të fundit tregojnë se titujt nuk janë problemi me të cilin përballen aktualisht gazetat kroate.

Mbizotërimi i burimeve të informacionit subjektiv -të njëanshëm, madje edhe mungesa tërësore e këtyre burimeve, numri i pamjaftueshëm i citimeve, shumica e të cilave në artikuj të shkurtër, kanë dëshmuar se mbeten një problem shumë i madh. Analizat e detajuar nxjerrin në pah politizimin e madh të gazetave kroate, teksa pesë titujt e parë në faqen kryesore të shumicës prej gazetave më të lexuara kroate u kushtohen poltikës, krimit e aksidenteve.[5]

4 ICEJ – Qendra Ndërkombëtare për Edukim të Gazetarëve

5 Igor Kanizaj "Opca politizacijadnevnik nobvine u Hrvatskoj(trans." The overall politicization of Croatian daily newspapers", Vjerodostojnost novena(trans "Newspapers credibility", ed Stjepna Malovic, Zagreb ICEJ,2007

Një nga studiuesit z. Igor Kanizaj nga Fakulteti i Shkencave Politike të Universitetit të Zagrebit së bashku me Dr. Gordana Viloviq nga Universiteti i Dubrovnikut (që formuloi aspektet etike të (pa) besueshmërisë të gazetave të përditshme) analizuan gazetat kryesore kroate Jutarnji List, Veçernji List, Vjesnik dhe 24 Sata prej periudhës 16 prill –1 maj 2007.

Përfundimi i arritur prej tyre vërente se shumica e gazetave të sipërpërmendur në 5 faqet e para mbulonte politikë, ekonominë, krimin dhe aksidentet. Mbizotërimi i artikujve të shkurtër është tepër i dukshëm tek këto gazeta ashtu sikurse mungesa e burimeve të duhura të informacionit. Ajo çfarë është e rëndësishme në këtë rast, sa i përket vëzhgimit tonë mbi mbulimin prej medias kroate të ngjarjeve në Kosovë, lidhet me faktin se gazeta Vjesnik – e cila është një prej atyre që kemi marrë në shqyrtim-ishte pjesë e këtij studimi mbi besueshmërinë e të përditshmeve në disa vende të rajonit. Në përgjithësi shumica e gazetarëve i mbështesin artikujt e tyre vetëm tek një burim informacioni, ata rrallë citojnë ndonjë dhe është fakt interesant që vetëm 10% e rasteve të artikujve të vendosur në faqen kryesore shtjellohen më tej në 5 faqet e para të gazetës.

> *Në lidhje me gazetën Vjesnik autori Igor Kanizaj deklaronte se "Vjesnik mbulonte lëvizjet dhe aktivitetet e zyrtarëve të qeverisë kroate e në shumicën e kohës përdorte si të vetmin burim informacion artikujt e përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Lajmeve, HINA. Gazeta përcillte informacion të detajuar mbi zyrtarët e qeverisë dhe shprehja" goja e qeverisë "që përdorej për të treguar gazetat pro-qeveritare në këtë rast ishte e dukshme për shumicën e artikujve e titujve, për shkak të mbizotërimit të mënyrës pohuese me të cilën ata raportonin mbi aktivitetet e qeverisë"*[6]
>
> *"Kur ne filluam studimin tonë…nuk e prisnim të ndesheshim me faktin sesa seriozisht janë të rrezikuara standartet profesionale gazetareske..Kjo analizë duhet të merret si një kontribut për të studiuar politizimin e përgjithshëm kaq të dukshëm të gazetave të përditshme kroate sipas temave që botojnë në faqen e parë. Politika, krimi dhe aksidentet janë pjesë e politikës editoriale të gazetave kroate me tirazhin më të madh"*[7]

6 Ibid, 113
7 Ibid, 113-114

Situata në tregun e medias kroate bëhet edhe më e qartë nëse i hedhim një sy të dhënave të mbledhura:

Rradhitja sipas numrit të artikujve	Gazeta (%)			
	24 sata	**Jutarnji list**	**Večernji list**	**Vjesnik**
1	Krime (21.9)	Politikë (32.3)	Politikë (52)	Politikë (38.2)
2	Aksidente (21.2)	Ekonomi (27.6)	Krime (12.9)	Ekonomi (25.6)
3	Politikë (20)	Krime (12.6)	Tjera (11)	Kulturë (7.6)
4	Tjera (9.7)	Tjera (6.7)	Aksidente (5.5)	Krime (7.5)
5	Zbavitje (8.7)	Kulturë (5.3)	Çeshtje sociale (5.2)	Çeshtje sociale (6.3)
6	Çeshtje sociale (7)	Çeshtje sociale (4.7)	Ekonomi (4.4)	Arsim (6)
7	Ekonomi (5.5)	Aksidente (4.1)	Kulturë (3.3)	Tjera (3.7)
8	Arsim (2.5)	Arsim (2.6)	Arsim (3.3)	Aksidente (2)
9	Shëndetësi (2.2)	Shëndetësi (2.6)	Shëndetësi (1.1)	Shëndetësi (1.7)
10	Kulturë (1.2)	Zbavitje (1.5)	Zbavitje (1.1)	Zbavitje (0.6)

Tabela 1: Temat mbizotëruese sipas gazetave[8]

Llojet e titujve që janë analizuar përbëjnë gjithashtu një ilustrim të përfundimit të mësipërm.



Grafiku 2: Lloji i titullit në gazeta[9]

8 Ibid, 111
9 Ibid, 110

Novi List, gazeta tjetër që unë kam përfshirë në këtë studimi, megjithëse nuk ishte subjekt i vëzhgimit mbi besueshmërinë e të përditshmeve, kryesisht ndjek të njëjtën kahje si më lart.

Sipas rezultateve që z. Igor Kanizaj botoi në librin e tij "Minoritetet mes publicitetit dhe realitetit"[10], shumica e gazetave kroate mund të klasifikohen si"gjysmë tabloide"– ato botohen në formën e një tabloidi por përmbajtja dhe forma e raportimit nuk përputhen me konceptin e tabloidit. Shumica e gazetave të përditshme harmonizojnë stile të ndryshme kështu që ne mund të ndeshemi me artikuj me të vërtetë tabloidë edhe në gazeta që e paraqesin veten e tyre si 2 serioze", ashtu sikurse mund të gjejmë një artikull të shkruar nga një akademik në gazeta tipike tabloide.

Duke folur rreth"tonit"të artikujve të botuar (në përgjithësi) ndokush mund të vëre re në mënyrë të qartë simpatinë, madje edhe mbështetjen për pavarësinë e Kosovës- çështja në këtë rast mund të jetë se kjo vinte për hir të vetë Kosovës (dhe njerëzve të saj) por ka shumë mundësi që të ishte kryesisht si rezultat I kundërshtimit të Serbisë si edhe deklarohej. Në shumë raste publiku kroat do të reagonte ndaj çështjeve që përfshinin Serbinë vetëm në një mënyrë – kundër Serbisë qoftë edhe për zyrtarët e saj apo çfarëdo që ajo të bënte. Mediat si një pasqyrë e opinionit të përgjithshëm, publik nuk mund të bënin përjashtim në këtë rast. Duke marrë parasysh kërcënimet e hapura, të bëra nga disa zyrtarë serbë (dhe burime jozyrtare) se "do të luftonin për Kosovën më armë në dorë" si edhe mesazhet që u dërguan vendeve që "gëzonin të njihnin pavarësinë e Kosovës", kjo e bëri të lehtë për median kroate "marrjen e anës" që është e dukshme në shumicën e rasteve e nuk ka rëndësi sesa shumë burime janë cituar apo nëse ilustrimet janë paraqitur në mënyrën e duhur (asnjanëse/të paanshëm).

Pjesa më e madhe e gazetave kroate kanë një numër të përcaktuar faqesh që u kushtohen ngjarjeve jashtë Kroacisë(2-3 faqe max) e disa prej tyre edhe më shumë kur botojnë suplementët javorë. Vetëm ngjarjet me rëndësi të veçantë në nivel botëror i prishin këta kufij dhe botohen lajme edhe jashtë kësaj hapësire "të përcaktuar"

Në periudhën e studimit të kryer prej nesh, ngjarjet që zunë vend në median kroate mbi dhe rreth Kosovës për nga hapësira konkurruan me ato që flisnin për zgjedhjet presidenciale në Amerikë (Obama vs Klinton), të pasuara prej ngjarjeve në Lindjen e Mesme dhe në zona të tjera lufte përreth botës. Gjithashtu fushata e zgjedhjeve presidenciale në Serbi zinte në këto faqe një vend të konsiderueshëm, por shumica e artikujve rreth kësaj ngjarje ishin të lidhura në njëfarë mënyre me Kosovën për shkak se ajo ishte tema kryesore e përdorur nga zyrtarët e kandidatët serbë gjatë fushatës. Megjithëse disa nga deklaratat e bëra prej zyrtarëve e kandidatëve presidencialë serbë u vunë në pah prej faqeve të para të gazetave, menjëherë pas viti të ri, gazetat kroate u orientuan kryesisht drejt mbulimit të ngjar-

10 Kanižaj, Igor. „Manjine između javnosti i stvarnosti" (trans. „Minorites between publicity and reality"), Zagreb, ICEJ, 2006

jeve e çështjeve që lidheshin me formimin e qeverisë kroate- koalicionet e mundshme e jo të mundshme politike, të gjithë llojet e deklaratave të lëshuara nga liderët apo persona "brenda" partive politike që ishin përfshirë në këtë proces.

ANALIZA E REZULTATEVE TË STUDIMIT

a) Hyrje

Analiza e mbulimit të ngjarjeve në Kosovë dhe rreth saj përcillet nëpërmjet dy të përditshmeve të shtypit të shkruar kroat Novi List dhe Vjesnik.

Megjithëse Novi List nuk është gazetë me tirazh të madh (ajo zë vendin e 4 e të 5-te),në krahasim me gazete e tjera ajo i mbuloi mjaft mirë ngjarjet që lidheshin me Kosovën përgjatë periudhës janar – shkurt 2008. Ai është edhe më i mirë se në dy gazetat më të shituar kroate Veçernji List dhe Jutarnji List, ndërkohë që gazeta më e shitur e ditëve të sotme 24 SATA është disi e ndryshme përsa i përket orientimit dhe zgjedhjes së temave pasi nuk mbulon ngjarje që lidhen me politikën e jashtme, por zgjedh prej tyre vetëm ato më domethënëset e" skandalozet.

Si gazetë të dytë kemi zgjedhur Vjesnik, e cila duke qenë në pronësi të shtetit kroat është një "gazetë qeveritare" që pasqyron më së shumti qëndrimin e qeverisë mbi një çështje të caktuar. Pavarësisht tirazhit të saj të ulët ajo lexohet gjerësisht mes zyrtarëve të qeverisë dhe nëpunësve të tjerë të saj. Ajo është e njohur për faqet e saj të politikës së jashtme por si tregon edhe ky studim kjo cilësi ka humbur me kalimin e viteve teksa shumica e artikujve të saj, jo vetëm ato që trajtojnë çështjen e Kosovës, nuk shkruhen prej gazetarëve të tyre por janë artikuj të agjencive të lajmeve. Theksojmë se shumica e artikujve u botuan nga HINA-Agjencia Zyrtare Kroate e Informacionit. Që kur Republika e Kosovës deklaroi pavarësinë e saj, megjithëse në fillim të periudhës së këtij studimi Kosova ishte pjesë kushtetuese e Serbisë, për hir të këtij kërkimi Serbia u emërtua në pyetësorë si "vendi tjetër". Duke bërë këtë ne mund të dallojmë më mirë numrin e ngjarjeve e artikujve të cilët i përkisnin zonës së Kosovës. Ajo çfarë vërejmë është fakti se 2/3 e artikujve sa i përket Kosovës përmendin Serbinë e kryeqytetin e saj Beogradin si vendveprimin e ngjarjeve e jo vetë Kosovën. Siç dihet tashmë, media kroate (këtu nuk përbëjnë përjashtim edhe Novi List dhe Vjesnik) mbulonin deklaratat që jepeshin rregullisht nga zyrtarët dhe kandidatët presidencialë serbë e më pas i interpretonin ato dhe ngjarje të tjera duke marrë në konsideratë ndikimin e tyre mbi situatën politike e të sigurisë në rajonin e Ballkanit ku bënte pjesë edhe Kroacia.

Fakti se gjatë periudhës kur u krye studimi zhvilloheshin zgjedhjet presidenciale në Serbi, deklaratat e Kosovës për shpalljen e pavarësisë ishin veçanërisht pjesë e pashmangshme e retorikës së fushatës e në këtë mënyrë përbënin pa dyshim një element me rëndësi për tu mbuluar prej medias.

Por do të ishte gabim nëse do të deklaronim se të gjithë artikujt e përfshinë në rubrikën e gazetës "Vende të tjera", lidheshin me Serbinë për shkak se një pjesë e madhe prej tyre që bënin pjesë në këtë kategori i përkisnin me të vërtetë vendeve të tjera dhe lidheshin me deklaratat e dhëna nga zyrtarët e vendeve evropiane, BE dhe SHBA sa i përket pavarësisë së Kosovës.

b) Rezultatet e studimit

Ashtu si tregojnë edhe rezultatet numri i artikujve të botuar në të dy gazetat (210 në tërësi ku 112 tek Novi List dhe 98 në Vjesnik) nuk është aq i ndryshëm megjithëse natyra e shkrimeve të përdorura dhe tregues të tjerë dëshmojnë për një dallim domethënës mes të dy gazetave. Sa i përket shpërndarjes së artikujve rreth 1/3 e tyre u botuan në janar dhe 2/3 në shkurt 2008.

Numri i plotë i artikujve të botuar në të dy gazetat (210) dhe shpërndarja e tyre (112 Novi List dhe 98 Vjesnik) na tregon saktësisht se përgjatë periudhës janar-shkurt 2008 nuk ka patur pothuajse asnjë ditë në të cilën të mos jetë botuar një artikull që lidhet me Kosovën. Sigurisht vërehen më pak artikuj sidomos në fillim të janarit (Viti i Ri, formimi i Parlamentit dhe qeverisë kroate i la disa çështje të tjera mënjanë) dhe në disa ditë (16 shkurt –23 shkurt) kishte më shumë se 1 artikull që i kushtohej ngjarjeve në Kosovë- vetë deklaratës së pavarësisë por edhe tensioneve etnike e dhunës së shfaqur në Kosovë, Beograd e disa vende të tjera- korrespondenca nga vendngjarja, të shoqëruara me deklaratat e zyrtarëve të qeverisë nga Kosova, Serbia e vendeve të tjera sa i përket njohjes së një Kosove të pavarur, komenteve mbi subjektin e saj etj.

Arsyeja e dukshme që shpjegon një shpërndarje të tillë lidhet me faktin se ngjarjet në Kosovë dhe rreth saj bëheshin më të shpeshta sa më shumë që afrohej dita e shpalljes së pavarësisë, e në mënyrë të veçantë në ato pak ditë që pasuan deklaratën ku u shfaqën skenat e dhunshme e tensionet etnike.

Shumica e artikujve nuk u vendosën në faqe të parë (90%) por deklarata e pavarësisë, protesta e veprimet e para serioze të dhunës u paraqitën në faqe të parë tek të dy gazetat. (Në tërësi ishin 20 artikuj në faqe të parë).

Shkaku i mundshëm për "mungesën" e Kosovës në artikujt e faqes së parë lidhej me gjendjen e përgjithshme të medias kroate, siç e shpjeguam në kapitullin e mëparshëm. Është një fakt i dukshëm se jo vetëm në gazetat Novi List dhe Vjesnik, artikujt e botuar në rubrikën "Bota" arritën të dalin në faqen e parë vetëm në raste shumë të veçanta-si p.sh deklarata e pavarësisë dhe protestat e mëdha e skenat e dhunës në Beograd. Normalisht faqja e parë i kushtohet politikës vendase, disa ngjarjeve sportive dhe reklamave e duke patur parasysh se vetëm 5-6 artikuj të botuar arritën të dalin në faqen e parë shpjegohet mjaft mirë edhe ky rezultat.

Të dhënat që i përkasin llojit të shkrimeve që kanë përdorur gazetarët janë disi të përziera e megjithëse artikujt (në të dy gazeta) mund të kat-

egorizohen sipas klasifikimeve të përcaktuara, një numër i madh i tyre nuk bëjnë pjesë tek ajo që ne quajmë kategori e "pastër". Rezultatet tregojnë se kategori mbizotëruese janë 2 lajmet e zgjeruar" (24.2%) e pasuar nga "deklaratat" (21.4%),"korrespondencat (17.6%) dhe artikujt klasikë të "lajmeve" (14.7%). Ka disa artikuj që përfshihen në kategorinë "analizë" (5.2%), "mbulim" (5.2%) dhe "komente" (7.15). Ndërkohë është edhe një numër i vogël intervistash (1.4% - vetëm 3 intervista e të gjitha të botuara tek Novi List) dhe një pakicë njoftimesh për shtyp (1.9%). Përgjatë periudhës janar-shkurt 2008 u botuan vetëm një shënim dhe foto-lajm Mungesa tërësore e editoriale ndaj çështjes së Kosovës nuk përbën ndonjë të papritur pasi ato janë në përgjithësi një rubrikë e rrallë në gazetat kroate. Përsa i përket letrave të lexuesve, hapësira e lënë për to është mjaft e kufizuar e shumica prej tyre kanë të bëjnë me çështje të karakterit lokal.

Nga ana tjetër edhe vëzhgimet/sondazhet nuk janë një kategori e zakonshme që përdoret nga shtypi e kryesisht realizohen lidhur me ngritjen e çmimeve apo çështje të ngjashme.



Grafiku 3: Lloji i tekstit

Rreth 131 artikuj (62.3%0 u shkruan nga gazetarët por vërehet edhe një ndryshim – nga njëra anë "Novi List" ku 76.7% e artikujve është shkruar nga gazetarët (pjesa tjetër pothuajse 23.2% janë artikuj të botuar nga agjenci lajmesh apo të ribotuara) ndërsa nga ana tjetër tek gazeta Vjesnik vetëm 45% e artikujve janë të shkruar prej gazetarëve dhe 48% janë të botuara nga

agjenci lajmesh. Të paktën Vjesnik ka 3 artikuj (3%) të shkruar nga ekspertë të fushës – por dy nga autorët e të cilëve nuk mund të identifikohen (foto lajm dhe shënim).

Përsa i përket burimeve të informacionit, 70% dhe 70.4% e artikujve në të dy gazetat mund të klasifikohen se kanë cituar burime të sakta dhe në 4.2% të artikujve burimi është vetë gazetari. Kështu që 74.% e artikujve mund të konsiderohen si legjitim duke nënkuptuar se ato përmbushin standartet profesionale të gazetarisë. Nga ana tjetër 3.8% e artikujve nuk kanë burime të deklaruara(shumica prej tyre u përkasin komenteve) dhe një numër i madh i artikujve i përkasin kategorisë "burime të paidentifikuara" (21.4%). Duke lexuar këto artikuj të krijohet një përshtypje disi e ndryshme – në disa prej tyre megjithëse burimi nuk deklarohet në mënyrë të qartë, informacioni përfshihet në kategorinë e asaj që shumica e njerëzve në Kroaci do ta quanin "dije e përbashkët" dhe lexuesi mesatar nuk arrin të vërë re se burimi i informacionit mungon (Ndokush duhet të marrë parasysh se ajo çfarë konsiderohet "dije e përbashkët" në Kroaci nuk do të jetë patjetër e njëjta gjë nëse e vërejmë në Serbi). Ajo çfarë po përpiqem të them është fakti se në përgjithësi opinioni publik në Kroaci nuk është i orientuar pozitivisht kur vjen fjala tek Serbia, veçanërisht zyrtarët e tyre dhe gazetat në Kroaci (dhe gazetaret) e kanë parasysh këtë fakt kur përgatisin artikujt e tyre. Publiku në Kroaci e priste që zyrtarët serbë ta kundërshtonin fitimin e pavarësisë së Kosovës si edhe që ata të ishin të ashpër e kërcënues kur flisnin rreth Kosovës (kjo konsiderohet si "mënyra e tyre e të folurit dhe sjelljes" kështu që kërcënimet e fshehura (e disa jo të tilla) që fillonin me "Nëse Kroacia (e vende të tjera) njihnin pavarësinë e Kosovës", nuk u erdhën të papritura. Për tu kthyer tek artikujt ku burimi nuk citohet, ata thyejnë një nga "rregullat e arta" të gazetarisë profesionale.



Grafiku 4: Burimet e informacionit sipas llojit

Lidhur me numrin e burimeve të informacionit të paraqitura në artikujt e botuar pothuajse se gjysma e tyre (43.8%) citojnë vetëm një burim informacioni- shumica e tij është e lidhur me deklaratat e dhëna nga zyrtarë të qeverisë së vendeve të ndryshme (Serbia apo ndonjë tjetër) sa i përket pavarësisë së Kosovës apo njohjes prej tyre të saj. Ndërkohë gjysma tjetër e artikuj citon të paktën 2 apo më shumë burime informacioni. Por ata megjithëse citojnë 2 apo më shumë burime ë tilla ato janë shpesh të të njëjtit kah. P.sh një artikull jep deklarata nga zyrtarë të ndryshëm serbë, të gjitha me të njëjtin ngjyrim por nuk jep të tilla nga krahu i kundërt p.sh të përfaqësuesve nga Kosova apo diçka të tillë.

Rreth 29.5% e artikujve japin informacion për ngjarje deri ditën e shpalljes së pavarësisë ndërkohë që numër i konsiderueshëm artikujsh u kushtohen "pseudo –ngjarjeve" (36.6%). Ndërkohë 19.5% e artikujve të tjerë u përkasin ngjarjeve që lidhen me të ardhmen, 4.2% fazave të ndryshme të zhvillimit të tyre dhe 7.1% u përket ngjarjeve të hershme që lidhen me çështjen e Kosovës.

Një shpërndarje e tillë e rezultateve lidhur me rastin e botimin të një artikulli dëshmon sesi shumicën prej artikujve e përbëjnë deklaratat, mesazhet e dërguara prej zyrtarëve (shumica e tyre nga Serbia) dhe lloje shkrimesh të ngjashme. Lidhur me gazetat e marra në shqyrtim, situate është disi e ndryshme për shkak se Novi List ka 42.8% të artikujve që trajtojnë ngjarjet deri ditën e shpalljes së pavarësisë, 21.4% e tyre flasin për ngjarjet në të ardhmen ndërkohë që 26.7% janë për "pseudo-ngjarjet". Nga ana tjetër gazeta Vjesnik ka vetëm 14.2% të artikujve për ngjarjet që zhvillohen në kohë para se të shpallet pavarësia, 17% e tyre janë për ngjarjet e ardhshme dhe 47.9% mund të kategorizohen si artikuj që u kushtohen "pseudo-ngjarjeve".

Sa i përket titullit dhe përmbajtjes së artikujve të botuar, raporti mes titull/nëntitull dhe tekstit është i tillë: 26.1% e titujve në gazetat e marra në shqyrtim mund të klasifikohen si përmbledhje me fjalë "asnjanëse e temës kryesores të shkrimit" dhe 55.2% e titujve përmbajnë një mesazh qe nxjerr pjesërisht në pah temën e artikullit. Pjesa tjetër e artikujve përmban tituj që ofrojnë një mesazh të qartë i cili thekson temën kryesore të shkrimit. Ndoshta duhet ta konsiderojmë pozitiv faktin që vetëm në një rast titulli përmban një mesazh që shtrembëron pjesërisht temën dhe ndërkohë nuk gjendet asnjë prej tyre që shtrembëron plotësisht temën e artikullit.

Shumica e artikujve të botuar kanë nga një ilustrim (77.6%) dhe në të gjitha rastet ajo është një fotografi- nuk gjenden harta, skica grafikë apo ilustrime të tilla të ngjashme. Pjesa tjetër e artikujve u botua pa ndonjë ilustrim.

Përsa i përket artikujve të ilustruar (163), në shumicën e rasteve (69%), fotoja është në përputhje me mesazhin e ilustruar siç edhe duhet të jetë dhe pjesa tjetër e fotove të përdorura (29.4%) në njëfarë vënë në pah mesazhin kryesor të shkrimit. Ndërkohë vetëm njëra prej tyre (0.6%) shtrembëron mesazhin. Duhet të merret parasysh se mes fotove që përputhen me mesa-

zhin përshihen edhe ilustrime të tilla si portretet e autorëve (gazetarëve) që shoqërojnë komentet apo portretet dhe disa lloje të tjera shenjash që dallojnë përmes karakteristikave të tyre një vend (ndërtesa, flamuj apo diçka të ngjashme) që shoqëronin shpesh deklaratat e zyrtarëve të qeverive të vendeve të ndryshme. Lajmet e aktualitetit, korrespondencat dhe elementë të tillë ilustrohen më së mire me "foto-live" të ngjarjeve – këtu mund të përmendim deklarimin e pavarësisë, festimin e saj në rrugët e Prishtinës, dhe aktet e dhunës në rrugët e Beogradit pas shpalljes së pavarësisë.

Lidhur me përmbajtjen e artikujve, një pjesë e mirë e tyre merren më së shumti me të drejtën e vetëvendosjes/pavarësinë e Kosovës (40.8%) dje 30.6% me lëvizjet diplomatike (apo mesazhet e dërguara publikut rreth tyre) të vendeve të tjera. Një numër i vogël artikujsh merren drejtpërdrejt me tensionet etnike në zonën e Kosovës (8%) dhe dhunën ushtruar (5.7%) ndërkohë që vetëm një pakicë e tyre mbulojnë lëvizjet diplomatike të kryera nga zyrtarët e Kosovës (2.9%) si edhe përpjekjet për zbatimin e ligjit (1%).

Një tregues tjetër është edhe përmendja e vendveprimit të ngjarjeve të nga media përmes artikujve të saj të botuar. Pasi në shumicën e rasteve raportohet më shumë nga ndonjë vend tjetër sesa nga vetë Kosova (63.8%). Në fakt shumica e tyre lidhet me Serbinë e pasuar edhe nga vende të tjera zyrtarët e të cilëve dhanë deklarata apo informacione të llojeve të tjera lidhur me statusin e Kosovës, veçanërisht para shpalljes së pavarësisë. Në kohën e deklarimit të pavarësisë Kosovës vendveprimi u rivendos në Kosovë- Prishtinë, Mitrovicë dhe në pikëkalimet e kufirit me Serbinë. Por kjo nuk ndodhi vetëm në Kosovë por edhe në vende të tjera për shkak të akteve të dhunshme në Beograd, sulmet mbi ambasadat e vendosura e aktet e tjera të vandalizmit në rrugët e tij

IV. KONKLUZIONE

Si përfundim, mbështetur edhe mbi numrin e artikujve të botuar në Kroaci, mbulimi prej medias së këtij vendi të ngjarjeve në Kosovës ishte mjaft i mirë por artikujt duhet të ishin më cilësorë. Shumica e tyre lidhen me vendveprimin për të cilën u shkruan ndërkohë që numër relativisht i vogël i artikujve dhe korrespondencave nga Kosova vërenin faktin se jo të gjithë gazetarët shkuan në Kosovë para mesit të shkurtit 2008. Megjithëse mund të përmendim faktin se Novi List botoi disa "histori të gjalla" nga Kosova në suplementet e saj javore, pak intervista e një pjesë e mbulimit të ngjarjes u shoqërua me analiza politike. Historitë sesi është "jeta e përditshme" në Prishtinë ishin të pakta ashtu si edhe ato rreth çështjeve ekonomike e luftës ndërkohë që gazetarët përmes vëzhgime të tyre theksonin ndonjëherë deklaratat e dhëna nga banorët vendas. Gazeta Vjesnik botoi disa histori të ngjashme por ato nuk u botuan si suplement - përkatësisht në vend të suplementit të saj, Vjesnik ka disa forma të rubrikave të përjavshme që u kushtohen ngjarjeve nga jashtë dhe të botuara si pjesë tërësore e gazetës.

Të krijohet përshtypja se media në Kroaci e konsideronte publikun kroat mjaft të informuar rreth Kosovës dhe se Kroacia(qeveria, publiku dhe media në mënyrë të njëjtë) do të miratonte (apo të paktën nuk do të kundërshtonte) deklaratën e pavarësisë së Kosovës siç e konfirmonin edhe rezultatet e sondazheve.

Ndërkohë është fakt që në vend të një raportimi sa më të përditësuar nga dhe rreth Kosovës (me përjashtim të pak ditëve para dhe pas shpalljes së pavarësisë) media më së shumti raportoi rreth asaj çfarë thanë zyrtarët serbë dhe se kur vendet e tjera (veçanërisht BE dhe SHBA) do ta njihnin pavarësinë e Kosovës.

Për pak ditë, në qendër të vëmendjes së medias u vendos çështja sesi (dhe kur) OKB, BE dhe SHBA do të përfshiheshin në mënyrë aktive nëse tensionet etnike përshkallëzoheshin në një dhunë serioze. Dhuna që u shfaq në rrugët e Beogradit, sulmet ndaj ambasadës kroate e disa dyqaneve në pronësi të nënshtetasve kroatë u mbuluan mjaft mirë prej medias, siç edhe pritej, për shkak se në të përfshihej Kroacia dhe qytetarët e saj.

Interesi i publikut dhe si rrjedhojë edhe mbulimi prej medias ishte më i lartë se në ato pak raste të dhunës që u shfaq kundër njerëzve nga Kosova që jetonin në Kroaci.

Siç e deklaruan në fillim, ndjeshmëria rreth luftës së kaluar në Kroaci e Bosnje, perceptimi i fajësisë ndaj Serbisë lidhur me këtë luftë si edhe roli i "liderit rajonal" që Kroacia përshtati gjatë periudhës së kaluar, të gjitha këto të marra së bashku, krijuan një klimë të veçantë në publik. Në këto rrethana, kur erdhi fjala për pavarësinë e Kosovës, publiku kroat ishte në përgjithësi mbështetës dhe si rrjedhojë mbulimi prej medias i kësaj ngjarjeve thjesht e nxori në pah këtë prirje.

BIBLIOGRAFI

The Political Science Research Center- downloaded section: "Nations in Transit 2008" Freedom House "The Democracy Score –Croatia" http://www.cpi.hr/download/links.hr/11597.pdf

Polslovni Dnevnik, Research Agency "PULS", http://www.poslovni.hr/73965.aspx

SEE biz.eu Tvrtk-Mediji http://www.seebiz.eu/hr/tvrke/mediji/medi-apuls-veliki-rast-citanosti-hrvatski-tiskovina 144889.html

Igor Kanizaj, Opca politizacija dnevnik novena u Hrvatskoj (trans: The overall politiciation of Croatian daily newspapers "in" Vjerodostojnost novena "(trans "Newspaper credibility") ed. Stjepan Malovic, Zagreb ICEJ, 2007, 95-115

Kanizaj, Igor "Manjine izmedni javnosti i stvarnosti (trans: "Minorities between publicity and reality") Zagreb, ICEJ, 2006



HUNGARIA

Gabor Szego



VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Ngjarjet e fundit të krizës së Kosovës, deklarata e pavarësisë së mesit të shkurtit 2008 e qeverisë së Kosovës, mbylli (të paktën për këtë kohë) dhe hapi një kapitull të ri në Ballkan. Përfundimi i periudhës së mëparshme me rivalitetin e brendshëm etnik shpresojmë se i ka dhënë fund rrezikut të vazhdueshëm të një konflikti të armatosur në Kosovë. Kjo periudhë e re mund të karakterizohet me aktivitet diplomatik e politik – cili ndonjëherë nuk do të jetë me më pak armiqësi. Me anë të vendimit të Parlamentit të Prishtinës më 18 shkurt 2008, lindi një shtet i ri në Evropë, kështu që ishte e natyrshme që të gjithë gazetat cilësore të rajonit e të kontinentit në tërësi të ndiqnin në muajt e fundit,me një interes të veçantë, ngjarjet në Ballkan. Kjo është veçanërisht e vërtetë në rastin e vendeve fqinj të Kosovës e Serbisë përderisa ato prekeshin në mënyrë më të drejtpërdrejtë: për to konflikti i Kosovës ishte më shumë se një dilemë sterile dhe e largët e politikës së jashtme. Hungaria ishte një prej këtyre vendeve (megjithëse kurrë nuk bëri pjesë në ish – Federatën Jugosllave) për shkak të minoritetit hungarez që jeton në Serbinë veriore.

I. KONTEKSTI POLITIK (QËNDRIMET POLITIKE VENDASE NË DREJTIM TË KOSOVËS)

Ky interes i veçantë përbën një ndër faktorët bazë që ka ndikuar në mbulimin e ngjarjeve të Kosovës prej shtypit hungarez. Në krahasim me çështje të tjera të politikës së jashtme si lufta në Irak apo lufta kundër terrorizmit, gazetat dhe mediat elektronike hungareze e trajtuan këtë konflikt në mënyrë të kujdesshme, pa harruar se një shpërthim i armiqësive në Kosovë mund të çonte në një valë masive refugjatësh serbë, të cilët në kërkim të shtëpie të re mund ta gjenin atë (si ndodhi gjatë krizës boshnjake) në Vojvodinë ku jetojnë afërsisht 200-350 mijë njerëz me origjinë hungareze. Ky aspekt i veçantë vërehet jo vetëm në përmbajtjen e artikujve por edhe në trajtimin e përgjithshëm të krizës, metodave editoriale, stilit si edhe disa vendimeve profesionale.

Kjo qasje e kujdesshme ishte gjithashtu e dukshme edhe tek vetë partitë e mëdha hungareze. Përveç disa grupeve të vogla radikale të së majtës e të së djathtës, forcat kryesore parlamentare reaguan relativisht në mënyrë të moderuar. Koalicioni qeverisës i Partisë Socialiste Hungareze (MSZP) dhe Aleancës së Demokratëve të Lirë (SZDSZ) bënin thirrje për një zgjidhje paqësore ashtu si edhe Forumi Demokratik Hungarez (MDF) Fidezs i qendrës së djathtë-forca më e madhe opozitare – dhe aleatja e saj Aleanca Kristian Demokrate (KDNP). Ato të gjitha theksonin nevojën për një zgjidhje diplomatike mundësisht me ndihmën e BE dhe në këtë pikë nuk kishte dallime të vërteta mes qeverisë dhe opozitës. Vihet re një ndryshim i vogël përsa i përket vënies së theksit mbi rëndësinë e të drejtave të minoriteteve (në këtë rast të serbëve që kishin mbetur në Kosovë).

Megjithatë, më vonë, kur çështja e njohjes së pavarësisë së Kosovës u shtrua për diskutim ky përkim harmonik mes palëve filloi të shprishej.

Dyshja MSZP- SZDSZ mbanin parasysh nevojën e bashkërendimit me vendet e tjera të rajonit. Ato duhet të kishin parasysh paralajmërimin e shumë ekspertëve se "lindja e një Kosove të pavarur mund të destabilizonte të gjithë rajonin e Ballkanit e të inkurajonte gjithashtu të gjithë forcat e tjera separatiste në botë"(1).

Nga ana tjetër Fidesz –KDNP kërkonin një njohje të shpejtë të Kosovës. Në fund, qeveria e qendrës së majtë priti përreth 1 muaj dhe e pranoi sovranitetin e Prishtinës vetëm aty nga mesi i marsit së bashku me Bullgarinë e Kroacisë si dhe pas bisedimeve të gjata përgatitore diplomatike.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm për udhëheqësit në Budapest ishte edhe fakti që kontingjenti hungarez kishte shërbyer në KFOR për një periudhë të gjatë. Siguria e ushtarëve hungarezë mbetej një çështje me rëndësi megjithëse analistët ushtarakë ishin të bindur sa i përket gjykimit të tyre se "lufta është jashtë diskutimit si një mundësi për Serbinë edhe sikur Kosova të deklarojë pavarësinë në mënyrë të njëanshme"(2)

II. KARAKTERISTIKAT E SISTEMIT TË MEDIAS

Si e përmendëm më sipër gazetat e përditshme dhe media elektronike hungareze e trajtuan më me kujdes situatën në Ballkan dhe krizën e Kosovës ndërkohë që nuk u vu re paragjykimi i zakonshëm politik përgjatë mbulimit të kësaj çështje.

Megjithatë politika editoriale ishte pak a shumë e lidhur me sfondin politik të organeve të shtypit. Kështu ne zgjodhëm dy gazeta të rëndësishme hungareze për të analizuar mbulimin prej tyre të ngjarjeve në Kosovë përgjatë periudhës janar – shkurt 2008: ato përfaqësojnë dy krahët kryesorë të skenës politike hungareze Magyar Nemzet (Kombi Hungarez) e cila përmendet zakonisht si një gazetë konservatore, e afërt me partinë kryesore të

opozitës(FIDESZ). Kjo e përditshme 71 vjeçare e përcakton veten e saj si një "e përditshme civile" –duke iu referuar emrit zyrtar të FIDESZ (Aleanca Civile Hungareze). Përgjatë vlerave të saj tradicionale, ne kemi vërejtur edhe një parapëlqim të fortë, megjithëse po venitet ngadalë, për çështjet e politikës së jashtme. Tirazhi i saj është 70-80 mijë megjithëse vihet re një rënie graduale e tij vitet e fundit. Gazeta botohet nga një kompani private në sfondin e së cilës qëndrojnë aksionarë hungarezë.

Gazeta tjetër, Nepszabadsag (Liria e Popullit) ishte e "përditshmja zyrtare" e MSZP (Partisë së Punëtorëve Socialistë Hungarezë, ish-Partia Komuniste). Ajo ndryshoi vetë-emërtimin e mëparshëm (e përditshme socialiste) dhe sot botohet pa ndonjë shenjë apo moto që tregon anësi politike. Megjithëse nuk është zyrtarisht e njëjtësuar me forcën aktuale qeverisëse në vend,Partinë Socialiste Hungareze, ajo vepron pa dyshim si një organ shtypi i së majtës politike. Rëndësia e saj e dikurshme si gazetë kryesore është zhdukur dalëngadalë por ajo ka akoma tirazhin më të madh mes të përditshmeve cilësore politike (afërsisht 110 000 kopje në ditë por edhe kjo shifër po bie me shpejtësi). Shumica e gazetës është në duart e Swiss Ringie Publishing Company. Megjithëse vërejmë se të dyja gazetat përfaqësojnë dy anë të kundërta politike ato ndonjëherë ato ndoqën të njëjtën linjë kur trajtuan çështjen e Kosovës.

III. ANALIZA E REZULTATEVE TË STUDIMIT

Magyar Nemzet

Gazeta ndoqi një linjë editoriale të moderuar e ishte disi e papritur nëse e krahasojmë me stilin e saj të zakonshëm aktiv e ndonjëherë agresiv sa i përket çështjeve që lidhen me minoritetet. Kjo qasje relativisht e zbutur u vërejt gjatë gjithë periudhës janar-shkurt. P.sh në janar ata e vendosën temën e Kosovës në faqe të parë vetëm 1 herë dhe madje edhe ajo korrespondencë e botuar u përqendrua në zgjedhjet në Serbi ku Kosova ishte vetëm një faktor shtesë. Numri total i artikujve që u morën me Kosovën nuk ishte shumë i madh (11). Në muajin shkurt, kjo shifër u rrit në mënyrë të konsiderueshme (42) dhe numri i artikujve të vendosur në faqe të parë arriti në 4 (u dyfishua menjëherë pas shpalljes së pavarësisë dhe demonstratave masive në Beograd)

Kjo qasje e gazetës u dëshmua jo vetëm nga numri dhe vendosja e artikujve në faqe të parë por edhe nga metoda e përgjithshme me të cilën u mbuluan ngjarjet. Gazeta botoi kryesisht vetëm përmbledhje të përditshme që nuk shprehnin ndonjë ngjyrim të caktuar rreth ngjarjes: Zakonisht një vëzhgues në Novi Sad (kryeqyteti i Vojvodinës që është larg nga Kosova) ndoqi ngjarjet dhe shkroi disa artikuj por pa ndonjë koment individual apo vlerësim subjektiv.

Politika editoriale ndryshoi vetëm mbi dy ngjarjet kulmore te dramës së

Kosovës (deklarata e pavarësisë dhe protestat e Beogradit) ku u botuan korrespondenca nga vendngjarja prej stafit të tyre. Lloji i artikujve të botuar u zgjerua dhe në të u përfshinë analiza e komente përpos edhe një analizë më e gjatë në numrin e fundjavës. Këto ishin më se të përshtatshme që të përcillnin edhe përmbajtje emocionale dhe informacion paraprak mbi ngjarjen duke i shtuar edhe ndonjë element subjektiv mbulimit të mëparshëm në formë sterile. Megjithatë larmia e shkrimeve mbeti e kufizuar. Gjithashtu në këto artikuj nuk gjendet ndonjë galeri e veçantë fotosh, vëzhgime/sondazhe apo letra të lexuesve megjithëse gazetat përpiqen të botojnë kontribute të shumta nga "qytetarë të zakonshëm" mbi tema që botuesit i shohin si të rëndësishme. Edhe karikaturat e botuara ishin të rralla dhe të "buta" - nuk ka përqeshje të vërtetë satirike por thjesht portrete të vizatuara të këtij apo atij politikani apo në vend të tyre edhe fotografi të zakonshme të agjencive të lajmeve.

Gazeta u bë më aktive vetëm në gjysmën e dytë të shkurtit, kur u shtrua problemi nëse Hungaria do ta njihte Kosovën. Ky ishte një rast i që i ofroi një mundësi gazetës Magyar Nemzet që ta trajtonte çështjen si një element të luftës së brendshme politike. Ata kritikuan në mënyrë të përsëritur qeverinë e udhëhequr nga socialistët që po tregohej e ngadaltë, nguruese e nuk po vendoste se çfarë do të bënte. Ata e sulmuan kabinetin qeveritar si "mosveprues" dhe që të pranonte "urdhrat" e Amerikanëve (p.sh ta njihnin pavarësinë e Kosovës sa më shpejt që të qe e mundur).

Shembulli më i mirë për të vënë në pah këtë lloj kritike ishte një vlerësim i shkruar nga kryetari i Komitetit për Marrëdhëniet me Jashtë të Parlamentit hungarez Zsolt Nemeth:

> *"Kryeministri shfaqi 5 pikëpamje të ndryshme vetëm vitin e fundit. Në vartësi të faktit me kë kishte folur, Ferenc Gyurscany e tregonte veten një herë mbështetës të fortë të pavarësisë së Kosovës, një herë mik të Serbisë (...) Pikëpamja e vërtetë e kabinetit hungarez është ende e panjohur"(12 shkurt)*

E njëjta formë përmbajtje u paraqit nga një staf i gazetës pas deklaratës së pavarësisë:

> *"Nëse ne analizojmë qasjen e elitës hungareze, pamja që shfaqet është shumë për të ardhur keq. Nuk ka absolutisht asnjë strategji qeveritare sa i përket kësaj çështje – ne mund të shohim vetëm përpëlitje, paqartësi e ngurrim të paprinciptë (28 shkurt).*

Gazetari i "lutej"liderëve rumunë" për të mos iu dorëzuar kërkesave të SHBA "e që të ndiqnin interesat e tyre kombëtare kur të kundërshtonin pavarësinë e Kosovës. Nënteksti i vërtetë i artikullit, megjithëse gjysmë i fshehur ishte ; qeveria hungareze është duke bërë të kundërtën dhe duke ndjekur këshillat e Uashingtonit si një shërbëtor oportunist…" Ne nuk kemi kushte, nuk kemi parime të qarta, s'kemi as politikë koherente e të qëndrueshme –kjo është mënyra sesi gazetari e përmbledh kriticizmin e tij, pa

përshkruar se cila duhet të jetë zgjidhja optimale (p.sh njohja, mohimi apo më shumë shtyrja e vendimit për këtë rast).

Një tjetër qasje karakteristike e gazetës është se ajo i ndjek ngjarjet, duke patur gjithnjë parasysh situatën e minoritetit hungarez. Pa dyshim që politikanët kryesore të shteteve më me ndikim të komunitetit ndërkombëtar duhet të merreshin në mënyrë të vazhdueshme me çështjen nëse Kosova mund të bëhej apo jo rast precedent për rajone apo grupe të tjera, etj. Nëse shqiptarët e Kosovës mund të arrinin pavarësinë në mënyrë të njëanshme, pa autorizimin e Këshillit të Sigurimit, përse nuk të mos bënin të njëjtën gjë baskët, kurdët, apo njerëzit që jetonin në Osetinë e Jugut apo Abkahazi ?

E njëjta dilemë shqetësonte liderët e minoritetit hungarez që jetoni në vendin fqinj: nëse ata e shihnin Kosovën si një precedent dhe theksonin nevojën për autonomi (kulturore, individuale apo më keq territoriale) ata rrezikonin përkeqësimin e kontakteve të tyre me qeveritë e Bukureshtit, Bratislavës, Kievit apo Beogradit. Për më tepër ata shihnin rrezikun në këto vende edhe për grupe nacionaliste/ parti/lëvizje më armiqësore ndaj minoriteteve. Ndonjëherë gazeta e përshkruan të ardhmen e këtyre minoriteteve si krejtësisht të pashpresë:

> *"Pavarësia e Kosovës nuk premton diçka të mirë për ne, hungarezët dhe për minoritetet hungareze që jetojnë jashtë kufijve të Hungarisë (…). Në të njëjtën kohë, ekzistenca e hungarezëve që jetojnë në Vojvodinë mund të rrezikohet nga ringjallja e nacionalizmit serb apo rivendosjet e serbëve atje të cilët mund të largohen në numër të madh nga Kosova (18 shkurt).*

Nepszabadsag

Shumë prej deklarimeve të mësipërme rreth gazetës Magyar Nemzet qëndrojnë edhe në rastin e së përditshmes tjetër hungareze Nepszabadsag, megjithëse ajo përfaqëson një orientim të ndryshëm politik. Përgjatë muajit janar kjo gazetë i mbuloi relativisht rrallë ngjarjet në Kosovë e në mënyrë rastësore (u botuan 11 artikuj). Në muajin shkurt numri i artikujve u rrit, madje edhe më shumë se gazeta Magyar Nemzet (55 vs 42).

Megjithatë përpjekjet e kësaj gazetën mbetën të kufizuara. Ata anashkaluan mundësitë e tyre profesionale kështu që dobësuan efektshmërinë, e cila mund të ndihmonte orientimin e lexuesve të saj rreth kësaj ngjarje. Kjo është për të ardhur keq veçanërisht duke rikujtuar informacionet e mëparshme grafike në rastin e temave të tjera (p.sh mbrojtja anti-raketë në Europën Lindore apo struktura dhe ndryshimi i buxhetit kombëtar hungarez). Ata nuk ia dolën të botonin tabela me të dhëna ekonomike për Kosovë, diagrami etnik, statistika sociale etj.

Ashtu si edhe në rastin e Magyar Nemzet, ndryshimi i vërtetë në linjën editoriale të kësaj gazete lidhur me ngjarjet e Kosovës, vërehet në mesin e

muajit shkurt 2008. Dy ditë para se Parlamenti i Prishtinës të shpallte pavarësinë ata ende e nënvleftësonin Kosovën. Kështu ato ditë në faqen e parë të kësaj gazete botohej një artikull për zgjedhjet në Pakistan (le të themi një ngjarje më pak e rëndësishme për politikën e jashtme Hungareze). Artikujt e tjerë për Kosovën u shfaqën vetë një ditë para dhe pas 17 shkurtit (deklaratës së pavarësisë) dhe në vijim të protestave masive në Beograd. Në tërësi artikujt që u morën me rastin e Kosovës zunë vend në faqe të parë të gazetës vetëm 3 herë: një ditë para pavarësisë, një ditë më pas dhe mbas trazirave në Beograd.

Qasja e një profile të ulët të kësaj gazete ndaj çështjes së Kosovës është e njëjtë me atë të gazetës Magyar Nemzet edhe sa i përket stilit të artikujve dhe titujve. Gjatë gjithë kohë përdoren tituj të qetë ndoshta me qëllim faktikë (madje mund të themi edhe të mërzitshëm). Ja disa shembuj "Amerika premton ndihmë", "Kosova shpalli pavarësinë saj"; "Moska kërkon mbledhjen e Këshillit të Sigurimit"; "BE kërkon qetësi" etj (18 shkurt)

Nëse ndjekim ngjarjet, nuk është rastësi që e njëjta strukturë titulli,me stilin e lajmit të shkurtër përdoret edhe më vonë: "Kosova duhet të presë akoma për njohjen", "Sllovakia është duke bërë llogaritë", "BE ia beson njohjen shteteve anëtare", "Deklarata kritike nga Rumania" (19 shkurt).

Edhe kur ngjarjet u bënë më të ndezura e më të nxehta,pas demonstratave në kryeqytetin serb, gazeta përdori tituj edhe në të ndrydhur: "Ata iu vunë flakën për Kosovën", "200 mijë njerëz demonstruan", "Shumë ambasada u sulmuan" (22 shkurt). Kjo metodë ishte edhe më paradoksale ashtu sikurse pamja shoqëruese që tregonte restorantin Mc Donalds duke u djegur…

Gazeta rrallë mori një qëndrim të njëanshëm dhe vetëm në mënyrë jo të drejtpërdrejtë. Të dy gazetat nuk përdorën kurrë shtrembërimi i nëntitujve apo diciturave në raport me foton apo domethënien e artikullit që vinte më pas. Madje Nepszabadsag përdori aty–këtu disa fraza në artikujt e saj, të cilat ishin në gjendje të orientonin apo ndikonin mbi lexuesin, të tilla si:

> *"Por disa njerëz u përpoqën të ngjallnin ndarje dhe tension. Serbia nuk do ta humbë Kosovën edhe sikur huliganët e terroristët (që ishte lidershipi kosovar në Prishtinë) të deklarojnë pavarësinë e shtetet armike ta njohin atë – deklaroi Artemije, peshkopi ortodoks serb i provincës. Lideri fetar është simpatizant i Partisë Radikale e nacionaliste serbe e kërkoi blerjen e armëve nga Moska dhe vullnetarë për një betejë të vërtetë".*

Të gjitha emrat e mbiemrat (armik, huliganë, terroristë dhe betejë e vërtetë) ishin të sakta, citime të drejtpërdrejta nga fjalia e peshkopit, por fjalia hyrëse ("Por disa njerëz përpiqen të ngjallin frikë e tension") ishte një vlerësim e tregonte një anësi jo të drejtpërdrejtë prej gazetarit, e pranuar njëkohësisht edhe nga botuesi (14 shkurt)

Gjithashtu gazeta Nepszabdasg përdori më shpesh format e çfarë-

doshme sterile të përmbledhjes së lajmeve sesa reportazhet apo shënimet nga korrespondenti e saj që vizituan Kosovën së bashku me një fotograf. Artikulli i tyre u botua në një suplement të fundjavës por vërejta se shkruante diçka groteske. Në vend që të raportonin nga Prishtina apo Mitrovica (ku zhvillohej "veprimi real" ato ditë) ato zgjodhën një fshat të vogël, i cili dukej krejtësisht jo karakteristik, me banorët e tij të përzier të shumë etnive dhe relativisht paqësorë.

> *"Kështu që ai ka vendin e tij – na tregon një burrë anonim me ton më shumë keqardhës sesa fyer për fqinjin e tij –"Gjatë vitit ata ndihmojnë njëri-tjetrin (...), ata nuk shprehin vrerin e tyre ndaj fqinjëve (..). Problemet e shpresat e tyre janë të njëjta (…)"- në këtë mënyrë gazetari përmblodhi mendimin e tij (23 shkurt)*

- Dëshirë e menduar? Optimizëm i zgjeruar? Një pamje tepër idilike? Kush e di- ndoshta ishte një gabim editorial apo një vendim i qëllimshëm për ta paraqitur situatën më mirë se ç'ishte në të vërtetë.

Një tjetër problem i linjës editoriale të Nepszbadsag, lidhur me mbulimin e ngjarjeve të Kosovës, është vonesa për të paraqitur një këndvështrim sa më të gjerë të çështjes përmes pyetjeve të ekspertëve e politikanëve. Lexuesit duhet të prisnin jo pak, por 10 ditë derisa gazeta botoi intervistën e parë, duke e ndihmuar kështu lexuesin të kuptonte, pse, çfarë e cilat ishin pasojat e saj që kishte ndodhur.

Edhe në këtë rast ata zgjodhën dy figura publike që nuk ishin të prekur drejtpërdrejt nga kjo ngjarje: një jurist nga Vojvodina që jepte mësim në një universitet amerikan dhe presidentin e Sllovenisë. Gjithashtu përmes intervistës me zv/ambasadorin serb në Budapest, për herë të parë një zyrtar serb përfitoi nga rasti të përcillte në gazetë opinionin e autoriteteve të Beogradit. (27 shkurt)

Edhe analiza e parë, e vërtetë, e një intelektuali hungarez u botua me mjaft vonesë në këtë gazetë. Autori Miklos Tomas Gaspar është një filozof që kontribuon përmes shkrimeve të tij në gazeta të ndryshme për një sërë çështjes, por nuk është një ekspert i vërtetë për krizën e Ballkanit. Më e keqja ishte se artikulli i tij mbetej shumë i njëanshëm, pa arritur të japë një shqyrtim të plotë të problemit. Gazeta i dha z. Tomas titullin e "studiuesit shkencor" dhe e botoi shkrimin e tij në faqen e opinioneve. Analiza e tij ishte subjektive dhe shprehte opinionin kundër njohjes së Kosovës prej Hungarisë si dëshmohet edhe në këtë citim të tij:

> *"Ne hungarezët jemi shumë të prekur nga katastrofa e Kosovës (…).Pavarësia e Kosovës ngjalli frikërat më të egra (serbe) –ato janë frikësuar prej nesh (…) Nëse qeveria hungareze tregohet budallaqe e mjaft mendjeshkurtër që të njohë sovranitetin e Kosovës, atëherë ne duhet të deklarojmë: e tërë elita politike hungareze, siç është, e ka humbur sensin e saj plotësisht (…)*

Unë kërkoj me mirësjellje që ta anulojë dokumentin, që pothuajse ka përgatitur, për njohjen e Kosovës (26 shkurt)".

Sigurisht që problemi nuk qëndronte se çfarë mendonte filozofi-studiues. As edhe fakti që gazeta me tirazhin e vetëvlerësimin më të lartë botonte një pjesë të tillë. Shqetësimin më të madh e përbënte fakti që gazetës i mungoi qëllimi të ofronte një kundër-peshë të krahut tjetër, pra ti përgjigjej me një shkrim "pro" të stilit së faqes e opinioneve. Për më tepër komentet që pasonin çështjen e njohjes duhet të ndiqnin të njëjtën linjë. Një nga publicistët më të njohur të gazetës shkroi një koment, saktësisht 2 herë më të gjatë se editorialet e tij të zakonshme, duke treguar në këtë mënyrë rëndësinë e saj. Shkrimi kritikon me fjalë të forta pavarësinë e Kosovës. Mjafton të citojmë diçka nga paragrafi i fundit për të kuptuar mesazhin e saj:

"Unë mendoj që Republika e Hungarisë nuk duhet ta njohë sovranitetin e Kosovës". Ky konkluzion është një rregull, si pjesë e dy komenteve pro dhe kundra që përdoren edhe në faqen e opinioneve të USA TODAY – por gazeta Nepszabadfsag kurrë nuk e botoi një shkrim "pro" procesit të njohjes së pavarësisë.

Publicisti sugjeron një njohje jo të drejtpërdrejtë të Kosovës, si në rastin e Tajvanit. Në vend të ambasadës, province kineze ka një zyrë përfaqësimi në Budapest. E njëjta zgjidhje duhet t'i ofrohet Kosovës, kështu në do të shmangim një betejë të panevojshme dhe absurde-ky është konkluzioni i autorit (21 shkurt).

Me të njëjtën qëllim, pra që të shtynte (apo të paktën kritikonte) një vendim të qeverisë rreth njohjes, gazeta përdori edhe metodën e letrave nga lexuesit. Ata botuan 2 letra në të njëjtën ditë, të dyja kundër njohjes. Një shembull i shkurtër:

"Njohja e Kosovës do të nënkuptonte një rikthim në traditën e tmerrshme të politikëbërjes etnike (…).Politik etnike është krim.. pjesë e marrëveshjes së bërë me Amerikanët(..) Kthimi i Europës Lindore në një makth të konflikteve etnike do të shkatërronte qetësinë e njerëzve në rajonin tonë dhe të vetë BE (…) Por ne jemi këtu, qytetarë të zakonshëm, mos e lini ta bëjnë këtë (27 shkurt)".

Me një fjalë "qytetari i zakonshëm" që shkruante letrën ishte një historian, një profesor universiteti, figurë e mirënjohur e qarqeve intelektuale të majta.

IV. KONKLUZIONE

Përveç ndonjë shenjë të lehtë të paragjykimit editorial, çdokush mund të gjejë shumë faktorë pozitivë që lidhen me mbulimin e përgjithshëm të krizës së Kosovës në dy gazetat e përzgjedhura.

-Le të fillojmë me lajmet e mira. Faktor pozitiv mbetet fakti se ato i ndoqën ngjarjet me kujdes profesional, pa qëllim që të shtrembërojnë faktet e pa paraqitur më shumë një krah apo një tjetër, serbë apo shqiptarë. Ndërkohë nuk u vërejtën shenja të teknikës së shtrembërimit të qëllimshëm me titujt nëntitujt, diciturat dhe fotot.

-Pseudo-ngjarjet u përdorën rrallë, më shumë si një pretekst për të shkrua rreth problemit ndërkohë që shumica e artikujve u mbështetën në burime të vërteta (zakonisht korrespondenca të medias apo të anëtarëve të stafit. Rastet që shërbyen për mbuluar ngjarjen zhvilloheshin në kohë reale apo parashikime për zhvillimet e ardhshme. (koha e shpalljes së pavarësisë apo vendimi i pritshëm i Hungarisë për njohjen e sovranitetit të Kosovës)

-Raporti i ilustrimeve ishte i pranueshëm qoftë nga përputhja me temën apo edhe vënia në pah e saj apo artikullit kryesor. Përmbajtja e artikujve u përqendrua tek lëvizjet diplomatike qoftë në Bruksel, Moskë, Uashington, çka është më e kuptueshme: ka shumë mundësi që vendimet e marra në "kuzhinat e tymosura" ndoshta ishin më të rëndësishme se ngjarjet e përditshme në Prishtinë apo Beograd.

-Përmbajtja ishte gjithashtu e saktë e në vend të qëllimeve luftënxitëse apo parashikimeve të frikshme, artikujt dukej sikur e anashkalonin një cikë krizën, çka është më mirë se ndonjë mënyrë tjetër.. Përshtypja e përgjithshme e përftuar nga botimet e shtypit të rajonit, të cilat janë shpesh pasqyrë dhe ndjekin politikat zyrtare e qëndrimet e lojtarëve në vendet përkatëse, nuk vërehet tek dy gazetat hungareze. Mbi të gjitha tek ato mbizotëron një qasje e zbutur ndaj kësaj ngjarje.

-Faktor negativ (si e theksuam më lart) është anësia e pamohueshme e gazetave në drejtim të mosnjohjes së pavarësisë. Nepszabadsag mori hapur anën kundër procesit të njohjes por në vend që ta deklaronin këtë qëndrim në një editorial me argumenta të mirëmbështetur, ata përdorën autorë me formime të ndryshme që ta përsërisnin këtë pikëpamje herë pas here.

-E njëjta gjë ndodhi me Magyar Nemzet. Duke qenë një "gazetë opozitare" ata nuk mund ta kapërcenin ndjesinë e tyre bazë për të kritikuar qeverinë megjithëse në këtë, një problem në politikën e jashtme ofronte një pikëmbështetje të vogël për të sulmuar lidershipin dhe diplomacinë hungareze në raport me një problem të brendshëm. Ata e humbën mundësinë që të realizonin intervista me figura zyrtare, ndoshta ngaqë nuk donin t'u jepnin atyre një shans që të shpjegonin qëllimin e mendimin e qeverisë. Për më tepër ata e përqendruan vëmendjen e tyre më shpesh tek problemi minoriteteve hungareze që jetonin në vendet fqinjë dhe duke parashikuar sesi do t'i prekte ata problemi i Kosovës.

- Sërish mbetën të kufizuara zgjidhjet profesionale sesi të mbulonin nga ana mediatike të gjithë çështjen. Artikujt, përmbledhjet e lajmeve plus një sërë reportazhesh nga vendi i ngjarjes ishin me të vërtetë të mira por të

pamjaftueshme. Nuk u vërejt tek artikujt asnjë informacion grafik, opinione, komente (pro-kundër) apo as edhe një galeri me fotot e biografitë e personazheve kryesore në këtë krizë.

Rutina e përditshme gazetareske e mundi hapësirën mediatike që u ofrua me këtë rast për t'i shërbyer më mirë lexuesit. Në të njëjtën kohë duhet të shtojmë me të drejtë se: botimet online shërbyen si burimet më të bollshme të informacionit përmes vëzhgimeve, hartave si dhe korrespondencave të shumta të Agjencisë Hungareze të Lajmeve, të cilat nuk u botuan në dy gazetat e sipërpërmendura.

Së fundi, një gabim për të ardhur keq: skandali më i madh në skenën hungareze, në lidhje me Kosovën, kaloi pothuajse pa u vënë re. Në fillim të shkurtit 2008, ambasadori amerikan në Budapest bëri një vërejtje të rastësishme apo ndoshta të qëllimshme për gazetarët, duke thënë: "Hungaria ka mundësi t'i përkasë grupit të parë e të madh të vendeve që do të njohin pavarësinë e Kosovës". A ishte kjo diçka e fshehtë ?. Pra disa javë para shpalljes së deklaratës së pavarësisë, një diplomat amerikan deklaroi qëllimin e Hungarisë, duke nxjerrë kështu rrezikun e përmendur shpesh të "patronazhit amerikan". Fatkeqësisht shtypi hungarez nuk pyeti apo nuk bëri përpjekje të mjaftueshme pranë MPJ sesi ishte e mundur kjo gjë, ndërkohë që zgjodhi një shpjegim të zbehtë të lëshuar nga zëdhënësi i kësaj ministrie se "Hungaria do të ndiqte vendimin diplomatik kolektiv të BE". Por ne mund të kujtojmë të gjithë se në atë ishte e qartë si kristali se për shkak të konflikti të interesit të 27 vendeve anëtare, nuk ishte e mundur të gjendej ndonjë emërues i përbashkët i tyre për këtë çështje.

BIBLIOGRAFI

Szilagyi, Imre, The Question of Kosovo's status, Budapest, Hungarian Foreign Political Institute, 2008, p63-65



MAQEDONIA

Marko Trosanovski
(kontribuuar nga Petrit Saraçini)



VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Ky artikull merret me fushën e medias së shkruar Maqedoni dhe mbulimin prej saj të situatës në Kosovë, përgjatë periudhës së shpalljes së pavarësisë. Rrethanat e veçanta në të cilat ndërtohet përmbajtja e kësaj medie, burojnë nga karakteri shumetnik i shoqërisë maqedonase që pasqyrohet edhe në sistemin mediatik. Ekzistojnë dy realitete të medias në Maqedoni dhe secila prej tyre e krijon përmbajtjen e saj sipas ndikimit të veçantë politik dhe etnik. Për shkak të pengesë së gjuhës mes shumicës maqedonase e pakicës shqiptare , ligjërimet mediatike janë më së shumti (etnikisht) të ndryshme dhe konfliktuese. Kjo është veçanërisht e dukshme në rastin e Kosovës. Ndërkohë nga aspekti teknik (përdorimi i llojeve të shkrimit gazetaresk, burimeve të informacionit dhe temave) qasja gazetareske është e njëjtë. Në nivelin kuptimor dallimet janë të qarta, e ato ecin zakonisht drejt ndjeshmërive etnike të popullsisë shqiptare apo qëndrimeve taktike e të rezervuara të autoriteteve maqedonase.

I. KONTEKSTI POLITIK (QËNDRIMET E POLITIKËS VENDASE NË DREJTIM TË KOSOVËS)

Që nga vitet 80 çështja e Kosovës është analizuar si një ndër prioritetet kryesore të në politikën e jashtme të Maqedonisë. Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë rreth 25% e popullsisë në Maqedoni janë shqiptarë etnikë[1]

Një përqindje kaq e madhe e popullsisë në Maqedoni , e cila ka të njëjtin identitet etnik si shqiptarët e Kosovës i kërkon qeverisë maqedonase të përshtatë një qëndrim shumë më të ndjeshëm ndaj pavarësisë së Kosovës. Ndërkohë janë edhe disa elementë që duhen të nënvizohen për të kuptuar politikën e Maqedonisë në drejtim të Kosovës. Pika e parë është se maqedonasit etnikë kanë qenë gjithmonë të frikësuar për krijimin e "Shqipërisë së Madhe" apo "Kosovës së Madhe" e cila nënkuptonte ndarjen prej Maqedonisë të bashkive në veri të vendit që banohen kryesisht apo krejtësisht me

1 Per me teper informacion shih www.stat.gov.mk/english/glavna_eng.asp?br=18

shqiptarë. Pjesëmarrja e partive politike shqiptare në koalicionin qeverisë maqedonas e bën situatën edhe më të ndërlikuar pasi të gjitha partitë etnike shqiptare në Maqedoni e kanë njohur pavarësinë e Kosovës para se qeveria të dalë me një qëndrim zyrtar rreth kësaj çështje. Së dyti, pasi fitoi pavarësinë e saj nga ish-federata jugosllave në 1991, Maqedonia nuk i ka përcaktuar ende kufijtë me fqinjët e saj. Vija e kufirit me Kosovën mbetet një prej temave më të ndjeshme në debatin e brendshëm publik. Përcaktimi i kufijve shtetërorë është me rëndësi për Maqedoninë ashtu si edhe për Kosovën si shtet i ri. Së treti, ekonomia e dobët maqedonase varet në një masë të madhe nga shkëmbimet tregtare me fqinjët e saj duke përfshirë edhe Serbinë. Njohja e pavarësisë së Kosovës do të përkeqësonte marrëdhëniet e fqinjësisë me Serbinë nga njëra anë por ndërkohë do të përputhej me qëndrimin e NATO-s dhe BE.

Kosova në sytë e qytetarëve maqedonas

Perceptimi i qytetarëve ndaj pavarësisë së Kosovës dhe ashtu si edhe politikës publike mbi këtë çështje, janë procese të paevitueshme që varen në mënyrë të dyanshme. Shumë qytetarë i krijojnë qëndrimet e tyre në vartësi të autoriteteve shtetërore. Gjithashtu shumë prej politikave shtetërore ndërmerren në kështillim paraprak me publikun. Duke patur parasysh se çështja e Kosovës është një prej atyre më jetësore për sigurinë rajonale e me një ndikim të drejtpërdrejtë në stabilitetin e brendshëm të vendit, do të ishte me dobi paraqitja këtu e rezultateve të një sondazhi të opinionit publik. Rezultatet mund të analizohen në bazë të tre kategorive apo çështjeve: ndjenjat (emocionet) e qytetarëve ndaj Kosovës, ndikimi i Kosovës mbi stabilitetin rajonal e kombëtar e sigurinë ashtu si edhe perceptimi s ai përket vendimit për njohjen e pavarësisë së Kosovës.

Në këtë sondazh , të kryer në maj 2007 nga Instituti për Demokraci në Shkup, kur personave iu drejtua pyetja "ju lutem rendisni ndjenjat tuaja sa i përket Kosovës", kishte një dallim të madh mes përgjigjeve që vareshin nga sfondi etnik i personit që përgjigjej. Një dallim kaq serioz mes dy komuniteteve kryesore etnike në Maqedoni kërkon politikëbërje të kujdesshme me qëllim që të shmanget çdo trazirë për stabilitetin rajonal e kombëtar e cila mbështetet tek këto emocione.

	Maqedonas	Shqiptarë	Gjithsej
shumë negative	40.4	3.0	30.7
negative	20.6	5.2	16.7
Indiferente	16.7	12.7	16.5
Pozitive	5.9	26.9	11.1
shumë pozitive	4.8	51.5	16.1
Nuk e di	11.6	0.7	9.0

Tabela 1: Ndjenjat ndaj Kosovës (të ndara sipas sfondit etnik)

Si e përmendëm më sipër dallimet në ndjenjat ndaj Kosovës mes shqiptarëve maqedonasve mund të kenë një ndikim serioz për sigurinë kombëtare e rajonale. Analiza e rezultateve të kryera nga vëzhgimi i Qendrës për Kërkime dhe Politikëbërje, tregon se qytetarët nuk kanë një vizion të qartë rreth zhvillimeve të ardhshme të situatës së sigurisë në Maqedoni, nëse kjo e fundit njeh shtetin e ri të Kosovës (Tabela 2). Megjithatë rezultatet e përgjigjeve ndaj kësaj pyetje lidhen në një masë të madhe me atë të mëparshmen. Përkatësisht duke heshtur një vështrim tek sfondin etnik i atyre që janë përgjigjur vërejmë se "Shqiptarët e Maqedonisë (82%) besojnë se situata e sigurisë do të përmirësohet nëse njihet pavarësia e Kosovës ndërsa 32%e maqedonasve thonë se ata presin që kjo situatë do të përkeqësohet nëse njihet pavarësia"[2]

	%
Do të përmirësohet	27.5
Nuk do të ndryshojë	25.0
Do të keqësohet	25.0
Nuk e di	22.5

Tabela 2: Ndikimet mbi sigurinë e Maqedonisë nëse njihet Kosova.

Në periudhën nga marsi në prill 2008 , e njëjta agjenci realizoi edhe dy sondazhe të tjera rreth kësaj çështje e rezultatet ishin pothuajse të njëjta. Lidhur me pyetjen se vallë duhet Maqedonia të njohë Kosovën si një vend të pavarur, megjithëse ishte e dukshme një kahje pozitive për këtë njohje, në sondazhin e fundit përgjigjet pozitive e negative janë në përgjithësi të njëjta.

	mars 2008	**prill 2008**
Po	35%	41.5%
Jo	45%	34%
Nuk e di	20%	24.5%

Tabela 3: A duhet Maqedonia ta njohë pavarësinë e Kosovës

Politika zyrtare e Maqedonisë drejt Kosovës

Pesë muaj pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës , Maqedonia ende nuk e ka njohur atë. Duhet dalluar se , qëndrimi i Maqedonisë ndaj kësaj çështje, qëkur filluan negociatat në Vjenë në vitin 2006 e deri më sot , ka qenë i ekuilibruar dhe i kujdesshëm, Qëndrimi i parë i Maqedonisë ishte që "ne do të pranojmë çdo zgjidhje për statusin final të Kosovës nëse ajo është e pranueshme për komunitetin ndërkombëtar dhe palët e interesuara"[3].

2 Studimi per Politikat "The Independence of Kosovo and the Consolidation of Macedonia – A Reason to Worry?" paraqitur ne Seminarin e 16 te PfP Consortium Study Group "Stabiliteti Rajonal ne Europen Juglindore" f. 15, 2008

3 Chaillot Paper 107, *Is there an Albanian question,* Nadege Ragaru, January 2008 p. 54

Ndryshimet në politikë ndodhën pas kësaj periudhe. Së pari menjëherë pasi u shpall Plani Ahtisari për Kosovë, zyrtarët maqedonas deklaruan se "Plani ofronte një zgjidhje të pranueshme që mund të kontribuonte në stabilitetin e rajonit dhe t'i ndihmojë vendet e tij në përgatitjet e tyre për anëtarësim në BE e NATO"[4]

Menjëherë sapo plani u përball me bllokimin në OKB, Maqedonia e ndryshoi qëndrimin e saj. Përkatësisht presidenti Cërvenkovski tha "Nëse nuk ka një rezolutë të OKB-së, ne si një vend kandidat për në BE e NATO do të ndjekim politikën e përbashkët të këtyre dy organizatave. Nëse pozicioni i tyre është që të vendosin marrëdhënie diplomatike e të njohin Kosovën, ne do të bëjmë të njëjtën gjë,"[5]

Megjithatë, pas dështimit të këtyre organizatave për të miratuar një politikë të përbashkët mbi këtë çështje, Maqedonia e ndryshoi për herë të dytë qëndrimin duke deklaruar se "sa i përket pavarësisë së Kosovës, Maqedonia do të udhëhiqet nga interesat e saj kombëtare" e cila nënkuptonte se ishte e sigurt që pavarësia do të njihej por vetëm pas përcaktimit të vijës së kufirit.

Në të njëjtën kohë, të mbështetur tek tregtia mes dy vendeve, Maqedonia po mbante marrëdhënie të mira me Serbinë. Në përgjithësi , megjithëse Maqedonia po përballet me presionin e fortë të brendshëm (nga partitë politike shqiptare) për të njohur Kosovën, ajo ende ka një politikë të ekuilibruar e të kujdesshme ndaj shtetit të ri. Megjithatë, pasi të arrijnë të përmbyllin përcaktimin e vijës së kufirit, autoritetet maqedonase do të njohin Kosovën duke vendosur marrëdhënie diplomatike me shteton e ri.

II. KARAKTERISTIKAT E SISTEMIT TË MEDIAS

Duke marrë në konsideratë popullsinë e saj, Maqedonia ka një numër mëse të mjaftueshëm të mediave. Aktualisht ekzistojnë 5 stacione private televizive nacionale, më shumë se 50 TV stacione lokale, afër 60 stacione radiosh e afërsisht 20 gazeta[6]. Kjo denduri kaq e madhe ka edhe efekte negative të tilla si konkurrenca për të ardhurat nga reklamat dhe dëgjuesit ka çuar në gazetarë të paguar , stafe të vogla , mungesë të gazetarisë kërkuese dhe profesionalizmit.

Sfera e medias së shkruar në Maqedoni ka disa tipare që duhet vënë në dukje me qëllim që të ofrojmë një kontekst bindës e domethënës për analizën.Së pari për shkak të pengesës së gjuhës mes maqedonasve e shqiptarëve ka një ndarje të thellë e cila ka çuar si rrjedhojë një paralelizëm të sistemit të medias në të gjitha nivelet, duke filluar nga politika editoriale e deri tek struktura e lexuesit. Qasja editoriale është e formësuar prej ndikimeve politike e etnike, lexuesve dhe partive politike, e si rezultat vërehen ligjërime publike të ndryshme, të cilat plotësojnë njëra-tjetrën. Si rrjedhojë

4 Ibid, p.55
http://www.president.mk/info.asp/SectionID=68InfoID=2662
5 http://www.president.mk/info.asp/SectionID=68InfoID=2662
6 www.srd.org.mk

fusha e medias në Maqedoni nuk është faktor problematik integrimi në shoqëri, dhe ajo shpeshherë krijon modele të steriotipeve dhe paragjykimeve në çdo formë të komunikimit multikulturor.

Së dyti fusha e medias së shkruar në Maqedoni përkundër asaj elektronike nuk është subjekt i një rregullimi ligjor. E mbështetur mbi një sindikatë të dobët dhe mjedis me institucione të paqëndrueshme , ajo është shpesh subjekt i manipulimit ekonomik e politik. Megjithatë ndryshe nga transmetuesit elektronikë që janë në pronësi të politikanëve lokalë dhe/ose qendrave të pushtetit ekonomik, pjesa më e madhe shtypit të shkruar maqedonas është në pronësi të një investitori të huaj (WAZ Media Consortium) dhe është më pak nën ndikimin e politikës lokale. Nga ana tjetër mjediset e shtypit të shkruar shqiptar në Maqedoni janë edhe më të brishtë ndaj ndikimeve politike, sa kohë ata financohen kryesisht nga "mbrojtësit e pushtetit" ekonomik e politik në nivel lokal.

III. ANALIZA E REZULTATEVE TË STUDIMIT

Për të analizuar mbulimin e ngjarjeve në Kosovë prej medias maqedonase u përzgjodhën 3 gazeta. Me qëllim që të ofrojmë një qasje sa më të plotë të fushës së medias së shkruar në Maqedoni, analiza përfshin dy të përditshme në gjuhën maqedonase (Dnevnik dhe Utrinski) dhe një të përditshme shqiptare, gazetën Koha. Grupi mediatik gjerman WAZ zotëron pjesën më të madhe të aksioneve në Dnevnik dhe një pjesë të mirë të tyre tek Utrinski. Dnevnik ka një tirazh ditor prej 55000 kopje[7] dhe shihet si gazeta e përditshme më e lexuar dhe më e besueshme në vend. Më shumë se 43% e të pyeturve në një sondazh e shihnin gazetën Dnevnik sit ë tillë [8]

Politika editoriale e të gjithë shtypit të shkruar që është në pronësi të WAZ është e pavarur nga kompania. Nga ana tjetër gazeta Utrinski ka tirazhin më të ulët si e përditshme, por shihet se përmban një informacion shumë të zgjeruar (me një element të fortë edukativ e informative). Gazeta e përditshme shqiptare Koha së bashku me televizionin privat kombëtar TVA1 dhe gazetat e përditshme Vreme dhe Spic(falas) është pjesë e grupit informal të medias që është pjesërisht apo plotësisht në pronësi të një biznesmeni e politikani maqedonas. Gazeta Koha ka një tirazh prej 27000 kopjesh[9] (20000 në periudhën e studimit) dhe përdor të njëjtin rrjet shpërndarje si të përditshmet e tjera. Kjo përparësi i mundëson asaj të jetë e përditshmja kryesore në gjuhën shqipe. Gazetat e tjera të përditshme në gjuhën shqipe, Fakti dhe Lajmi arrijnë së bashku një tirazh 6000-7000 kopje. Zakonisht gazeta shtypet me 24 faqe(përveç edicioneve të zgjeruara të fundjavës) dhe është e përqendruar kryesisht në mbulimin e jetës së brendshme politike e ekonomike nga këndvështrimi i komunitetit shqiptar që jeton në Maqedoni. Politika editoriale e kësaj gazete është e qendrës së djathtë-konservatore

7 http://dnevnik.com.mk/default.asp?ItemID=B5A63F2830732B4AA8E35EE016CC68DB

8 Institut za demokratija (2006), javnoto mislenje za mediumite vo Makedonija, Skopje:MIM

9 http://www.koha.com.mk/kolumna.html

dhe mbështetëse e pikëpamjeve politike të PDSH(Parti Demokratike e Shqiptarëve të Maqedonisë), një partner koalicioni me partinë qeverisëse VMRO-DPMNE (gjatë periudhës kur u krye studimi).

Dnevnik dhe Utrinski mbi Kosovën përmes këndvështrimit ndërkombëtar [10]

Në të dy gazetat u cituan saktë burimet e informacionit në shkrimet e botuara për çështjen e Kosovës. Përkatësisht në Utrinski Vesnik , në 84% të shkrimeve të botuara , burimet janë cituar në mënyrë të saktë ndërkohë që tek Dnevnik kjo vërehet në 63% të tyre. Ajo çfarë binte në sy gjatë studimit është se Dnevnik në dallim nga gazeta tjetër ka një përqindje më të madhe të teksteve që vinin nga burime të paidentifikuara apo ai nuk përmendej fare (32%).

Sa i përket numri të burimeve të përdorura gjatë shkrimit të tekstit , rezultatet e studimit janë të njëjta për të dyja gazetat. Përkatësisht tek Dnevnik gazetarët kanë përdorur 3 ose më shumë burime në 30% të shkrimeve të tyre ndërsa tek Utrinski Vesnik kjo vërehet në 30% të artikujve. Megjithatë në shumicën e rasteve të dyja gazetat përdorin vetëm nga asnjë burim. Kjo përbën rreth 45% të shkrimeve në gazetën Dnevnik dhe 52% tek Utrinski Vesnik. Ajo çfarë vërehet në këtë drejtim është se në 10% të teksteve të analizuara tek gazeta Dnevnik burimet e informacionit nuk përmenden fare ndërkohë që tek Utrinski Vesnik kjo ndodh vetëm në 3% të teksteve. Lloji më i përhapur i shkrimit gazetaresk në të dyja gazetat është lajmi i zgjeruar (Dnevnik 44% dhe Utrinski 48%). Ndërkohë lajmi klasik përdoret rëndom (Dnevnik 34% dhe Utrinski 30%). Me përjashtim të komenteve dhe deklaratave e një përqindje të vogël analizash , llojet e tjera të shkrimit janë të përfaqësuara në mënyrë të varfër në të gjithë shembujt e kësaj analize.

Në 23% të rasteve në gazetën Dnevnik gazetari është autori i tekstit ndërkohë që kjo përqindje është shumë më e madhe tek Utrinski Vesnik (37%). Ky raport është për shkak të qasjes specifike në lajmet e botuara tek Dnevnik. Sa kohë ato janë një përpunim i burimeve të ndryshme të informacionit (informacione të agjencive të lajmeve, gazeta të huaja etj) ato nuk mbajnë në fund emrin e ndokujt, par autorët e tyre nuk mund t ë identifikohen gjatë analizës. Nga ana tjetër praktika e Utrinski është që të përcaktojë autorësinë e këtij lloji teksti me burimin kryesor të informacionit (p.sh informacion i veçantë i agjencisë së lajmeve). Kjo është arsyeja përse ka një përshtypje të gabuar mbi të qenit anonimë të shumicës së artikujve tek Dnevnik. Ky tipar duhet të merret në konsideratë kur të bëjmë një konkluzion përfundimtar mbi mbulimin prej mediave të ngjarjes së Kosovës.

Megjithatë ndryshori tipi i burimit të informacionit dëshmon se të dyja gazetat, veçanërisht Utrinski, janë shumë të saktë e të kuptueshëm kur bëjnë të ditur burimet e tij. Më shumë se 83%e artikujve në Utrinski Vesnik kanë bërë të njohura burime të sakta ndërsa në rastin e Dnevnik ajo kalon mbi

10 Kodimi i pjeseve te analizuara ne te perditshmet ”Dnevnik” dhe ”Utrinski” u krye nga Tome Smilevski, hulumtues ne Institutin Euro Balkan.

62%. Megjithatë mundësia për spekulim brenda teksteve të Dnevnik, vihet në pah pasi që një përqindje e konsiderueshme e artikujve (më shumë se 34%) kanë pohuar burime të paidentifikuara, të pasakta apo nuk kanë përmendur fare të tilla. Këto rezultate vetëm se vërtetojnë qasjen profesionale të gazetave sa i përket mbulimit të situatës në Kosovë lidhur me deklaratën e pavarësisë.

Sa i përket numrit të burimeve të ndryshme , të përdorur në artikujt e tyre, mund të pohohet se është arritur shumësia e informacionit. Më tepër se 1/3 e teksteve të analizuara kanë përdorur 3 apo më shumë burime të ndryshme. Pasi që shumë artikuj janë një krijim prej lajmeve të agjencive të informacionit apo mediave të tjera , përqindja e teksteve që kanë përdorur vetëm një burim është e lartë (Dnevnik 44% dhe Utrinski 52%).

Nga të dhënat e mbledhura është e dukshme shpejtësi e mbulimit të lajmeve ku shumica e artikujve klasifikohen për ngjarje në kohë reale. Mbulimi prej medias ka vënë në pah mjaft qartë qasjen informuese e parashikuese, teksa shumica e ngjarjeve të trajtuar prej tyre do të ndodhin në të ardhmen apo janë pseudo-ngjarje(konferenca shtypi, njoftime për shtyp etj)

Raporti titull /nëntitull është i ekuilibruar dhe të drejton në mënyrë objektive tek përmbajtja e artikujve. Nuk janë vërejtur raste të shtrembërimit të elementëve kyç brenda tekstit prej mënyrës së paraqitjes së titullit. Për më tepër, elementët e interpretimit të lajmit (titulli/nëntitulli) vënë pjesërisht në pah elementët bazë që përmban artikulli. Titujt kryesorë janë informues , jo sensacionalë dhe nuk synojnë të manipulojnë qëndrimin politik të lexuesit.

Kur vjen fjala për mbështetjen pamore e grafike të artikujve, mund të themi se lidhur me Kosovën, Dnevnik është ka më shumë tekst e më pak pamje në raport me Utrinski. Utrinski përkrah përdorimin e fotografisë me qëllim që të komunikojë e të nxjerrë në pah mesazhin e tekstit. Janë të pakta rastet kur elementët pamorë , keqinformojnë, shtrembërojnë apo kundërshtojnë vlerësimet që janë dhënë në tekst. Kompleksiteti i rastit të Kosovës ofronte aspekte të ndryshme për mbulimin e kësaj ngjarje nga ana e medias. Të 14 ndryshorët që përqendrohen në përmbajtjen e tekstit , tregojnë pa mëdyshje se kuadri kuptimor i mbulimit prej medias të kësaj ngjarje, është i përbërë nga 3 tema kryesore: 1) e drejta e vetëvendosjes 2) pavarësia 3) tensionet etnike dhe lëvizjet diplomatike të vendeve të tyre duke e vënë theksin më të madh tek kjo e fundit.

"Koha" mbështetëse e plotë e pavarësisë së Kosovës [11]

Kosova dhe ngjarjet që lidheshin me shpalljen e pavarësisë ishin temat më të trajtuara nga gazeta e përditshme Koha. Me afro 351 të botuar në dy muajt vendimtar për këtë pjesë të trazuar të Ballkanit, (264 vetëm në shkurt 2008) është më se e dukshme se kjo gazetë i dha prioritet njërës prej

11 Analiza e permbajtjes e te perditshmes "Koha" u krye nga Petrit Saracini (Menaxher projektesh ne Institutin Maqedonas te Medias)

çështjeve më të nxehta rajonale në dekadën e fundit, duke lënë në hije tema të tjera që ishin gjithashtu pjesë e vëzhgimit të vazhdueshëm të gazetës. Në to përfshiheshin çështje të tilla si ato politike e sociale, qeverisja e brishtë dhe kriza politike që po çonte drejt zgjedhjeve të parakohshme në Maqedoni, integrimi në NATO , mosmarrëveshjet me Greqinë për emrin dhe zgjedhjet serbe (deri në një farë niveli). Gazeta botoi edhe dy faqe të plota që përmbanin lajme të përditshme për Kosovën. Shumica e artikujve e korrespondencave ishin tekste që mbështeteshin tek agjencitë e lajmeve dhe përdornin median e Kosovës dhe atë ndërkombëtare, ndërkohë që një numër më të vogël artikujsh e përbënin opinionet, editorialet, intervista e analiza me rëndësi të medias së huaj. (kryesisht gjermane, britanike, SHBA) Artikujt u botuan në rubrikën standarte "Kosova" të gazetës (Rubrika Kosova/Rajoni atëherë kur kishte artikuj edhe mbi politikanë serbë) e cila botohej në faqen 10 dhe 11 të saj. Në vartësi nga dita dhe denduria e ngjarjeve, artikujt që u botuan kyçnin edhe intervista e opinione me ekspertë e politikanë edhe në faqen 8,9, 10. Përveçse kur botoheshin në rubrikën Kosova/Rajoni, artikujt që lidheshin me qëndrimin e Serbisë dhe ngjarjet politike që lidheshin me Kosovën u botuan në rubrikën Rajoni(Rajoni/Bota), e cila zakonisht botohej në faqe 4. Qëndrimet e përfaqësuesve politikë ndërkombëtarë që lidheshin me Kosovën me pak përjashtime u botuan tek të dy këto rubrika. Një përjashtim nga ky rregull përbënte periudha 15-20 shkurt, ku u rrit me shpejtësi numri i artikujve për Kosovën dhe u vendosën në faqen e parë të gazetës Koha. Ndërkohë numrat "festivë" të gazetës Koha të datës 18 dhe 19 shkurt iu kushtuan plotësisht shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Politika editoriale-mbështetëse e plotë e pavarësisë së Kosovës

Duke marrë parasysh faktin se gazeta u drejtohej shqiptarëve të Maqedonisë, ishte pak a shumë e pritshme që pozicioni i saj editorial do të ishte në favor të qëndrimit për pavarësinë e shqiptarëve të Kosovës, e kjo mund të provohet edhe prej vëzhgimeve të thjeshta. Nga 40 artikuj mbi Kosovën që u botuan në faqet e para në periudhën janar –shkurt nuk kishte as edhe një artikull mbi Serbinë apo mbështetësve të saj kundër pavarësisë së Kosovës. E njëjta gjë ndodh edhe kur është fjala për intervistat dhe opinionet e politikanëve, opinionistëve apo gazetarëve - shumica e tyre u shkruan nga shqiptarët nga Maqedonia, Kosova e Shqipëria ndërsa nuk kishte as një intervistë apo shkrim për ndonjë politikan serb apo që mbështeste qëndrimin serb. Nga të 35 artikujt e botuar për Serbinë apo pasqyronin qëndrimin e saj lidhur me Kosovën, u vendosën në faqen kryesore vetëm 2 herë- një herë kur raportohej se Tadiq kishte fituar zgjedhjet presidenciale dhe herën e dytë kur u raportua mbi demonstrimet e dhunshme në Beograd, të cilat pasuan 17 shkurtin.

Në total artikujt e botuar përmbanin vetëm 35 deklarata të drejtpërdrejta ose jo të politikanëve serbë nga Kosova e Serbia dhe 17 të politikanëve rusë që mbështesnin qëndrimin e Serbisë, në krahasim me 74 deklarata të

politikanëve kosovarë e 145 të diplomatëve ndërkombëtarë që ishin në mbështetje të pavarësisë së Kosovës. Nuk ka nevojë të përmendet se në shumicën e rasteve artikujt që përmbanin deklarata në mbështetje të pavarësisë së Kosovës u jepej një mbështetje më e madhe dhe shoqëroheshin me fotografi, ndërsa artikujt mbi Serbinë zinin një hapësirë më të vogël dhe vetëm në 30% të rasteve u paraqitën me fotografi. Në periudhën më aktive për Kosovën (15-23 shkurt 2008), gazeta Koha botoi vetëm 8 artikuj që pasqyronin reagimet e Serbisë mbi shpalljen e pavarësisë dhe ato përfshinin edhe korrespondenca mbi marshimet e dhunshme në Beograd, protesta serbe në Mitrovicë dhe dhunën në pikat e kalimit kufitar me Kosovën. Artikujt ishin në faqet e brendshme, ndërkohë artikujt që raportonin në mënyrë pozitive aktivitetet e shpalljes së pavarësisë dhe politikës ndërkombëtare "u zhvendosën" në faqet e para të kësaj të përditshme.

Pavarësia: SHBA, Kosova dhe BE(shumica) thanë se kjo është punë e kryer: serbët dhe rusët përpiqen ta ndalojnë e të fillojnë negociatat

Gazeta i ndoqi nga afër të gjitha ngjarjet që lidhen me pavarësinë, duke u përqendruar tek spekulimet rreth datës së shpalljes (veçanërisht në janar dhe ditët e para të shkurtit) dhe aktivitetet e dendura të politikanëve të Kosovës e atyre të Evropës Perëndimore- kryesisht të porsa zgjedhurve Thaçi e Sejdiu e kryetarit të Parlamentit Krasniqi – lidhur me përgatitjet për pavarësinë ashtu edhe për njohjet nga vendeve të ndryshme pas 17 shkurtit. Një emërues i përbashkët i të gjithë artikujve ishte se vendet perëndimore e politikanët shqiptarë nga rajoni e konsideronin pavarësinë një proces të pakthyeshëm ndërkohë që Rusia e politikanët serbë përpiqeshin ta ndalonin në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, duke argumentuar se pavarësia po krijonte një precedent të rrezikshëm dhe do të shkelte shumicën e parimeve të së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë edhe atë të mosndryshimit të kufijve. Artikujt analizuan OKB dhe Rezolutën 1244 në termat e pengesave ligjore dhe bashkëpunimin e mundshëm në fushën e sigurisë, i krijuar pas shpalljes së përfundimit të misionit të UNMIK-ut dhe zëvendësimin e tij me misionin EULEX që drejtohej nga BE.

Deklaratat e politikanëve perëndimorë në favor të pavarësisë së Kosovës dhe artikujt mbi aktivitetin e tyre diplomatik ishin mbizotërues në krahasim me tekstet e aktiviteteve të politikanëve kosovarë, për të mos folur për ato që u shkruan lidhur me qëndrimin e Serbisë e Rusisë. Dukej sikur qëllimi i gazetës ishte që të provonte se e tërë bota demokratike qëndronte e bashkuar dhe mbështeste në rrugën e ndarjes nga Serbia. Veçanërisht me rëndësi ishin deklarimet e administratës së SHBA në të gjitha nivelet. "Presidenti Bush ka pohuar qëndrimin se duhet të jemi në gjendje për të lëvizur përpara dhe ne ata duhet t'i mbështesim në kërkesat e tyre për pavarës".-deklaronte Dana Perino, Zëdhënëse e Shtëpisë së Bardhë.[12]

12 15 shkurt, faqe 109. me titull: SHBA e vendosur për shtetin e Kosovës, nëntitulli: Kosova të lëvizë drejt pavarësisë

Kjo e përditshme i kushtoi shumë artikuj marrëdhënieve Serbi - BE dhe bisedimeve për të përmbyllur MSA (Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit) , të cilat u panë jo vetëm nga një këndvështrim për të mbështetur presidentin më të moderuar Tadiq në zgjedhjet presidenciale në Serbi por edhe përmes perspektivës së një marrëveshje që i ofrohej Serbisë me qëllim që të ishte më konstruktive lidhur me çështjen e Kosovës. Në një artikull të botuar më 9 janar ajo vërente "ultimatumin e politikanëve serbë që ofruan dy mundësi për BE: ose të dërgonin misionin e EULEX-it në Kosovë e kështu të dhunonin integritetin territorial të Serbisë , apo të nënshkruanin MSA me Serbinë."[13] Nga ana tjetër në të njëjtën faqe gazeta botonte përgjigjen e MPJ të Sllovenisë , Dimitri Rupel që e cilësonte këtë si "dilema e rreme e Koshtunicës"[14]

Përveç vështrimit mbi aktivitetin e figurave kyç të politikës serbe, artikujt që u botuan mbi Serbinë pas pavarësisë i kushtoheshin kryesisht incidenteve në kufirin kosovaro –serb dhe përleshjeve të dhunshme në Beograd e qytetet e tjera serbe.

"Pas trazirave serbe në Beograd e qytete të tjera- SHBA kërcënon qeverinë serbe"[15]; "Solana: Trazirat në Serbi nuk të çojnë askund"[16]; "Pas trazirave e kërcënimeve Serbe-Rusia bëhet më e butë"[17] - janë artikuj që përcjellin reagimin e ashpër të komunitetit ndërkombëtar sa i përket incidenteve e përleshjeve që ndodhën në qytete të ndryshme serbe.

Politikanët maqedonas e figurat publike të kujdesshme, shqiptarët nga Maqedonia mbështesin hapur pavarësinë

Paraqitja nga gazeta Koha e skenës publike maqedonase, sa i përket çështjes së Kosovës, mbizotërohej nga artikuj intervista, të cilat paraqisnin qëndrimin e partive politike shqiptare e të opinionistëve. Gazeta botoi dy intervista e shumë opinionet e veçanta të presidenti të nderit të Partisë Demokratike të Shqiptarëve, z. Arbër Xhaferri, deklarata e liderit të kësaj partie Menduh Thaçi si edhe anëtarit të Parlamentit Ruzhdi Matoshi së bashku me shumë artikuj të liderëve të Bashkimit Demokratik për Integrim, të cilat i kërkonin qeverisë maqedonase të njihte Kosovën.

Artikujt përfshinin edhe deklarata të politikanëve maqedonas dhe lidershipit politik të vendit por që ishin më të pakta në numër , duke qëndrimin e mirënjohur se pavarësia e Kosovës është e pashmangshme dhe se Maqedonia duhet të ndjekë BE e aleatët e saj perëndimore në politikën e tyre drejt Kosovës, por edhe të marrë në konsideratë interesat e vendit, veçanërisht çështjen e përcaktimit të kufirit (Titulli: Mosmarrëveshja mes Maqedonisë e Kosovës vazhdon: nëntitulli: Maqedonia kërkon vijën e kufirit , Kosovarët

13 Serbia vazhdon t'i bëjë shantazh BE -Ose Serbia ose shteti kukull, 9 janar faqe 11, pa fotografi

14 Rupel kritikon kryeministrin serb-Dilema e rreme e Koshtunicës, 9 janar, faqe 11, me fotografi

15 23 shkurt, faqe 4

16 23 shkurt, faqe 4

17 26 shkurt, faqe 7

njohje)[18]. Vihet re se nuk ka opinione apo analiza të politikanëve jo shqiptarë lidhur me Kosovën përveç një artikulli që përcjell qëndrimin e një intelektualit më të njohur të Maqedonisë, filozofit me prejardhje boshnjake Ferid Muhiq, që deklaron se "Tërheqja e Maqedonisë nga njohja e Kosovës mund të shkaktojë pakënaqësi mes shqiptarëve të Maqedonisë e krizë të mundshme në vend"... Aktualisht nuk mund të mendohej se Maqedonia do të tërhiqet nga njohja e Kosovës sepse kjo do të krijonte revoltë brenda shqiptarëve".- theksonte analisti Muhiq në Ohër[19].

Gjuha e raportimi - kryesisht korrekte me pak përjashtime të vogla

Ndërsa shkruante e informonte rreth Kosovës, gazeta Koha u përqendrua mbi tema të shumta që ishin të lidhura drejtpërdrejt me shpalljen e pavarësisë. Në to mbizotëronin qëndrimet e politikanëve kryesorë ndërkombëtarë, informacion e analiza mbi datën e shpalljes së pavarësisë, korrespondenca nga takimet e aktiviteteve diplomatike të drejtuesve të Kosovës, ashtu si edhe artikuj mbi njohjen e Kosovës nga shtete të ndryshme pas 17 shkurtit. Gazeta mbuloi marrëdhëniet EULEX-UNMIK, çështjen e sigurisë në Kosovë dhe hipotezat për ndarjen e mundshme të saj, ndërkohë që qëndrimi serb rreth çështjes u mbulua në mënyrë shumë sipërfaqësore, kryesisht përmes pasqyrimit të negociatave mes Serbisë e BE për MSA, refleksionet mbi zgjedhjet presidenciale serbe në drejtim të Kosovës dhe aktivitetin diplomatik të politikanëve serbë. Një mbulim i pakët u vërejt edhe ndaj qëndrimit e politikës së figurave publike maqedonase.

IV. KONKLUZIONE

Mbulimit të ngjarjeve të Kosovës nga media maqedonase i dhanë formë dy realitete. Qasjet e Dnevnik e Utrinski nga njëra anë dhe nga ana tjetër të gazetës përditshme e shqiptarëve të Maqedonisë, Koha të cilat edhe përputhen por edhe dallohen në aspekte të ndryshme. Kryesisht të përditshmet maqedonase kishin një qasje më të rezervuar jo të njëanshme në mbulimin e tyre ndërsa gazeta Koha i vendosi ato në një rrethanë ku i dha mbështetje të hapur e të njëanshme.

Duke patur parasysh dendurinë e madhe të llojit të shkrimeve gazetareske të përdorura, ato më të zakonshmet e përbënin lajmet e zgjeruar. Të dyja gazetave maqedonase në këtë periudhë u munguan analizat e brendshme për situatën. Të dhënat e studimit tregojnë për një prani të konsiderueshme të analizave nga ekspertë të huaj në këto media , qendra kërkimore ashtu si edhe nga gazeta të huaja të rëndësishme. Të tre përditshmet e marra në shqyrtimin u mbështetën në mënyrë të dukshme tek ato ndërkombëtare,pra tek politikanët e huaj, agjencitë e lajmeve , si edhe ar-

18 29 Shkurt, faqe 1, faqe 3

19 Titulli: Ferid Muhiq mbi njohjen e Kosovës: As nuk mund të mendohet tërheqja prej saj; 25 shkurt , faqe 4

tikujt e shumtë që morën prej medias së huaj. Kjo është një karakteristikë e përbashkët e të gjithë gazetave.

Në thelb artikujt e botuar ishin të karakterit informativ por funksioni i tyre edukues u anashkalua për shkak të mungesës së analizave tërësore e formave narrative të shkrimit gazetaresk. Editorialet, rrallë ishin të njëanshëm politikisht dhe nuk u ndikuan nga presionet e politikës vendase dhe qendrat e pushtetit , me përjashtim të pak rasteve kur u lanë mënjanë këndvështrimi e argumentat serbe kundër pavarësisë.

Kompleksiteti i çështjes së Kosovës ofroi aspekte të ndryshme për mbulimin e saj prej medias maqedonase. Megjithatë përmbajtja e teksteve të analizuar tregon pa mëdyshje se kuadri kuptimor i kësaj ngjarje është i përbërë nga 3 tema: e drejta e vetëvendosjes, p.sh pavarësia, tensionet etnike e lëvizjet diplomatike të vendeve të tjera, duke e vënë theksin tek kjo e fundit. Përsëri si në rastin e llojeve të shkrimit gazetaresk , vërehet zhvillimi i pamjaftueshëm i debatit të brendshëm publik lidhur me situatën në Kosovë qoftë në median e gjuhës maqedonase apo shqiptare. Intervista dhe opinionet e liderëve ishin rastësore dhe u përqendruan rreth periudhës së shpalljes së pavarësisë.

Duke marrë në konsideratë të gjithë ndryshorët nga analiza e përmbajtjes, mund të arrimë në përfundimin se ato janë pak a shumë të pranueshëm tek dy gazetat. Dallimet më të dukshme janë sa i përket kuadrit kuptimor të mbulimit prej tyre të ngjarjes së Kosovës. Gazeta Koha vë theksin fort tek qëndrimet e argumentet rajonalë pro-Kosovë ndërkohë anashkalon krejtësisht këndvështrimet e ndryshme. Nuk ka ndonjë shkrim që të paraqesë pikëpamjet e kundërta (argumente kundër pavarësisë u injoruan plotësisht). Edhe përzgjedhja e lajmeve prej agjencive të informacionit ndoqi të njëjtën kahje në këtë gazetë. Teksa po "afrohej dita e pavarësisë", përmbajtja në "shtypin shqiptar" forconte e nxiste ndjenjat etnike e në përputhje të plotë me bllokun politik shqiptar. Nga ana tjetër të përditshme maqedonase arritën një qasje më të ekuilibruar duke synuar të përfshinin "pikëpamje të ndryshme" mbi këtë çështje e duke përdorur tituj asnjanës që nuk i bënin thirrje retorikës emocionale. Në mënyrë të përmbledhur mund të arrimë në përfundimin se dyja gazetat maqedonase e vendosën çështjen e Kosovës në një kontekst asnjanës e nuk përcollën ndonjë qëndrim të veçantë politik. Qëndrimet e politikës zyrtare Maqedonase drejt Kosovës kanë qenë të kujdesshme e të ekuilibruara. Ata ndiqnin të njëjtën linjë me komunitetin ndërkombëtar e në këtë pikëpamje ata plotësonin me mbulimin në media.

Megjithatë e përditshmja shqiptare Koha siç treguan edhe analizat e teksteve nxiti këndvështrimin e partive shqiptare në qeveri, nxiti e mbrojti interesat e Kosovës.

Këto qasje vërtetojnë dualizmin e sferën politike e mediatike në Maqedoni. Është e qartë se ky dualiatet i debatit publik (në këtë rast) duke përdorur më shumë argumente të huaja se vendase nuk është një kontribut për zhvillimin e një medie të shëndoshë në Maqedoni.

Në të ardhmen ky segment duhet të shqyrtohet më tej nga përpjekjet e akademikëve, politikës para se të fillojë të ndajë në mënyrë të pakthyeshme "pllakat tektonike" të Maqedonisë shumetnike.

BIBLIOGRAFI

Chaillot Paper 107, Is there an Albanian question, Nadege Ragaru, January 2008 p. 54

Институт за демократија „Социетас Цивилис„ (2006), Јавното мислење за медиумите во Македонија, Скопје: МИМ

Policy Paper "The Independence of Kosovo and the Consolidation of Macedonia – A Reason to Worry?" presented at the 16th Workshop of the PfP Consortium Study Group "Regional Stability in South East Europe" p. 15, 2008

Electronic sources:

http://www.idscs.org.mk

http://www.stat.gov.mk/english/glavna_eng.asp?br=18

http://www.srd.org.mk

http://www.president.mk/info.asp/SectionID=68InfoID=2662



MOLDAVIA

Victoria Boian



VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Qëllimi kryesor i këtij raporti është që të analizojë mënyrën me të cilën e mbuloi shtypi moldav çështjen e Kosovës gjatë muajve janar dhe shkurt, duke marrë parasysh situatën e brendshme politike ashtu edhe karakteristikat e sistemit të medias. Synimi është të arrimë një këndvështrim sa më objektiv e për të kuptuar më mirë analizat e përmbajtjes duhet të vëmë në pah qëndrimet e politikës vendase dhe ndikimin e saj mbi mbulimin e medias moldave të çështjes së Kosovës. Kjo do të jetë edhe pjesa e parë e raportit. Republika e Moldavisë ndikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë prej Rusisë në të gjitha fushat e aktivitetet e të saj, duke përfshirë edhe median, e cila në këtë rast përdoret si mjet për të arritur qëllime të caktuara. Fakti se Moldavia ndikohet nga Rusia lë gjurmë në një pjesë të madhe të artikujve që kemi marrë nën shqyrtim. Jo më pak domethënës është edhe sistemi i medias në Moldavi çka lidhet drejtpërdrejt edhe me rezultatet e studimit. Ky vëzhgim përfundon me disa konkluzione që theksojnë mungesën e vëmendjes që iu kushtua çështjes së Kosovës, e cila mund të ketë qenë shkaktuar nga frika mos të shndërrohet deklarata e pavarësisë në një precedent edhe për rajone të tjera që duan të shkëputen.

I. KONTEKSTI POLITIK (QËNDRIMET E POLITIKËS VENDASE NË DREJTIM TË KOSOVËS)

Situata politike e Moldavisë u përcaktua nga fundi i Luftës së Ftohtë dhe shpërbërja e BS. Në 1990, Republika e Moldavisë deklaroi pavarësinë ashtu si edhe republikat e tjera ish-sovjetike. Në zgjedhjet parlamentare të marsit 1990, Fronti Popullor mori 40% të vendeve në Parlament së bashku me partnerët e koalicionit dhe u bë forca kryesore politike që mbizotëronte në vend. Një nga aktet e para të Sovjetit të ri Suprem ishte miratimi më 27 prill i flamurit tringjyrësh rumun me stemën e Moldavisë dhe himnin kombëtar rumun. Më 23 Qershor 1990 u miratua Deklarata e Sovranitetit duke pohuar mbizotërimin e legjislacionit republikan mbi atë të ish-BS. Pas përpjekjeve për grusht shteti

në Moskë, ajo deklaroi pavarësinë. Më 30 janar 1992, Republika e Moldavisë u bë shtet anëtar i OSBE dhe në muajin mars u pranua në OKB[1].

Në vitin e parë të pavarësisë situate politike në Moldave krahasohej me një koalicion të paqëndrueshëm e qeveri që nuk funksiononte. Qeveria e re e porsaformuar nuk kishte asnjë eksperiencë që të merrej me sfidat e menjëhershme e kjo shkaktoi një prirje për mosbesim e zhgënjim mes qytetarëve të Moldavisë.

Paralelisht me procesin e emancipimit të Moldavisë nga qendra sovjetike, që nga viti 1989 kishin filluar lëvizjet e protestës në rajonet me shumicë jo-moldave, në zonat e bregut të majtë dhe në jug të vendit, e filluan të vetë-organizohen për t'iu kundërvënë përpjekjeve për pavarësi të Moldavisë. Ky kundërshtim ishte kryesisht i shtyrë nga frika se Moldavia sapo të bëhej e pavarur do të bashkohej me Rumaninë. Ndër elementët kryesorë që çuan në përshkallëzimin e tensioneve ishte miratimi i një ligji për gjuhën në 31 gusht 1989 që i jepte rumanishtes, të shkruar në alfabetin latin, statusin e gjuhës zyrtare. Sot Moldavia po merret me një konflikt të ngrirë separatist që mbështetet nga politika ruse, e qëllimi kryesor është që të kontrollojë rajonin.

Meqë jemi duke folur për situatën politike, duhet të theksojmë se zgjedhjet Parlamentare të 2001 e ndryshuan krejtësisht situatën. Partia Komuniste fitoi shumicën e votave në një numër prej 71 vendesh në Parlament (nga 101) e në këtë mënyrë opozita mori pushtetin në duar. Vladimir Voronin u zgjodh dhe rizgjodh president në 2005. Zgjedhjet parlamentare të 2005 u njohën si të zhvilluara në përputhje me standartet e OSBE dhe KE, megjithë vërejtjen e disa vëzhguesve lidhur me lirinë e shtypit dhe presionin administrativ mbi opozitën. Një nga ngjarjet më të papritura të 2008, që pati ndikim mbi situatën e brendshme të Moldavisë ishte shpallja e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008[2].

Deklarata e Pavarësisë së Kosovës e ndau komunitetin ndërkombëtar në dy kampe: pro dhe kundra. SHBA, Franca, Gjermania, Britania e Madhe dhe Italia ishin shtetet që mbështetën Kosovën në vendimin e saj, duke marrë në konsideratë "Planin Ahtisari" që përfaqësonte një pavarësi të mbikëqyrur nga komuniteti ndërkombëtar dhe e garantuar nga një mision i BE dhe NATO-s. Por çfarë do ta ndihmonte Kosovën të bëhej një shoqëri demokratike ku të mbroheshin të drejta e minoriteteve. Rusia ishte kundër këtij vendimi, duke patur parasysh se aleati i saj humbte integritetin territorial por edhe pse ishin 4 shtetet më të vogla fqinj me të (Transdnistria, Abkahzia, Karabah dhe Osetia e Jugut) që do t'u pëlqente të kishin në status të tillë, ashtu si edhe 3 shtete (Gjeorgjia, Moldavia dhe Azerbajxhani) që nuk

1 Boian, Victoria. "Impactul proclamării independenței Kosovo asupra politicii internaționale". (February 19th, 2008). http://www.unimedia.md/index.php?mod=home&hmod=interviewbyid&id=44 (accessed May 13th, 2008).

2 Cristal, Oleg. "Chișinăul schimbă din nou accentele, anunțând că integrarea europeană este principala prioritate", (June 25th, 2008), http://oleg-cristal.blogspot.com/2008/06/chiinul-schimb-din-nou-accentele-anunnd.html (accessed June 25th, 2008

hiqnin dorë nga integriteti i tyre territorial që parashikohej në Aktin Final të Helsinkit (1975).

Në vitin 2005 qeveria moldave e shpalli integrimin evropian si prioritetin e saj kryesor. Kjo ndodhte në një periudhë ku marrëdhëniet me Federatën Ruse ishin në ditët më të këqija e negociatat lidhur me konfliktin transdnistrian ishin bllokuar për të rinisur në verën 2007-2008 duke u deklaruar si prioriteti kryesor për integrimin e vendit.

Sot qasja ka ndryshuar përsëri pasi qeveria e ka kuptuar që nuk ka ndonjë perspektivë reale për të zgjidhur problemin transdnistrian[3].

Këto ndryshime në politikën e brendshme e të jashtme ndodhën në periudhën kur Kosova po kërkonte pavarësi. Politikanët rusë vërenin se njohja e pavarësisë së Kosovës mund të shërbente si një arsye për një ndarje të mundshme të botës. Sot, pyetja më e shpeshtë është nëse shpallja e pavarësisë së Kosovës mund të shërbejë si precedent për rajone të tjera separatiste? Në një artikull mbi Kosovën dhe konfliktet post-sovjetike, Vladimir Sochor thotë se "Politika ruse kërkon të errësojë dallimin e fortë mes konfliktit të Kosovës nga njëra anë ashtu si edhe 4 konflikteve postsovjetike. Kriteri më themelor për të vlerësuar natyrën e secilit prej konflikteve janë a) përbërja etnike e popullatës me vështrim të veçantë nga grupi kryesor etnik b) zhvendosjet e popullsisë dhe pastrimi etnik c) rrugët e konfliktit dhe përplasjet në shoqëri d) axhenda politike e shkëputjes e)një autoritet i jashtëm që përcakton zhvillimet e brendshme politike f) një prani ushtarake e huaj g) mekanizmat ekzistues për negocim dhe h)pozicioni i qeverisë së njohur ndërkombëtarisht në raport me procesin e shkëputjes brenda kufijve të saj "[4].

Dukë bërë një krahasim mes situatës në Kosovë dhe saj transdnistriane ne vërejmë se ka më shumë dallime se ngjashmëri. Një prej shkaqeve themelore të shkëputjes së Kosovës është etniciteti: shqiptarët përfaqësojnë 90% të popullsisë, janë pjesë e një territori etnik shqiptar ndërkohë që Transdnistria nuk është pjesë e ndonjë territori etnik rus. Një tjetër dallim është statusi që kanë patur të dy rajonet gjatë periudhës së komunizmit. Transdnistria nuk ka ekzistuar kurrë si entitet autonom, ajo ishte pjesë integrale e Republikës Socialiste Sovjetike të Moldavisë. Nga ana tjetër, Kosova ka patur një status të njohur autonomie, si provincë brenda Jugosllavisë. Shkalla e ndikimeve nga jashtë ka ndërkohë shumë rëndësi. Republika e Moldavisë ndikohet drejtpërdrejt nga Federata Ruse në të gjitha fushat, duke përfshirë edhe masmedian si një ndër elementët kryesorë. Ndërsa Kosova është nën administrimin e vendeve perëndimore dhe OKB-së.

Prania ushtarake përbën një tjetër faktor vendimtar. Federata Ruse va-

3 Socor, Vladimir. "Kosovo and the post-soviet conflicts: no analogy means no" precedent (Eurasia Daily Monitor, Friday, April 14, 2006, http://www.jamestown.org (accessed April 23, 2008).

4 Socor, Vladimir. "Kosovo and the post-soviet conflicts: no analogy means no" precedent (Eurasia Daily Monitor, Friday, April 14, 2006, http://www.jamestown.org (accessed April 23, 2008).

zhdon të mbajë deri më tani trupat e saj ushtarake në Moldavi, megjithëse sipas vendimeve të Samitit të OSBE-së në Stamboll (1999) ajo është angazhuar t'i heqë ato nga Moldavia e Gjeorgjia deri më 30 dhjetor 2002. E gjitha kjo ka ndodhur për shkak të vendimi të panjohur që çoi në nënshkrimin e Konventës së 1992 ku Republika e Moldavisë dhe Federata Ruse futën një "nocion" të ri në historinë e së drejtës ndërkombëtare: forcat paqeruajtëse të krijuara nga palët e përfshira në konflikt[5]

Konflikti separatist në Moldavi e ndërlikon së tepërmi çështjen e tërheqjes së forcave ruse. Forcat separatiste shpallën dëshirën të integrohen si dikur nën Rusinë e marrin mbështetje nga faktorë të ndryshëm politikë e qeveritarë në Rusi. Ndërkohë Rusia pretendon statusin e paqeruajtësit për forcat e saj në rajon por de facto këto forca lehtësojnë shkëputjen e suksesshme të rajoneve dhe mbështesin shtysat e tyre të ardhshme për autonomi e integrim me Rusinë. Në Transdnistria, veprimtaritë e kontrabandës ofrojnë një nxitje shtesë për ekonominë dhe forcat Ruse e separatistët kundërshtojnë ndaj çdo ndryshimi të status-quosë. Ndërkohë në Kosovë nuk ka prani ruse, përkundrazi atje janë vetëm NATO e BE. SHBA e BE u pranuan si vëzhgues në formatin e negociatave për konfliktin në Transdnistria, si rezultat i konsultimeve të mbajtura më 26-27 shtator në Odesa në formatin e mëparshëm 5 –palësh. Republika e Moldavisë dhe Republika Moldave e Transdnistrisë u konsideruan si palë në konflikt ndërsa Rusia, Ukraina dhe OSBE kishin mandatin e ndërmjetësimit në procesin e negociatave [6]

Përsa i përket pavarësisë së Kosovës, qeveria moldave ka një pozicion unik për mosnjohjen e saj. Vendimi ka një shpjegim logjik: konflikti i ngrirë me të cilin po merret Moldavia dhe pasojat e mundshme të tij.

II. KARAKTERISTIKAT E SISTEMIT TË MEDIAS - KONTEKSTI I MEDIAS

Kur ne flasim rreth medias në Moldavi duhet të pyesim veten se çfarë shtypi ka në vendet post-komuniste. Sipas disa vlerësimeve ndërkombëtare ne nuk kemi shtyp të lirë. Pengesa kryesore për një shtyp liberal vjen nga vendet me kulturë politike jodemokratike,pafuqi për të kundërshtuar liderët politikë e ata të medias që të tregojnë se nga duhet të shkosh[7]

Vitet e fundit megjithëse nuk ka patur ecje mbrapsht vihet re një ngecje

5 Garaz, Marcel. "Juridical evaluation of peacekeeping operations in Transnistria in conformity with international law." Aspects of the Transnistrian Conflict. (Chisinau: Institute for Political Policy, 2003).

6 Nantoi, Oazu. Transnistrian Conflict: What Could the European Union and the United States of America Do? (Chisinau: Institute for Public Policy, November 21, 2005), http://www.ipp.md/public/comentarii/39/en/Transnistrian%20Conflict-EU%20and%20SUA_Engl29.doc (accessed May 16, 2008).

7 Bogatu, Petru. „E posibilă ralierea presei autohtone la standardul mediatic occidental?". (Presa si Puterea, June 2007), http://ijc.md/bulmm/2007iunie/BMM_iunie2007.pdf (accesed May 14).

në vend. Në vitin 2007, një studim vendas vëren se sfida më e madhe shtypit moldav është menaxhimi apo më mirë mungesa e tij. Një nga shtysat që e ndryshoi disi këtë gjendje ishte pavarësia që iu dha shtypit shtetëror nga viti 2000: këtu mund të japim si shembull gazetën Moldova Suverana në gjuhën rumune dhe Nezavisinaia Moldova në gjuhën ruse. Fatkeqësisht ato janë ende të financuara e të kontrolluar nga qeveria. Në Moldavi shtypi mbetet mjeti kryesor për të nxitur interesat politike, ai nuk ka një pavarësi financiare e si rrjedhojë as atë editoriale[8]

Në një raport të Freedom House, "Liria e Shtypit në Botë", Moldavia ishte përfshirë tek vendet me "shtyp pjesërisht të lirë" përkundër vendeve "pa liri shtypi". Renditja e Moldavisë mbetet e njëjtë edhe për vitet 2005 e 2006.[9]

Shpesh ne shtrojmë pyetjen nëse kjo situatë shqetëson ndokënd; ndoshta disa gazetarë apo pak politikanë. Sa i përket publikut ai është i kënaqur. Shumë studime sociologjike tregojnë se vitet e fundit, niveli besimit të shtypit tek publiku është rritur 66% në 2007 krahasuar me 53% në 2001.[10]

Sa besim keni te media?



Bazuar ne rezultatet e Barometrit te Opinionit Publik, Instituti per

8 Sarbu, Angela. Provocarile si performantele presei moldovenesti. (Chisinau: Independent Journalism Center, 2007), http://ijc.md/Publicatii/provocari.pdf (accessed June 02, 2008).

9 Report. "Freedom of the press". (Freedom House. 2006), http://www.freedomhouse.org/template.cfm?page=251&year=2006 (accessed June 02, 2008).

10 Barometrul de opinie publică. (Chisinau: Institutul de politici Publice, May 2007), http://ipp.md (accessed June 02, 2008).

Politikat Publike

Në të njëjtën kohë gjysma e popullsisë e konsideron masmedian si jo të lirë për të paraqitur lajme e komente të pacensuruara nga qeveria e partitë politike. Ndikimi medias së shkruar është ende i kufizuar(një sondazh optimist i botuar në maj 2007 pohon zvogëlimin e popullaritetit të gazetave). Studimi tregonte se 85.4% e popullsisë së Moldavisë nuk kishin lexuar gazeta në 3 muajt e fundit ndërkohë që vetëm 1/3 e popullsisë(35%) lexon gazetën çdo ditë apo disa herë në javë. Ja vlen të theksojmë se sipas sondazheve të opinionit numri i njerëzve që nuk lexojnë gazeta ka pësuar një rritje të lehtë vitet e fundit[11]

Një tipar i veçantë i shtypit moldav është vënia e tij në shërbim të interesave të politikës e më pak në atë të qytetarëve të zakonshëm. Gjatë periudhën mars –maj 2007 u monitorua përmbajtja e 6 gazetave kombëtare dhe 4 kanaleve televizive kombëtare e rajonale. Duke folur rreth mënyrës sesi i kanë pasqyruar ato ngjarjet, institucionet, monitoruesit i ndanë në 3 grupe [12]

Të parat janë mediat private apo publike që mbështesin drejtpërdrejt apo jo qeverinë. Grupi i dytë përbëhet nga institucioneve të mediave që përputhen me interesat e partive politike e grupi i tretë përfshin mediat që ofrojnë informacion të baraslarguar nga të dy palët e mësipërme (qeveria dhe partitë). Një tipar i përbashkët i tyre është se anashkalojnë temat që janë me rëndësi për publikun dhe e përqendrojnë vëmendjen tek ngjarjet e ndryshme politike. Ashtu si në rastin e përzgjedhjes së temave ku kryesisht bëjnë jehonë ngjarjeve politike ashtu edhe për dokumentim e tyre, ku parapëlqejnë burimet zyrtare të informacionit.

III. ANALIZA E REZULTATEVE TË STUDIMIT

Mas-media në Moldavi luajti një rol kryesor në informimin e krijimin e një pikëpamje rreth deklaratës së pavarësisë së Kosovës. Masmedia është një element që përcakton gjendjen e nivelit të demokracisë. Me qëllim të realizonim studimin lidhur me mbulimin prej medias moldave të situatës në Kosovë, ne përzgjodhëm gazetën e përditshme Timpul dhe Moldova Suverana të cilat konsiderohen nga gazetat më popullore në këtë republikë. Timpul del 5 herë në javë e Moldova 4 herë në javë. Periudha e analizës përfshin muajt janar-shkurt 2008. Duhet të përmendim se java e parë e janarit nuk ka lajme për shkak të pushimeve. Numri i parë i Moldova Suverana për vitin 2008 doli më 9 janar ndërsa ai Timpul më 11. Është me rëndësi të përmendim se të dyja janë gazeta të pavarura megjithëse deri vonë Moldova Suverana ishte gazetë qeveritare. Botimi i përjavshëm i Timpul është 46 750 kopje ndërsa Moldova 18 452.

11 Ibidem

12 Sarbu, Angela. Provocarile si performantele presei moldovenesti. (Chisinau: Independent Journalism Center, 2007), http://ijc.md/Publicatii/provocari.pdf (accessed June 02, 2008).

Situata në Kosovë kishte rëndësi për Moldavinë për shkak të problemit separatist me të cilën ajo po merrej në një pjesë të territorit të saj. Kjo është një ndër arsyet se përse shumë materiale të botuara analizonin sesi do të ecte zgjidhja e konfliktit transdnistrian si rezultat i shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Autorët e artikujve më së shumti i referoheshin pozicionit të Federatës ruse e reagimeve të saj për ngjarjen. Disa prej artikujve i krahasonin të dy situatat duke sjellë në mendje edhe kushtet historike. Në një artikull mbi Kosovën (Timpul, 25 shkurt 2008) Andrei Vartic përshkruante elementët historikë të ndikimit të politikës Ruse ashtu si edhe perspektivën e Kosovës si shtet i pavarur. Një rëndësi e madhe iu kushtua ndryshimeve të politikës ruse drejt rajoneve separatiste, një kurs politik që u deklaruar nga MPJ rus Sergei Lavrov. Në një artikull mbi ndryshimet e orientimit të stilit të Rusisë (Timpul, 20 shkurt 2008), Gheorge Budenau sillte ndërmend deklaratën e ministrit të jashtëm rus se "shpallja e njëanshme e njohja e pavarësisë së Kosovës e detyron Rusinë të ndryshojë politikën e saj drejt Abkhazisë e Osetisë"

Moldova Suverana e konsideronte të rëndësishme informimin dhe përshkrimin e evolucionit të konfliktit të Kosovës dhe analizonte ndikimin e saj në shkallë ndërkombëtare. Ata përqendroheshin tek ngjarjet e ardhshme e ato që po ndodhnin e ruanin një ndjesi prej vëzhguesi të situatës në Kosovë dhe ndikimin e saj në arenën ndërkombëtare. Në një artikull të botuar në Moldova Suverana (20 shkurt 2008) Oleg Christal analizon Kosovën dhe zinxhirin e dobësive duke përshkruar situatën e atjeshme pas fitimit të pavarësisë si edhe reagimet e mundshme nga shtetet e tjera. Timpul e vë theksin më shumë tek deklaratat sa i përket ndikimit nga vend nga shpallja e pavarësisë së Kosovës dhe pozicionin e shteteve të tjera të përfshira në këtë proces. Ajo paraqiti reagimet e shteteve të tjera sa i përket ngjarjes që sapo kishte ndodhur. Çështja e Kosovës përmendet më shumë si një shembull apo argument që të mbështetej opinioni i autorit sesa vetë paraqitja.

Megjithëse tek Moldova Suverana ka më pak materiale se Timpul, ne vërejmë se e para i dha një rëndësi më të madhe çështjes së Kosovës duke botuar më shumë artikuj në faqen e parë. Në këtë rast nuk kemi vetëm titullin por edhe një pjesë të tekstit e në dy raste edhe të gjithë tekstin të botuar në faqe të parë. Ndërkohë vetëm 2 artikuj u botuan në faqen e parë tek gazeta Timpul e ne mund të gjejmë atje të gjithë tekstin.

Lloji i tekstit është një nga ndryshorët më të rëndësishëm, për shkak se ai përcakton tipin e informacionit dhe shumë aspekte të tjera që janë me rëndësi për lexuesin. Llojet më mbizotëruese të teksteve janë lajmet, deklaratat, dhe komentet. Timpul mbështetet më shumë tek deklaratat e ka më pak komente në krahasim me Moldova Suverana që nuk ka asnjë deklaratë të botuar por ka tre komente. Kështu kjo gazetë nxjerr më shumë në pah pozicionin e gazetarit lidhur me çështjen e Kosovës dhe inkurajon shkrime që mbështeten mbi fakte dhe argumente. Timpul nga ana tjetër i kushton më shumë vëmendje qëndrimit e vlerësimit të politikanëve, ekspertëve dhe personaliteteve publike. Llojet e dyta më të zakonshme të

tekstit janë shënimet dhe editorialet. Një tjetër ndryshor jo më pak i rëndësishëm është autori i tekstit. Shumica e artikujve janë shkruar nga redaksia. Disa prej materialeve janë marrë nga media ndërkombëtare për t'i dhënë mundësi lexuesit ta analizojë çështjen nga në këndvështrim tjetër. Timpul p.sh nxori artikuj të ribotuar Christian Untenu "Zin Newspapers" (Romania), komentin "Post-Kosova: Skenari post-Kosova: episodi i dytë" (International Herald Tribune); "Ndarja e BE lidhur me njohjen i nxjerr probleme Kosovës"; Moldova Suverana nuk ka artikuj të ribotuar por shumica e tyre mbajnë në fund emrin e gazetarëve.

Nëse flasim rreth burimeve të cituara mund t'i ndajmë në dy pjesë: burime të cituara saktë dhe mospërmendje burimesh. Përqindja e materialeve me burime të deklaruara e të cituara saktë është më e lartë se to raste ku ai nuk përmendet fare. Kështu që ne mund të arrinim në konkluzionin se informacioni apo analiza që i ofrohet lexuesit ka një shkallë të lartë vërtetësie. Të dyja gazetat kanë praktikisht të njëjtën përqindje artikujsh me burime të mirëcituara.

Një tjetër ndryshor që lidhet me sa kemi dalluar më sipër është përfaqësimi i burimeve. Ky ndryshor na jep mundësinë të gjejmë se sa burime të drejtpërdrejta informacioni paraqiten ashtu si edhe pozicionin e institucioneve të ndryshme, personaliteteve publike apo politikanëve. Shkrimet e botuar që nuk përfaqësohen me asnjë burim janë më pak se 1, 2, 3 apo më shumë. Në gazetën Timpul mbizotërojnë materialet që përfaqësohen me një burim ndërsa tek Moldovo Suverana ne mund të gjejmë shkrime të botuara që përfaqësohen nga 3 ose më shumë burime. P.sh në Timpul ne kemi 5 deklarata ku burimet që i përfaqësojnë janë anëtarë të partive të ndryshme politike që shprehin qëndrimet e tyre për pavarësinë e Kosovës si edhe ndikimi i saj në zgjidhjen e konfliktit të ngrirë transdnistrian.

Shumica e artikujve u përkasin ngjarjeve që ndodhin në kohë reale. Moldova Suveran u përqendrua më shumë tek vetë Deklarata e Pavarësisë, paraqitje e ecurisë së reagimeve të ndryshme e analizën e qëndrimeve. Timpul shkroi më pak rreth ngjarjes së mësipërme dhe arsyet e saj lidheshin më shumë me reagimet, deklaratat, analizat sa i përket ndikimit të pavarësisë së Kosovës në situatën ndërkombëtare. Ka edhe disa artikuj që flasin për ngjarjet e ardhshme por janë të paktë në numër.

Në shumicën e rasteve vërejmë se ky raport raporti mes titullit dhe nëntitullit përmban një mesazh që vë në pah temën kryesore të shkrimit. Në gazetën Timpul shohim se ka 3 apo më shumë shkrime ku raporti i tyre përmban një mesazh që thekson pjesërisht temën kryesore ndërsa tek Moldova Suveran kjo ndodh vetëm tek 1 artikull. Nëse flasim rreth efektit pamor ai është i vogël teksa janë vetëm 7 materiale me fotografi dhe vetëm 2 me harta. Është fakt me rëndësi se ato përfaqësojnë mesazhin e tekstit dhe paraqesin elementë me ngjyrim emocional. Gazeta Moldova Suverana është e vetmja që ka përdorur harta dhe është e interesuar të fitojë vëmend-

jen e lexuesit. Në këtë mënyrë lexuesi përfshihet në proces jo vetëm duke marrë informacion por edhe duke e analizuar atë. Është për të ardhur keq që në 27 shkrime të botuara, 18 prej tyre nuk përmbajnë asnjë ilustrim. Kjo në njëfarë mënyre ul vëmendjen e lexuesit. Fatkeqësisht duhet të përmendim, megjithëse është disi e shpjegueshme që përmbajtja e shkrimeve i kushtohet ndikimit të Deklaratës së Pavarësisë sesa vetë asaj. Në përgjithësi gazetarët flasin më shumë rreth hapave diplomatikë e lëvizjeve diplomatike të vendeve të tjera. Një vëmendje e veçantë iu dha reagimit të BE e pozicionit të saj në drejtim të deklaratës së pavarësisë.

Shumica e ngjarjeve në median moldave që kishin ndodhur në nivel ndërkombëtar apo në vende të ndryshme ishin të lidhura me Kosovën. Një pjesë e madhe e veprimit në tekstet e shkruara zhvillohet në vende të tjera apo në Moldavi por është i lidhur drejtpërdrejt me Kosovën. Artikujt e botuar shprehin pozicionin e vendeve të ndryshme sa i përket çështjes së Kosovës si dhe reagimit e ndikimit të saj në skenën ndërkombëtare.

IV. KONKLUZIONET

Mbulimi prej medias moldave i kësaj ngjarje ishte në nivelin mesatar edhe në periudhën kur ajo ishte në krye të lajmeve ndërkombëtare. Duke marrë parasysh tiparet e medias lokale, rezultatet analizës nuk e ndryshojnë një pritshmëri të tillë. Është fakt se u vërejtën pak komente, editoriale e lajme rreth Kosovës çka dëshmon edhe njëherë se shtypi moldav i kushton më tepër vëmendje ngjarjeve politike; kjo sepse ata marrin mbështetje financiare nga partitë politike e nuk vendosin vetë për politikën e tyre editoriale.

Ndikimi i Rusisë mbi Republikën e Moldavisë është shumë i dukshëm. Shumica e artikujve analizojnë reagimin e Rusisë ndaj kësaj ngjarje dhe drejtimin e ardhshëm të politikës së saj të jashtme drejt rajoneve ku ka konflikte separatiste. Ata paraqesin edhe opinionin e partive të ndryshme politike rreth kësaj ngjarje. Në mund të arrimë në përfundimin se stabiliteti financiari gazetës ndikon shumë në llojin e informacionit që shpërndan si edhe në përmbajtjen e tij. Ne vërejmë se Moldova Suveran e përditëson vazhdimisht informacionin mbi Kosovës e në krahasim me Timpul ka përmbajtje më me vlerë. Edhe fakti që shumica e artikujve në këtë gazetë janë shkruar nga një gazetar i vetëm është dëshmi stabiliteti e vazhdimësie. Kjo shpjegon pse publiku moldav është i kënaqur. Ata nuk duan t'ia dinë kush e mbështet gazetën, ata duan informacion të sistemuar prej gazetarit. Unë mendoj se fatkeqësisht ndikimi i artikujve tek s'ishte shumë i thellë. Së pari për shkak se ndikimi i shtypit të shkruar në Moldavi s'është i konsiderueshëm e së dyti për shkak të mungesës së interesit në çështje të caktuara nga ana e shtypit vendas.

Ngjarja e pavarësisë së Kosovës meritonte mbulim më të mirë e informacion më të qartë me qëllim që të krijohej një idé e përgjithshme mbi situatën reale e pozicionin e palëve të përfshira në këtë çështje.

Mas-media moldave u përqendrua më shumë në çështjet e brendshme duke i dhënë më pak vëmendje atyre ndërkombëtare. Ky përgjithësim mbështetet prej faktit se në Moldavi shtypi duhet të përshtatet me kërkesat e tregut që të mbijetojë. Pavarësisht kësaj ne nuk mund të mohojmë faktin se gjatë kësaj periudhe u vërejtën komente e editoriale serioze që analizuan situatën ndërkombëtare dhe dështmuan profesionalizmin e gazetarëve në të dy gazetat.

BIBLIOGRAFI

Background Paper "The Transnistrian Conflict in Moldova: Origins and Main Issues".

CSCE Conflict Prevention Centre, Vienna, 10th June 1994. http://www.osce.org/documents/mm/1994/06/455_en.pdf (accessed May 13th, 2008).

Barometrul de opinie publică. Chisinau: Institutul de Politici Publice, May 2007. http://ipp.md (accessed May 14th, 2008).

Boian, Victoria. "Impactul proclamării independenţei Kosovo asupra politicii internaţionale". February 19th, 2008. http://www.unimedia.md/index.php?mod=home&hmod=interviewbyid&id=44 (accessed May 13th, 2008).

Bogatu, Petru. "E posibilă ralierea presei autohtone la standardul mediatic occidental?". Presa si Puterea, June 2007. http://ijc.md/bulmm/2007iunie/BMM_iunie2007.pdf (accesed May 14th).

Cristal, Oleg." Chişinăul schimbă din nou accentele, anunţând că integrarea europeană este principala prioritate", June 25th, 2008. http://oleg-cristal.blogspot.com/search?updated-max=2008-06-27T13%3A57%3A00%2B03%3A00&max-results=10 (accessed June 25th, 2008).

Garaz, Marcel. "Juridical evaluation of peacekeeping operations in Transnistria in conformity with international law." Aspects of the Transnistrian Conflict. Chisinau: Institute for Public Policy, 2003.

Nantoi, Oazu. Transnistrian Conflict: What Could the European Union and the United States of America Do? Chisinau: Institute for Public Policy, November 21st, 2005. http://www.ipp.md/public/comentarii/39/en/Transnistrian%20Conflict-EU%20and%20SUA_Engl29.doc (accessed May 16th, 2008).

Report. "Freedom of the press". Freedom House. 2006. http://www.freedomhouse.org/template.cfm?page=251&year=2006 (accessed June 02th, 2008).

Sarbu, Angela. Provocarile si performantele presei moldovenesti.

Chisinau: Independent Journalism Center, 2007. http://ijc.md/Publicatii/provocari.pdf (accessed June 02th, 2008).

Socor, Vladimir. "Kosovo and the post-soviet conflicts: no analogy means no "precedent". Eurasia Daily Monitor, Friday, April 14th, 2006. http://www.jamestown.org (accessed April 23th, 2008).



MALI I ZI

Danijela Seferoviq



VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Duke qenë se shoqëria malazeze është e polarizuar për shkak të lidhjeve politike e historike me fqinjin e saj Serbinë, edhe media ka ndjekur të njëjtën kahje. Gazeta e përditshme më me ndikimi në vend, Vijesti megjithëse në kohën e referendumit të 2006 mbështeti pavarësinë e Malit të Zi, kohët e fundit u bë kritike ndaj regjimit aktual, ndërkohë që e përditshmja tjetër me tirazhin më të lartë, Dan, mbeti përherë besnike e mbështetësve për një shtet të përbashkët me Serbinë dhe përkrah opozitën pro-serbe. Shtypi në Mal të Zi ofroi një mbulim të mirë të ngjarjeve në Kosovë dhe madje me shkrime të botuara në faqet e para, ndonëse kjo u shfaq më shumë tek gazeta Dan. Megjithëse të dy gazetat që janë marrë për shqyrtim zbatuan rregullat e saktësisë së informacionit, niveli i lartë i deklaratave të botuara në gazetën Dan ndikoi mbi larminë e lajmit ashtu si edhe korrespondencat e shumta të marra nga agjencitë e lajmeve dhe që u botuan tek gazeta tjetër Vijesti. Në situatën ku përmbajtja mbizotëruese e shkrimeve ishte e lidhur me fushën e diplomacisë ndërkombëtare, artikujt më të shumtë u kushtoheshin pseudo-ngjarjeve apo ngjarjeve që kishin ndodhur në faza të ndryshme dhe vetëm një numër veprimesh në shkrimet e botuara zhvilloheshin në Kosovë. Pyetja që shtrohet është nese kjo teme shmangej duke u instrumentalizuar në opinionin publik dhe kjo ndodhte në situatën ku media më me ndikim në këtë vend nuk do të ishte dakord nëse lajmet për Kosovën

I. KONTEKSTI POLITIK (QËNDRIMET E POLITIKËS VENDASE NË DREJTIM TË KOSOVËS)

Lidhje dhe pengesa

Në kohën e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, Mali i Zi ishte afër përkujtimit të përvjetorit të dytë të shpalljes së pavarësisë që e fitoi me referendum më 21 maj 2006 dhe që shënoi fundin e Unionit Serbi-Mal i Zi, një federatë e pasuksesshme që pasoi RFJ, e kjo nga ana e saj një mbetje e RSFJ që u shpërbë dhunshëm në fillim të viteve 90 të shekullit të kaluar. Megjithatë

disa lidhje nuk ishin shpërbërë akoma. 45% e votuesve në referendum votuan për një shtet të përbashkët me Serbinë ndërsa 1/3 e popullsisë së Malit të Zi ishte Serbe. Rreth 160000 refugjatë kosovarë që jetonin në Mal të Zi ishin shifrat më të dukshme që ilustronin praninë e konfliktit të Kosovës në Mal të Zi. Kjo shifër arriti deri në 70 000 gjatë eksodit masiv të shqiptarëve nga provinca e Serbisë Jugore që u njoh edhe si "kriza e refugjatëve" teksa numri i atyre arriti deri në 16% të popullsisë. Po t'i hedhim një vështrim në periudhën e luftës në Kosovë, konflikti përfshiu shtetin e përbashkët të Republikës Federative të Jugosllavisë dhe gjatë ndërhyrjes së NATOs, Mali i Zi u bombardua në shumë raste. Por megjithëse qeveria federale shpalli gjendjen e luftës, disa ditë më pas Mali i Zi deklaroi se ky shtet nuk i referohej territorit të saj pasi që atje nuk kishte ndonjë aktivitet lufte. Megjithëse këto ngjarje nxitën emocione të forta kombëtare dhe pasojat e saj mund të ndjehen edhe sot përmes alergjisë së një pjese të popullsisë së saj për t'iu bashkuar NATO, ku arsyeja që përmendet më shpesh është ndërhyrja e lartpërmendur.

Sondazhi më i fundit i opinionit publik i kryer nga Qendra për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut[1], e që i kushtohet qëndrimeve mbi situatën në Kosovë vëren se 2/3 e malazezëve e konsiderojnë këtë çështje si të rëndësishme ose disi të rëndësishme për ta. Qëndrimet zyrtare të strukturave drejtuese politike janë të ndara rreth kësaj çështje. Reagimet e para zyrtare nga qeveria malazeze mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës, sipas drejtorit politik të MPJ, Vladimir Raduloviq ishin se "Ne(Mali i Zi) do të vazhdojmë të monitorojmë zhvillimet nga afër…. Por sigurisht nuk do të nxitohemi e as do të ndërmarrim ndonjë veprim të shpejtë" (Vijesti, 13 janar 2008). Rezultati i pritshëm u zbulua më vonë në një intervistë dhënë më vonë nga Milo Gjukanoviq (President i Partisë Demokratike të Solialistëve –DPS, ishpresident dhe kryeministët) televizionit Hayat në Sarajevë i cili deklaronte "Ne kemi zgjedhur të jemi pjesë e BE dhe do të respektojmë vendimet e tij. Natyrisht Mali i Zi nuk do të marrë rolin e liderit kur vjen fjala për pavarësinë e Kosovës… Por në fund ne do ta njohim pavarësinë e Kosovës kur edhe vendet e tjera të rajonit ta bëjnë këtë" (Vijesti 28 janar 2008).

Qëndrime të tilla u kundërshtuan fort nga partitë e opozitës megjithëse këto ishin deklarata të rralla. Fushata e tyre kundër pavarësisë ishte më e zhurmshme. Thirrjet e tyre të vazhdueshme drejtuar qeverisë u mbështetën me argumente të tillë si "Për ne Kosova është çështje morali…ajo duhet të jetë pa dyshim çështje e sigurisë" (Dan, 10 janar 2008, Vijestit 13 janar) dhe se për ata ky vendim ishte "precedent", një përpjekje për të krijuar një "gjojashtet "dhe se ai duhej të anulohej për shkak se ishte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare dhe rezolutën e OKB-së.

1 Center for Democracy and Human Rights, *Political Public Opinion - February 2008*, (2008) http://www.cedem.co.me/ (accessed May 1, 2008)

II. KARAKTERISTIKAT E SISTEMIT TË MEDIAS - KONTEKSTI I MEDIAS

Kush është shkruesi?

Skena e medias malazeze ka qenë lojë e situatës politike në vitet e kaluara dhe të ndarjeve që e karakterizonin atë. Profesioni i gazetarit u polarizua në Mal të Zi fillimisht në vitet 90, kur atyre u duhej të vendosnin nëse duhej të mbështesnin kryeministrin e atëhershëm malazez Millo Gjukanoviq që kishte filluar të shkëputej nga politika e tij e bashkëpunimit të ngushtë me Sllobodan Millosheviqin, për të hyrë tek rruga e kundërshtimit të tij. Nevoja për të siguruar mbështetje masive për të dy kampet i dha jetë lindjes së dy prej gazetave të përditshme më popullore e më me ndikim në Mal të Zi; Vijesti- pro pavarësisë së Malit të Zi dhe Dan – e përditshme pro serbe.

Në shtator 1997 Vijesti filloi vetëm si gazeta e dytë e përditshme në Mal të Zi së bashku me gazetën tjetër në pronësi shtetërore Pobjeda, statusi i së cilës mbetet i pandryshuar edhe sot. Në kohën që filloi të dalë kjo gazetë po vazhdonte fushata për zgjedhjet presidenciale të 1997, ndërkohë që ai vazhdonte të ishte pjesë e RFJ. Malazezët duhet të zgjidhnin mes ish-aleatit të liderit të DPS, njeriut pro-Millosheviq, Momir Bullatoviq dhe Millo Gjukanoviqit, që në atë kohë filloi ta distanconte veten me kujdes nga politika e Millosheviqit. Vijesti përkrahte Gjukanoviqin, i cili i fitoi zgjedhjet atë vit duke u bërë president i Malit të Zi. Megjithëse në ndonjë rast ajo ishte kritike ndaj Gjukanoviqit, në përgjithësi ajo i mbështeti politikat e qeverisë së tij lidhur me çështjet kryesore si p.sh marrëdhëniet me Serbinë. Në vitet e para të ekzistencës së saj ajo qe akuzuar si mbështetëse agresive e pavarësisë së Malit të Zi dhe qeverisë së Malit të Zi. Në vitin 2003, Vijesti hyri në një partneritet strategjik me koncernin mediatik gjerman WAZ, i cili bleu 50% të aksioneve të Vijesti.

Në referendumin e 2006 për pavarësi, Vijesti ishte një mbështetëse e moderuar e Gjukanoviqit ndërsa që prej shpalljes së pavarësisë së Malit të Zi ajo i është bashkëngjitur një qëndrimi kritik e kundërshtues ndaj regjimit të Gjukanoviqit e DPS-partisë që ai drejton. Situata u përshkallëzua pas sulmit ndaj drejtorit të kësaj gazete, Zheljko Ivanoviq. Ivanoviq akuzoi publikisht "familjen biologjike e kriminale" të presidentit të DPS Gjukanoviq, për "orkestrimin e sulmit, në një përpjekje për të shkatërruar fortesën e fundit të lirisë gazetareske". Ivanoviq iu referua atyre si "njerëz që donin të kontrollonin çdo aspekt të jetës në Mal të Zi". Gjukanoviqi si këmbim e akuzoi Ivanoviqin për shpifje dhe ndaj filloi një gjyq në Podgoricë më 26 nëntor 2007. Në fillim të tetorit 2007, pas katër vjetëve e gjysmë bashkëpronësi, grupi gjerman WAZ ia shiti aksionet e Vijestit disa pronarëve të tjerë (4 individë)

Vijesti krijoi edhe kanal televiziv në tetor 2007 dhe që prej 11 majit 2008 ai transmeton në të gjithë Malin e Zi. TV Vijesti synon të bëhet lider në programet informuese në Mal të Zi.

Numri i parë i gazetës së përditshme Dan doli në 31 dhjetor 1998. Që në fillim ajo ishte një ndër kritiket më të ashpra të regjimit të Gjukanoviqit dhe propagandonte një politikë të përbashkët me Serbinë, të cilën e vazhdon edhe sot. Pothuajse që në fillim Vijesti mori përparësi sa i përket tirazhit pasi ishte gazeta e parë në rajon që zbatoi idenë e shitjen e librave së bashku me gazetën.

Nga ana tjetër gazeta Dan, pa ndihmën e buxhetit të përbashkët të FRY, por me mbështetjen financiare të atyre që ndanin të njëjtin mendim mbi alternativën e bashkimit me Serbinë (unitaristët) ia arriti të ketë sukses. Në ndihmë i erdhi botimi i "Revija D" e cila në një periudhë të shkurtër u kthye në të përjavshme me tirazhin më të lartë në treg. Kjo e lejoi gazetën të mbesë në betejën për ndikim te publiku. Tabloidi "Revija D" të sjell në mendje në gazetë Dan, e cila vazhdon të ndjekë sensacionin, informacionet mbi skandalet ashtu si edhe artikujt ekskluzive, që praktikisht i gjen me vështirësi tek gazetat e tjera të përditshme në Mal të Zi.

Rreth orës 11:45 p.m, më 27 maj 2004 vritet në një rrugicë të Podgoricës përballë zyrave të gazetës, themeluesi e kryeredaktori i gazetës DAN Dushko Jovanoviq. Megjithëse një hetim i gjatë policor rezultoi me një sërë arrestimesh së bashku edhe me një të dyshuar për vrasje që po gjykohet, ende nuk janë identifikuar individët që qëndrojnë pas kësaj ngjarje. Kjo ngjarje fatkeqe hodhi hije mbi lirinë e shtypit malazez dhe pavarësinë e tij nga regjimi shtetëror. Ndikimi i kësaj ngjarje është ende i pranishëm tashmë përmes përpjekjeve të rastit për të vendosur kontroll mbi televizionin shtetëror të Malit të Zi.

III. ANALIZAT E STUDIMIT

Nëse flasim me gjuhën e shifrave, mbulimi ngjarjeve nga media malazeze lidhur me situatën në Kosovë ishte i bollshëm. Rreth 382 u botuan në gazetat e marra në shqyrtim përgjatë periudhës së studimit, megjithëse shpërndarja e tyre nuk ishte e barabartë. Më shumë se 2/3 e artikujve të botuar apo 267 u vërejtën tek e përditshmja Dan. Kjo mund të shpjegohet me politikën e saj editoriale pro-serbe.

Një tjetër argument mbështetës e ilustrues gjendet tek mënyra e paraqitjes së artikujve. Artikujt mbi ngjarjet që lidhen me Kosovë e tërë Serbinë, E përditshmja Dan i vendos në faqen 4 e 6 duke i trajtuar ata si artikuj që i përkasin fushës së politikës e duke i barazuar me lajmet e vendit, ndërkohë që Vijesti i trajton si Lajme nga Bota dhe i vendos në faqet e mesit.

Shkalla e rëndësisë

Kronologjia e ngjarjeve e regjistruar nga të dy gazetat në Mal të Zi zhvendoset që nga debati politik e diplomatik i Serbisë lidhur me vendimin e BE për të dërguar misionin e saj policor e gjyqësor në Kosovë nën

dritën e nënshkrimit të MSA e deri tek trajtimi që iu dha situatës në Kosovë gjatë zgjedhjeve presidenciale në Serbi. Natyrisht që ngjarjet kryesore ishin shpallja e pavarësisë, fillimi i protestave në Beograd dhe protestat e organizuara nga nxënësit e shkollës së mesme në Podgoricë.

Vëmendja që tërhoqën këto ngjarje është lustruar ë së miri prej numrit të titujve që u shfaqën në faqe të parë: nga tërësia e artikujve, 42 prej tyre (10%) u botuan në faqe të parë. Sërish 2/3 e titujve në këtë rast i përkisnin gazetës Dan. Për më tepër ngjarjet e lidhur me Kosovën u përzgjodhën si lajmet kryesore në 10 raste dhe për këtë qëllim meritonin analiza më të hollësishme. Për gazetën Vijesti katër data ishin më të rëndësishme 17, 18, 19. 20, 22 shkurt.

Parashikimi

Në prag të shpalljes së pavarësisë më 17 shkurt, gazeta Vijesti botoi një korrespondencë të gjerë nga korrespondentët e saj nga Kosova e titulluar "Prishtina po numëron orët" duke deklaruar për lexuesit edhe qëndrimet e dy kryeministrave, kosovar (Thaçi) e atij serb (Koshtunica).

Në qendër të kësaj korrespondence nga Prishtina ishte mundësia për shpërthimin e dhunës e cila ishte këndvështruar nga burime të ndryshme opinionesh të tilla si- Kryetari i Bashkisë së Mitrovicës, Bajram Rexhepi, Komandanti i KFOR, Xavier de Marnhac, Millan Ivanoviq, President i Këshillit Kombëtar Serb për Kosovën veriore. Ajo çfarë binte në sy tek këto opinione ishte mohimi i mundësisë për shpërthimin e dhunës. Ky pohim mbështetej më tej edhe nga analisti politik shqiptar Ilir Dugolli. Në të njëjtën ditë, në gazetën Dan u botua një artikull me titull "O Kosovë, o fushë me emër tragjik"[2], e cila është një citim prej veprës së famshme "Kurora e Malit" e Petar Petroviq Njegosh, princi-peshkop i Malit të Zi në shek XIX dhe që është marrë shpesh si simbol i qenies kombëtare serbe në Mal të Zi. Artikulli ilustrohej me foton e një burri që ngrinte 3 gishtat lart mbi shajkaçë, kapelën kombëtare serbe. Vëmendja kryesore e artikullit nuk ngjarja e shpalljes së pavarësisë por pasojat e mundshme dhe reagimet nga autoritetet serbe. Me burime shumë të varfra informacioni (vetëm deklarata të presidentit Tadiq e kryeministrit Koshtunica) artikulli paraqet lëvizjet e pritshme nga qeveria serbe, duke filluar nga miratimi i vendimit të qeverisë serbe për të anuluar vendimin e Parlamentit të Kosovës ; kërkesë KS të OKB për të bërë të njëjtën gjë; vënia në zbatim e një plan-veprimi sekret apo edhe ndërprerje të marrëdhënieve diplomatike me shtetet që do të njihnin pavarësinë e Kosovës.

Gjithsesi faktet e paraqitura këtu janë dhënë në mënyrë të njëanshme çka e bën shkrimin të afërt me llojin e komentit. Kështu artikulli vëren "Në këtë ditë, e cila është dita më e vështirë në historinë e Serbisë….Struktu-

2 ..."O Kosove, Ti Fushe me kete emer kaq tragjik,/Nuk pat fund me te tmerrshem as Sodoma ne flake!"…, P. P. Nyegosh, peshkop i Malit te Zi, *The Mountain Wreath*, perkthyer ne anglisht nga James W. Wiles, Botuar ne fillim ne 1930 nga George Allen & Unwin, Ltd., Londer, http://www.njegos.org/petrovics/wreath.htm

rat më të larat publike dhe të gjithë institucionet serbe në koordinim me Rusinë e presidentin e saj Vlladimir Putin e ministrin e punëve të jashtme Sergei Lavrov po kryejnë një luftë të ashpër diplomatike kundër dhunimit ndërkombëtar mbi Serbinë, në mbrojtje të sovranitetit dhe integritetit të saj territorial …"[3]. Në këtë rast nuk del e qartë nëse burimi i informacionit është nga ata të përmendurit apo është vetë gazetari. Në artikujt që lidhen me këtë ngjarje, të dy gazetat botuan informacionin mbi vendimin e BE për të dërguar misionin e saj EULEX në Kosovë, deklaratën e liderit të Listës Serbe Andrija Matiq, partisë opozitare në Mal të Zi që pohonte se do të organizonte në Podgoricë një protestë kundër pavarësisë së Kosovës ashtu si edhe protesta e organizuara përmes Serbisë e Kosovës. Dallimi ishte se Vijesti kishte përdorur kryesisht agjencitë e lajmeve ndërsa Dan mori deklarata nga liderë të shumtë opozitarë në Mal të Zi dhe 2 intervista me ministrin serb të religjionit Radomir Naumov mbi vizitën e tij në Kosovë si edhe me Milan Ivanoviq, presidentin e Këshillit Kombëtar Serb për Kosovën veriore.

Shpallja

Më 18 shkurt 2008, një ditë pas shpalljes së pavarësisë, të dyja gazetat e vendosën këtë ngjarje në faqe të parë. Përsëri edhe në këtë rast u shfaqën dallime të konsiderueshme mes të dy gazetave. Vijesti u përpoq ta paraqiste përmes qasje të ekuilibruar e të drejtë që u pasqyrua që në titull: "Shqiptarët festojnë, Serbët protestojnë." Sërish artikullin kryesor e përbënte mbulimi prej korrespondentëve të saj në Prishtinë, të cilët sillnin detaje të hollësishme nga atmosfera në Prishtinë, dhe që mbante titullin: "Thaçi: Kosova, shtet qytetar." Pjesët e tjera të titullit mbi kopertinën e gazetës të vendosur përbri saj përmblidhnin reagimin e Serbisë zyrtare nën titullin: "Koshtunica – Kosova, shtet i rremë për interesat ushtarake të NATO-s." Burimet e informacionit ishin Agjencia Beta dhe B 92. Përveç qëndrimeve të palëve në konflikt, korrespondencat që zinin dy faqe qendrore 10 e 11, tashmë plotësoheshin nga të tjera që lidheshin me protestat në Beograd, (p.sh "Protesta në Beograd: Shkatërrohen ambasadat e Sllovenisë dhe SHBA") ndërkohë që jepnin edhe reagimet e shteteve të tjera ndaj lëvizjes së Kosovës ("Rusia bën thirrje për anulim") teksa vërehet që informacioni është marrë nga media të tjera. Nga ana tjetër u botuan edhe dy korrespondenca të tjera në këtë faqe, (si p.sh "Festime pa pompozitet") që regjistronin reagimet e shqiptarëve vendas në ato zona të Mallit të Zi ku përbënin shumicën si edhe deklaratën e liderit opozitar pro-serb Andrija Mandiq lidhur me vizitën e tij në Mitrovicë të Kosovës.

Në rastin e gazetës Dan, mënyra e mbulimit të kësaj ngjarje u përcoll më së shumti në mënyrë emocionale dhe me slogane të tilla si "Kosova është zemra e Serbisë". Në shkrimet e botuara kishte fjalime të plota ekskluzive të

3 «...U ovom najtežem danu u istoriji Srbije..», «...najviši državni organi i sve institucije Srbije u koordinaciji sa Rusijom i njenim predsjednikom Vladimirom Putinom i ministrom spoljnih poslova Sergejem Lavrovim vodili su do sada žestoku diplomatsku bitku protiv međunarodnog nasilja nad Srbijom u odbrani njenog suvereniteta i teritorijalnog integriteta....», (Oj, Kosovo grdno sudilište, *Dan*, February 17, 2008, p. 5)

Tadiqit, Koshtunicës e presidentit të Parlamentit serb Oliver Duçiq me anë të cilave ata i drejtoheshin kombit serb lidhur me shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Përsa kohë një analizë e hollësishme e pjesëve të marra në shqyrtim do të kërkonte shumë vend, por duke marrë parasysh faktin e 26 artikujve që u botuan në atë datë, të bie në sy se të gjithë kanë një karakteristikë të njëjtë – njëanshmëri; një qëndrim i njëanshëm ndaj temës. Kjo mund të shihet edhe prej titujve ku disa pre tyre lexonin "Trazirat kanë filluar" (Dan, 18 shkurt 2008, faq 5) i cili në këtë rast u referohej demonstrative në Beograd para ambasadave të të SHBA apo "Evropa shkel mbi historinë e saj" (Dan, 18 shkurt 2008, faqe 5) ashti si edhe deklarata për shtyp e Këshillit të Kurorës së Princit Aleksandër Karagjorgjeviq apo edhe të Republikës Srpska për shpalljen e pavarësisë. Edhe titulli tjetër "Duhet të bëhet e drejta" (Dan 18 shkurt 2008, faqe 5) reagonte ndaj vendimit të njëanshëm të Parlamentit të Kosovës ndërsa tek "Të dy të ofenduar: Zoti dhe drejtësia njerëzore" (Dan, 18 shkurt 2008, faqe 6) pasqyrohej një njoftim për shtyp i Kishës Ortodokse Serbe.

Ndërkohë më 19 shkurt kjo temë nuk përbënte më prioritet për gazetën Vijesti, ndërsa Dan vazhdoi të mbulonte zhvillimet e mëtejshme me intensitet të pazvogëluar duke botuar artikuj në faqe të parë me titull të tillë si "Shteti i rremë do të dështojë" ku paraqitej një korrespondencë nga sesioni i Parlamentit serb i cili miratoi vendimin e qeverisë për të anuluar shpalljen e shtetit të Kosovës.

Reagimet

Më 20 shkurt, lajmet kryesore në të dy gazetat ishin të lidhura sërish me zhvillimet rreth pavarësisë së Kosovës, por tani veprimi u zhvendos në Mal të Zi. Në një artikull me tillë "Erdhën shumë për të ndarë klasat" (Vijesti 20 shkurt 2008. faqe 6) boton një reportazh mbi protestat e nxënësve të shkollave të mesme përmes Podgoricës. Në këtë shkrim përveçse u paraqitën në mënyrë kronologjike faktet dhe një përshkrim në vend i ngjarjeve u dhanë edhe opinionet e një zyrtare të ambasadës së SHBA, drejtorit të shkollës së mesme si dhe gazetari u përpoq të hetojë mbi motivet që qëndronin prapa protestës së tyre duke cituar pjesëmarrës të shumtë me qëndrime të ndryshme. Ndërkohë këto ngjarje në gazetën Dan u paraqitën duke vlerësuar me nota pozitive veprimin e nxënësve të shkollës së mesme. Titulli i kësaj gazete "Nxënësit meshë të veçantë e lutje për Kosovën" (Dan 20 shkurt 2008, faqe 40) përqendrohet tek mesha që u mbajt në tempullin e Ringjalljes së Krishtit ku mes të tjera përzgjedh citate nga meshtari e të rinjtë e pranishëm që bënin thirrje për mbrojtjen e popullit serb kundër padrejtësive e mbajtëseve të pushtetit botëror.Megjithatë, pavarësisht se kjo ngjarje u përkiste ndodhive të përditshme, gazeta Dan e trajtoi si lajm në faqe të parë dhe botoi një intervistë me Radovan Nikoliq, president i Shoqatës së Veteranëve të Luftës së Malit të Zi pas 1991. Duke qenë se kishte marrë pjesë në Luftën e Kosovës në 1998 dhe 1999, gazeta shfrytëzonte mundësinë për t'i paraqitur këto ngjarje si argument kundër pavarësisë së Kosovës. Titulli i artikullit ishte

"Në 1998 dhe 1999 UÇK vrau 38 të rinj malazezë". Në këtë mënyrë titulli shpreh më pas qëllimin e artikullit "Shteti nuk duhet t'i njohë vrasësit" (Dan 20 shkurt 2008, faqe 1, 9). Për më tepër artikulli heton edhe mbi përfshirjen në krimet e luftës në Kosovë të kryeministrit të sotëm Kosovar Hashim Thaçi, duke renditur krimet për të cilat akuzohet. Artikulli ilustrohej më tej me një fotografi të Thaçit i rrethuar me 4 ushtarë të veshur me uniforma, dy prej të cilëve mbanin armë. Fotografia u vendos në faqe të parë së bashku me titullin.

Situata në Kosovë mbeti në faqet e para të gazetës Dan edhe për tre ditë me radhë dhe titujt së bashku me fotografitë që mbushnin këto faqe ishin të njëanshëm dhe propagandistik, p.sh "ADN e Kosovës është tek çdo serb" (Dan, 21 shkurt 2008, faqe 1, 4); "Shpirti i popullit serb ka folur" (Dan 22 shkurt, faqe 1, 3, 4, 5). "Nuk u shkon serbëve të jenë të qetë" (Dan, 23 shkurt 2008, faqe 60). Një nga ngjarjet kryesore që pasoi shpalljen e pavarësisë – protesta në Beograd nga 21 shkurti – gazeta Vijesti i mbuloi përmes korrespondencës së mediave të tjera dhe agjencive të lajmeve (Beta, Reuter, B 92).

Llojet e shkrimit dhe burimi

Të dhënat statistikore lidhur me llojet e shkrimeve të përdorura tregojnë se në periudhën e zgjedhur për studimi, shumica e teksteve të përdorura nga të dy gazetat janë deklaratat (37%) të cilat ndiqen prej lajmeve (20%), lajmet e zgjeruara (16%) dhe korrespondencat (11%). Numri i deklaratave sa i takon mbulimit të ngjarjeve është më i madh tek gazeta Dan (40%). Burimet e këtyre deklaratave janë në shumicën e rasteve të politikanëve malazezë pro-serbë e përfaqësuesve të organizatave serbe në Kosovë, të cilët kanë lidhje me këtë provincë.

Format e tjera të shkrimit gazetaresk nuk u përfaqësuan në mënyrë të konsiderueshme. Të dyja gazeta ofruan kryesisht analiza të shkruara nga gazetarë që punonin në media të tjera. Shumica e analizave dhe autorëve të shkrimeve u morën prej medias së huaj ose u shkruan nga autorë të huaj.

Një ndarje e tillë e llojeve të shkrimeve të përdorur mund të shpjegohet nën dritën e të dhënave të mëposhtme që lidhen me autorësinë e artikujve. Përkatësisht 30% e artikujve të botuar janë ribotime apo informacione të agjencive të lajmeve. Të marra veçmas përqindja e informacionit të huaj tek Vijesti është shumë e lartë rreth 75%. Këto artikuj u botuan kryesisht në formën e korrespondencave apo lajmeve të zgjeruara, të përgatitura kryesisht nga përpunimi i informacionit që ofruan 3 media të ndryshme, më së shumti, Agjencia Beta, Reuter dhe B 92. Një situatë e tillë ishte e kuptueshme sepse asnjë prej të dy mediave të përzgjedhur për studim nuk kishin korrespondentë në Kosovë. Përjashtim ishte rasti i gazetës Vijesti që dërgoi dy nga gazetarët e saj për të raportuar drejtpërdrejt nga Prishtina me rastin e shpalljes së deklaratës së pavarësisë nga parlamenti i atjeshëm.

Shifrat tregojnë një situatë krejt të kundërt për gazetën Dan, agjencitë e lajmeve dhe mediat e tjera shërbyen si burim informacioni vetëm në 10% të

artikujve. Megjithatë në këtë rast duhet të bëjmë një vërejtje metodologjike - artikujt që mbanin apo jo në fund emër autori nga këndvështrimi i kësaj medie u trajtuan si shkrime, autori i të cilave ishte gazetari, megjithëse në strukturën e artikullit citohej shumë shpesh një agjenci lajmesh apo media tjetër si burim informacioni. Të dyja gazetat ishin të sakta sa i përket deklarimit të burimeve të tyre të informacionit. 77% e artikujve në Vijesti dhe 76% në gazetën Dan përdorën burime të sakta që linin pak hapësirë për spekulim veçanërisht duke patur parasysh se vetëm 2% e artikujve në Vijesti e 7% në Dan u botuan pa përmendur asnjë burim në to.

Në përgjithësi vërehet një dallim i madh mes të dy mediave lidhur me larminë e burimeve. Nga njëra anë Vijesti paraqet rezultatet të kënaqshme ku rreth 43% e artikujve deklarojnë më e apo më shumë burime, nga ku mund të nxirret përfundimi se kjo gazetë e respekton parimin e shumësisë së informacionit. Nga ana tjetër 2/3 e artikujve në Dan kishin vetëm nga një burim. Kjo është sërish rrjedhojë e përfaqësimit të mëparshëm të llojeve të shkrimit gazetaresk në këtë gazetë, ku rreth 40% e lajmeve mund të klasifikohen si deklarata.

E vërteta vs E rreme

Në përgjithësi, situata e Kosovës në mediat malazeze u paraqit si e pritshme sa i përket karakterit të saj dhe kjo provohet nga fakti që 42% e artikujve u referohen pseudo-ngjarjeve p.sh deklarata, njoftime për shtyp, raporte etj. Kjo nënkuptohet, duke marrë parasysh afërsinë me veprimet e për rrjedhojë bën të mundur përgatitjen e më shumë artikujve që regjistrojnë reagimet nga një ngjarje e cila zhvillohet në një vend tjetër. Kategoria e dytë më e madhe e artikujve ishin ato që mbulonin ngjarjet në faza të ndryshme kohore siç ishin sesionet e lëvizjet diplomatike. E njëjta prirje u vërejt pothuajse në të dy gazetat. Shumica e artikujve (78%) kishin një raport të ekuilibruar mes titullit e temës i cili jepte në mënyrë të përmbledhur e të paanshme informacionin e paraqitur në strukturën e shkrimit. Megjithatë siç tregohet më poshtë, gazeta Dan përdor më shumë tituj me ngjyrim emocional p.sh më 3 shkurt 2008, ajo botoi në artikull me titull "Dhimbja e vëllait ndjehet më shumë" me nëntitull: "Marrëdhënie të ftohta mes Serbisë e Malit të Zi nëse Podgorica zyrtare njeh pavarësinë e Kosovës". Teksti përmban deklarata apo më shumë janë opinione nga Millan Ivanoviq, President i Këshillit Kombëtar Serb për Kosovën por ajo çfarë mund të lexohet në tekst, titulli nuk është citimi i tij i drejtpërdrejtë.

Ilustrimet

Sa i përket ilustrimeve të përdorura në të dyja gazetat ato ishin më shumë fotografi të cilat u paraqitën në rreth 40% të artikujve. Por nëse vërejmë shifrat veçmas për çdo gazetë, tek Vijesti rreth 60% e artikujve përmbanin ilustrime ndërkohë që tek Dan kjo ndodhte vetëm në 30% të tyre. Pra Vijesti është më pamore.

Shumë prej fotove janë vetëm informuese, shpesh të arkivit, të cilat përdoren me qëllim portretizimin e personit që është aktor i ngjarjes apo burim i informacionit, ndërkohë që afërsisht 1/5 e tyre i kontribuon shkrimit duke përforcuar në këtë mënyrë mesazhin e tij.

Përmbajtja mbizotëruese

Kuadri kontekstual i artikujve të analizuar u përket fushave të shumta tematike në to përfshihen ato të aktivitetit diplomatik qoftë vendas apo ndërkombëtar dhe ato që janë përkufizuar si përpjekje për të zbatuar të drejtën ndërkombëtare.

Këtu duhet të bëjmë një vërejtje metodologjike për të kuptuar në mënyrën e duhur rezultatet e studimit. Dallimi mes lëvizjeve diplomatike vendase e atyre të vendeve të tjera është bërë sipas fakti nëse një veprim diplomati është nxitur nga pala në konflikt, Mali i Zi, ndonjë vend i huaj apo komuniteti ndërkombëtar. Me një ndarje të tillë vërejmë se gjysma e artikujve në të dy gazetat janë marrë me atë që zakonisht quhet diplomaci e nivelit të lartë. Kështu gjysma e artikujve që i kushtohen situatës në Kosovë ishin raporte dhe deklarata zakonisht të karakterit parashikues, të përqendruara rreth ngjarjeve të tilla si procesi i vendim-marrjes së BE për të dërguar misionin e saj në Kosovë, lidhja e një vendimi të tillë me nënshkrimin e MSA me Serbinë, sesionet e KS të OKB dhe një sërë takimesh dypalëshe e shumëpalëshe që pasuan njohjen e pavarësisë së Kosovës dhe qëndrimet mbi këtë çështje. Përqindja e këtyre artikujve ishte e njëjtë në të dy gazetat. Siç e kemi, Vijesti mbulon këto ngjarje në shumicën e rasteve përmes agjencive të lajmeve apo informacioneve të mediave të tjera.

Ndërkohë ishin të rrallë artikujt lidhur me veprimet zyrtare diplomatike të Malit të Zi. Këndvështrimi i parë mbi situatën u dha nga një artikull i botuar nga Vijesti më 13 janar 2008 që paraqiste qëndrimet e BE e SHBA si edhe të dy figurave të opozitës politike në Mal të Zi si edhe qëndrimet e qeverisë së këtij vendi përmes deklaratës së Vlladimir Radulloviq, drejtor politik në MPJ, i cili pohonte se Mali i Zi nuk do të nxitonte për një vendim të tillë si njohja e pavarësisë. I njëjti qëndrim u pohua edhe nga Millo Gjukanoviq në një intervistë televizive që thoshte se "Mali i Zi nuk do të ngutet të njohë atë (Kosovën). Por në fund ne do të bëjmë si vendet e tjera në rajon"[4]

Gazeta Dan mbuloi përmes shkrimeve të saj të njëjtat qëndrime por nga këndvështrime të ndryshme. P.sh ajo komentoi deklaratën e z. Bajram Rexhepi, zv/president i Partisë Demokratike të Kosovës se "Mali i Zi së bashku me Maqedoninë e Shqipërinë duhet të ishin mes shteteve të para që të njihnin Kosovën" (Dan, 1 shkurt). Kjo gazetë e mbuloi në mënyrë të konsiderueshme debatin e brendshëm politik në vend, që shfrytëzonte temën e situatës në Kosovë duke përdorur tituj që mund të konsideroheshin deri

4 Do ta njohim Kosoven kur vendet e tjera te rajonit ta njohin ate", Vijesti, January 28, p.3

provokativë si p.sh "Çfarë mendon Millo, thotë Dinosha" (Dan, 4 shkurt) [5] – i cili ishte një koment i zëdhënësit të Listës Serbe Dobrillo Dedeiq mbi Deklaratën e Unionit Demokratik të Shqiptarëve që bënte thirrje për pavarësinë e Kosovës. Një artikull tjetër me titull "Millo erdhi me Kosovën e me Kosovën do të ikë" (Dan, 10 shkurt) – ishte një opinion nga intervista me liderin e Partisë Demokratike Serbe Ranko Kadiq (Dan, 11 shkurt). Nga ana tjetër, titulli "Bojkot Parlamentit nëse Millo njeh Kosovën" (Dan, 11 shkurt 2008) – përsëriste një deklaratë nga intervistat me një lider tjetër të opozitës. Një mbulim i tillë mund të ilustronte vetëm orientimin politik të kësaj medie.

Ndërkohë një sërë qëndrimesh të kundërt arritën të pasqyroheshin vetëm në Vijesti. Kështu p.sh e tillë ishte një intervistë e botuar më 9 janar me Juddy Batt, ekspert i Institutit për Studimet e Sigurisë të BE (EUISS) në Paris që deklaronte se "Mali i Zi duhet të njohë pavarësinë e Kosovës në interes të stabilitetit në rajon".

Një tjetër përmbajtje mbizotëruese te shkrimet e botuara ishte edhe ajo që klasifikohet si përpjekje për zbatimin e së drejtës ndërkombëtare. Këto artikuj përmbanin mesazhin kryesor tek rreth 32% e shkrimeve të gazetës Dan.

Shumica e tyre lidheshin me pseudo ngjarjet si deklarata, njoftime për shtyp, intervista para fushatës elektorale në Serbi e Mal të Zi por pa ndonjë qëllim konkret informues përveç përcjelljes së mesazheve politike dhe qëndrimeve të politikanëve vendas.

Artikujt me një kontekst të tillë mund të konsiderohen mbështetës së palës serbe në konflikt ndërsa të tjerët ato i kushtoheshin temës së të së drejtë të vetëvendosjes, p.sh pavarësia si pasqyrim i palës shqiptare.Në tërë raporti i dy gazetave kryesore malazeze duhet të ishte ilustrim i këtyre qëndrimeve. Në Vijesti raporti është 13% me 14% ndërsa në Dan 32% me 3%.

Përmbajtja e shkrimeve të lidhur me dhunën e tensionet etnike zunë 20% të mbulimit të ngjarjes mbi Kosovën, ndërkohë që vërejmë një dallim të vogël mes dy gazetave. Këto artikuj i referoheshin kryesisht incidenteve që pasuan shpalljen e pavarësisë në Beograd dhe në pikat e kalimit të kufirit në Kosovë, incidente të vogla në Kosovë dhe krimeve të kaluar të kryer në Kosovë gjatë vitit 1999. Megjithatë shumica e tyre nuk janë mbulim i drejtpërdrejtë por informacion i marrë. Megjithëse këndvështrimet e qëndrimet e autorëve në raport me përmbajtjen mund të ndryshojnë, siç tregohet edhe në shembujt e mëposhtëm, nuk ka dhunim të parimeve gazetareske sa i përket dallimeve etnike apo ndonjë përfshirje në përhapjen e gjuhës së urrejtjes etnike.

Janë vetëm disa shembuj të izoluar që shmangen nga kuadri i përcaktuar i rrethanave të tilla si analiza mbi ndikimet e mundshme të pavarësisë së

5 Ferhat Dinoša eshte udheheqesi i Bashkimit Demokrat te Shqiptareve, parti e vogel politike ne Mal te Zi.

Kosovës ndaj sezonit të ardhshëm turistik në Mal të Zi, duke patur parasysh se një numër i konsiderueshëm turistësh në këtë vend vinin nga Kosova, Serbia e Shqipëria. Artikuj të tillë kaq afër jetës reale mungon në këto dy gazeta, veçanërisht ato që duhet të vinin prek komuniteteve multikulturore në Mal të Zi, duke iu referuar jetës së minoriteteve etnike.

Fakti që numri i më i vogël i artikujve (13%) u shkruan në Kosovë dëshmon sesa pak korrespondenca vijnë prej andej apo edhe pamjaftueshmërinë e informimit të publiku malazez mbi zhvillimet në rajon. Një shifër më e madhe e shkrimeve i përket Malit të Zi ndërkohë që shumica e tyre veprimi ndodh në një vend tjetër (64%) cak tregon sërish se diplomacia e nivelit të lartë ishte fusha ku u zhvillua shumica e ngjarjeve të situatës në Kosovë, të paktën sipas këtyre gazetave.

IV.KONKLUZIONE

Përgjatë dy muajve të parë mbulimi prej dy gazetave më të mëdha malazeze të situatës në Kosovë përgjatë ishte voluminoz megjithëse ky fakt nuk shërben si garanci për mangësitë e materialit. Sa i përket formës mbizotëruese të shkrimit gazetaresk, prania e pakëshillueshme e llojeve të tilla si deklaratat i përket dhe përqendrohet më së shumti tek gazeta Dan. Ato ishin mbulesa e jashtme e mangësisë së burimeve që cenuan larminë e informacionit që ofroi kjo gazetë.

Format më komplekse gazetareske si analizat ishin të rralla iu rezervuan krejtësisht burimeve e autorëve të huaj, çka nuk përbën një praktikë të mirë për t'i ofruar publikut kuptimin e plotë të situatës. Saktësia e informacionit u respektua nga të dy gazetat që deklaruan me saktësi burimet e tyre megjithëse të dhënat tregojnë se 2/3 e e informacionit për Kosovën në gazetën Vijesti ishte dhënë nga media e agjenci të tjera lajmesh. Ky fakt nuk duhet të na habisë duke patur parasysh madhësinë e tregut të medias malazeze dhe pamundësinë ekonomike për të mbajtur zyra të korrespondentëve të huaj. Kështu edhe i vetmi rast i mbulimit të drejtpërdrejtë nga Kosova përmes reporterëve të dërguar nga gazeta Vijesti duhet marrë si shembull i veçantë sesa si mangësi në raportim.

Karakteristikat formale të vërejtura gjatë studimit pasqyrojnë tiparet e rrethanave që paraqiten përmes shpejtësisë së ngjarjes, afërsisë së tyre e përmbajtjes mbizotëruese. 2/3 e artikujve ishin me raste pseudo-ngjarjesh dhe ngjarje të ndodhura në faza të ndryshme kohore si p.sh deklarata, njoftime për shtyp e shumica e tyre u zhvilluan jashtë Malit të Zi, kurse vetëm një numër i vogël i përkisnin Kosovës. Sipas mbulimit të medias malazeze zhvillimet rreth shpalljes së pavarësisë së Kosovës ishin kryesisht një betejë diplomatike sa kohë që lëvizjet diplomatike mbizotëronin tek përmbajtja e artikujve të analizuar. Për më tepër dallimet e mëdha në formë e përmbajtje treguan se media në Mal të Zi vazhdon të jetë ende e ndarë si në fillimet e viteve 90 në bazë të kundërshtive politike. Ndërkohë që gazeta Vijesti shfaqi

një qëndrim të ekuilibruar e jo të njëanshëm megjithëse të distancuar, gazeta Dan mbajti në mënyrë të hapur një qëndrim të njëanshëm që përfshinte opozitën pro-serbe.

Kjo qasje ofroi tituj e artikuj provokativ emocionalë e jo të ekuilibruar. Fakti që artikujt për Kosovën zunë vend në rubrikën e Lajmeve Nga Bota në Vijesti, ndërsa tek Dan u përfshinë tek politika e brendshme, krijuan imazhin e dy realiteteve në Mal të Zi. Megjithatë, siç tregoi analiza, qëndrimet e paraqitur në mënyrë të përsëritur të palëve politike mbi Kosovën janë shpesh vetëm një temë në luftën e përditshme për të fituar përkrahje politike drejt një qëllimi dhe rolet e tyre mund të shkëmbehen me lehtësi.

BIBLIOGRAFI

Center for Democracy and Human Rights, Political Public Opinion - February 2008, (2008) http://www.cedem.co.me/ (accessed May 1st, 2008)

Institut za medije Crne Gore, Medijsko vlasniљtvo i njegov uticaj na nazavisnost i pluralizam medija,. (2004)

International Exchange and Research Board, Media Sustainability Index 2008 (2008), http://www.irex.org/msi/index.asp/ (accessed May 10th, 2008)

Kovach, Bill and Rosenstiel, Tom, The Elements of Journalism, What Newspeople Should Know and the Public Should Expect, New York 2001. Three RiversPress, New York

Media and War, ed. Nena Skopljanac Brunner, Stjepan Gredelj, Alija Hodžić, Branimir Krištofić, Centre for transition and civil society research Zagreb, Agency Argument Belgrade, (2000)



RUMANIA

Tea Vasilescu



VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Studimi i këtushëm analizon mbulimin prej medias të krizë së Kosovës – një çështje e cila normalisht nuk duhej të ishte ndër titujt kryesorë të medias rumune. Megjithatë kur shfaqet një shtet i ri në hartën e Evropës, në zemër të Gadishullit Ballkanik, prioritetet editoriale ndryshojnë kështu që edhe gazeta përqendrohen në çështje të tilla e normalisht dërgojnë korrespondentët e tyre për të mbuluar ngjarjet.

Gazetat që kemi zgjedhur janë Evinementul Zilei dhe Journalul National –e para zakonisht ka një këndvështrim të gjerë mbi temat e politikës ndërkombëtare ndërkohë që ajo e dyta përqendrohet më shumë tek lajmet jo të forta. Në këtë mënyrë është thelbësore analiza cilësore për të theksuar se periudha që kemi marrë në shqyrtim janar – shkurt 2008 ndahet në 3 faza kryesore:

1. muaji para pavarësisë

2. dita e pavarësisë dhe ditët më pas

3. javët në vijim (artikujt që pasqyrojnë reagimin ndërkombëtar.

Gjithashtu duhet të vërejmë se çështja e Kosovës i mbulua më së shumti nga mediat rumune në periudhën që pasoi shpalljen e pavarësisë, në kontekstin e reagimeve vendase e ndërkombëtare.

Shumë artikuj iu kushtuan refuzimit të Rumanisë për të njohur shtetin e ri ashtu edhe Szekeky Lan- një rajon rumun i banuar nga minoriteti hungarez, i cili mund të ndiqte prirjen e Kosovës në pretendimet e tyre për të kërkuar autonomi.

I. KONTEKSTI POLITIK (QËNDRIMET E POLITIKËS VENDASE NË DREJTIM TË KOSOVËS)

Reagimi zyrtar i Rumanisë për pavarësinë e Kosovës u paraqit nga Presidenti Basesciu më 18 shkurt 2008: Rumania nuk do ta njohë pavarësinë e

Kosovës. Ky refuzimi erdhi në rrethanat e miqësisë së hershme mes Serbisë e Rumanisë e mund të konsiderohet një qëndrim i kujdesshëm sipas artikujve të shkruar në Evinimentul Ziele nga Oana Dobre. Terma e përdorur nga Presidenti Basecu e përforcojnë lidhjen: Rumania nuk është pajtohet me ndarjen e Kosovës nga Serbia. Basecu shtoi se pavarësia është shpallur në mënyrë të paligjshme pasi që Serbia nuk ishte dakord me të. Duke përjashtuar UDMR[1], partinë e minoritetit hungarez, të gjithë partitë e tjera apolitike vendosën unanimisht të kundërshtonin pavarësinë e Kosovës. Senatorët e deputetët rumunë e pasqyruan këtë prirje duke e kundërshtuar pavarësinë: 357 vota kundër dhe 27 pro. Disa editorialistë spekuluan me faktin se reagimi i UDMR vinte për shkak se hungarezët dëshironin një ndarje të ngjashme për Szekely Land.

II. KARAKTERISTIKAT E SISTEMIT TË MEDIAS - KONTEKSTI I MEDIAS

Sipas www.mediaindex.ro, një projekt i realizuar nga Qendra për Gazetari të Pavarur- Bukureshti, media në Rumani është e përqendruar në dhe rreth Bukureshtit (129 gazeta revista e stacione televizive) dhe qytetet kryesore Brasshov 9 27), Iasi, Konstancë, Kluzh etj. Numri i gazetave u rrit me shpejtësi pas viteve 90, por pas rënies së regjimit komunist. Ndërkohë edhe shumë të tjera kanë falimentuar gjatë kësaj periudhe e të tjera kanë dalë e riorganizuar. Ndërkohë një pjesë e tyre janë blerë nga trustet kryesore të medias që kanë interesa qoftë ekonomike apo politike. Media rumune është e përqendruar rreth gazetave të përditshme, atyre javore që mbulojnë 18.7% të tregut dhe duke lënë pas ato mujoret që zënë një përqindje të papërfillshme. Dy gazetat që kemi zgjedhur për këtë studim janë ndër botimet me tirazhin më të lartë në Rumani siç dëshmon edhe Zyra Rumune e Kontrollit të Tirazhit (wwww.brat.ro). Gazeta Evinementul Zilei është në pronësi të Ringier dhe shtet 66 957 kopje në ditë. Ajo konsiderohet një nga gazetat kryesore në vend që mbulon gjerësisht politikën e brendshme dhe atë të jashtme. E krijuar më 1990, ajo vlerësohet shumë nga publiku e konsiderohet si firmë e fortë në tregun mediatik rumun. Gazeta ka ecur nga media e tipit tabloid në një gazetë cilësore par se të blihej në 2004 nga Korporata Mediatike Zviceriane Ribgier. Njëherë e një kohë gazeta shumë popullore Evinementul Zilei u përball me një rënie të fortë të shitjeve që e detyroi pronarin e saj të ndryshonte më se njëherë ekipin e gazetarëve, menaxherin si edhe të kalonte (ndonjëherë) vijë e lehtë nga cilësia tek popullorja sa i përket mënyrës si qasej një storie. Aktualisht politika e saj editoriale konsiderohet si e afërt me atë të presidentit Basescu.

Jurnalul National është pjese e Intact Group- një trust mediatik në pronësi të një biznesmeni dhe ish-politikani rumun Dan Voiculescu, ish-president i Partisë Konservatore dhe kundërshtar i presidentit Basescu. Cilësia e linjës editoriale të gazetës shpesh mbështetet ose ndjek atë të partisë. Ak-

1 UDMR – Unioni Demokratik i Hungarezëve në Rumani

tualisht për zgjedhjet e vjeshtës 2008 kjo parti është në aleancë me social-demokratët. Intact Group përfshin gjithashtu shumë stacione TV, një radio e shumë botime; Jurnalul National shet 82 814 kopje në ditë. Ajo preferon ngjarje që përqendrohen më shumë në politikën e brendshme e mënyrën e të jetuarit. Faqja e lajmeve ndërkombëtare zakonisht është e mbushur përgjysmë me reklama ose përmban lajme të lehta të tipit tabloid.

Gjatë periudhës tonë të monitorimit gazeta Evinementul Zilei botoi 51 artikuj që lidheshin apo flisnin rreth Kosovës (6 në janar dhe 45 në shkurt), ndërsa gazeta e dytë Jurnalul National botoi vetëm 18 (1 në janar dhe 17 në shkurt).

III. ANALIZA E REZULTATEVE TË STUDIMIT

Para shpalljes së pavarësisë

Në janar dhe në fillim të shkurtit, të dyja gazetat mbuluan zgjedhjet presidenciale në Serbi si edhe lajme të thera të lidhura me Kosovën duke përshirë edhe vendimin e BE për të dërguar një mision sigurie atje pas shpalljes së pavarësisë.

Zgjedhjet në Serbi u trajtuan në mënyrë të zgjeruar e me shumë detaje rreth kandidatëve e lidhjeve të tyre ndërkombëtare. Disa prej artikujve theksonin se e vetmja dëshirë e përbashkët e të dy kandidatëve serbë ishte që të ndalonin pavarësinë e Kosovës. Nga ana tjetër, disa artikuj nënvizonin deklaratën e kryeministrit të Kosovës Hashim Thaçi që besonte se zgjedhjet në Serbi nuk do të kishin asnjë ndikim në vendimin për ta bërë Kosovën të pavarur.

Burime të paidentifikuara deklaronin se pavarësia e Kosovës lidhej me zgjedhjet serbe vetëm sa i përket datës: nëse fitonte Nikoliq, Deklarata e Pavarësisë do të bëhej me 9 ose 10 shkurt. Nëse fitonte Tadiqi ajo do të shtyhej për 18 shkurt 2008, pas takimit të MPJ të BE. Ndërkohë historive lidhur me këtë ngjarje iu shtua edhe një këndvështrim i shkurtër lidhur me reagimet e mundshme të vendeve të tjera: SHBA-BE ishin deklaruar pro –shkëputjes ndërsa Rusia ishte kundër. Vendet e BE që kishin probleme etnike do të përmbaheshin nga çdo deklaratë. Vëmendja kryesore ishte mbi opinionin e BE: Zyrtarët e tyre deklaronin se liderët në Prishtinë do ta shpallnin pavarësinë rreth muajit shkurt, ndërsa trupat e tyre do të dërgoheshin në Kosovë për të mbështetur rrugën e këtij rajoni drejt pavarësisë.

Reagimi i Rumanisë ndaj pavarësisë së mundshme të Kosovës nuk përbënte ndonjë temë me interes të madh për median rumune. Ne identifikuam vetëm një artikull që pasqyronte deklaratën e ministrit të punëve të jashtme të Rumanisë që pohonte se "Rumania ishte tërësisht kundër një shpallje të mundshme të pavarësisë së Kosovës për shkak të rrezikut të krijimit të një precedenti të mundshëm".

Para dhe gjatë ditës së shpalljes së Pavarësisë

Pas zgjedhjeve në Serbi, gazetat dërguan gazetarë në Prishtinë për të mbuluar zhvillimet. Artikujt e parë të shkruar prej raporteve në Kosovë u botuan në 6 shkurt.

Duke filluar nga kjo datë, gazeta Evinemtul Zilei zgjodhi të bëjë një këndvështrim të gjerë mbi ngjarjen: lajmet rreth trazirave dhe deklaratave politike tregonte sesi kriza prekte jetët e njerëzve të zakonshëm, apo edhe një intervistë me presidentin e Kosovës Fatmir Sejdiu. Reporteri e fotografët e gazetës shkuan në Kosovë për 4 ditë por ndenjën 1 muaj - kjo tregon se gazeta ishte mjaft e interesuar për temën që do të paraqiste në lajme.

Reporteri Jurnalul National u përqendrua vetëm tek lajmet e zgjeruara dhe korrespondencat për shkak të politikës editoriale të gazetës. Në të ishin të pranishme lajme të shkurtra që nuk kishin në fund emër autori ashtu si edhe pak editoriale mbi reagimet e politikanëve rumunë.

Lloji gazetaresk



Grafiku 1- Llojet gazetareske tw artikujve

Të dyja gazetat mbuluan reagimet zyrtare në Kosovë, por vetëm Evinementul Zilei shikonte më në brendësi të jetës së përditshme në Kosovë qoftë për shqiptarët ashtu edhe për serbët. Titulli i një artikulli ishte "Njerëzit e Kosovës me varfërinë e tyre, politikanët me pavarësinë", vërente se vendi ishte aq i varfër saqë mbijetesa e përditshme ishte shpesh më e rëndësishme se

strategjitë politike. Gazetari i Evinementul Zilei shkroi të dhëna me hollësi rreth jetës në geto serbe dhe mënyrës sesi shqiptarët e përqafuan pavarësinë e re. Reporterët shkuan në komunitetet e ndryshme të Kosovës me qëllim që të kapnin reagimet e tyre e për të mbuluar më pas trazirat që pasuan.

Një sërë artikujsh u shkruan rreth festimeve apo protestave në Beograd dhe në qytetet evropianë ku kishte komunitete të mëdha me serbë e shqiptarë: Gjenevë, Lozanë, Bruksel dhe Paris. Disa prej reagimeve të dhunshme u trajtuan me lajme të zgjeruara, por shumica e tyre thjesht sa u përmendën.

Reagimet ndërkombëtare

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, gazeta u përqendruan mbi reagimet e zyrtarëve vendorë të vendeve të tjera. Një analizë e hollësishme u shkrua pre tyre kur SHBA njohën shtetin e ri, i cili pasohej prej lajmeve të shkurtra rreth efektit bumerang kur edhe shtetet e filluan ta njohin Kosovën njëra pas tjetrës. Kryeministri i Kosovës përmendi në një fjalim se ai priste që 100 shtete në botë ta pranonin statusin e ri të Kosovës. Rusia nuk e njohu shtetin e ri dhe përgëzoi Rumaninë që kishte bërë diçka të tillë. (Lajmet në 21 shkurt 2008, artikulli fundit mbi këtë temë nga Evinementul Zielei). Menjëherë pas ditës së pavarësisë filluan të shfaqen lajmet rreth rajoneve separatiste si Transdnistria, Qiproja Veriore apo Osetia e Jugut; deklaratat e udhëheqësve të tyre u paraqitën në lajme dhe lajme të zgjeruara. Ata këmbëngulnin se pavarësia e Kosovës është një precedent që do të funksiononte edhe për ato raste. Në një intervistë në Evinementul Zilei më 20 shkurt 2008, Presidenti i Kosovës Fatmir Sejdiu deklaronte se situatat në Kosovë ishte unike dhe kjo lloj strategjie e pavarësisë nuk ishte e përshtatshme për rajone të tjera që donin pavarësi.

Reagimi i Serbisë ishte më i frikësuar. Reagimi i saj zyrtar ishte që të anulonte pavarësinë që në rrënjët e saj edhe para 17 shkurtit. Ky ishte vetëm një akt simbolik pasi Serbia nuk mund të përdorte dhunën për të ripushtuar territorin e saj.

REAGIMET NË RUMANI

Në Rumani gazetat vëzhgonin nga afër dy lloj reagimesh: deklaratën zyrtare të Parlamentit Rumun dhe reagimin e Marko Bela, liderin e partisë së minoritetit hungarez në Rumani. Siç raportonin edhe dy gazetat, politikanët rumunë e kishin theksuar se vazhdonin të të vinin sërish në pah se nuk kishte asnjë ngjashmëri mes situatës së shqiptarëve të Kosovës dhe minoriteteve hungareze të Covasna dhe Harghita. Siç pritej, presidenti Basescu deklaroi se Bukureshti mbante të njëjtin qëndrim sa i përket mungesës së rregullit ndërkombëtar që do ta lejonte Rumaninë ta njihte shtetin e ri. Sipas Basescut, Rumani do ta hiqte misionin e saj diplomatik nga Prishtina. Ndërkohë xhandarët rumunë që janë pjesë e misionit të OKB-së do të qëndronin atje ku po merrnin pjesë me operacionet paqeruajtëse.

Më 18 shkurt 2008, liderët e të gjitha partive parlamentare u ftuan në pallatin presidencial për tu njohur me qëndrimin e Rumanisë lidhur me Kosovën. Në një deklaratë për shtyp pas takimit, Presidenti Basescu mohoi mundësinë që Kosova mund të ishte precedent për Rumaninë pasi këtij skenari i mungonte baza. Sipas deklaratës Rumania nuk mund ta njihte Kosovën pasi kjo do të nënkuptonte shkelje të atyre pak parimeve të rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare; integriteti territorial, mosndryshimi i kufijve dhe sovraniteti i Serbisë. Nga ana tjetër deklarata e paraqiste situatën e shkeljes dhe abuzimit të të drejtave që kishte pësuar minoriteti shqiptar të pangjashme e Rumaninë ku minoritetet gëzonin të gjithë të të drejtat në të gjithë nivelet.

Pak ditë pas takimit në pallatin presidencial, zëdhënësi i presidentit deklaroi se ky nuk ishte një vendim përfundimtar dhe njohja zyrtare e Kosovës mund të shihej nëse ndryshonin prioritetet diplomatike të Rumanisë. Pavarësisht grindjeve serioze në vitet e fundit, mes presidentit dhe kryeministrit liberal Calin Popescu Tariceann, të dy ranë dakord që Rumania ta merrte situatën me qetësi e përgjegjësi. Ndërkohë partia e ekstremit të djathtë PRMC (Partia e Rumanisë së Madhe) i kërkoi kryeministrit të largojë nga qeveria organizatën ilegale, separatiste UDMR (Partia e minoritetiet hungarez) duke e quajtur atë si nxitëse të ndarjes territoriale duke kërkuar të përdorë Kosovën si shembull.

Nga ana tjetër lideri i UDMR, Marko Bela i kërkoi qeverisë rumune që të njihte shtetin e vetë-shpallur të Kosovës por kurrë nuk mori një përgjigje zyrtare për këtë problem. Në vend të saj shumë politikanë rumunë pretendonin se partia e minoritetit hungarez dëshironte një ndarje të ngjashme të dy lokaliteteve të saj në Transilvani të banuara kryesisht nga hungareze, pra të krijonin të ashtuquajturën Szekeky Land.

Situata u qetësua pas dy ditësh kur analistët politikë e bënë të qartë se një ndarje sipas modelit të Kosovës nuk ishte e mundur brenda ligjeve të BE. P.sh Partia Konservatore që ishte e vogël por me ndikim deklaroi se "pavarësia e Kosovës përbënte një precedent të rrezikshëm. Partia risillte në vëmendje marrëdhëniet e mira me Serbinë dhe se Rumania qe përfshirë në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në rajon". Mbi këtë temë u shkruan shumë artikuj nga gazetat rumune.

Veçanërisht tek gazeta Jurnalul National editorialet theksonin se temat e ndryshme si ato të Kosovës apo reagimet e partisë së minoritetit hungarez po përdoreshin si arsye për të rigjallëruar sulmet e betejat politike. Ato këmbëngulnin se Kosova nuk është një precedent për të dy lokalitetet në Transilvani ashtu sikurse do t'i pëlqente ndokujt të kishte ngjashmëri në Rumani. Mesazhi më i rëndësishëm që duhej të dëgjonin politikanët nga kjo krizë ndërkombëtare ishte se minoritetet duhet të trajtohen mirë në mënyrë që të shmangen konfliktet. Kështu disa përfaqësues të UDMR e mbështetës të Kosovës u mblodhën në Kluzh (qytet rumun në Transilvani me ku ka shumë

pjesëtarë të minoritetit hungarez) dhe këmbëngulnin për më shumë autonomi për minoritetet. Në ditët e fundit, gazeta Evinemtul Zilei shkroi dy artikuj, një paralele origjinale se çfarë mendonin qytetarët e Rumanisë dhe të Kosovës për njëri-tjetrin. Në Kosovë, shqiptarët nuk janë të mërzitur që rumunët nuk kanë njohur pavarësinë, ndërsa serbët na konsiderojnë miq të mirë. Nga ana tjetër rumunët ndahen në dy kategori: në zonat urbane veçanërisht në qytet e mëdha njerëzit janë të interesuar për situatën në Kosovë por nuk janë të shqetësuar se kjo mund të përbëjë precedent për vendin e tyre; rumunët në zonat rurale besojnë se politikanët duhet të interesohen më shumë për problemet kombëtare. Është me rëndësi të shohim disa aspekte lidhur me artikujt të tillë si ilustrimet dhe autorët e tekstit.

Siç tregohet në grafikun e mëposhtëm (2), fotografitë ishin më të përditshme si imazhe përgjatë ilustrimit të teksteve. Hartat ose skicat u përdorën pak e kryesisht për të treguar vendndodhjen gjeografike të rajonit- për t'i ndihmuar rumunët të kuptonin sa afër ishte Kosova me vendin e tyre. Imazhet zakonisht përputhen me artikujt e shkruar. Fotoja më goditëse ishte njëra që tregonte varfërinë në Kosovë, dhe tjetra që portretizonte reagimet e dhunshme në Serbi: godinat e sulmuara e turmat e egërsuara.

Shumica e artikujve në fund mbanin emrin e gazetarit, siç shihet në grafikun tjetër të mëposhtëm (3) çka dëshmon se gazetat i dërguan gazetarët në Kosovë që të mbledhin informacionin e tyre. Kjo është shenjë përgjegjësie që u jep gazetave besueshmëri, veçanërisht pasi që analiza dhe tiparet janë shume të individualizuar për një sërë detajesh.



Grafiku 2: Ilustrimet që u përdorën në artikuj



Grafiku 3: Autorët e artikujve

IV. KONKLUZIONET

Si përfundim, artikujt e gazetave u përshtatën me politikën e tyre editoriale. Gazeta e përditshme Evinemnetul Zilel që përqendrohej tek politika vendase e ajo ndërkombëtare kishte një qasje më të detajuar ndaj ngjarjes në Kosovë duke përziere lajmet me analizat rreth jetës së përditshme në atë vend. Editorialet e tyre u shkruan më së shumti në 17 shkurt 2008 dhe u përqendruan mbi rrjedhojat e menjëhershme të pavarësisë ashtu si edhe mbi ndikimet e saj në politikën rumune. Ndërkohë u shkruan edhe 3 artikuj historikë ; njëri mbi historinë e hershme (origjinën e Serbisë) dhe dy të tjerë mbi Jugosllavinë dhe regjimin e Titos.

Gazeta Jurnalul u përqendrua kryesisht tek politika e brendshme dhe në llojin e reportazhit kështu që nuk pritej që prej tyre të hynin në detaje të shumta. Ata dërguan një reporter në Prishtinë në periudhën e Ditës së Pavarësisë por versioni i shtypur i gazetës botoi vetëm lajme të shkurtër dhe raportime (versioni on-line ofroi më shumë detaje: megjithatë ato nuk mund të krahasohen me ato që u botuan tek Evinementul Zilei). Gazetarët nuk shkruan artikuj të gjatë rreth popullsisë në Kosovë por vetëm rastësish prekën çështje të tilla si varfëria. Analiza vëren se të dy gazetat i mbuluan gjerësisht zgjedhjet në Serbi dhe lajmet që lidheshin me Kosovën. Shumica e artikujve merreshin me ngjarje që zhvilloheshin në një vend tjetër, kryesisht në Serbi apo mbulonin reagimet ndërkombëtare duke arritur në përfundimin se Kosova si çështje në këtë periudhë pati një vëmendje të dorës

së dytë. Vendi kryesor më me interes ishte Serbia çka vërteton miqësinë mes rumunëve e serbëve. Të dyja gazetat luftuan të sjellin më afër lexuesit mesatar rumun histori që nuk ishin të afërta për ata, ndërkohë që fjalimet zyrtare luhateshin që nga reagimet e alarmuara deri tek thirrjet për qetësi. Debatet për Kosovën zgjatën për pak javë ndërkohë që liderët politikë u morën me ndikimet e saj për shoqërinë. Megjithëse presidenti e kryeministri rumun deklaronin se qëndrimi zyrtar sa i përket Kosovës nuk do të ndryshojë, të dy kanë lënë të kuptohet se në kushte të caktuar (një rezolutë e OKB-së apo nëse ndonjë ligj tjetër ndërkombëtar e lejonte këtë) Rumania do ta tjetërsonte qëndrimin e saj në përputhje me ato të partnerëve brenda BE dhe NATO.

BIBLIOGRAFIA

www.mediaindex.ro

www.brat.ro



SERBIA

Dubravka Valiq - Nedeljkoviq



VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Ky studim përcakton kuadrin social e politik të raportimit të medias serbe mbi Kosovën në fillim të vitit 2008. Për me tepër ai ndalet në praktikën informuese të gazetës së përditshme më të madhe në një gjuhë minoritare, e cila botohet në Vojvodinë si edhe atë të së përditshmes më popullore në Serbi. së fundmi studimi përmban rezultatet e monitorimit të 137 shkrimeve të botuara në Magyar Szo dhe 381 të botuar në gazetën Blic të botuar janar-shkurt 2008, duke u përqëndruar tek përmbajtja e tyre që lidhet me Kosovën.

Fjalët kyçe: interes publik, media e shkruar, gjuhë hungareze, gjuhë serbe, Magyar Szo, Blic, pseudo-ngjarje, përmbajtje nga jeta reale, mesazhi, nënteksti, multikulturalizëm.

I. KONTEKSTI POLITIK (QËNDRIMET E POLITIKËS VENDASE NË DREJTIM TË KOSOVËS)

> "Ku fillojnë të drejtat njerëzore para së gjithash? Në vendet e vogla, afër shtëpisë… Të tilla janë vendet ku çdo burrë, grua dhe fëmijë kërkon drejtësi të barabartë, mundësi të barabartë, të drejta të barabarta" (Eleanor Roosvelt)

Mesazhi i Eleanor Roosvelt është mëse i përmbledhur dhe një përcaktim i qartë i interesit publik për çdo media që funksionon në komunitetet multikulturor e veçanërisht tek ato që mbartin barrën e konflikteve dhe dhunimin e të drejtave të njeriut. Ky mesazh përkufizon skemën e përcjelljes së lajmit dhe boshtin e raportimit të medias së shkruar e elektronike në çdo zonë konflikti qofshin dëgjuesit e lexuesit e tyre të huaj apo vendas.

Mund të arrimë në përfundimin se gazetarët që raportojnë sot nga zonat e konfliktit zakonisht e informojnë publikun se çfarë tha dikush rreth ngjar-

jeve që ndodhën sesa rreth atyre ngjarjeve të përditshme në zonat e konfliktit. Për më tepër ata raportojnë rreth marrëdhënieve mes njerëzve që u përkasin nacionaliteteve, grupeve gjuhësore apo komuniteteve fetare të ndryshme si edhe rreth marrëdhënieve mes qeverisë dhe individit etnik, komuniteteve fetare dhe të afërmve të tyre. Me pak fjalë, gazetarët raportojnë rreth marrëdhënieve mes të gjithë aktorëve – nuk ka rëndësi nëse ata kanë pushtet të veçantë, të padukshëm apo s'kanë fare të tillë që mund të ndikojnë në praktikën e përditshme politike. Për dekada, Kosova ka qenë në qendër të politikës e si rrjedhojë edhe të informacionit të Ballkanit Perëndimor. Mosmarrëveshjet për statusin e Kosovës në 1989 ishin pikënisja e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë më tej. Sipas analistëve politikë, deklarata e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 shënoi fundin e shpërbërjes së plotë t federatës jugosllave.

Konteksti politik e social i Kosovës mund të paraqitet në mënyrë kronologjike si më poshtë [1]

1989: I hiqet autonomia Kosovës në bazë të amendamenteve që u bënë në Kushtetutën e Serbisë, duke e sjellë provincën në kontrollin e drejtpërdrejtë të Beogradit. Sllobodan Millosheviq u zgjodh president i Serbisë

1990: Mijëra shqiptarë nga Kosova marrin pjesë në protesta. Beogradi forcon praninë e ushtrisë jugosllave e të policisë serbe në Kosovë. Vendoset gjendja e jashtëzakonshme.

Korrik: Liderët shqiptarë të Kosovës deklarojnë pavarësinë. Serbia shpërndan parlamentin e provincës së Kosovës.

Që nga shtatori 1990 mbi 100 000 shqiptarë në Kosovë të punësuar në ndërmarrjet shtetërore dëbohen nga puna, Institucionet arsimore e kulturore në gjuhën shqipe pezullohen për tu vendosur në 1994.

1991: Shqipëria njeh pavarësinë e Kosovës

Prill 1992: Pas shkëputjes së Bosnjës, Sllovenisë, Kroacisë e Maqedonisë, Serbia e Mali i Zi krijojnë Republikën Federale të Jugosllavisë. Shqiptarët e Kosovës realizojnë një referendum që nuk njihet nga Beogradi. Shkrimtari Ibrahim Rugova, një mbështetës i "rezistencës paqësore" zgjidhet president i Republikës së vetshpallur të Kosovës, dhe krijohet një parlament lokal.

1995: Një gjykatë serbe dënon 68 shqiptarë të Kosovës deri 8 vjet burg për ngritjen e një policie paralele.

Gusht: Një lëvizje e autoriteteve serbe për të vendosur qindra refugjatë serbë nga Kroacia në Kosovë ngjall protesta.

1996: një grup separatist rebel i quajtur UÇK (Ushtria Çlirimtare e Kosovës) del për herë të parë në skenë duke marrë përgjegjësinë për disa sulme kundër policisë.

1 www.balkantimes.org

1997: UÇK kryen një sërë sulmesh mbi liderët serbë, policët dhe shqiptarët e Kosovës që bashkëpunojnë e ta. Serbët etnikë dëbohen nga fshatrat e përziera.

Tetor: Demonstrata e studentëve shqiptarë të Kosovës shtypet nga policia serbe duke nxitur sulme të reja të UÇK.

1998 shkurt–mars: Serbia fillon mësymjen kryesore në Kosovë. Qindra njerëz vriten dhe qindra mijë civilë kryesisht shqiptarë të Kosovës detyrohen të lënë shtëpitë e tyre.

Prill: 95% e serbëve votojnë në një referendum kundër ndërmjetësimit ndërkombëtar për Kosovën.

Maj: Millosheviqi e Rugova mbajnë për herë të parë bisedime. Në Deçan vriten disa qindra shqiptarë, pala shqiptare tërhiqet nga bisedimet.

Shtator: 22 shqiptarë të Kosovës u gjendën të masakruar në Kosovën qendrore pas sulmeve serbe në rajon. KS i OKB miraton një rezolutë që bën thirrje për armë-pushim në Kosovë e paralajmërohen autoritetet e Beogradit se do të përballen me "masa shtesë" nëse ata dështojnë t'i përmbushin ato.

Tetor: Duke e përballuar me kërcënimin e NATO-s për sulme ajrore ndaj objektivave ushtarake serbe dhe pas një marrëveshje të ndërmjetësuar nga i dërguari i SHBA Riçard Hollbruk, Millosheviqi bie dakord që të tërheqë trupat e të lejojë 2000 monitorues të OSBE-së në Kosovë.

Dhjetor: 36 luftëtarë të UÇK vriten nga forcat serbe në betejë të ashpër që nga armëpushimi. 6 serbë vriten në një kafe duke nxitur protestat e serbëve. Luftimet e fundit në veri lënë 15 të vdekur

1999 janar: Zbulohen në Reçak trupat e 45 shqiptarëve të vrarë.

Shkurt- mars: Mbahen në Rambuje bisedimet e paqes mes palëve në konflikt me ndërmjetësimin e faktorit ndërkombëtar. Bisedimet u ndërprenë ne 19 mars pasi përfaqësuesit serbë kundërshtojnë marrëveshjen. Marrëveshja firmoset vetëm nga pala shqiptare.

20 mars: Monitoruesit ndërkombëtare të paqes largohen nga Kosova, duke përmendur sigurinë për një sulm të mundshëm ajror të NATO-s.

24 mars: NATO fillon fushatën ajrore kundër Jugosllavisë.

10 qershor: Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s deklaron ndërprerjen e sulmeve ajrore. KS i OKB kalon rezolutën 1244 që parasheh pranimin prej Jugosllavisë të një marrëveshje politike duke përfshirë tërheqjen e trupave. Duke e vendosur Kosovën nën administrimin e OKB-së, Rezoluta autorizon krijimin e UNMIK-ut dhe vendosjen e forcës paqeruajtëse te NATO-s KFOR

Nëntor 2001: Kosova mban zgjedhjet e para demokratike ku fiton LDK e Rugovës.

Shtator 2002: Rugova zgjidhet President, Bajram Rexhepi kryeministër.

14 tetor 2003: Liderët kosovarë e serbë ulen për herë të parë ballë për ballë pas konfliktit.

Dhjetor: OKB përcakton një sërë standartesh që Kosova duhet të përmbushë para se të fillojnë bisedimet për zgjidhjen e statusit e që shpallet për vitin 2005

Mars 2004: 3 ditë përleshje etnike – më të këqijat që nga konflikti i 1999. Në të mbetën të vrarë 19 persona e u dogjën shumë shtëpi e objekte fetare.

Tetor: LDK fiton zgjedhjet dhe rizgjedhet President ndërsa kryeministër ish-luftëtari i UÇK, Ramush Haradinaj.

Mars 2005: Haradinaj dorëhiqet për t'u paraqitur në Hagë ku e akuzojnë për krime lufte. E zëvendëson Bajram Kosumi.

21 janar 2006: Vdes presidenti Ibrahim Rugova, e zëvendëson Fatmir Sejdiu.

3 prill: KS i OKB fillon të diskutojë për planin Ahtisari

20 korrik: Një projekt rezolutë e OKB-mbështet planin Ahtisari por e kundërshton Rusia

10 gusht: Treshi i ndërmjetësuesve (SHBA, Rusi, BE) shpall raund të ri negociatash.

29 nëntor: Bisedimet përfundojnë pa sukses

16 janar 2008: Mblidhet KS i OKB por sërish mbetet i ndarë.

28 janar 2008: MPJ të BE diskutojnë për situatën

17 shkurt 2008: Parlamenti i Kosovës voton për të shpallur pavarësinë nga Serbia. Kosova njihet si shtet nga SHBA, BE e disa vende të tjera.

Në një sesion urgjent të dielën Parlamenti i Kosovës më 17 shkurt shpalli deklaratën e pavarësisë nga Serbia. Ne liderët e institucioneve të Kosovës e deklarojmë Kosovën një vend të lirë e të pavarur e do të punojmë sipas Planit Ahtisari. "Ne shprehim e vullnetin e institucioneve dhe angazhimin tonë për të mbrojtur e nxitur të drejtat e të gjithë komuniteteve në Kosovë e pjesëmarrjen e tyre në vendim-marrje" -kështu deklarohet në dokumentin që u lexua aty nga zoti Hashim Thaçi, kryeministër. Ai deklaronte se "Ne nuk heqim dorë nga Plani Ahtisari e do të përmbushim të gjitha detyrimet që rrjedhin prej tij, veçanërisht Aneksin R e atë që merret me të drejtat e komuniteteve etnike. Deklarata mirëpret misionin e BE në Kosovë dhe deklaron mes të tjera: "Kosova do të vazhdojë të punojë për procesin e pajtimit etnik, do të punojë për marrëdhënie të mira me fqinjët e veçanërisht me Serbinë".

Deklarata e pavarësisë nxiti demonstrimet në rrugë dhe tek qytetet përreth Serbisë. Kryeministri serb Koshtunica foli në TV kombëtar menjëherë pas kësaj deklaratës e votës në Prishtinë. Ai u bëri thirrje qytetarëve serbë "të qëndrojnë së bashku e t'i tregojnë të gjithë botës se nuk do të njohin krijimin e një shteti të rremë në territorin tonë". Serbia kërcënoi të ndërpresë marrëdhëniet me të gjitha vendet që mund të njihnin Kosovën duke i kërcënuar edhe me pasoja ekonomike vendet që do ta ndërmerrnin një hap të tillë. Në mëngjesin e 18 shkurtit 2008, NATO dhe BE u bënë thirrje palëve të ruanin qetësinë. Festimet në Prishtinë filluan që me datë 16 shkurt 2008 ku njerëzit zbritën në rrugë duke kënduar, kërcyer e valëvitur flamuj shqiptarë nëpër rrugë. Ndërkohë në Beograd qindra protestues nacionalistë marshuan kundër pavarësisë. Rreth 1000 vetë u mblodhën për të protestuar rreth ambasadës serbe në Slloveni, vend që mbante presidencën e radhës së BE. Koshtunica tha se Serbia mund të jetë në BE vetëm me Kosovën si pjesë përbërëse të saj. Për çfarëdo bisedimesh të ardhme për anëtarësimin e Serbisë në BE, kjo e fundit duhet të përcaktonte qartë territorin serb. Rusia e Kina që kishin veton si anëtarë të KS shprehën shqetësimin e tyre mbi vendimin e njëanshëm të Kosovës. Rusia mbetet kundërshtarja më e fortë e pavarësisë së Kosovës në arenën ndërkombëtare. Ajo kërkoi mbledhje urgjentë të KS të OKB më 18 shkurt 2008 në mënyrë që ajo të anulonte vendimin e organeve vetëqeverisëse të Kosovës. Ndërkohë shprehu "shqetësime serioze" për situatën në Kosovë dhe gjykonte Tajvanin se përse kishte njohur pavarësinë e Kosovës. Në një intervistë të dhënë për Agjencinë Austriake të Lajmeve –ADP, kryeministri i Shqipërisë Sali Berisha mohoi faktin se Shqipëria kishte ndonjë dëshirë t'i bashkohej Kosovës. Që prej shpalljes së pavarësisë, Kosova është njohur nga një sërë shtetesh, por jo me ritmin e duhur.

Media serbe mbuloi nga afër e në mënyrë të plotë ngjarjet mbi Kosovën dhe komunitetin ndërkombëtar. Megjithatë kjo nuk nënkupton që dëgjuesit apo lexuesit u informuan në mënyrën e duhur.

II. METODA, KORPUSI

Metoda bazë që është përdorur në këtë studim është ajo krahasimtare, e karakterit sasior e cilësor, lidhur me përmbajtjen e shkrimeve mbi Kosovën të botuara tek gazeta e përditshme në gjuhën hungareze Magyar Szo dhe ajo në gjuhën serbe Blic.

Analiza e përmbajtjes është e përqendruar tek elementët e shumtë të mënyrës së përfaqësimit të ngjarjeve në Kosovë në dy gazetat e sipërpërmendur. Gazetat që janë marrë në shqyrtim për këtë analizë botohen në gjuhën e shumicës së popullsisë serbe dhe të minoritetit hungarez që është më i madhi në këtë vend dhe më i organizuari politikisht. Për sa i takon temave e subjekteve mbi të cilat kanë raportuar këto media, vëmendja jonë është përqendruar në strukturën e përmbajtjes. Së fundmi, në qendër të këndvështrimit tonë mbetet edhe krijimi i nivelit të pavarësisë së medias

lidhur me iniciativën e raportimit si p.sh përcaktimi i disa temave si më me rëndësi për publikun. Korpusi (tërësia e materialeve të shqyrtuara) përfshin të gjitha shkrimet mbi Kosovën të botuara në këto dy gazeta në periudhën janar – shkurt 2008.

1)Magyar Szo- gazeta e vetme e përditshme në gjuhën e minoritetit hungarez në Serbi. Numri total i shkrimeve të botuara në këtë gazetë për Kosovën është 138 (45 në janar dhe 93 në shkurt). Magyar Szo u krijua nga Këshilli Kombëtar Hungarez. Duhet të theksojmë se në 29 qershor 2004, Asambleja e Vojvodinës i bëri me dije Këshillit Kombëtar të Minoritetit, se kanë marrë të drejtat e pronësisë dhe menaxhimit mbi shtëpinë botuese të gazetës në gjuhën e minoritetit. Magyar Szo botohet që prej 65 vjetësh dhe financohet nga Këshilli Ekzekutiv i Asamblesë Parlamentare të Vojvodinës-Sekretari për Informacionin. [2]

2) Prej disa vitesh gazeta Blic ka qenë e përditshmja më e shitur në Serbi. Numri total i shkrimeve të botuara mbi Kosovën në këtë gazetë është 381 (137 në janar dhe 254 në shkurt) Gazeta është në pronësi të korporatës zvicerane Ringer. Blic botohet prej 12 vjetësh dhe ishte gazeta e parë e përditshme e krijuar prej një korporate të huaj në Serbi[3]

Njësia e analizës ishte një shkrim më vete i këtyre gazetave, duke përfshirë përmbajtjen e plotë të tij që nga titulli kryesor e deri tek emri i autorit si edhe mënyrën e vendosjes së tij në faqen e gazetës, si edhe ilustrimet e përdorur si fotografitë, skicat etj.

2 NSSJ dëshiron të falënderojë Csilla Csoke dhe Norbert Sinkovics për kodimin e ekzemplarëve të gazetës Magyar Szo

3 NSSJ dëshiron të falënderojë Zharko Bogosavljevic për kodimin e ekzemplarëve të gazetës Blic

III. ANALIZA E REZULTATEVE TË STUDIMIT

Rezultatet e analizës paraqiten si krahasim mes kategorive. Kjo është bërë me qëllim, në mënyrë që të hynim në brendësi të mbulimit të situatës në Kosovë prej medias së minoritetit, duke marrë parasysh se minoritetet janë pjesë përbërëse e Serbisë, por në këtë rast nuk preket nga ana kulturore afërsia e tyre me Kosovën.

Nga ana tjetër popullsia me shumicë serbe është e lidhur me Kosovën me një mënyrë më të veçantë e më të kushtëzuar kulturalisht. Miti i Kosovës si "djepi i kulturës serbe", shtetit serb, fesë ortodokse dhe luftës për pavarësi, kanë qenë mjaft domethënëse e kujtesës serbe përgjatë historisë, pavarësisht se çfarë ka ndodhur në Kosovë mijëvjeçarin e mëparshëm.

b) Rezultatet e analizës

3.2 Paraqitja e shkrimit në faqe të parë



Grafiku 1:.2 Paraqitja e shkrimit në faqe të parë

Përkundër asaj që pritej, informacioni për Kosovën në periudhën para shpalljes së pavarësisë nuk u botua në faqen e parë të dy gazetave të monitoruara e kjo edhe për shkak të politikës së tyre editoriale. Kjo përbënte 81.6% të shkrimeve tek Magyar Szo dhe 91.86% në gazetën Blic. Përjashtim bënte vetëm një pjesë e informacionit por që nuk mund të konsiderohet me rëndësi për të të gjithë situatën në Kosovë. Ai është informacion i

botuar si lajm kryesor në gazetën Blic gjatë kohës së përgatitjes së festimeve për shpalljen e pavarësisë- ai lidhej me qëndrimin e aktorëve të Hollivudit George's Clooney dhe Sharon Stone mbi pavarësinë e Kosovës.

Mesazhi që përcillet për publikun në këtë periudhë, përmes shkrimeve të këtyre gazetave, është se zgjedhjet presidenciale në Serbi gjatë muajit janar janë një informacion shumë më i rëndësishëm se statusi i Kosovës pavarësisht faktit se dy kandidatët presidencialë serbë e kishin cilësi Kosovën në fushatën e tyre elektorale si çështjen kryesore të politikës së tyre të ardhshme.

3.2.2 Lloji i shkrimit



Grafiku 2: Lloji i shkrimit

Llojet e shkrimeve të përdorura mund të ndahen në dy grupe: a) jo-gazetareske b) gazetareske. Duhet të theksojmë se llojet jo-gazetareske përfaqësojnë shembujt më karakteristikë.

a) Kodi i monitorimit përcakton 6 lloje shkrimesh jo-gazetareske: deklaratat, sondazhet e publikut, karikatura, vizatimet dhe letrat e lexuesit. Deklarata është lloji jo-gazetaresk më i përdorur nga në të dy gazetat e monitoruara nga ana jonë – në gazetën Blic ato përbëjnë 39.11% të shkrimeve ndërsa tek Magyar Szo 13.4%. Në këtë mënyrë mund të arrimë në përfundimin se gazeta Blic i ka informuar lexuesit e saj se çfarë mendojnë rreth statusit të Kosovës aktorët e politikës së përditshme në vend e jashtë saj e jo se çfarë ka ndodhur realisht në Kosovë.

b) Kodi i monitorimit përcakto 10 lloje shkrimesh gazetareske –lajmet, lajmet e zgjeruara, korrespondencat, raportimet, intervistat, shënimin, komentin, analizën, shkrimet me autor, editorialin, foto-lajmin dhe/ose mbulimin e një ngjarje me foto.

Në shembujt e marrë në shqyrtim vërejmë se të dy gazetat e sipërpërmendura kanë përdorur llojet e mëposhtme: lajme, lajme të zgjeruara, korrespondenca/raportime, intervista, analiza, komente dhe foto –lajme. Megjithatë jot ë gjitha këto lloje vërehen tek shkrimet e botuara. Ato që mbizotërojnë janë lajmet tek gazeta Magyar Szo me 34.7% të shkrimeve dhe lajmet e zgjeruara tek Blic me 29.71%. Ndërkohë tek gazeta Blic mbizotëron analiza, intervista dhe komenti në 35.5% të shkrimeve. Nga ana tjetër kjo nënkupton që lexuesit e Magyar Szo u informuan për Kosovën, kryesisht përmes lajmeve të agjencive të informacionit. Edhe lexuesit e gazetës Blic u informuan përmes lajmeve në 17.45% të shkrimeve, lajmeve të zgjeruara në 14.127% e në mënyrë rastësore nëpërmjet një analize më të detajuar për çështjet e Kosovës. Ky tregues i larmisë së llojeve të shkrimeve të botuara nënkupton që të dy gazetat nuk kishin korrespondentë të qëndrueshëm në Kosovë pavarësisht rëndësisë së kësaj teme për axhendën e publikut. Kjo mund të shpjegohet pjesërisht me faktin që Magyar Szo sii gazetë e minoritetit ka staf e kapacitet më të ulët se të tjerat. Ndërsa në rastin e gazetës Blic si një ndër gazetat e përditshme me tirazhin më të madh ky fakt shpjegohet qartazi me politikën e saj editoriale.

3.2.3/Autori i shkrimit/tekstit



Grafiku 3: Autori i shkrimit

Të dhënat e paraqitura në kapitujt e mëparshëm përputhen plotësisht me kategorinë autori i shkrimit. Në gazetën Magyar Szo në 73.9% të rasteve autorin e shkrimit e përbëjnë kryesisht agjencitë e lajmeve ndërsa tek Blic zakonisht në rreth 51.8% të shkrimeve autori nuk mund të identifikohet-duke nënkuptuar se autori është një agjenci lajmesh përsa kohë kjo është një mënyrë tipike e gazetës Blic.

Në të dy gazetat, përqindja e gazetarëve si autorëve të shkrimeve të botuara rreth Kosovës është pothuajse e njëjtë (22.46% tek gazeta Magyar Szo dhe 29.13% tek Blic.) çka nuk mund të konsiderohet një praktikë e mirë e medias në raport me gazetat e përditshme.

3.2. Burimi i informacionit

Burimi i informacionit analizohet duke marrë parasysh dy aspekte të ndryshme –tipin e burimit të informacionit dhe burimet e përfaqësuara. Nga analiza e të dy mediave të monitoruara vërejmë se ato e paraqesin përmbajtjen e shkrimeve të botuara në një mënyrë përgjithësisht profesionale e mundtë thuhet se ato janë pjesërisht të ekuilibruara dhe të sakta sa i përket burimeve të informacionit. Tipi i burimit përputhet gjithashtu me kategorinë e autorit të shkrimit. Në shumicën e rasteve burimet e cituara janë të sakta cak është kryesisht një nga karakteristikat mbizotëruese të raportimit të lajmeve që vijnë nga agjencitë. Për më tepër media ka transmetuar deklaratat në mënyrën e duhur, pasi që ato janë lloji më mbizotërues i shkrimeve në median e monitoruar. Të dhënat përkatëse të nxjerra nga studimi përfshijnë edhe kufizime të caktuara të mediave në drejtim të përmbajtjes.



Grafiku 4: Burimi i informacionit –lloji

Sipas standarteve për media të mirë i gjithë informacioni duhet të verifikohet në të paktën dy burime. Në mediat që kemi marrë nën shqyrtim, tek shkrimet e botuara mbizotëron përdorimi i vetëm një burimi informacioni (tek Magyar Szo në 58.70% dhe tek Blic në 75.54%). Kjo sigurisht nuk përbën praktikën në një media të mirë. Gjersa nuk mund të deklarohet që informacioni nga një burim tjetër kishte qenë botuar në të njëjtin numër gazete kështu që lexuesit mund të kishin një këndvështrim të situatës nga shumë perspektiva të ndryshme…

Deklarata dhe lajmet e agjencive janë llojet më të thjeshta të artikujve të botuar në këto gazeta e në këtë mënyrë është e qartë përse mbizotëron vetëm një burim.



Grafik 5. Burimet perfaqesuese



Grafik 6: Rasti i informacionit/Rasti për artikull

Në gazetat e monitoruara Magyar Szo dhe Blic, rasti i informacionit –rasti që ka që shërbyer për të shkruar një artikull në masën mëtë madhe u përket pseudo ngjarjeve. Kjo vërehet tek 40.58% e shkrimeve të Magyar Szo dhe 54.5% të tyre tek gazeta Blic. Sërish kjo nuk mund të konsiderohet një praktikë e medias së mirë sa i takon gazetave të përditshme. Në këto gazeta nuk janë të mjaftueshëm artikujt për ngjarjet e ndodhura në kohë reale (p.sh ngjarje që ndodhin në periudhën e shpalljes së pavarësisë) dhe nuk vërehet ndonjë iniciativë e mediave në këtë drejtim. Kjo është mëse e kuptueshme përderisa nuk ka patur gazetarë në terren që duhet të vëzh-gonin e mbulonin ngjarjet reale.

Pseudo-ngjarjet janë kryesisht vizioni i autorit/autores për mënyrën e tij të veprimit dhe nuk përbëjnë një gazetari të paanshme. Gjithashtu duhet të theksojmë se pseudo-ngjarjet janë krijuar për të garantuar publicitetin për qeverinë, partitë politike, organizatën, korporatën apo të personit të njohur publik.

Pseudo–ngjarjet krijohen që të jenë tërheqëse për mediat. Gazetarët duhet të vlerësojnë rëndësinë që kanë disa ngjarje për publikun. Ndryshe ajo shndërrohet në një shembull të klientelizmit mediatik.

Ngjarjet e nxitur nga media janë ngjarje që merrem prej saj dhe vendos-en në kalendarin e prioriteteve të publikut si ngjarje që përmbajnë rëndësi të madhe në zaptim të interesit të tij. Ngjarje të tilla dalin nga periferia e

interesit të publikut dhe vendosen në qendër të tij përmes angazhimit të një gazetarie aktive dhe shqyrtimit të praktikës publike.

Në përgjithësi këto janë ngjarje që qendrat e pushtetit përpiqen ti mbajnë larg nga mediat.

Ngjarja në kohë reale është kryesisht çdo ngjarje që nuk mund të vendoset në asnjë nga kategoritë e sipërpërmendura. Nga ana tjetër një pseudo-ngjarje krijohet dhe vihet në lëvizje për të tërhequr vëmendjen e medias. Sipas Bostin (2006: 82, 95-96) ajo karakterizohet si më poshtë:

1) Nuk është kurrë rastësore. Ajo është gjithmonë e nxitur dhe e planifikuar.

2) Ajo planifikohet për gazetarët që të raportojnë rreth saj. Megjithatë ajo plotësisht në përputhje me faktorin e parë të Galtung & Ruge(19993, 32-34) që thotë sesa më e njëjtë të jetë shpeshtësia e lajmeve aq më shumë mundësi ka që të regjistrohen sit ë tilla. Këtu suksesi i pseudo-ngjarjes karakterizohet nga qëllimi i njoftimit për shtyp. Sa më e gjatë të jetë lista e medias që ka raportuar rreth një pseudo-ngjarje aq më shumë ajo konsiderohet e suksesshme. Ajo bëhet me rëndësi nëse ngjarja është e vërtetë. Ajo çfarë është në të vërtetë nëse lajmi ka vlerë.

3) Marrëdhënia me realitetin është disi problematike. Interesi në një pseudo-ngjarje është rezultat i vlerave të saj të shumëfishta. P.sh kur raportojmë për konfliktet etnike publiku është i interesuar në atë çfarë ndodh realisht dhe cilat janë pasojat. Kur pseudo-ngjarja është një deklaratë apo thënie, interesi i publikut është nëse ka vlerë të vërtetë ajo që thuhet. Për një kundërshti të tillë, pseudo-ngjarjet e humbin vlerën e tyre për dëgjuesit apo lexuesit.

4) Është e zakonshme që pseudo-ngjarjet të përmbajnë informacionin që autori dëshiron tu paraqesë atyre që po e dëgjojnë apo shikojnë.

5) Krijimi i një pseudo ngjarje paguhet p.sh ka njerëz që krijojnë pseudo-ngjarje për median.

6) Një pseudo-ngjarje planifikohet që të jetë e kuptueshme. P.sh ne nuk mund të dallojmë ndonjë problem të ndërlikuar apo të vlerësojmë rolin e pjesëmarrësve të saj. Ne mund të argumentojmë gjithmonë pasojat e paraqitjes së tyre për median.

7) Një pseudo ngjarje është më interesante se realiteti. Ajo përshtatet për një grup të caktuar dëgjuesish apo lexuesish.

8) Një pseudo ngjarje është një provë. Ajo provon se deri në çfarë shkalle lexuesi është i informuar rreth VIP-ave. Pseudo –ngjarjet kanë aktorë prototip. Aktorët më të zakonshëm të pseudo ngjarjeve janë presidentët e shteteve të fuqishme dhe menaxherët e korporatave të mëdha ndërkom-

bëtare. Faktori i 10-të I Galtug &Rounge thotë se sa më shumë të lidhet ngjarja me elitën aq më shumë mundësi ka që ajo të bëhet lajm.

9) Një pseudo ngjarje përforcon iluzionin së dëgjuesit apo lexuesit kuptojnë çështjet ndërkombëtare dhe çështje të tjera me rëndësi publike. Një përqindje e dëgjuesve dhe lexuesve beson se problemet serioze zgjidhen në samite, konferenca,konferenca për shtyp, debate mediatike apo deklarata politike. Kjo vërtetohet nga analiza e monitorimit të gazetave Magyar Szo dhe Blic.

3.2.6 Titulli kryesor/nëntitulli dhe teksti



Grafiku 7: Raporti i titullit kryesor/titullit/nëntitullit

Përderisa mediat e marra në shqyrtim janë në përgjithësi profesionale, raporti i titullit kryesor, nëntitullit dhe tekstit i përmbush standartet e parashikuara me këtë rast.

3.2.7 Ilustrimi



Grafiku 8: Ilustrimi-tipi

Pasi që nuk ka shumë shkrime të botuara në ngjarje në kohë reale dhe korrespondenca klasike është e kuptueshme që nuk do të ketë edhe shumë ilustrime. Vetëm çereku i artikujve të botuar tek gazeta Magyar Szo dhe një e treta e tyre në gazetën Blic përmbajnë ndonjë ilustrim. Këto të dhëna janë krejtësisht të papranueshme për gazeta që e konsiderojnë veten e tyre të përditshme.

Ndërkohë fotografitë përbëjnë llojin mbizotërues të ilustrimeve në këto artikuj të botuar(janë më shumë fotografi të arkivit se aktuale). Ndërkohë në muajin shkurt në gazetën Blic u botuan vetëm 3 harta për të ilustruar numrin e vendeve që njohën pe Kosovës. Të marrësh sot një fotografi nuk është diçka e ndërlikuar dhe teknikisht më e thjeshtë për t'i përfshirë ato brenda tekstit. Në këtë rast nuk ka ndonjë justifikim që lexuesit përveçse leximit të opinioneve e mendimeve rreth ngjarjeve të Kosovës të mos kenë mundësi të shohin pjesëmarrësit në këto ngjarje.

Raporti ilustrimit me përmbajtjen e shkrimit në përgjithësi ruan anën e duhur cak është disi e pritshme nëse dimë se ilustrimet janë portrete të personave duke dhënë deklarata apo fotografi të gjalla nga ngjarjet.



Grafiku 9: Raporti i ilustrimit me përmbajtjen

3.2.8 Përmbajtjet



Grafiku 10. Përmbajtjet e shkrimit gazetaresk

Në kodin e monitorimit përmbajtja e shkrimeve të botuara përshtatet me shqyrtimin në nivel ndërkombëtar. Megjithatë nuk është plotësisht e përshtatshme për median serbe që çështja e Kosovës të marrë rëndësi sipas deklaratave të elitës politike. Për më tepër duke marrë në konsideratë kontekstin e kohës (muajin para dhe pas shpalljes së pavarësisë) ishte e lehtë që të parashikoheshin rezultatet- në tërësinë e tyre përmbajtja e shkrimeve gazetareske të botuara në të dy gazetat mbizotërohej nga lëvizjet diplomatike (Magyar Szo 50.53% dhe Blic 72.55%). Për më tepër, Magyar Szo i kishte kushtuar më tepër vëmendje çështjes së vetëvendosjes kombëtare që vërehet në 24.8% të shkrimeve përkundër 9.36% të atyre të Blic. Me fjalë të tjera minoritetet kombëtare e kanë çështjen e vetëvendosjes në kalendarin e tyre e ndërkohë që popullsia shumicë në vend e zgjidhi këtë çështje përgjatë zhvillimit historik. Rezultatet e përfituara nga studimi tregojnë se as Magyar dhe as Blic nuk raportuan nga Kosova por rreth Kosovës. Këto gazeta informuan kryesisht publikun rreth asaj se çfarë mendojnë mbi Kosovën pjesëmarrësit e jetës së përditshme politike. Ndërkohë në këto dy media munguan edhe disa lajme me rëndësi rreth jetës së përditshme në Kosovë ose mund t'i gjeje në fund të faqes së rubrikës së kronikës së zezë. U botuan edhe shumë njoftime për shtyp të policisë së Kosovës. Këto ishin edhe të vetmet lajme lidhur me jetën reale në Kosovë të cilat u paraqitën në Kosovë. Lajme të tilla janë ato rreth një personi nga Mitrovica që mashtroi 23 familje serbe të shisnin apartamentet e përfunduara; padia që policia ngriti kundër një banori në Beograd që zotëronte një kompani me të cilën kishte mashtruar për taksat; deklarata nga Forca Policore e Kosovës se kishte nën vëzhgim 111 vende dyshohej se ushtrohej prostitucion. etj. Këto ishin pjesë informacioni që nuk lidheshin drejtpërdrejt me statusin e Kosovës e as nuk kishin ndonjë rëndësi kombëtare por ato përfaqësonin lajme të botës reale.

Duke patur parasysh se çfarë kemi deklaruar, lexuesit serbë nuk u informuan rreth jetës së përditshme të serbëve, shqiptarëve apo edhe banorëve të tjerë të Kosovës. Në këtë mënyrë edhe duke lexuar gazeta e përditshme më të shitura lexuesit serbë nuk arritën të informoheshin rreth nevojave apo dëshirave apo realitetit. Ishin vetëm 2 apo 3 tema shkrimesh që bënin fjalë për lajme ku flitet lidhur me ndërtimin në Serbi të një spitali e të një kopshti në Kosovë dhe vetëm një copëz informacioni nga problemi i madh i energjisë. Blic nuk i informoi lexuesit e saj rreth demonstratave të studentëve në Mitrovicë pas shpalljes së pavarësisë - kjo u bë vetëm pasi Koshtunica lëshoi një deklaratë. E vetmja gjë që e ndante gazetën Blic nga ato të tjerat është fakti se botoi të plotë Deklaratën e Pavarësisë kështu që lexuesit panë në brendësi një dokument origjinal e jo vetëm interpretimin e politikanëve.

Rezultatet e monitorimit tregojnë se edhe kur mund të krijohet një përmbajtje tërheqëse përmes mediave nga nxitja e saj, ajo nuk ndodh. Le të kujtojmë mes të tjerave se, në fjalimin e tij në Sesionin OKB, Tadiq lexoi letrën e një vajze të vogël nga një fshat serb në Kosovë. Asnjë nga mediat nuk e botoi faktin se familja e saj ishte zhvendosur nga Kosova para 17 shkurtit. Historia e saj jetësore nuk u përdor kështu që pas disa ditësh ajo u harrua.

Ky nuk është shembulli i vetëm që tregon iniciativën e pakët gazetareske në mbulimin e temave të tilla në Kosovë.

Duke analizuar shembujt e marrë në shqyrtim, arrimë në përfundimin se media e monitoruar raportoi rreth Kosovës si rreth një vendi të pavarur. Me fjalë të tjera raportimi ndaj Kosovës ngjante më shumë me "Lajmet nga Bota" dhe jo "rreth realitetit të brendshëm social, ekonomik politik e kulturor". Kjo është arsyeja përse mbizotëron informacioni rreth aktivitetit diplomatik, krahasuar me historitë e jetës reale. Në mënyrë jo të drejtpërdrejtë media i dha pavarësinë Kosovës me zgjedhjen e temave që botoi. Publikut iu paraqit për informim vetëm aktiviteti diplomatik rreth statusit të territorit. Siç e përmendëm, në kalendarin e medias ato u paraqitën për një kohë të gjatë në rubrikën "Lajme nga Bota"

3.2.9. Vendi



Grafiku 11: Ku zhvillohet veprimi në tekst

Informacioni i botuar u shpërnda në përputhje me vendin e veprimit ku zhvilloheshin ngjarjet. Duhet të theksojmë se një shkrim përshinte vende të shumta. Megjithatë, në këtë rast sasia e vendeve nuk përputhet me numrin e shkrimeve të monitoruara.

IV. KONKLUZIONE

IV a) Konkluzion

Blic, gazetë e përditshme në gjuhën e popullsisë me shumicë serbe, me tirazhin më të madh në Serbi si edhe e vetmja e përditshme në një gjuhë minoriteti Magyar Szo, e mbështetën praktikën e tyre informuese mbi ngjarjet e Kosovës si më poshtë.

- Ngjarjet që u mbuluan e temat që iu ofruan publikut nuk përbënin larminë e duhur (shkrimet e botuara merreshin kryesisht me aktivitetet diplomatike)
- Mungesa e shkrimeve mbi temat multikulturore
- strukturë e ngurtë e llojeve të shkrimit gazetaresk (mbizotërojnë lajmet dhe deklaratat)
- U zgjodhën më shumë pseudo-ngjarje se ngjarje në kohë reale.
- Nuk u bënë përpjekje për të përfshirë burime të shumat informacioni në shkrimet e botuara por edhe burimet ekzistuese ishin me rëndësi.
- Struktura e shkrimit ishte modeste por në përputhje me standartet, të paktën sa i përket marrëdhënieve mes përmbajtjes, titullit e nëntitullit.

Gazetat e monitoruar ishin në përgjithësi profesionale, jo të njëanshme e nuk përhapën paragjykime apo steriotipe. Megjithatë ata nuk ofruan informacion të strukturuar në mënyrë kritike (të konfirmuar nga burime të besueshme) për lexuesit e tyre rreth asaj çfarë ndodhi në Kosovë, duke përdorur modelin modern të përhapjes së informacionit me interes për publikun.

IV b) Rekomandimet për praktika të mira

Rekomandimet mbështeten tek elementët që munguan. Lista e mëposhtme vlen për gazetat që ofrojnë mbulim në nivel kombëtar e ndërkombëtar e gazetat e përditshme që kanë një tirazh të konsiderueshëm.

- Të hapen zyra në Kosovë me stafin e duhur; autorët e raportimeve të jenë gazetarë; më pak lajme nga agjencitë, të forcohet qasja e autorit.
- Të mirëpresë larminë e temave - veçanërisht tekstet të kenë tërësi multi-kulturore që të mund t'i kontribuojë pajtimit mes komuniteteve që mbartin peshën e një konflikti të gjatë.
- Nëse media përkon me politikën aktuale shtetërore serbe, atëherë sipas Rezolutës 1244 të OKB, Kosova është pjesë e territorit serb.

Megjithatë raportet duhet të hartohen sikur vijnë nga rajoni e jo nga ndonjë vend tjetër.

- Ligjërimi mediatik duhet të jetë më i larmishëm sa i takon llojit të shkrimit gazetaresk.
- Gazetat duhet të mbështeten përgjatë mbulimit nga ana e tyre të ngjarjeve aktuale; më pak arkiv në gazetarinë e përditshme, pasi ajo duhet të paraqesë imazhin e jetës së çdo dite.

BIBLIOGRAFIA

Boorstin, Daniel (1964), The Image, Harper and Roë, Neë York.

Boorstin, Daniel (2006), From Neës Gathering to Neës Making: a Flood of Pseudo-Events, in Journalism: The democratic Craft, ed. G. Stuart Adam and Roy Peter Clark, Oxfor University Press, Oxford/Neë York, 80-98.

Galtung & Ruž (1993), Obrasci novinarske selekcije vesti, u Gledišta 1-6: Javnost i manipulacija – sociologija vesti, Beograd, 31-39.

Valić Nedeljković, D. (2002) Praktikum novinarstva, drugo dopunjeno izdanje, Privredni pregled, Beograd (prvo izdanje isti izdavač, 2000)

Valić Nedjković, D. (2007). Pseudo događaj ili dvosmislena istina – Studija slučaja javni servis Vojvodine. mediAnali, međunarodni znnstveni časopis za pitanja medija, novinarstva, masovnog komuniciranja s javnostima, godište 1, br 2. studeni 2007, glavni urednik Stjepan Malović. Dubrovnik: 67-87.

Valić Nedeljković, Dubravka (2003), TV novinar i pritisci dnevnopolitičke prakse u odabiru medijskog događaja – kako izveštavati o drugima; Zbornik radova Funkcionisanje lokalne televizije, ur. Rastislav Durman, NNŠ, Novi Sad, 157-180.

Valić Nedeljković Dubravka (2005), Mediji i javni interes, edicija Link plus, Medisa Art Service International, Novi Sad.

Valić Nedeljković, Dubravka i Višnja Baćanović (2007), From an emotional approach to the fate of Kosovo to progressive civil activities, in Indicator of public interest: TV Prime Time Domestic Neës Monitoring and analysis of TV neës programs in 10 SEENPM countries, ed. Radenko Udovičić, Media Plan Institut, Sarajevo, 197- 230.



SLLOVENIA

Gorazd Kovaçiç

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Së pari studimi paraqet disa nga këndvështrimet e mundshme prej të cilave mund të interpretohet situata në Kosovë, me qëllim që të vlerësojmë përmes metodës së imagjinatës kritikes se çfarë duhet të ishte një mbulim sa më i gjithanshëm i situatës së atjeshme. Qëndrimi autorit të këtij studimi është se kushtet e jetesës në Kosovë janë rrethanat më të rëndësishme që justifikojnë krijimi e institucioneve shtetërore efektive në këtë vend. Këto kushte duhet të paraqiten në media si një ndër elementët kryesorë të Kosovës, me qëllim që të shpjegojnë për publikun e huaj rrethanat e procesit të pavarësisë. Në mbulimin që i bënë situatës në Kosovës dy gazetat e përditshme sllovene Delo dhe Veçer, gjatë periudhës janar – shkurt 2008, këndvështrimi për jetën e përditshme atje u anashkalua krejtësisht. Kosova u paraqit më së shumti si një subjekt pasiv i lojës së pushtetit mes superfuqive. Politikat editoriale të gazetave paraqitën me shumicë aktivitetet diplomatike nga shtetet e treta, ku problemi kryesor ishte se si do të reagonte Serbia për shkëputjen e Kosovës dhe se si faktorët ndërkombëtarë do të përpiqeshin të ruanin stabilitetin e Serbisë. Përkundër këtij elementi, qëndroi krejt në periferi informimi i lexuesit sesi jetonin njerëzit në Kosovë, cilat ishin nevojat e tyre dhe aktivitetet për përmirësimin e kushteve të jetesës.

Arsyeja kryesore për një trajtim të tillë është vartësia e madhe e gazetave në rajon prej një pakice agjencish të lajmeve të tipit oligopoli që ofrojnë informacion të reduktuar nga anë të ndryshme të botës por që kënaq kërkesat e konsumatorëve të pasur të vendeve perëndimore.

Hyrje: shpjegimi epistemologjik

Ecuria epistemologjike e këtij studimi qëndron në dy hapa. Në hapin e parë do të paraqes kuadrin e përgjithshëm argumentues në të cilin u zhvillua debate dhe informimi në Slloveni mbi rastin e Kosovës, ashtu siç e kam vërejtur në mediat e përditshme e javore, tavolinat e rrumbullakëta dhe takimet me njerëz të ndryshëm. Brenda këtij kuadri diskutimesh do të paraqes

gjykimin tim për drejtësinë e pranimin e elementëve kryesorë të argumenteve. Në hapin e dytë do të paraqes në mënyrë analitike të dhëna sasiore rreth politikës editoriale mbi Kosovën që ndoqën dy gazetat e përditshme sllovene, Delo dhe Veçer. Në këtë nënkapitull do të shpjegoj arsyet për një ecuri të tillë epistemologjike.

Një nga metodat më të rëndësishme në këtë test është që të bëjmë një dallim mes pikëpamjeve të paraqitura në mënyrë të hapur (zakonisht nga aktorë të vërtetë dhe komentues të ngjarjeve që i kanë përmbledhur në shkrime gazetareske) dhe pikëpamjet e shprehura jo drejtpërdrejt, të cilat formojnë politikën editoriale dhe përzgjedhjen e temave e këndvështrimeve mbi ngjarjet për të cilat raportohet. Ndërkohë që media ofron pikëpamje të drejtpërdrejta, transparente e objektive, qëndrimet e tyre jo të drejtpërdrejta editoriale janë të pakapshme dhe një lexues nuk mund t'i dallojë ato në një tekst të tillë por në strukturën e saj që tregohet e nuk tregohet. Aftësia më e rëndësishme në këtë drejtim është diçka që ne mund ta quajmë aftësia për të imagjinatën kritike të asaj çfarë mund të ishte thënë por që nuk ishte.

Vendosja në vend të parë e një shqyrtimi më të gjerë të pikëpamjeve mbi çështjen e Kosovës është me rëndësi nga pikëpamja epistemologjike, për shkak se ajo nxit ndërgjegjësimin mbi mënyrat e ndryshme të interpretuarit. Ajo çfarë është thelbësore përgjatë analizës së mbulimit prej medias të një situate të caktuar, mbetet fakti se një ndërgjegje e tillë na mundëson një analizë për të vëne re e theksuar përzgjedhjen editoriale të pikëpamjeve dhe interpretimin jot ë drejtpërdrejtë mediatik të ngjarjeve. Është me rëndësi të qenit e vetëdijshëm se çfarë mund të thuhet rreth një situate, si mund të interpretohet e cilat nga aspektet e saj mund të vihen në dukje në mbulimin mediatik, në mënyrë që të gjykojmë se si është realizuar ky mbulim: si më i gjithanshëm dhe i ndjeshëm apo si i reduktuar, pa njohuri dhe për interes vetjak. Pikëpamjet e ndryshme mbi situatën në Kosovë nënkuptojnë gjykime të ndryshme të asaj çfarë është me rëndësi në këtë rast e cilat janë domethëniet e saj. Të kuptuarit është gjithmonë sesi e kupton dikush apo grupe të ndryshme njerëzish një aspekt të caktuar. Në rastin e çështjes së Kosovës grupe të tilla me rëndësi mund të jenë banorët e saj, anëtarët e minoriteteve apo serbët etnike, politikanët në Kosovë, Serbi apo shtete të tjera me ndikim që mund t'i përkasin llojeve të ndryshme të publikut e spektatorëve ndërkombëtarë: biznesmenë dhe investitorë, turistë, qytetarë të shteteve fqinj etj. Përzgjedhja e të kuptuarit mund të jetë shumë e ndryshme: disa njerëz janë të interesuar për stabilitetin politik e makroekonomik në rajon, të tjerë për sigurinë lokale ndërsa të tjerë kërkojnë informacion vetëm për rritjen e mundshme të kriminalitetit, refugjatëve që vijnë prej vendeve fqinj. Ndërkohë grupe të tjera njerëzish ashtu si në Kosovë mendojnë në termat e përgjithshme të drejtësisë njerëzore e të drejtave të njeriut. Spektatorët (vëzhguesit e ngjarjeve) janë ata që u japin kuptimin, ngjarjeve situatave dhe e bëjnë këtë sipas këndvështrimeve të tyre respektive. Në termat e medias këto grupe të ndryshme spektatorësh janë grupet e ndry-

shme të publikut, lexuesit, dëgjuesit dhe vëzhguesve të prodhimit mediatik. Media i paraqet ngjarjet në atë mënyrë që u intereson konsumatorëve të saj. Përzgjedhja e gazetarëve dhe editorialeve me rëndësi më së shumti pasqyron pikëpamjet dhe nevojat e konsumatorëve të tyre. Për këtë arsye çdokush duhet të jetë sa më i ndërgjegjshëm se lajmet ashtu siç paraqiten zgjidhen për shkak të kategorive të caktuar të konsumatorëve të medias që kanë interes të informohen. Çdo politikë editoriale është e pjesshme nëse tekstet e gazetarit janë të shkruara me një stil të thatë përshkrues, të regjistrojë burime të ndryshme e të paraqesë pikëpamjet e dhëna nga faktorë të ndryshëm pa marrë anën e askujt. Përkatësisht, pasqyrimi i situatave, ngjarjeve apo edhe aktorëve të caktuar të saj pothuajse nënkupton një qëndrim sa i përket domethënies së këtyre informacioneve dhe historive. Në shumicën e rasteve një politikë e tillë editoriale nuk shpallet në mënyrë transparente por mund të vihet re përmes imagjinatës kritike se çfarë gjëje tjetër duhet të ishte por që mungon. Botuesit apo anëtarët e redaksive të mediave rrallëherë paraqesin arsyet për mënjanimin e temave të caktuara në editorialet e tyre. Zakonisht përzgjedhja e pikëpamjeve për çështje të caktuar vetëm nënkuptohet e ndonjëherë edhe botuesit e gazetarët nuk mendojnë gjatë rreth kritereve të tyre me rëndësi informuese por ata vazhdojnë të përsërisin në mënyrë rutinë realizimin e lajmit.

Natyra përsëritëse e rutinë e punës së gazetarëve nuk i nxit ata të paraqesin kushtet e tyre të punës dhe rrjedhojat ideologjike të produkteve të tyre sikurse i shohin njerëzit ata prej pozicioneve nga jashtë.

Kjo epistemologji nënkupton që ka një qëndrim të caktuar për një situatë reale ashtu edhe për mënyrat me të cilat e ka mbuluar media atë. Por ideja ime është se çdo komunikim publik, duke përfshirë edhe atë gazetaresk, mban qëndrime të caktuara. Megjithëse ato mund të jenë të padukshme apo të fshehura autorët e tyre janë përgjegjës për ato për shkak se çdo përmbajtje e mesazh është në gjendje të japë efekte të caktuara në hapësirën publike. Asnjanësia nuk është e mundur në çështjet e interesave dhe ideologjive prandaj është më e ndershme nga pikëpamja intelektuale që të marrësh hapur e pa mëdyshje përgjegjësinë për një pikëpamje.

Një tjetër qasje e mundshme kundër kësaj epistemologjie mund të kritikojë subjektivitetin dhe kuriozitetin e zgjedhjes time për rëndësinë interpretuese, e cila ndryshon nga zgjedhjet e bëra nga shumica e studiuesve, gazetarëve e politikanëve të tjerë. Është e vërtetë se vetëm 3 artikuj në gazetën Veçer (2 të shkruar nga intelektualë të njohur kosovarë) dhe 3 në Delo (njëri i shkruar nga një albanolog slloven e dy të tjerë nga një gazetar me emër) arritën të flisnin për Kosovën në një mënyrë që duket me interes për mua, pra nga këndvështrimi i popullit të Kosovës. Por që të kesh një pikëpamje origjinale përbën në fakt bazën e cdo gazetari të shquar dhe vepre të tjetër intelektuale. Gjithashtu, në të dy gazeta është vetëm një gazetar (Bostjan Vidernsek), i cili ka një ndjenjë për situatën e viktimave e njerëzve të zakonshëm dhe ka mundësi t'i ketë bërë vetes të njëjtën pyetje: përse ai

nuk ndjekur rrugën me të cilën e interpretojnë botën shumica e gazetarëve të medias, studiuesve, instituteve të kërkimit apo institucioneve politike dhe çfarë e ka justifikuar atë që të zgjedhë të shkruajë rreth të pafuqishmëve e jo rreth njerëzve me pushtet e të fuqishëm?

Unë besoj, se kjo strukturë justifikon të qenit e vërtetë një pikëpamje dhe është një justifikim reflektues e jo shpeshtësia e apo popullariteti i një opinioni teksa e dimë se ky i fundit është një produkt industrial i aparatit ideologjik, i kontrolluar prej grupeve të njerëzve me pushtet e të fuqishëm.

I. KONTEKSTI POLITIK (QËNDRIMET E POLITIKËS VENDASE NË DREJTIM TË KOSOVËS)

I. a) Argumentime lidhur me statusin e Kosovës

Spektri i gjerë i pikëpamjeve të shprehura për Kosovën mund të ndahen në grupe të shumta argumentesh e justifikimesh në favor apo kundër pavarësisë së Kosovës (76). Grupi i parë përfshin argumentet që përqendrohen mbi kushtet e varfër të jetesës në Kosovë[1]. Kjo situatë përbën një nevojë të shpejtë për ndërtimin e institucioneve efektive që kanë munguar për dekada në këtë vend. Grupi i dytë ka një pikëpamje të kundër mbi situatën e qytetarëve në vend. Ajo shpreh dyshim rreth besueshmërisë së liderëve të Kosovës dhe shoqërisë e kulturës së shqiptarëve të atjeshëm. Këto argumente paraqesin forcimin e krimit të organizuar dhe traditën e dobët të ndërtimit të institucioneve dhe të administrimit të përgjegjshëm të pushtetit shtetëror nga shqiptarët e Kosovës. Për këtë arsye pavarësia e Kosovës është interpretuar si kërcënim për sigurinë. Grupi i tretë paraqet statusin moral të viktimave. Ai vë theksin mbi domethënien e vuajtjen historike të shqiptarëve të Kosovës nën regjimin e Millosheviqit apo të serbëve të Kosovës që nga eksodi i tyre i madh i 1690. Grupi i katërt është formalist: ai mbron të drejtën e shtetit serb për të ruajtur sovranitetin në një territori të njohur ndërkombëtarisht. Një argument shumë i shpeshtë që përmblidhet tek shkrimet e analizat i referohet ligjit aktual ndërkombëtar. Një nëngrup i dytë i argumenteve formalë flet rreth të drejtave të popullsive vendase për të kontrolluar territorin e tyre - ky argument ndonjëherë lidhet me Serbët por mund t'i referohet edhe banorëve para-sllavë (ilirët). Grupi i fundit i argumenteve është ai realist: ai vë theksin tek marrëdhëniet mes superfuqive e interesave të tyre strategjike si faktor kyç në zhvillimin e ngjarjeve.

Personalisht e konsideroj të dobët grupin e tretë e të katërt të argumenteve. Argumentet për vuajtjen historike duken të mirë për shkak të keqardhjes njerëzore për viktimat. Por rrjedhojë e tyre është identiteti i viktimës që e shkarkon atë nga çdo përgjegjësi që ai/ajo u ka bërë të tjerëve.

1 Vështrova një sërë argumentesh dhe justifikimesh lidhur me statusin e Kosovës në shkrimin tim »Zakaj bi Kosovo moralo postati država?« [Pse Kosova duhet bërë shtet?]. Refleksionet e mia lidhur me këtë dilemë ishin kryesisht të inspiruara nga libri "Nacionalizmi Liberal" i Yael Tamir

Për nga përcaktimi duket se viktima është marrë apriori nga ana morale e për këtë s'duhet të përballet me fajet apo gabimet e saj. Viktimizimi përbën pengesën për trajtimin racional të një marrëdhënie me të tjerët që mendohet se janë dhunuesit. Situata bëhet edhe më e paarsyeshme e emocionale kur të dy palët përfshihen në një konflikt për ta menduar veten si viktima të mira që si ka bërë keq askujt. Më tej duket sikur e kaluara traumatike merr më tepër rëndësi se e ardhmja dhe se çdokush e kupton dhunën e ushtruar ndaj tjetrit si kënaqësi e justifikuar dhe ndreqje e padrejtësive të së shkuarës. Objektivisht situata duket sipas formulës "Ne jemi viktimat e viktimave të viktimave të viktimave… "Është e vështirë të arsyetosh parimin e drejtësisë jashtë përcaktimit të statusit të viktimës. Por ajo çfarë është me rëndësi është ndjenja subjektive e viktimës për traumën, e cila praktikisht mund ta bëjë bashkekzistencën të vështirë. Ky fakt duhet të konsiderohet në mënyrë pragmatike edhe sikur të jetë problematik në termat e parimit.

Argumenti për ligjin e rendin ndërkombëtar duket jo bindës. E drejta/ligji ndërkombëtar nuk është një sistem rregullash të përgjithshme e jo të pjesshme që parashihen nga një strukturë legjislative globale. Ai është më shumë një tufë marrëveshjes mes shtetesh, duke përfshirë marrëdhënie të caktuara të fuqisë së tyre. Një nga qëllimet e tyre është ruajtja e status-quose cila nënkupton që shtetet ekzistuese të jenë më para shteteve që nuk ekzistojnë ende. E drejta e shteteve ekzistuese për të ruajtur tërësinë e tyre territoriale është në fakt një marrëveshje me disa prej lojtarëve kryesorë të marrëdhënieve ndërkombëtare që parandalojnë që të porsaardhurit e mundshëm të hynë në skenën e këtyre marrëdhënieve. Nëse nuk ka ndonjë arsye tjetër logjike do të ishte e mundur që të ndryshohej e gjithë harta politike e botës. Por përdoret një logjikë tjetër kur u referohemi ligjeve ndërkombëtare: është logjika e interpretimit të këtyre ligjeve. Interpretimet me një domethënie të veçantë për rregulla të caktuara ndërkombëtare nuk kryen nga gjykata por nga vetë shtetet. Delegimi për të bërë një interpretim të vlefshëm në Këshillin e Sigurimit të OKB është vetëm një instrument për të arritur ekuilibrin mes superfuqive, siç është në shumicën e rasteve një instrument i masave bllokuese kur përplasen interesat e rëndësishme të këtyre të fundit. Përpjekjet e Kosovës për ta mbajtur rastin e Kosovës nën autoritetin e Këshillit të Sigurimit të OKB-së nuk rezultuan të frytshme: kjo strategji nuk qe në gjendje të ndalte ndarjen edhe pas kundërshtimit të disa prej anëtareve të përhershëm të KS.

Të vetmet rezultate reale të kundërshtimi të vazhdueshëm të Serbisë ndaj këtij precedenti të paligjshëm ishte vasaliteti i Serbisë me Rusinë (ajo u materializua nga koncesionet që iu dhanë industrisë ruse të naftë) dhe ringjallja e statusit të viktimës në sytë e partnerëve ndërkombëtarë.

Argumentet rreth të drejtave të popullsive vendase për të kontrolluar territorin e tyre (slogani "Kosova ka qenë zemra e Serbisë që nga mesjeta") janë jopraktike, të pajustifikuara dhe absurde. I njëjti argument mund të vendoset si për serbët ashtu edhe për banorët shqiptarë para-sllavë (ilirët). Por e

kemi të vështirë të gjykojmë se cila etni është më autoktone. Ajo çfarë është më e rëndësishme mbetet fakti i papranueshëm për t'i ngarkuar njerëzit e sotëm e të nesërm me dhunën e shkuar ndëretnike. Brezat që vijnë nuk duhen ndëshkuar për mëkatet e paraardhësve të tyre. Duket absurde kërkesa që njerëzit të praktikojnë një kulturë të huaj, thjesht sepse ajo është kulturë mbizotëruese në atë territori shumë shekuj më parë. Por ka arsye të tjera më të justifikuara përse shqiptarët e Kosovës duhet të respektojnë e të nxisin kulturën e gjallë të serbëve në Kosovë: për shkak të situatës demografike, pra për shkak se serbët jetojnë sot në Kosovë. Problemi themelor i të mënyrë së menduarit, sipas së cilës një territor apo shtet mund e duhet të kontrollohet gjerësisht nga një grup, është se shmang diskutimin rreth nevojës për të zhvilluar e ruajtur një lloj politike multikulturore e zgjidhje të shoqërisë civile.

Unë e kundërshtoj interpretimin e situatës institucionale, ligjore, sociale e ekonomike në Kosovë si një ndër arsyet kundër lejimit të vetëvendosjes e vetëqeverisjes së popullit të Kosovës. Është fakt se institucionet publike në Kosovë kanë qenë të dobëta prej dekadash, ekonomia joformale e kriminale më e fortë se ajo formale, format patriarkale të organizimit të shoqërisë janë të dukshme e niveli i besimit ndëretnik ka qenë i ulët. Por të nxjerrësh nga kjo situatë idenë se kemi të bëjmë me kulturë inferiore të shqiptarëve atëherë kemi përballë një argument të racizmit kulturor. Të fajësosh popullsinë që u detyrua të jetonte në një gjendje të jashtë zakonshme për të paktën një brez, se ata kanë një kulturë të dobët evropiane të kombformimit, kjo është një hipokrizi. Përkatësisht, situata e jetesës e përshkruar në Kosovë është sipas opinionit tim argumenti më i rëndësishëm në përkrahje(dhe jo kundër) të krijimit të institucioneve shtetërore efektive në Kosovë. Diagnoza politike e kushteve të kaluara institucionale të Kosovës është si më poshtë: Nuk ka patur shtet të përgjegjshëm në Kosovë për dekada me radhë e si pasojë Kosova ka qenë një vend i pazhvilluar, i vendosur në Evropë. Situata e dëshpëruar ekonomike i ka detyruar njerëzit të emigrojnë. Por që nga viti 1999 shqiptarët e Kosovës janë vënë në dilemë për atë se çfarë duhet të bëjnë nëse duan të udhëtojnë jashtë: nga njëra anë të përdorin pasaportën e Serbisë të cilin ai/ajo nuk e ka njohur si shtetin e vet apo të mos ketë të drejtë të lëvizë lirisht e të përdorë të drejtën e mbrojtjes konsullore. Kosova ka qenë teknikisht një territor nën administrimin ndërkombëtar por nga pikëpamja e banorëve të saj ajo ka qenë një kamp i madh. Fatkeqësisht deri më tani strukturat e institucioneve ndërkombëtare nuk kanë nxitur marrjen e përgjegjësive nga institucionet e Kosovës. Qoftë policia civile destruktive e Serbisë dhe policia e UNMIK-ut në Kosovë, që ruan institucionet, kanë shkelur të drejtën njerëzore bazë të popullit të Kosovës, për të jetuar në kushtet e shtetit. Sipas opinionit tim, e drejta për të jetuar në kushtet e shtetit është arsyeja më urgjente që nxiti ndërmarrjen e një hapi vendimtar për statusin e papërcaktuar të Kosovës.

Kjo është pikëpamja ime e përgjithshme mbi situatën në Kosovë. Një tjetër dilemë është: cili shtet është më i përshtatshëm për të përmbushur

nevojën e përgjithshme të njerëzve për të jetuar në kushtet e shtetit – Serbia apo Kosova e pavarur? Sipas këndvështrimit të shumicës së shqiptarëve të Kosovës, Serbia e hodhi poshtë shansin për të gjetur një formulë bashkëjetese kur kreu pastrimin masiv etnik në 1999. Trupat ushtarake e paraushtarake serbe, vranë, dogjën, dëbuan e përdhunuan shtëpitë e 1 milion shqiptarëve. Elementët e mësipërm të dhunës së mësipërme të kryera ndaj shqiptarëve mund të interpretohen si një hap domethënës drejt një gjenocidi që u ndalua nga ndërhyrja e NATO-s. Shkatërrimi i dokumenteve personale të refugjatëve kosovarë kur kalonin kufirin, shkatërrimi i të dhënave administrative për viktimat dhe realizimi i hapave të tjerë ishin çështje të rrethanave e frymës së njërit komunitet për të mbisunduar tjetrin me çdo lloj force. Pas këtyre ngjarjeve nuk mund të pritej që shqiptarët të dëshironin të jetonin brenda një shteti që ishte armiqësor ndaj tyre.

Edhe në vonë pas rënies së Millosheviqit, Serbia nuk bëri ndonjë gjest pozitiv me qëllim që të tregonte gatishmërinë e saj për të pranuar shqiptarët e për t'i integruar në sistemin politik. Nëse Serbia do të ishte e gatshme të jetonte së bashku me shqiptarët në një shtet të përbashkët ajo duhej që mundësisht të nxiste një model të integruar politik i ngjashëm me atë në Maqedoni. Pra një parti shqiptare duhej të hynte në çdo koalicion qeverisës në Serbi e 1/5 e ministrave serbë të ishin shqiptarë etnike. Ofrimi i një posti ministri që i jepej një politikani shqiptar nga lugina e Preshevës mund të ishte një shembull bindës se Serbia e ka lënë pas të kaluarën e saj raciste anti-shqiptare.

Në fakt që nga viti 1999 nuk ndodhur asgjë e tillë. Kur Serbia pretendonte se do të mbante Kosovën, ajo dukej sikur interesohej më shumë vetëm për zotërimin e territorit dhe banorët etnikë serbë, por jo për integrimin e shqiptarëve të Kosovës.

Këto ishin rrethana konkretet historike që mbyllën mundësinë e zgjidhjes së problemit të statusit të Kosovës me anë të një autonomie të gjerë brenda Serbisë. Për opinionin tim dhunimet masive të të drejtave të njeriut janë argumente shumë serioze në përkrahje të ndarjes nga Serbia sesa thjesht fakti që shumica e Kosovës i përket një etnie tjetër nga jo që mbizotëron në Serbi. Përkatësisht e në përgjithësi është diçka më e zgjuar që të kërkosh zgjidhje multikulturore të sistemeve politike sesa të mbështeteshin copëzimet e territoreve drejt krimit të hartave etnike e me logjikën e shtetit-komb, për shkak se në botë nuk ka territor etnikisht të pastër. Por dhuna masive e kryer kundër etnive të caktuar përbën një përjashtim të justifikuar në këtë rast.

Aspekti i fundit as i përket argumenteve aktuale mbi çështjen e Kosovës e përbën realizmi politik. Ky është këndvështrimi më me ndikim nga të tjerët veçanërisht në masmedia. Kur flasim rreth të ashtuquajturit argument realist ne përshkruajmë një pikëpamje të caktuar të marrëdhënieve ndërkombëtare. Kjo pikëpamje thekson marrëdhëniet e fuqisë që ka një shtet dhe

interesat me rëndësi të veçantë. Realizmi paraqet logjikën e fuqisë e jo të fuqisë së shteteve në kuptimin e pikëpamjeve të arsyeshme. Megjithatë ligjërimi realist vështirë se emërtohet me një lloj argumenti real: është më tepër një vëzhgim sesi vepron fuqi apo forca e shteteve në marrëdhëniet ndërkombëtare. Vëzhgimi realist është se Kosova pati sukses sa i përket fitimit të pavarësisë për shkak se e mbështetën SHBA, të cilat si rastësisht e përdorën këtë mundësi për të bërë biznes e për të vendosur bazën e saj ushtarake në këtë pjesë të Evropës. Prej një vëzhgimi të tillë nuk mund të rrjedhë një parim moral. Nëse një vend si Sllovenia i cili nuk është i përfshirë drejtpërdrejt i përfshirë në konfliktin e Kosovës e donte të vepronte sipas një arsye të justifikuar për të njohur pavarësinë, realizimi në këtë rast nuk do të shërbente si e tillë. E vetmja arsye bindëse por jo e justifikuar është bindja ndaj SHBA. Por megjithëse realizimi nuk përmban brenda tij moralin, ne ende mund të arrimë në përfundimin se ai mbetet një lloj parimi, përkatësisht parimi i fuqisë dhe forcës së shtetit. Megjithëse pretendon të jetë objektiv, realizmi përmban një këndvështrim të caktuar elitist sa i përket çështjeve ndërkombëtare, për shkak se ai e koncepton fuqinë e shteteve të caktuar si një marrëdhënie të pabarabartë zotërimi e cila ka nevojë ndonjëherë të ekuilibrohet në mënyrë të dyanshme. Pikëpamja e realizmit është se aktorët me fuqi të vogël në marrëdhëniet ndërkombëtare vlejnë më pak se ato me fuqi të madhe dhe njerëzit e zakonshëm janë të parëndësishëm përveç si një masë me fuqinë e saj blerëse apo me një mundësi konflikti.

I. b) Qëndrimet e politikës sllovene në drejtim të Kosovës

Që prej vitit 1990 politika parlamentare sllovene ka qenë thellësisht e ndarë në dy blloqe ideologjike. Pika kryesore ideologjike të ndarjes mes ë majtës dhe të djathtës kanë qenë trajtimi i të huajve, liritë caktuara individuale, ndarja e kishës nga shteti, gjykimi mbi luftën civile gjatë periudhës së pushtimit në vitet 1942-1945. Një dallim edhe më i rëndësishëm është stili i të qeverisurit dhe kontrolli i sistemeve të pavarura mbi qeverinë: institucionet publike, kompanitë e mëdha, media, sfera akademike, gjyqësori etj. Në këtë drejtim metodat e majat liberale ishin më të buta se ato të djathta. Që kur e djathta fitoi zgjedhjet parlamentare në Sllloveni në 2001 besnikëria partiake ka marrë përparësi mbi kompetencën profesionale dhe është zvogëluar autonomia institucionale në të gjithë sistemin. Një nga pikat jo shumë radikale të kundërshtimit të së majtës ka qenë çështja e amerikanizmit, i cili u kristalizua në periudhën e fushatës së referendumit në Sllloveni për t'u anëtarësuar në NATO. Votuesit e majtë (o të mbështetur nga liderët e tyre të bllokut të majtë) mendonin se anëtarësimi në NATO nënkuptonte shërbimin ndaj interesave të paligjshme të politikës së jashtme të SHBA, ndërsa të djathtët besonin se anëtarësimi do të pohonte se Sllovenia i përkiste qytetërimit perëndimor. Pasi që në 2008 Kosova nuk ishte një nga çështjet e rëndësishme politike në Sllloveni, marrëdhëniet e politikës sllovene me këtë vend mund të vendosen politikisht brenda qëndrimeve të gjera të këtij karakteri mbi çështjet e politikës së jashtme e në këtë mënyrë ajo i bashkohej situatës

të përgjithshme të kësaj politike. Politika e jashtme aktuale e së djathtës në Sllloveni karakterizohet nga personaliteti i ministrit të punëve të jashtme Dimitrij Rupel. Në drejtimin e tij diplomacia ka qene e përfshirë relativisht ashpër në luftën e brendshme brenda partive politike, ndërkohë që ka qenë përgjithësisht arrogante e joefektive në lidhje me mosmarrëveshjet e gjata së vijës së kufirit me Kroacinë. Ndërkohë stili i tij veprimit në marrëdhëniet më të gjera ndërkombëtare ka qenë shumë veprues duke ndjekur iniciativat e kërkesat e lojtarëve të mëdhenj, veçanërisht të SHBA e duke kërkuar një ekuilibër mes interesave konfliktuale në rajon (p.sh Serbi dhe në Kosovë). Aktiviteti diplomatik i Sllovenisë në muajt e parë 2008 u karakterizua nga mangësitë e përgjithshme të diplomacisë sllovene: mungesë njohurish, mungesë iniciative dhe servilizëm ndaj të gjithë fuqive të mëdha dhe e gjitha kjo përforcoi një marrëdhënie të veçantë të së djathtës ndaj SHBA.

20.9% e të gjithë artikujve që lidhen me Kosovën në gazetat sllovene e që janë marrë në shqyrtim periudhën janar-shkurt 2008, bëjnë fjalë rreth veprimeve të kryera nga Sllovenia. Ky numër duhet të ishte më i vogël nuk do të ekzistonin dy rrethana të veçanta që rritën pjesëmarrjen e Sllovenisë në shkrimet rreth Kosovës: Presidenca sllovene e BE në gjysmën e parë të vitit 2008 dhe një skandal diplomatik lidhur me udhëzimet diplomatike të SHBA në janar 2008.

Një element shtesë ishin edhe zgjedhjet parlamentare që priten të zhvillohen në shtator 2008. Qeveria u përpoq ta paraqesë presidencën e BE si një projekt me rëndësi historike dhe si një mundësi për nxitjen më tej të imazhit të vendit i cili vuante nga ndjenja i të qenit i panjohur dhe periferik. Diplomacia sllovene që po udhëhiqte aktivitetin e BE kishte një detyrë të vështirë për të përmbushur: si ta mbante të bashkuar politikën e jashtme ndaj një ngjarje të tillë kundërshtuese si shkëputja e Kosovës e si të vepronte në mënyrë konstruktive e pa vonesë për statusin. Është i diskutueshëm suksesi qeverisë sa i përket koordinimit të diplomacisë evropiane mbi Kosovën për shkak se politika e jashtme e përbashkët e BE qe fundosur sërish i vetmi rezultat ishte që çdo vend i BE të vendoste vetë lidhur me Kosovën ndërkohë që BE do të dërgonte atje misionin EULEX. Skepticizmi ndaj suksesit të diplomacisë sllovene u rrit në janar 2008 kur gazeta Dnevnik botoi një raport të brendshëm diplomatik rreth udhëzimeve autoritare të diplomacisë së SHBA për Sllovenine rreth mënyrës se si Sllovenia duhet të vepronte sa i përket ngjarjeve në Kosovë. Materiali përfshinte një paraqitje të hollësishme të pritshmërisë të SHBA rreth aktivitetit të Sllovenisë dhe nuk kishte asnjë raport mbi përgjigjen e pjesëmarrësve nga pala sllovene në këtë takim që duhet të tregonin një partneritet të barabartë.

Të dyja ngjarjet, rezultatet e politikës së jashtme të përbashkët të BE e skandali diplomatik me SHBA krijon një rrethanë në të cilën vihet në pikëpyetje besueshmëria e politikës së jashtme sllovene dhe e vetë qeverisë. Por deri në fillim të korrikut 2008 (kur u shkrua edhe ky studim) suksesi i diplomacisë sllovene sa i përket Kosovës apo në përgjithësi nuk është shndërruar

ende në një temë të dukshme të luftës së brendshme politike dhe fushatës para-elektorale. Duket sikur ekziston një konsensus mes të dy krahëve politikë se i gjithë procesi i presidencës të BE pati statusin e një projekti me rëndësi kombëtare dhe nuk u bë objekt mosmarrëveshjes brenda politikës së brendshme.

II. KARAKTERISTIKAT E SISTEMIT TË MEDIAS - KONTEKSTI I MEDIAS

Tregu i medias sllovene është i vogël dhe ai nuk përfshin më shumë se 2 milion konsumatorë të mundshëm për shkak se lidhet me pengesën gjuhësore. Në fillim të viteve 90 ekzistonte shumë frika për shitjen e pasurive sllovene tek kapitali i huaj. Rezultati i privatizimit ishte një model ku qeveria dhe dy fonde qeveritare zotëronin paketën e aksioneve në të gjithë kompanitë e mëdha. Ndërkohë një oligarki e ndërlikuar me lidhje të dyanshme me elitën politike e ekonomike po kontrollon tashmë të gjithë sistemet e rëndësishme në vend. Në këtë kuadër janë të shumta rrjedhojat për pronësinë e medias dhe situatën e standarteve të gazetarit profesionist. Këtu do të paraqes vetëm ato elementë të sistemit që kanë rëndësi për gazetarinë informative.

Para 1990 Radio Televizioni Slloven kishte monopolin në fushën e televizioneve dhe të radios. Qeveria kishte kontrollin mbi bordin e programit të këtij institucioni megjithëse formalisht ishte i përbërë nga përfaqësues të shoqërisë civile. Në 1990, hyri në treg një korporatë nga SHBA e quajtur CME e cila krijoi një stacion komercial "POP TV" (ajo bleu më vonë TV Kanal A) i cili jep programe të përditshme informative. Ai ka sjellë një mënyrë më dinamike e sensacionale të raportimit me një interes të madh në kronikën e zezë por edhe me dëshirën qëtë japë materiale për çështje politike. Që nga ajo periudhë Radio Televizioni i Sllovenisë ka ndjekur një stil më komercial të informimit si edhe në aspektin argëtues të programeve me qëllim që të mbajë sa më afër dëgjuesit e tij të cilët e ndihmojnë përmes reklamave. Kanalet e tjera private janë shumë të vogla për të ofruar programe informuese.

Radio Publike Sllovene vazhdon të ruajë monopolin e programeve informative për shkak se struktura e radiove private është e fragmentuar. Një numër kaq i vogël nuk arrin të ofrojë materiale informative në një treg po me një madhësi të tillë. Përmbajtja e tyre është muzika, komentet, bisedat në studio e reklamat por ndërkohë pagat e gazetarëve dhe standartet profesionale janë shumë të ulëta. Në fushën e gazetave të përditshme e të përjavshme qeveria e ruajti monopolin për një kohë të gjatë. Me përjashtim të përditshmes për biznes Finance që është në pronësi të grupit mediatik suedez Bonner, nuk gjenden gazetat të përditshme apo të përjavshme që janë krijuar pas viteve 90.

Të gjitha gazetat ekzistuese në Slloveni botohen që nga koha e social-

izmit. Kompanitë e gazetave janë privatizuar pjesërisht nga brenda nëpërmjet fondeve të investimeve dhe të qeverisë që kanë edhe paketat kontrolluese. Gabimi më i madh ndaj kushteve për të ruajtur pavarësinë e gazetarisë u realizua prej vetë gazetarëve e të punësuarve tjerë të cilët shiten aksionet në këto media sapo u ngritën çmimet e tyre në treg. E përjavshmja e majtë liberale, Mladina ishte i vetmi përjashtim në këtë drejtim. Gjatë viteve 90 pronësia e gazetave u përqendrua në duart e disa kompanive të mëdha dhe fondeve investuese të cilat kontrollohen prej aksioneve të qeverisë. Një numër i vogël oligarkësh kanë patur sukses në kontrollin e sektorit të gazetave përmes pronësive të dyshimta, anëtarësimit në borde kontrolli si edhe duke vepruar me politikën e reklamave. Si rregull qeveria kontrollon reklamuesit më të mëdhenj që kanë bojkotuar të përjavshmet që kanë profil anti-qeveritar.

Në përgjithësi motivi i pronësisë së gazetave nuk ka rezultuar me përfitim sa i përket shtimit të produktit gazetaresk në një treg të hapur. Motivi ka qenë zotërimi i një mjeti për të bërë presion apo për të shkëmbyer favore me qeverinë me qëllim që të fitojë biznesi jo-mediatik që varet nga vullneti i qeverisë. Botuesit e gazetat detyrohen të censurojnë informacionin kritik mbi politikën dhe ekonominë jo sipas vendimeve të tyre të pavarura por sipas pozicionit të biznesit të pronarit të medias.

Redaktorët e gazetave po vihen nën presion që të marrin përgjegjësi për suksesin e biznesit të pronarit të tyre që ka rezultuar në fshirje të kufijve mes reklamës e gazetarisë. Të gjithë gazetat e përditshme botojnë shkrime shtesë të përjavshme mbi stilin e jetës, shëndetin, shtëpinë, me qëllim që të nxisin shitjet e produkteve.

Legjislacioni i media ka ndryshuar disa herë që por ai ende mbron interesat e elitave politike e ekonomike ndërkohë që ka mbetur mënjanë mbrojtja e interesave të qytetarëve Një ndryshim i rëndësishëm ndodhi në vitin 2004 kur e djathta sllovene erdhi në qeveri pas 12 vjet qeverisje koalicionesh të përziera nën drejtimin e Partisë së Demokracisë Liberale të Sllovenisë (LDS). Nën regjimin e LDS presionet kundër pavarësisë së gazetarëve ishin më të fshehura e metodat e kontrollit më të buta e më me pak rastesh konfliktesh të hapura. Ndërkohë nën qeverisjen e djathtë u ndërmorën 3 ndërhyrje të rëndësishme.

1. Në vitin 2005 Radio Televizioni i Sllovenisë u mor sërish e brutalisht nën kontroll nga qeveria. Sipas ligjit të ri të miratuar, anëtarët e bordit të këtij televizioni emërohen nga shumica parlamentare.

2. Në vjeshtë të viti 2005 qeveria i shiti aksionet e saj të mediave në disa kompani të mëdha e kjo si rrjedhojë mundësoi përqendrimin e shtuar të pronësisë private në pothuajse të gjithë gazetat me rëndësi përveç Dnevnik dhe Mladina. Por qeveria i shiti aksionet kapitalit aleat në shkëmbim të forcimit të ndikimit politik ndaj përzgjedhjes së gazetarëve dhe politikës editoriale. Ajo çfarë pasoi ishte periudha e terrorit më të ashpër mbi gazetarët

që nga mesi i viteve 80. Shumë gazetarë u pushuan, u transferuan, tekstet e tyre censurohen çdo ditë dhe e drejta për t'iu përgjigjur e për të ndrequr të metat shpërdorohet nga grupet e fuqishme që i zotërojnë këto media[2]. Pakënaqësitë me këtë situatë kulmuan me një peticion ndërkombëtar në vjeshtën e vitit 2007 në të cilin 571 gazetarë sllovenë[3] akuzuan kryeministrin Janez Jansha se po ushtronte presion ndaj gazetarëve.

Pas një grindje në vjeshtën e 2007 mes qeverisë e kompanisë monopoliste të pijeve Pivovarno Lasko, e cila ishte bërë me vullnetin e të njëjtës qeveri aksionarja kryesore e gazetës së përditshme Delo e Veçer si edhe ekzekutuese e terrorit më të ashpër kundër gazetarëve, drejtuesit kryesorë të këtyre gazetave u zëvendësuan. Politika editoriale filloi të bëhej qartazi pro-qeveritare e dukej gati të merrte forma të tjera sipas ndryshimeve të mundshme në zgjedhjet parlamentare të shtatorit 2008. Megjithatë situata në median sllovene vështirë se mund të përshkruhet si treg i medias së lirë. Gazetat e botuesi vihen nën presion të llojeve të ndryshme nga elitat e biznesit që lidhen me ato të politikës. Në vend të kushteve për një treg të mirë e pavarësi gazetarësh e shumësia mediash, sistemi slloven i medias i përket atij mesdhetar apo të tipit pluralist të polarizuar[4] me paralelizmin e instrumentalizimin politik të medias e me një profesionalizëm të dobët të saj.. Lufta me aksionet e pronësisë në media është pjesë e një procesi më të gjerë oligarkie. Pronar i mediave në shumicën e rasteve ka qenë qeveria dhe kompanitë brenda të cilave biznesi i medias nuk është pjesa kryesore e aktivitet të tyre ekonomik por i shërben si mjet për pakte jo –transparente me qeverinë.

Ndërkohë ndikimi i kësaj situate të mësipërme lidhur me shkrimet rreth Kosovës në median sllovene më së shumti është jo i drejtpërdrejtë. Përsa kohë Kosova nuk ishte çështje me rëndësi për politikën e brendshme sllovene, asnjë grup politik nuk ishte i interesuar në mënyrë të veçantë për mënyrën e mbulimit prej medias të kësaj ngjarje.

Arsyet për një cilësi pa pretendime rreth shkrimeve mbi Kosovën burojnë kryesisht prej ekonomisë së gazetave bashkëkohore të cilën e diskutoj

2 Një dëshmi tejet e rëndësishme për metodat e presioneve ndaj gazetarëve në këtë periudhë kohore u shkrua nga gazetari i Veçer dhe koautor i peticionit protestues Blazh Zgaga. Shiko: Zgaga, Blaž, »Dober Večer in lahko noč!« [Mirëmbrëma (apo gazeta e mirë Veçer, sepse në sllovenishte veçer do të thotë mbrëmje) dhe natën e mirë !]

3 Shoqata e Gazetarëve Sllovenë vlerëson se në vitin 2007 në Slloveni ka patur 1,697 gazetarë të punësuar, 420 të vetëpunësuar, dhe përafërsisht 400 gazetarë të punësuar por pa status. Numri i të nënshkruarve në peticionin protestues përfaqëson 22.7% nga të gjithë gazetarët profesionistë në vend dhe 33.6% nga numri i përgjithshëm i gazetarëve me punësim të rregullt – e dhëna e fundit është më e rëndësishme, sepse në kushte të presioneve të vazhdueshme, ishte e vështirë të pritej nga gazetarët e lirë (frilenserët) që të ekspozohen personalisht duke nënshkruar një protestë të tillë.

4 Ky tipizim është marrë prej: Hallin, Daniel C., dhe Paolo Mancini, Comparing Media Systems: Three Models of Media and Politics (Cambridge: Cambridge University Press, 2004), ashtu si është prezantuar në: Hrvatin Bašićc, Sandra, dhe Brankica Petković, In temu pravite medijski trg? : Vloga države v medijskem sektorju v Sloveniji [Vallë këtë e quani treg medial? : Roli i Qeverisë në sektorin medial në Slloveni].

në kapitullin përmbyllës. Një rezultat jo i drejtpërdrejtë mbi mediat në vitet e fundit që arrijnë të krijojnë një ndikim të caktuar mbi ngjarjet botërore, ishte fakti që ata të cilët vuajtën nga represioni i sipërpërmendur humbën disa nga gazetarët e tyre më të mirë si edhe një numër të konsiderueshëm lexuesish[5]. Kjo situatë e bëri median më të dobët profesionalisht e financiarisht e si rrjedhojë botuesit u detyruan të zvogëlojnë investimet mbi burimet njerëzore e buxhetin që lidhet me përgatitjen e lajmeve të ndërlikuara të karakterit ndërkombëtar.

III. ANALIZA E REZULTATEVE

III. a) Vërejtje të përgjithshme

Metodologjia sasiore që na është përcaktuar nga Instituti Maqedonas për Media synon të evidentojë tiparet e shumta formale të shkrimeve që lidhen me Kosovën. Metodologjia nuk përfshin mjetet për një analizë të detajuar të argumenteve e pikëpamjeve lidhur me problemin e statusit të Kosovës. Por ajo tërheq vëmendjen tek mënyrat e sistemit të produktit që nxjerr gazetari si edhe për trajtimin editorial të çështjes së Kosovës e aktorët e përfshirë në të. Ajo e drejton analizën në prioritetet e padukshme të këndvështrimit të medias lidhur me rastin e Kosovës dhe tregon gjithashtu mënyrën me të cilën përgatiten lajmet për Kosovën. Të dhënat e mbledhura që pasojnë metodologjinë sasiore, të kombinuara me këndvështrimin cilësor të një spektri të gjerë pikëpamjesh të këtij rasti, sipas epistemologjisë së imagjinatës kritike, mbushin dy prej boshllëqeve në mbulimin prej medias të situatës në Kosovë. Njëri, boshllëku mes informacionit të treguar e të patreguar dhe pikëpamjeve me këtë tast. Tjetri është ai mes paraqitjes së qëndrimeve pro e kundra të aktorëve kryesorë në këtë ngjarje, të raportuar normalisht në mënyrë objektive e të ekuilibruar si edhe media jo e drejtpërdrejtë apo pikëpamjet editoriale të cilat rezultojnë në një përzgjedhje të llojeve të ngjarjeve, aktorëve dhe vendeve me të cilat informohet lexuesi. Nga pikëpamja e epistemologjisë së përdorur këtu për imagjinatën kritike, të dhënat më interesante nuk vijnë nga krahasimi mes dy gazetave por nga tërësia e rezultateve brenda disa ndryshorëve, sa i përket domethënies së tyre: përmbajtja e shkrimit, vendi i veprimit, rasti për të cilin është shkruar artikulli, lloji i burimit të informacionit, lloji i shkrimit, autori i tij, numri i burimeve të informacionit. Rezultatet më domethënëse të këtyre ndryshorëve të kombinuar me këndvështrimin cilësor të perspektivave të mundshme interpretative, tregojnë mënyrën me të cilën u përgatitën shkrimet lidhur me Kosovën. Ky shqyrtim shtron pyetje të karakterit strukturor rreth mënyrës së produktit gazetaresk me përmbajtje nga bota që relativisht përbën një hori-

5 Sipas të dhënave të Odës së Reklamuesve Sllovenë, shitja e të përditshmes Delo ra prej 73.329 kopjeve në prill-qershor 2005 në 63,073 kopje në tetor-dhjetor 2007 (rënie prej 14%), kurse numri mesatar i abonuesve ra prej 59,953 në 52,542 në po të njëjtën periudhë (rënie prej 12.4%). Prej periudhës prill-qershor 2005 e gjer në tetor-dhjetor 2007 mesatarja e shitjes së gazetës Veçer ra prej 48,902 në 43,297 (11.5%), kurse numri mesatar i abonuesve u zvogëlua prej 41,252 në 37,889 (rënie 8.2%). Shiko: http://www.soz.si/projekti_soz/preglednica_revidiranih_prodanih_naklad/.

zont të ngushtë gjatë mbulimit të vendeve e grupeve periferike të njerëzve. Së fundi ngrihet çështja e praktikave të mira gazetareske në bazë të kushteve jo –nxitëse të punës. Këto dy çështje do të diskutohen në kapitullin përmbyllës.

III. b) Një përshkrim i shkurtër i dy gazetave të analizuara

Gjatë studimit tim analizova mbulimin e ngjarjeve në Kosovë në dy gazeta të përditshme sllovene, gjatë periudhës janar – shkurt 2008. Të dy gazetat Delo dhe Veçer janë serioze dhe mbulojnë një spektër të gjerë fushash e shpërndahen në të gjithë Slloveninë. Delo ka statusin e gazetës më serioze e më të rëndësishme në nivel kombëtar. Delo së bashku me Radio Televizionin e Sllovenisë është një ndër mediat me kapacitetin më të madh profesional në Slloveni. Delo kishte ekspertët më të fortë të gazetarisë deri para sulmit të përmendur më lart prej qeverisë e kapitalit privat në vjeshtën e vitit 2005. Pas kësaj ajo humbi një sërë gazetarësh e staf teknik me përvojë por sërish mbetet një gazetë që ka një rrjet të fortë korrespondentësh ndërkombëtarë. Delo zotëron arkivin më të madh të medias në vend. Nga ana tjetër Veçer është më së shumti një gazetë e karakterit rajonal, me qendër në Maribor të Sllovenisë. Përmbajtja e saj është kryesisht lokale e mbulon gjysmën e pjesës verilindore të Sllovenisë por trajton edhe tema me rëndësi kombëtare. Rrjeti i saj korrespondentëve është më i dobët dhe redaksitë e saj mbështeten në një masë më të madhe se Delo tek agjencitë e lajmeve. Formati i shkrimeve të saj është më i vogël se Delo kështu që s'ka shumë hapësirë për të mbuluar marrëdhëniet ndërkombëtare.

Vlerësimi i përgjithshëm është se Veçer ka kapacitete të kufizuara për të trajtuar lajmet ndërkombëtare ndërsa Delo duket se ka mundësi më të mëdha për të paraqitur në mënyrë të shumanshme tema të tilla si Kosova. Çështja është nëse e përmbushi Delo këtë sfidë gjatë kësaj kohe.

Duhet të shtojmë edhe diçka tjetër. Metodologjia e paraqitur i përjashtonte gazetat e përjavshme nga analiza e materialit. Gazetat sllovene, duke përfshirë edhe këto të dyja që kemi marrë në shqyrtim, botojnë suplemente të dielave ku paraqiten analiza të thelluara intelektuale për çështje politike, sociale e kulturore. Një përfshirje e këtyre suplementeve do të na jepte një pamje më të ndryshme sa i përket interpretimeve mbi situatën në Kosovë dhe domethënien ndërkombëtare të procesit të fitimit të pavarësisë.

III. c) Dallimet sasiore të mbulimit të çështjes së Kosovës mes gazetave Delo dhe Veçer

Nga një vështrim i përgjithshëm mbi analizën sasiore, vërehet se mes të dy gazetave, nuk ka një ndryshim të thellë mes strukturës së shkrimeve mbi Kosovë, gjatë periudhës janar-shkurt 2008. I vetmi dallim mund të interpretohet si pasojë e kapaciteteve të ndryshme, formatit dhe strukturës së gazetave.

Dinamika e përkohshme e shkrimeve të botuara rreth Kosovës ishte më e dendur rreth Ditës së Pavarësisë tek gazeta Veçer sesa te Delo. Numri i artikujve të botuar për Kosovën tek Veçer ishte 167 apo 77.3% përkundër 216 të tilla që botuan tek gazeta Delo. Një dallim i dukshëm është mes shkrimeve që fillojnë në faqen e parë: këto janë rreth 62 tek gazeta Delo (28.7%) dhe vetëm 13 (7.8%) tek Veçer dhe që u botuan në ditët kyç të periudhës së shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Arsyeja për këtë ndryshim mes të dy gazetave është teknike pasi Veçer ka në format faqe shumë më të vogël e më me pak hapësirë për të përfshirë në faqen e parë një numër më të madh shkrimesh. Ndërkohë 4.6% e artikujve mbi Kosovën të botuar në gazetën Delo ishin editoriale në faqe të parë ndërsa Veçer nuk botoi asnjë lloj shkrimi të tillë. Një situatë e ngjashme vërehet edhe me botimin e karikaturave (5.1% tek Delo vs 1.2% tek Veçer) teksa Delo i botonte në faqe të parë ndërsa Veçer e përdorte atë rastësisht brenda faqeve të të tjera. Disa të dhëna tregojnë kapacitetet e ndryshme të gazetarëve. P.sh Delo botoi më shumë korrespondenca (12.5% vs 9% të Veçer) e analiza (2.7% vs 0% të Veçer) por Veçer e kompensoi mungesën e gazetarëve të specializuar në çështjet ndërkombëtare me një përqindje të lartë shkrimesh nga autorë të huaj mbi çështjen e Kosovës (4.2% tek Veçer vs 2.8% në gazerën Delo).

Një pjesë interesante e të dhënave që mbështetet mbi njohuritë e brendshme nga gazetat është edhe përqindja e gazetave. Ky raport është 0.5% tek Delo vs 1.8% tek Veçer e cila botoi shtatë të tilla. Rreth 21% e shkrimeve të gazetës Veçer i përkiste llojit të lajmeve ndërsa kjo përqindje tek Delo ishte 8.8%. Mbështetja tek agjencitë e lajmeve për shkrimet e botuara ishte më e lartë tek Veçer, por siç do të argumentojmë më vonë edhe Delo varet shumë prej tyre. Agjencitë e lajmeve dhe mediat e tjera ishin autorë të 37% të artikujve në gazetën Delo dhe të 17.4% të tyre tek Veçer. Nga ana tjetër 50.3% e shkrimeve të Veçer nuk deklaronin burime ndërkohë që kjo shifër për gazetën Delo ishte 35.6%. Ndërkohë në rreth 25.9% të shkrimeve në gazetën Delo deklarohet vetëm 1 burim informacioni. në 17.1% të tyre dy dhe 20.8% e tyre kanë 23 ose më shumë burime të tilla. Ndërsa tek gazeta Veçer këto përqindje ishin shumë më të ulëta: 32.3% ; 9.6% dhe 7.8%. Struktura e burimeve të informacionit rezulton edhe në struktura të ndryshme sa i përket llojit të ngjarjeve dhe rastit që kishte shërbyer për të shkruar artikullin. Tek 34.7% e artikujve të gazetës Delo informohemi për ngjarje në kohë reale dhe po e njëjta përqindje është për pseudo-ngjarjet, ndërkohë tek gazeta Veçer vetëm 26.3% e shkrimeve flasin për ngjarje të tilla ndërsa 45.5% u kushtohen pseudo ngjarjeve. Veçer është një gazetë me hapësira të vogla për shkrimet kështu që është pjesë e koncepti të saj që 47.3% e shkrimeve të përmbajnë fotografi (kjo shifër tek Delo është 35.2%) ndërkohë që mesazhet e materialeve me fotografi të gazetës Veçer ishin shumë më asnjanëse e mbushnin hapësirën në faqe në rreth 67.1% të tyre ndërsa 29.4% nuk e vinin në pah në mënyrë interpretuese mesazhin që përmbanin. Ndërkohë tek gazeta Delo këto përqindje qëndronin në raportin 55.1% me 34. 8%.

Në njërin nga ndryshorët më të rëndësishëm, përmbajtja e shkrimeve, struktura e rezultateve ishte e njëjtë në të dy gazetat. Dallimi i fundit ishte

një përqindje më e lartë e shkrimeve ku Sllovenia përmendet si vendveprimi i ngjarjes (tek Veçer në 58.1% të shkrimeve ndërsa tek Delo në 67.7% të tyre) në raport me vendet e treta (26.3% tek Veçer dhe 16.7% tek Delo).

Ky krahasim me të dallime të vogla sa i përket të dhënave sasiore vërteton pritshmërinë se Veçer është një gazetë me mjete më të kufizuara e nuk është e orientuar drejt çështjeve ndërkombëtare, është më e varur nga shërbimet e informacionit të agjencive të lajmeve si edhe ka një format më të vogël e më të lehtë për të lexuar strukturën e shkrimeve. Nga ana tjetër ajo u përpoq ta kompensonte mungesën e kapaciteteve në lajmet ndërkombëtare me përfshirjen më të madhe të ekspertëve të huaj për të ofruar informacion të gjithanshëm e me rëndësi për çështjen e Kosovës. Në këtë drejtim Delo ishte më pak e suksesshme ndoshta për shkak të mbështetjes së saj mbi fuqinë e brendshme të gazetarëve, një numër korrespondentësh në rajon si edhe të një departamenti me gazetarë që kanë njohuri të pasura mbi çështjet ndërkombëtare e që kanë mundësi të shkruajnë komente.

III. d) Analiza e të dhënave sasiore përmes perspektivës së pikëpamjeve të mundshme: qëndrimi i nënkuptuar editorial mbi Kosovën.

Në këtë pjesë të studimit unë do të përdor të dhënat mesatare të të dy gazetave, përveçse në rastet kur shfaqet ndonjë e dhënë e veçantë për to,për shkak se dallimet mes tyre lidhur me mbulimin e çështjes së Kosovës ishin relativisht shumë të vogla. Të dy mbulimet ngërthejnë probleme të përbashkëta strukturore sa i përket trajtimit të çështjeve ndërkombëtare e që janë me rëndësi për këtë lloj medie.

Shumica e shkrimeve të botuara tek gazetat Delo dhe Veçer u përkisnin llojeve informative gazetareske. Rreth 47% e tyre ishin lajme të zgjeruar. Llojet interpretuese letrare (analizat, intervistat, komenti, editoriale, autorët jo-gazetarë) ku paraqiten interpretime më të gjithanshme përfshinin 19% të të gjitha artikujve të botuar. Përfshirja e suplementeve javorë do të na jepte një pamje më të ndryshme sa i përket situatës në Kosovë dhe domethënies ndërkombëtare të këtij procesi në fitimin e pavarësisë, por këto botime u përjashtuan metodologjikisht nga analiza e materialit.

Llojet e shkrimit informativ gazetaresk në përgjithësi japin informacion për ngjarjet reale (dhe ato përbënin 49.3% të artikujve të analizuar) apo ngjarjeve të imagjinuara, që konsistojnë në përgjigjet e aktorëve me ndikim politik në ngjarjet reale (kategoria e pseudo-ngjarjeve përbënte 39.4% të shkrimeve ndërsa to të ngjarjeve në periudha të ndryshme kohe ishin 10%). Duke informuar për ngjarjet dhe përgjigjen e lojtarëve ndaj tyre, tekstet informative gazetareske paraqesin disa pikëpamje lidhur me situatën në Kosovë, por spektri i tyre është relativisht i ngushtë. Vetëm një pakicë artikujsh ishin të suksesshëm përgjatë evidentimit të atyre elementëve të situatës që shmangen ka këndvështrimi kryesor, i cili më së shumti informon për ak-

tivitetet diplomatike të shteteve të treta dhe ngjarjet spektakulare të tilla si shkëputja apo dhuna që ndodh në vende periferike si Kosova.

Në nënkapitullin "I b) Argumentimet sa i përket statusit të Kosovës" unë diskutova qëndrueshmërinë e këndvështrimeve më popullore sa i përket pavarësisë së Kosovës. Unë rendita pesë grupe arsyesh dhe vëzhgimesh në përkrahje dhe kundër pavarësisë: nevojat e popullsisë së Kosovës, mungesa e institucioneve publike, vuajtjet e kaluar të viktimave, legalizmi dhe realizmi. Në shumicën e rasteve të shkrimeve të analizuara (shumica u përkasin llojeve informative të shkurtra) në edicionet e përditshme të dy gazetave sllovene, paraqiten dy qëndrime shumë të kundërta sa i përket statusit formal ndërkombëtar të Kosovës: njëri nga shqiptarët e Kosovës, që me mbështetjen e fortë të SHBA nuk tërhiqen nga kërkesa për shkëputje, të cilit i kundërvihen fort Rusia e Serbia. Secila palë paraqitet tek përsërit një argument: atë të viktimës dhe atë formalist. Tema e përbashkët e paraqitur nga këta aktorë që kanë kundërshtuar pavarësinë e Kosovës ishte kërkesa për të respektuar të drejtën/ligjin ndërkombëtar që mbron sovranitetin e shteteve mbi territoret e tyre dhe autorizon Këshillin e Sigurimit të OKB të vendosë regjime e masa përjashtuese për shtetet.

Argumenti i kundërt që paraqitet më shumë në shkrimet e analizuar është ai se Kosova është një rast sui generis ku dhunimet masive të të drejtave të njeriut kanë krijuar një situatë ku shumica e popullsisë shqiptare në Kosovë i ka refuzuar autoritetet serbe. Por analiza sasiore, duke marrë në konsideratë një masë të gjerë pikëpamjesh, jep një pamje krejt të ndryshme të qëndrimit të gazetave lidhur me atë se çfarë është me rëndësi në ngjarjet në Kosovë. Përzgjedhjet e Delo-s dhe Veçer-it për qëndrimet me rëndësi rreth kësaj ngjarje nënkuptonin mbështetjen ndaj paradigmës realiste të interpretimit të çështjes së Kosovës. Ndryshorët kyç sasior janë dy të fundit: ata mbulojnë "përmbajtjen kryesore të shkrimit gazetaresk" dhe "vendin ku zhvillohet veprimi i ngjarjes". Vetëm 14.6% e artikujve të analizuar shkruajnë rreth të drejtës për vetëvendosje dhe pavarësinë. Shumica e shkrimeve vendosen në Kosovë dhe raportojnë rreth ndjenjave, emocioneve, opinioneve të shumicës së popullsisë së Kosovës gjatë festimit të pavarësisë. Nga ana tjetër, 43.1% e artikujve që lidhen me Kosovën të informojnë rreth lëvizjeve diplomatike të cilat u kryen nga shtete të fuqishme (SHBA, Rusi, BE) dhe vetëm 1% e tyre informojnë lexuesit rreth veprimtarisë diplomatike të politikanëve kosovarë.

Përveç kategorisë diplomatike të aktiviteteve diplomatike nga vendet e treta 20.1% e shkrimeve bëjnë fjalë rreth politikës së brendshme në Serbi (tema të tilla si zgjedhjet presidenciale, firmosja e MSA me BE) ku situata në Kosovë është një ndër çështjet e saj.

Një diçka e ngjashme ndodh edhe me aspektin gjeografik: vetëm 15.7% e veprimit në artikujt e botuar ndodh në Kosovë ndërsa 63.4% e ngjarjeve të paraqitura lidhen me ndikimin e statusin e Kosovës në vende të

tjera (p.sh Serbia) dhe 20.9% e tyre në Slloveni. Vëzhgimi thelbësor rreth qëndrimit të nënkuptuar editorial të gazetave Delo dhe Veçer në çështjen e Kosovës është se Kosova nuk trajtohet si një lojtar më vete e ne rëndësi në lojën diplomatike të përcaktimit të statusit të saj ndërkombëtar. Kosova ishte shumë e papërfaqësuar si faktor edhe në fazën e veprimit dhe mund të arrimë në përfundimin se ajo u trajtua si subjekt i nënrenditur në marrëdhëniet ndërkombëtare. Mesazhi i dytë i nënkuputuar dhe i rëndësishëm i politikës editoriale të dy gazetave, të cilat raportuan kryesisht mbi diplomacinë dhe statusin formal por jo rreth situatës së jetesës në vend, ishte se popujt e vegjël nuk janë të rëndësishëm e nevojat e tyre s'merren parasysh: ajo çfarë duket si thelbësore ishin përplasjet e interesave mes lojtarëve të fuqive të mëdha sesa fati i popullit të Kosovës.

Ilustrimi më i qartë e kritik i rendit të temave me prioritet editorial u krijua nga karikaturisti i Delos- Marko Kovecar. Më 21 shkurt 2008 në gazetën Delo ai botoi karikaturën që titullohej "Duke fluturuar mbi folenë e kukuvajkës". Tre shqiponja të shqetësuar fluturonin rreth folesë që qëndronte në majë të një shkëmbi të vetmuar. Në fole një shqiponjë e hutuar serbe, shikonte poshtë ku qëndronte pa u trembur një shqiponjë e re shqiptare me 2 koka e cila ra nga foleja. Shqiponja me dy koka qe një çikë e zhgënjyer që e gjithë vëmendja ishte për shqiponjën serbe megjithëse ishte vetë më e dobët e kishte më shumë nevojë për mbështetje.

Rezultatet e tjera të ndryshores sasiore "përmbajtja e teksteve gazetareske" tregonin gjithashtu qëndrimin editorial për të mos e marrë në konsideratë situatën e brendshme në Kosovë. Rreth 8.9% të artikujve të analizuar shkruajnë rreth dhunës (kryesisht në ditët pas deklaratës së pavarësisë kur ndodhën incidentet e dhunshme në Beograd, Mitrovicë dhe kufirin mes Kosovës e Serbisë) dhe 4.4% u kushtohen tensioneve ndër-etnike. Struktura e përmbajtjeve të shkrimeve e paraqiste të tillë situatën në Kosovë në të cilën komunitetet shqiptare e serbe kanë jetuar të ndarë edhe sipas kuadrit institucional ashtu sikurse nuk kishte asnjë marrëdhënie mes komuniteteve por as konflikt të pastër për të mos folur për bashkëpunimin ndëretnik. Konflikti ndërkombëtar diplomatik mes protagonistëve e antagonistëve të pavarësisë u mbulua në një shkallë më të madhe prej mediave sesa tensionet e brendshme në shoqërinë kosovare, megjithëse kjo e fundit do të mbetet një problem për një kohë të gjatë në këtë vend.

Ndërkohë nuk u vërejtën shumë shkrime që bënin fjalë për zbatimin e ligjit në shtetin e porsalindur të Kosovës(7-8%). Shumica e tyre flisnin rreth masave diplomatike e administrative perëndimore për t'iu imponuar Kosovës nga jashtë. Vetëm 12 nga 383 artikujt e analizuar, lidhen me çështjet ekonomike në këtë vend e jo më shumë se 5 prej tyre japin veçse një informacion të shkurtër mbi ekonominë e Kosovës. Vetëm 3 artikuj të botuar në gazetën Veçer (dy prej tyre u shkruan nga intelektualë të njohur kosovarë si Veton Surroi dhe Nehat Sadiku, një politolog që jetonte në Slloveni, ndërsa e treta ishte një intervistë me ekspertin slloven për sigurimet shoqërore Vl-

lado Dimovski që kishte qenë për 1 vit këshilltar në Kosovë), dhe një në Delo (nga albanologu slloven Dargo Flis), të cilat janë një pamje relativisht më te gjerë te situatës ligjore, institucionale e ekonomike në vend. Rishikimi i llojeve interpretative të shkrimit gazetaresk (analiza, komente, editoriale) nuk shfaqin ndonjë dallim lidhur ne ato të karakterit informativ. Përveç një pakice të tyre, të gjithë paraqesin aspektin ndërkombëtar të çështjes, ndërkohë që problemet e brendshme strukturore në Kosovë përmenden shkurtazi dhe kryesisht si një subjekt për t'u menaxhuar apo frenuar nga institucionet e huaja.

Lexuesit patën mundësi të marrin në informacion mbi ndryshimet e thella e të shpejta strukturore që kishin ndodhur në Kosovë vetëm nga 4 tekste të përmendura në paragrafin e mëparshëm. Në fakt ata lexues sllovenë që mbështeten vetëm tek media vendase vështirë se kanë ndonjë ide rreth faktit se proceset më të rëndësishme në Kosovë zhvillohen jashtë institucioneve: urbanizimi modernizimi vlerave, rënia e lindshmërisë, problemet infrastrukturore dhe ekonomia joformale që mbështetet tek ndihma e kontrabanda.

Pyetja kryesore është se cilat janë shkaqet për një pakësim të tillë të informacionit e interpretimit rreth një vendi që shtrihet relativisht afër Sllovenisë dhe me të cilin shumë qytetarë sllovenë kanë kontakte të pasura profesionale e private? Ka individë në Slloveni që njohin në situatën në Kosovë shumë mirë dhe që njohin njerëz të mirinformuar në Kosovë. Pse nuk bënë asnjë përpjekje të vogël të dy gazetat që të përdorin këto lidhje me qëllim që të ofrojnë një informacion më të shumanshëm e kritik? Një përgjigje mund të burojë prej të dhënave nga burimet e përdorur e të deklaruar në shkrimet e botuara për Kosovën.

Artikujt që u përkasin llojeve informative gazetareske zakonisht japin një përshkrim të shkurtër të një ose më shumë ngjarjeve (ngjarjeve që kanë ndodhur në kohë të ndryshëm). Mirëpo, 42% e teksteve nuk citonte burime. Kur citoheshin një ose më shume burime, zakonisht nuk pasqyronin autenticitetin e të gjitha burimeve. Në shume raste, burimet e cituara qartë ishin mediat e tjera, p.sh, atëherë kur gazetaret informonin për reagime ndaj ngjarjeve ose fushatave të bëra në media. Në pamje të parë, leximi i gazetave si Delo dhe Veçer duket se sjell një vështrim piktoresk, dinamik dhe me shumë perspektiva, po në të njëjtën kohë edhe të moderuar dhe neutral të ngjarjeve, kontekstit të tyre dhe reagimeve ndaj tyre. Por mungesa e shpeshtë e burimeve të cituara, të cilat do të garantonin vërtetësinë e deklaratave, dëshmon për rutinën e riprodhimit të informacionit në media, pasi këto burime janë aq të njohura, të zakonta dhe gjenden në të gjitha mediat e rëndësishme, saqë duket se nuk është nevoja të citohet origjina e tyre, nëse puna e gazetarit konsiston në hartimin rutinë të informacionit tipik, pa asnjë përpjekje shtesë për hulumtim apo analizë. Ky lloj informacioni përcillet nga disa agjenci lajmesh oligopoliste.

IV. PERFUNDIMET

Në shënimet përmbledhëse do të vë në dukje disa dimensione strukturore te situatës në gazetarinë që pasqyron çështjet e jashtme dhe shkurtimisht do të propozoj disa kushte profesionale personale, të cilat do të siguronin një praktikë të mirë gazetareske në kushtet e vështira të punës.

IV. a) Mënyra e prodhimit te lajmeve: nga shërbimet e marrëdhënieve me publikun, te agjencitë e lajmeve dhe te gazetaret

Agjencitë e lajmeve hartojnë agjendën e atyre që supozohen të jenë ngjarje dhe interpretime të rëndësishme, të cilat reflektojnë interesat dhe perspektiven e grupeve më të fuqishme në bote. Praktika e tyre është i ashtuquajturi realizëm, një paradigmë që përshkruan boten nga perspektiva e lojtareve të pakët politikë dhe ekonomikë dhe bashkëveprimit mes tyre. Kosova dukej se ishte një histori e rëndësishme për të vënë në pah zënkën midis lojtareve të mëdhenj dhe jo se ishte e rëndësishme në vetvete. Një interpretim i tille nënkuptohet në shërbimet e agjencive të lajmeve që mbizotërojnë dhe me pas transferohen, riprodhohen, shpërndahen dhe konfirmohen nga të ashtuquajturat media serioze kombëtare, si Delo dhe Veçer. Lajmet e agjencive kryesore janë zgjedhur dhe kontrolluar paraprakisht dy here para se gazetarët të shkruajnë për to, në fillim kur shërbimet profesionale të komunikatave për shtyp në institucionet e rëndësishme i krijuan ato dhe së dyti kur agjencitë kryesore të lajmeve i përmblodhën ato.

Arsyeja e riprodhimit të lajmeve dhe të axhendes nga agjencitë e lajmeve në mediat e tjera duhet kërkuar në mënyrën bashkëkohore të prodhimit në media, sidomos në gazeta. Gazetat serioze janë në krizë ekonomike pothuajse kudo dhe administrata po i detyron redaksitë të ulin kostot. Gazetat reduktojnë rrjetet e korrespondenteve ndërkombëtare dhe ajo që është akoma më e rëndësishme, korrespondentet kanë një buxhet te kufizuar për udhëtim dhe hulumtim dhe janë të detyruar t'i bazojnë tekstet e tyre te shërbimet e agjencive të lajmeve dhe te akreditimi i mbledhjeve shtetërore. Për gazetaret është e vështire të shkruajnë në mënyre më krijuese dhe kritike, pasi kane mundësi financiare të kufizuara për ketë qellim dhe sistemi i kushteve të tyre të punës nuk nxit shkrimin në mënyre më kritike dhe të thelluar.

Një nga të dhënat më habitëse për gazetën Delo është që pavarësisht rrjetit relativisht të pasur të korrespondenteve, arriti të botonte vetëm një interviste në lidhje me Kosovën për dy muaj. Duket se nuk ka ndonjë dallim të madh midis sistemit dhe rezultatit të lajmeve të sjella nga korrespondentet dhe nga redaksia: të dyja grupet e gazetarëve ulen në zyrat e tyre të lidhura me disa agjenci lajmesh të bazuara në Perëndim dhe rishkruajnë informacion të përzgjedhur dhe të kontrolluar paraprakisht. Largësia e tyre nga jeta e përditshme në vendet për të cilat shkruajnë është pothu-

ajse e njëjta, pavarësisht vendndodhjes se zyrave. Dallimi i vetëm është që korrespondentët e jashtëm lexojnë të përditshmet lokale, por pasqyrimi i Kosovës, p.sh. edhe në median serbe, ishte po aq i largët sa ai i medias sllovene, ndërkohe që asnjë nga gazetat sllovene nuk ka pasur korrespondent të përhershëm nga Kosova.

IV. b) Horizonti i interesit vetjak te lexuesit

Kriza ekonomike e gazetave krijon një rreth vicioz, në të cilin gazetat kryejnë pamjaftueshmërisht funksionin e tyre publik të edukimit të qytetarëve për një pjesëmarrje të mirinformuar dhe të përgjegjshme në jetën publike. Rrethi vicioz fillon me ekonominë e prodhimit të lajmeve, i cili rezulton në një informim të cekët të ngjarjeve në botë dhe kjo shkakton injorance dhe pandjeshmëri për fatet në botë te konsumatorët e medias kryesore me fuqi më të madhe blerjeje, p.sh. te anëtaret e klasës se mesme dhe të biznesit në Perëndim. Nëse për pasoje këto nuk kërkojnë lajme të larmishme nga bota, kërkesa e ulet e tregut për këto mallra informative justifikon uljen e kostove. Historitë nga bota e pazhvilluar anashkalohen pasi konsumatorëve të pasur të medias nuk u intereson jeta e shumicës dërrmuese të popullsisë në botë dhe anasjelltas: mungesa e informacionit nga bota e tretë si dhe nga shtresa më e varfër qe jeton në vendet e pasura lejon që konsumatorët e pasur të medias të shijojnë jetesën e tyre pa ndonjë shqetësim. Për më tepër, perspektiva e tyre shpesh legjitimohet nga paragjykimet ndaj njerëzve të anashkaluar, për shembull paragjykimi që njerëzit në Kosovë në thelb priren të jenë kriminele dhe ata që kanë këtë paragjykim arrijnë në përfundimin që shteti i pavarur i Kosovës do t'i zgjeronte në vend që t'i zgjidhte problemet e krimit, etj.

Konsumatorët e pasur dhe egoiste të medias diktojnë kërkesën për axhendan e medias dhe kjo është arsyeja pse rasti i vetëm kur një vend si Kosova do të hynte sërish në faqet e para të gazetave kryesore do të ishte nëse vendi do të shfaqej si një burim kërcënimi për banorët e vendeve të pasura: refugjatët, ekstremistët, etj., ndërsa tregtia e drogës, trafikimi i njerëzve dhe migracionet ekonomike tashmë mendohen si fenomene relativisht normale.

Ka edhe tri të dhëna sasiore interesante për pasqyrimin e medias në Kosovë. Delo dhe Veçer nuk botuan asnjë artikull në lidhje me Kosovën të shkruar nga ndonjë politikan slloven. Ndërhyrja e vetme publike nga personalitetet e rëndësishme u bë nga shoqata sllovene e menaxherëve, të cilët paralajmëruan qeverinë të mos e njihte Kosovën shume shpejt, në mënyre që të mos përkeqësoheshin marrëdhëniet ekonomike me Serbinë, ku kompanitë sllovene kanë shumë më tepër tregti dhe investime sesa në Kosovë. Në janar dhe shkurt 2008 vetëm një letër nga lexuesit në lidhje me Kosovën u botua në të dyja gazetat. Letra u botua në Veçer dhe me të gjitha gjasat shkruhej nga një serb etnik që jetonte në Slloveni. Duket sikur sllovenët kanë qenë pothuajse shpërfillës ndaj situatës në Kosovë, pasi në përgjithësi nuk janë të interesuar për çdo çështje që nuk ndikon në jetën e tyre private dhe në kushtet në vend.

Një pjesë e shpjegimit për një qëndrim të tillë karshi pjesës tjetër të botës vjen nga gjendja post-socialiste, ku njerëzit u depolitizuan, interesat e tyre u kthyen në interesa private dhe ndjenja e tyre për gjendjen globale apo edhe rajonale dhe ndjenja e solidaritetit pothuajse u treten, me përjashtimin e donacioneve humanitare. Njëzet vjet me parë, ndërgjegjja politike në Slloveni ishte krejt ndryshe: intelektualet, politikanet dhe njerëzit e thjeshtë ishin të gatshëm të mbronin të drejtat njerëzore të shqiptarëve të Kosovës pasi ekzistonte një konsensus i gjerë për mbrojtjen e lirisë sllovene në Kosovë si dhe për mbrojtjen e lirisë së Kosovës në parim. Një shpjegim tjetër është më i përgjithshëm dhe vlen për të gjithë botën demokratike: publiku kritik gjendet në një krizë të thellë strukturore, ashtu si e përshkroi Jürgen Habermas në vitin 1962 në librin e tij shterues Strukturwandel der Öffentlichkeit ("Transformimi strukturor i sferes publike"). Për pasojë, qytetaria dhe demokracia aktive janë edhe ato në një krize serioze.

IV. c) Gazetat nuk arrijnë të përmbushin detyrën e përcjelljes së informacionit kritik për qytetaret

Kriza e gazetarisë klasike autonome dhe kritike nuk është vetëm ekonomike – ajo lidhet edhe me legjitimimin e profesionit të gazetarit. Kur gazetaret përballen me presion të hapur ata zakonisht paralajmërojnë duke ngritur zërin për interesin publik të cilit thuhet se i shërbejnë. Por realiteti i tyre i punës i detyron të kryejnë operacione përsëritëse, pa i nxitur të reflektojnë kushtet e punës, rezultatet e punës dhe pasojat në sferën publike, së cilës gazetaret i referohen. Gazetaret besojnë se profesionalizmi është kura kundër punës së dobët. Por standartet profesionale të dëshiruara, si përdorimi i disa burimeve dhe citimi transparent i tyre nuk përbejnë kompensimin e duhur për kufizimet që sjell vetë mënyra e prodhimit në gazetari, e cila në heshtje imponon një axhendë të kufizuar të temave, interpretimeve dhe pikëpamjeve. Për pasojë, media nuk arrin të përmbushë detyrën më të thjeshtë që legjitimon autonominë e gazetarëve: detyra e tyre është të përcjellin informacion kompleks për qytetaret me qellim që t'i aftësojnë ata të krijojnë qëndrime kompetente për çështje të ndryshme publike.

Pasqyrimi i cekët dhe i kufizuar i Kosovës në dy gazetat sllovene është prova e një dështimi të tillë. Është e qartë që gazeta si Veçer dhe Delo shkruajnë për lexuesit e tyre në vend, perspektiva e të cilëve është mjaft provinciale. Ata janë të interesuar pothuajse vetëm për atë që ndodh në zonën e tyre, ndërsa pjesa e tjetër e botës duket se bëhet e rëndësishme vetëm kur ajo ndërhyn në realitetin e lexuesve vendas. Por edhe nëse Kosova përben një temë interesante vetëm kur prodhon telashe ndërkufitare, pasqyrimi i gazetave sllovene sërish ka qenë shumë i ceket dhe miop sa i përket vizionit dhe shpjegimit. Në pasqyrimin e gazetave që u analizua pothuajse nuk kishte asnjë shenjë që redaktoret ishin të ndërgjegjshëm për telashet e mundshme që mund të shpërthenin në Kosove së afërmi.

Për vite me radhë, gjendja e vazhdueshme e dëshpëruar në Kosovë

është bëre më e durueshme fale premtimeve të politikaneve për një jetë më të mirë pas shpalljes së shtetit të pavarur. Ky qëllim kombëtar tashmë është përmbushur më së shumti, por gjendja sociale dhe ekonomike nuk është përmirësuar. Vendi është plot me të rinj, të cilët duke parë kanalet televizive satelitore perëndimore, kane të njëjtat vlera dhe pritshmëri si perëndimorët, por perspektiva e tyre ekonomike mbetet e varfër. Askush nuk e di sa kohe do ta duroje popullsia këtë gjendje dhe do të pranojë të kompensojë varfërinë me nacionalizmin. Struktura e shoqërisë në Kosovë është e tille që është një fuçi e mundshme baruti për shkak të pakënaqësisë serioze sociale. Duke marre parasysh statusin e margjinalizuar të shkrimeve të gazetave sllovene për gjendjen sociale dhe ekonomike në Kosovë, nuk është e qarte nëse këto redaksi do të jenë në gjendje të parashikojnë mundësinë e një shpërthimi të tillë dhe nëse kanë grumbulluar informacion për t'u aktivizuar në një rast të tillë. Si do të reagonin dhe si do të interpretonin gazetat këto ngjarje, nëse do të ndodhnin? Do të ishin në gjendje të kontaktonin vetë ekspertet apo do të mbështeteshin sërish te shërbimet e agjencive të lajmeve dhe te klishetë e mundshme që përcjellin ato?

IV. d) Praktika e mire gazetareske

Ka diçka që mbetet në pushtetin e gazetarëve për t'u bërë, pavarësisht buxheteve të tyre të kufizuara. Një gazetar i mirë duhet të jetë një analist i mirë, në gjendje për të reflektuar dhe kuptuar implikimet e punës rutinë me lajmet. Ajo që është kryesore është kultivimi i ndjenjës së perspektives, e cila fshihet nga burimet kryesore, d.m.th. zhvillimi i imagjinatës kritike. Kjo gjë shoqërohet edhe me aftësinë për të njohur dhe kuptuar kompleksitetin e botës. Një kusht i domosdoshëm për gazetarinë kritike është edhe mbajtja e një qëndrimi të fuqishëm etik ndaj situatave për të cilat shkruhet, me qëllim që të mos bjerë pre e distancës cinike për gjithçka.

Një rast tipik i praktikës së mirë gazetareske në dy gazetat sllovene për Kosovën ishin shkrimet e Bostjan Videmsek, një korrespondent në lëvizje i Delo, i specializuar për krizat dhe luftërat. Videmsek njihet për stilin dramatik të të shkruarit dhe i pëlqen të shkruajë në zhanret e reportazhit dhe intervistës kryesisht. Është në gjendje të përshkruaje spektaklin me mjete letrare shprehëse dhe priret paksa të shkruajë në një mënyrë sensacionale. Por ajo që është me të vërtete e vlefshme dhe e jashtëzakonshme për të është që në krahasim me gazetarinë kryesore rutinë, ai është një nga gazetarët e rralle sllovenë me një ndjenjë të spikatur për gjendjen e viktimave dhe të njerëzve të zakonshëm. Jeta e njerëzve të thjeshtë është ndoshta problemi më i rëndësishëm për Videmsek dhe gjithnjë përpiqet të paraqesë gjendjen nga pikëpamja e vet, por të kombinuar me ekspozimin e problemeve interesante nga ana analitike. Në shkrimet e tij për Kosovën midis 16 dhe 23 shkurtit, kur u dërgua në Kosovë dhe Serbi, ai theksonte qarte dimensionin e traumës post-konflikt, por edhe vetëpërgjegjësinë si përfitim dhe sfidë kryesore për popullin e Kosovës pas shpalljes se pavarësisë.

Rasti i shkrimeve te Videmsek zbulon dimensionet e pasqyrimit të cilat pothuajse mungojnë krejtësisht te koleget e tij, të cilët kryesisht riprodhojnë informacion për ngjarje jospontane, ku udhëheqësit botërore luajnë rolin kryesor. Për pasojë, gazetaret shkruajtën për Kosovën nga perspektiva realiste, duke paraqitur domethënien e pavarësisë si një provë të pushtetit të pandalur te SHBA, ose disa të tjerë, sidomos në editorialet e Veçer, shprehën një skepticizëm të matur për efikasitetin e shtetit të Kosovës dhe për pasojat e tij si precedent për lëvizje të tjera separatiste. Nga pikëpamja e popullit të Kosovës, krijimi i një shteti sovran është para së gjithash një mundësi për përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës, diçka që mund të sjellë dhe një pakësim të problemeve që vijnë nga Kosova. Por kjo pikëpamje duket që nuk vlen edhe për konsumatorët mendjengushtë të medias kryesore në rajon.

BIBLIOGRAFIA

Bourdieu, Pierre. Na televiziji [Sur la télévision]. Ljubljana: Krtina, 2001.

Habermas, Jürgen. Strukturne spremembe javnosti [Structural Transformations of the Public Sphere]. Ljubljana: ЉKUC in Znanstveni inљtitut Filozofske fakultete, 1989.

Hrvatin Bašić, Sandra, and Brankica Petković. In temu pravite medijski trg?: Vloga države v medijskem sektorju v Sloveniji [And You Call this Media Market?: The Role of the Government in Media Sector in Slovenia]. Ljubljana: Mirovni inštitut, 2007.

Hrvatin Bašić, Sandra, and Marko Milosavljević. Medijska politika v Sloveniji v devetdesetih / Media Policy in Slovenia in the 1990s. Ljubljana: Mirovni inštitut, 2001.

Hrvatin Bašić, Sandra, Lenart J. Kučić, and Brankica Petković. Medijsko lastništvo: Vpliv lastništva na neodvisnost in pluralizem medijev v Sloveniji in drugih post-socialističnih evropskih državah / Media Oënership: Impact on Media Independence and Pluralism in Slovenia and Other Post-Socialist European Countries. Ljubljana: Mirovni inštitut, 2004.

Kovačič, Gorazd. »Zakaj bi Kosovo moralo postati država?"[Ëhy Kosovo should Become a State?]. In: 2000. – ISSN 0350-8935. - No. 197/198/199 (2008), p. 51-66.

Kovačič, Gorazd. »Zunanje politično ali svetovno novinarstvo?« [Foreign Affairs Journalism or Ëorld Journalism?]. In: Medijska preža, No. 31, May 2008, p. 4-5.

Tamir, Yael. Liberalni nacionalizem [National liberalism]. Ljubljana: Krtina, 2008.

Zgaga, Blaž. »Dober Večer in lahko noč!« [Good evening (slov. Večer) and good night!]. In: Drčar Murko, Mojca et al. (ed.). Pet minut demokracije: Podoba Slovenije po letu 2004 [Five minutes of democracy: The image of Slovenia after 2004]. Ljubljana: Liberalna akademija, 2008.

TRANSKRIPTIM I KONFERENCËS NDËRKOMBËTARE TË MBULIMIT NGA MEDIAT TË SITUATËS NË KOSOVË

Transkriptimi është një përmbledhje e pikave më të rëndësishme të debatit që ishte pjesë e Konferencës ndërkombëtare të mbajtur në Shkup 16 dhe 17 maj 2008 me titull "Mbulimi nga mediat i situatës në Kosovë". Thuajse nëntëdhjetë profesionistë të medias dhe përfaqësues të shtypit maqedonas dhe rajonal morën pjesë në këtë konferencë të organizuar nga Instituti Maqedonas për Media dhe South East European Network for Professionalization of Media (SEENPM).

Konferenca trajtoi tema të lidhura me mbulimin mediatik të situatës në Kosovë nga vendet e Evropës Juglindore. Në të u analizuan çështjet më të spikatura të raportimit në media, dallimet në mbulimet e kryera nga secili vend dhe u përpoq t'i japë përgjigje pyetjeve sa afër janë mediat me politikat zyrtare të vendeve përkatës. Gjithashtu, në këtë Konferencë, pjesëmarrësit patën mundësinë të dëgjojnë prezantimet e disa raportimeve të kryera nga vende të ndryshëm të përfshirë në këtë projekt.

Konferenca u zhvillua në tre seksione të ndara. E para, "Media në Serbi dhe në Kosovë – Një konflikt, dy realitete", ku u krahasua pasqyrimi i të njëjtit konflikt në Serbi dhe në Kosovë. Në seksionin e dytë të titulluar "Fqinjët dhe Kosova – ndikimi i politikës lokale lidhur me Kosovën në raportimin nga mediat", panelistët analizuan se si ndikuan politikat lokale në mbulimin e kësaj teme në vendet fqinjë Shqipëria, Maqedonia dhe Mali i Zi. Në seksionin e tretë të titulluar "Kosova e parë me syrin e medias rajonale dhe ndërkombëtare", ekspertë nga Britania e Madhe, Italia, Polonia, Rumania dhe Sllovenia diskutuan se si konflikti dhe shpallja e pavarësisë së Kosovës u paraqitën nga mediat e vendeve të tyre.

Po ju paraqesim këtu disa nga titujt kryesorë që u mbajtën në Konferencën e Shkupit. Bashkëngjitur do të gjeni axhendën e Konferencës dhe listën e pjesëmarrësve.

Konferenca Ndërkombëtare

Mbulimi nga Media i Situatës në Kosovë

Holiday Inn, Shkup, Maqedoni

16 dhe 17 maj, 2008

Dita 1: 16.05.2008 – E premte

9.30 – 10.00 Regjistrimi i pjesëmarrësve

10.00 – 10.25 Fjalimi i mirëseardhjes

Sulejman Rushiti, Minister i Arsimit dhe Shkencës në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë

Zhaneta Trajkoska, Drejtore Ekzekutive e Institutit Maqedonas për Media

Sandor Orban, Drejtor Ekzekutiv i South East European Network for Professionalization of Media

10.25 – 11.00

Seksioni 1: Media në Serbi dhe Kosovë – Një Konflikt, Dy Realitete

Moderator: Boro Kontiq, Drejtori i Mediacentar, Sarajevo (Bosnje Hercegovinë)

Folës:

Willem Houwen, Drejtor i Institutit të Kosovës për Gazetari dhe Komunikim (Kosova)

Dubravka Valiq-Nedeljkoviq, Presidente e Shkollës së Gazetarisë Novi Sad dhe autore e kërkimit për Serbinë (Serbia)

Agron Bajrami, Kryeredaktor i Koha Ditore (Kosova)

Boshko Jakshiq, Kolumnist i Gazetës së përditshme Politika (Serbia)

Nexhmedin Spahiu, Drejtor i RTV Mitrovicë (Kosova)

11.15 – 13.00

Seksioni 1 (vazhdim)

- Diskutime

14.30 – 16.30

Seksioni 2: Fqinjët dhe Kosova – Ndikimi i politikës lokale lidhur me Kosovën në raportimin e mediave

Moderator: **Ognian Zlatev**, Drejtor i Qendrës për Zhvillimin e Medias (Bullgaria)

Folës:

Ilda Londo, Instituti Shqiptar i Medias dhe autore e kërkimit për Shqipërinë (Shqipëria)

Marko Troshanovski, instituti për Demokraci dhe autor i kërkimit për Maqedoninë (Maqedonia)

Danijela Seferoviq, Instituti i Medias të Malit të Zi dhe autore e kërkimit për Malin e Zi (Mali i Zi)

Diskutime

Dita 2: 17.05.2008 – E shtunë

10.00 – 12.00

Seksioni 3: Kosova e parë me syrin e mediave rajonale dhe ndërkombëtare

Moderator: **Remzi Lani**, Drejtor i Institutit Shqiptar të Medias (Shqipëria)

Folës:

Gabriel Partos, Analist për Evropën Qendrore dhe Juglindore (Britani e Madhe)

Giuseppe Zaccaria, Korrespondent i Ballkanit për gazetën e përditshme La Stampa (Itali)

Gorazd Kovaçiç, Universiteti i Ljubljanës, Fakulteti i Arteve, Departamenti i Sociologjisë (Sllovenia)

Teodora - Olivia Vasilescu, Autore e kërkimit për Rumaninë (Rumania)

Agnieszka Skieterska, Gazetare e të përditshmes Gazeta Wyborcza (Poloni)

12.20 – 13.40

Seksioni 3 (vazhdim)

- Diskutime

13.40 – 14.00

Konkluzionet e Konferencës

TITUJT E SEKSIONIT 1:

Seksioni 1: Media në Serbi dhe Kosovë – Një Konflikt, Dy Realitete

Moderator: **Boro Kontiq**, Drejtori i Mediacentar, Sarajevo (Bosnje Hercegovinë)

Folës:

Willem Houwen, Drejtor i Institutit të Kosovës për Gazetari dhe Komunikim (Kosova)

Dubravka Valiq-Nedeljkoviq, Presidente e Shkollës së Gazetarisë Novi Sad dhe autore e kërkimit për Serbinë (Serbia)

Agron Bajrami, Kryeredaktor i Koha Ditore (Kosova)

Boshko Jakshiq, Kolumnist i gazetës së përditshme Politika (Serbia)

Nexhmedin Spahiu, Drejtor i RTV Mitrovicë (Kosova)

Boro Kontiq

Mediacentar Sarajevo (Bosnje dhe Hercegovina)

Siç e dini, SEENPM, rrjeti i qendrave te medias dhe institucioneve te Evropes Jug-lindore, qe eshte nje organizate e rendesishme jo vetem ne rajon por edhe me gjere, organizoi kete konference per te pasqyruar mbulimin e situates ne Kosove nga mediat keto muaj dhe me konkretisht keto dy muajt e fundit te ketij vitit – janar dhe shkurt. Gjate këtyre dy diteve ne do te njihemi me kerkimet e kryera nga punonjes te qendrave tona, te cilet kane bere hulumtime ne median e vendeve te tyre. Diskutimi i pare eshte titulluar "Nje Konflikt, Dy Realitete". Titulli tingellon disi letrar, madje do te thosha romantik, por gjate ketyre diskutimeve do te mund te ballafaqojme gjerat e ndryshme qe pasqyrohen ne kerkimet tuaja. Folesi i pare ne kete panel do te jete Dubravka Valic-Nedeljkovic, Presidente e Shkolles se gazetarise se Novi Sadit dhe njeheresh autore e kerkimit per Serbine, me teme: Si e ka mbuluar shtypi serb situaten ne Kosove.

Dubravka Valiq-Nedeljkoviq

Presidente e Shkollës së Gazetarisë Novi Sad dhe autore e kërkimit për Serbinë (Serbia)

[…] Kemi vendosur te zgjedhim vetem nje gazete te perditshme te botuar ne Serbi ne gjuhen e pakices hungareze, e cila eshte politikisht aktive ne vend - Magyar Soz – e botuar nga Keshilli Kombetar i minoritetit hungarez ne Serbi. Kjo gazete botohet prej 65 vjetesh dhe financohet nga buxheti i

Sekretariatit te Informacionit ne kete province. Gazeta tjeter eshte e perditshmja Blic, e cila sipas sondazheve te publikut, eshte gazeta me e njohur dhe me me ndikim ne Serbi keto vitet e fundit. Botohet prej 12 vjetesh dhe shperndahet ne te gjithye vendin. Magyar Soz botoi 138 artikuj per Kosoven ne janar dhe shkurt, kurse Blic 381 artikuj. […]

[…] Qellimi i ketij kerkimi ishte te identifikonte se cilat ngjarje ishin ne vemendje te ketyre dy gazetave. U arrit ne perfundimin se gazetaret nuk perpiqeshin sa duhet per te raportuar mbi Kosoven. Kjo konfirmohet nga temat e artikujve, pasi te dyja gazetat ua kushtuan shumicen e hapesires aktiviteteve nderkombetare dhe diplomatike ne Kosove dhe dhane pak ose aspak informacion per jeten e perditshme te qytetareve kosovare. Fotografite deshmojne per te njejten gje – nuk kishte fotografi aktuale te Kosoves dhe po te flasim per vendndodhjen, shperndarja ne kete aspekt eshte relativisht e balancuar, edhe pse perparesia iu dha aktoreve nderkombetare dhe vendeve te huaja.

[…] Gazeta me e njohur ne Serbi Blic dhe e vetmja e perditshme e pakices hungareze Magyar Soz e ndertuan praktiken e raportimit ne kete menyre: oferte modeste temash per publikun, kryesisht pasqyronin aktivitetet diplomatike dhe sa i perket ngjarjeve te perditshme, raportonin vetem per veprimtarite kriminale ne Kosove. Mungonin krejtesisht artikujt per temat multi-kulturore, strukturat e zhanreve nuk ishin elastike dhe mbizoteronin lajmet dhe deklararat, ngjarjet standarte.

Gazetat nuk bene perpjekje per te cituar burime te shumefishta informacioni, megjithate ato qe citoheshin ishin pak a shume te besueshme. Baza e tekstit ishte modeste, por plotesonte standartet e gazetarise.

Nuk mund te themi qe nuk ishin objektive, jo profesionale dhe qe perhapnin stereotipe dhe paragjykime, por njeheresh nuk mund te themi qe iu ofruan lexuesve informacion kritik dhe te mirestrukturuar nga burime te shumefishta dhe as qe informuan lexuesit per ate ç'po ndodhte vertet ne Kosove, ne nje zhanr modern te paraqitjes se informacionit.

Rekomandimet per praktikat me te mira: zyra te pajisura me korrespondente duhet te hapen ne Kosove, larmia e temave dhe e zhanreve duhet permiresuar, ne vecanti, i duhet kushtuar vemendje temave multikulturore, si menyra e vetme per te tejkaluar atmosferen e zgjatur te konfliktit, polemikave dhe pakenaqesive te te dy komuniteteve. Te gjitha keto te dhena ne cojne ne perfundimin qe gazetat po raportonin per Kosoven ashtu si do te benin me nje vend te huaj. Nese Serbia, sipas Rezolutes 1244 te OKB e konsideronte Kosoven si nje pjese integrale te saj, atehere gazetat duhet te kishin raportuar per Kosoven si per ngjarje qe zhvilloheshin ne rajon.

Nje tablo perfundimtare e struktures se gazetave duhet te bazohet ne zhvillimet aktuale ne terren dhe jo ne informacion arkaik.

Me dy fjale, gazetat e perditshme duhet te reflektojne jeten e perditshme. Faleminderit, shpresoj qe do te paraqisni pikepamje te ndryshme per median ne Serbi, pasi koleget e mi do te flasin per gazeta te tjera dhe per pasqyrimin e ngjarjeve te fundit ne Kosove.

Willem Houwen

Drejtor i Institutit të Kosovës për Gazetari dhe Komunikim (Kosova)

[…] Keto jane pershtypjet tona si konsumatore te perditshem, por edhe si profesioniste qe merren me lajmet, si mesues te gazetarise dhe si gazetare. Do te doja te filloja me nje citim te shkurter nga zoti Haekkerup, ish- minister i mbrojtjes se Danimarkes, qe qendroi ne Kosove vetem per 9 muaj dhe ishte perfaqesues i posacem i Sekretarit te Pergjithshem te OKB ne Kosove dhe pasues i Bernard Kouchner. Ky ishte fjalimi i pare i rendesishem i tij dhe u transmetua drejtperdrejt ne televizion dhe u citua nga te gjitha gazetat. Ai tha: "Do ta konsideroj misionin tim te perfunduar atehere kur Kosova te zhduket nga faqet e para te lajmeve ne bote".

Thenia e tij u citua ne te gjithe boten. Siç e thashe, zoti Haekkerup qendroi vetem pak muaj, sepse sipas meje u lodh nga veshtiresite qe haste administrata e OKB per t'i dhene nje zgjidhje problemeve te Kosoves ne vitet e para pas nderhyrjes se NATO. Po flasim per vitin 2001, por edhe nese keto jane kriteret per sukses ose deshtim ne Kosove. Lajmet normalisht jane per ngjarje jo te zakonshme, te cilat jane zakonisht te keqija, prandaj Kosova u shfaq ne lajmet evropiane dhe boterore vetem atehere kur konflikte te medha ndodhen.

Ne muajt e fundit mund te permendim disa pika kryesore dhe te pershkruajme artikujt per Kosoven dhe shumica e tyre jane negative. Natyrisht, besoj se shumica e njerezve ketu e kane lexuar artikullin e Der Spiegel, i cili jep nje tablo te gjere te Republikes se re te Kosoves, duke theksuar strukturat mafioze dhe egersine e krimit te organizuar dhe te elitave politike. 'Koha Ditore' ishte serish e vetmja gazete qe pati guximin te perkthente artikullin dhe u habita qe nuk pati shume reagime ne opinionin publik ne vend.

Ajo qe na mungon ne Kosove eshte nje gazetar i mire, i cili mund te prodhoje edhe per tregun nderkombetar te lajmeve. Kemi disa perjashtime, shumica e tyre online – keshtu qe nuk jane media kryesore te shkruara apo elektronike – por kemi edhe nje faqe interneti te quajtur APIX – i cili merret me zhvillimin e biznesit dhe ekonomise dhe ka si publik investuesit globale, te cilet mund te jene te interesuar te investojne ne Kosove. Gjithashtu, ka informacion edhe per pjesen gjermanisht-folese te biznesit evropian dhe ideja eshte qe media europiane dhe ne kete rast te veçante – vendet gjermanisht-folese – te marrin lajme nga Kosova.

Frankfurter Allgemeine Zeitung tashme e ka zbuluar kete dhe po per-

gatit nje sere artikujsh per zhvillimin ekonomik ne Kosove per edicionet e tij te perjavshme.

Nje tjeter media online qe pergatitet ne vend dhe ne diaspore, si ne shumicen e rasteve kur flitet per Kosoven, eshte i ashtuquajturi Raporti per Kosoven, i cili paraqet me shume lajme te pergjithshme, por gjithashtu thekson akoma me shume zhvillimin, i ashtuquajturi 'ddt.net', audienca e te cilit eshte me shume burokracia e BE ne Bruksel, i krijuar nga korrespondentet per nje gazete vendase te perditshme. Gjithashtu duhet te permend Balkan Investigative Reporting Network (BIRN), i cili prodhon ne pergjithesi raporte shume te mira. Ky eshte nje grup i madh te rinjsh – nje degezim i IWPR – nen drejtimin e Jeta Zares, e cila gjithashtu ka nje emision televiziv kritik ne transmetuesin publik ne Kosove. Kjo lloj gazetarie duhet zhvilluar me shume ne Kosove me qellim qe te lidhet me shtypin nderkombetar dhe te globalizoje sistemin e ri. Sigurisht qe ka artikuj te perditshem lokale nga AP dhe Reuters, gjithashtu te shkruar nga nje apo dy persona, por ato rralle perdoren ne lajmet nderkombetare. Kjo ishte kategoria e mediave kryesore apo mediave serioze online, te cilat nuk shqetesohen aq shume per sasine e raportimeve per Kosoven, por ka pasur nje shkendije ne sferen globale. Gjate dy viteve te fundit ose gjate procesit te Ahtisarit dhe gjate muajve para dhe pas shpalljes se pavaresise: miliona faqe ne Internet, disa prej tyre nga Serbia, disa nga Amerika, Australia, disa nga grupet e ish-te majteve, disa prej tyre te fokusuar ne tema si ligji nderkombetar etj, ku kemi pare pothuajse per dite me qindra artikuj, forume dhe shkembime te lajmeve nga Kosova, shumica teper negative, per procesin qe solli shpalljen e pavaresise.

Agron Bajrami

Kryeredaktor i të përditshmes Koha Ditore – Prishtina (Kosova)

Ajo qe do te doja te beja tani eshte t'ju jap kendveshtrimin e dikujt qe i sheh gjerat nga brenda. Si kryeredaktor i nje prej te perditshmeve ne Kosove jam mjaft i ndergjegjshem qe mund ta kishim ndryshuar titullin e ketij paneli dhe te thoshim: Nje konflikt – dy realitete, dy konflikte nje realitet, ose ndoshta tre konflikte dhe nje realitet, ose ndoshta shtate konflikte dhe disa realitete. Çeshtja eshte qe duke u nisur nga kendveshtrimi, njerezit shohin lloje te ndryshme raportimi dhe perceptime te ndryshme te realiteteve dhe ngjarjeve. Ne rastin tone eshte e qarte qe kjo nuk ndodh vetem me konfliktin e Kosoves, por ka ndodhur edhe me Afriken dhe rajone te tjera ne bote. Kudo ku ka nje konflikt dhe dy pale luftojne per nje pretendim te caktuar, do te kete gjithnje kendveshtrime te ndryshme, perceptime te ndryshme te realitetit. Ne kete kuptim mendoj se media reflekton shoqerine si te tille, me problemet dhe avantazhet e saj. Mediat reflektojne menyren se si shoqeria sheh vetveten dhe menyrat se si shoqeria shikon shoqerite e tjera. Gjithashtu ato reflektojne kulturen e shoqerive te tyre, paragjykimet, traditat dhe realitetet politike.

Ne kohe konflikti, media ashtu si dhe shoqeria priret te jete me e shqetesuar emocionalisht dhe atehere dalin ne pah lloje te ndryshme raportimi, te cilat jane kontradiktore. Ne kete drejtim, do te thoja qe konflikti i Kosoves gjithmone eshte pare ndryshe nga mediat, ne varesi te vendit nga ku ato raportojne, apo ne varesi te ciles i perkasin.

Ajo qe ndodhi ne vitin 1998 dhe 1999 u pa si nje lufte Çlirimtare e shqiptareve te Kosoves, u pa si nje sulm i serbeve dhe Serbise dhe si nje nderhyrje humanitare e komunitetit nderkombetar. Per pasoje, media ka reflektuar ate qe shoqerite dhe politikat e tyre kane deklaruar. Ne kete menyre, duhej marre parasysh qe shumica e gazetareve do te perdornin terminologjine qe u perdor nga establishmenti i tyre. Kjo qendron per Kosoven, per Evropen perendimore dhe sidomos per korrespondentet e Brukselit dhe ata qe punonin per gazetat dhe televizonet kryesore ne Perendim. Ne kete aspekt ishte e pritshme qe do te kishte nje lloj tjeter raportimi, por ne disa raste gazetaret dhe kryeredaktoret i kane lene pasdore detyrat e tyre profesionale per nje raportim te vertete dhe objektiv dhe kane perqafuar nje kendveshtrim te shtrember i cili u perfaqesua nga qeveri te ndryshme. Mendoj se ne kete drejtim disa prej mediave moren pjese ne krijimin e llojeve te ndryshme te konflikteve, kur ne te vertete kishte vetem nje konflikt.

Siç e thashe, dhe kjo do t'iu shpjegohet me disa shembuj, nje prej te cileve perdoret me shpesh, pra qe njerezit qe po luftonin kunder policise serbe ne Kosove u quajten luftetaret e lirise nga shumica e medias ne Kosove, u quajten terroriste nga shumica e medias serbe dhe u quajten guerrilas nga shumica e medias nderkombetare. Se cila eshte e verteta eshte e veshtire te sqarohet dhe problemi nuk eshte vetem se si e emerton dike, por edhe se si lexuesit dhe shikuesit reagojne ndaj ketyre emertimeve.

Mendoj se vitet e fundit, deri ne ngjarjet e vitit 2004, te cilat u quajten telashe ne median kosovare dhe probleme ne median serbe, deri ne kete periudhe mendoj se kishte presion per median kosovare qe te bente disa dallime qe do te garantonin se do te perdorej me pak gjuha e urrejtjes dhe do te perdorej me shume raportimi konstruktiv qe do te ndihmonte procesin e zgjidhjes se statusit, si dhe procesin e pajtimit midis serbeve dhe shqiptareve.

Mendoj se e pare me syrin e brendshem do te ishte gabim te thuhej se media ne Serbi e beri kete dhe media ne Kosove beri diçka tjeter. Mendoj se ne keto shoqeri kemi lloje te ndryshme mediash dhe lloje te ndryshem gazetaresh. Mendoj se eshte e qarte qe asnje gazete nuk do te kishte mundesine te ishte profesionale nese i sherbente nje politike te caktuar pervec raportimit objektiv, korrekt dhe profesional. Nuk ka asnje dallim nese gazeta eshte serbe apo shqiptare dhe as se kush eshte gazetari. Dallimi eshte nese gazetari eshte i mire apo i keq. Persa me perket keta gazetare jane njelloj dhe kane disa çeshtje, te cilat i vendosin perpara detyrimit per te raportuar me korrektesi dhe objektivitet.

Ne kete aspekt do te perpiqesha t'ju jepja disa kendveshtrime per tablone e medias ne Kosove. mendoj se mediat me profesionale jane ato me te kerkuarat. Lexuesit lexojne dhe kjo nuk ndodh ne shumicen e vendeve ne rajon, ate qe zakonisht quhet gazete cilesore dhhe jo tabloid. Verejme se numri i kopjeve te shitura nga gazeta ime eshte me i larte sesa numri i kopjeve te gazetave qe perpiqen te anashkalojne te tjeret ose t'i steriotipizojne ata. E gjitha kjo lidhet me standartet profesionale.

Gjithashtu ia vlen te permend se pati disa rrjete televizive dhe disa gazeta qe u perpoqen te raportonin me korrektesi dhe te merrnin parasysh qe duhet te shkaterrojne paragjykimet, qe duhet te raportojne mbi veten tone, per menyren se si i shohin te tjert dhe si ata na shohin ne dhe qe duhet te gjejne baze te perbashket qe do t'i japе kuptim jetes se perditshme dhe jo vetem konfliktit politik. Mendoj se te gjitha keto tregojne qe ka me shume permbajtje se sa raportimi i zakonshem me stereotipe de-mode, me nje burim dhe me etiketime te ndryshme. Kjo deshmon qe shoqeria eshte gati te levize pertej konfliktit, gje qe nuk do te thote qe mund t'ia arrijme kesaj brenda dites, sepse ka shume gazeta, shume media, te cilat mendojne se ceshtja politike per ndonje incident politik eshte me e rendesishme sesa profesionallizmi dhe ndoshta duhet te shohim menyrat se si duhet te minimizojme impaktin e ketyre mediave joprofesionale. Ne kete aspekt, nese do te ekzistonte nje force me e madhe qe mund t'i ndryshoje gjerat brenda nates, do te thoja qe do te kishim nevoje te kufizonim ose parandalonim ndikimin politik mbi median, duhet te siguronim qe drejtuesit e medias jane te perkushtuar ndaj standarteve te gazetarise, ndaj disa vlerave, te cilat perbejne nje baze te perbashket jo vetem per shoqerine, por edhe per shume shoqeri te tjera. Besoj se keto jane disa nga problemet me te cilat perballet shumica e mediave jo vetem ne rajon por edhe ne Kosove, ku partite politike, sidomos ne periudhe zgjedhjesh, apo kur mendojne se jane ne nje moment historik, perpiqen ta blejne median dhe te fitojne mbeshtetjen e saj te verber per procese te caktuara.

Ne kete moment ne Kosove, siç mund te themi pas shpalljes se pavaresise, ekziston nje nevoje politike per te qene tolerante, per te raportuar ne menyre pozitive per shumicen e gjerave. Mendoj se raportimi kritik nuk duhet te bjere viktime e nevojave politike, diçka qe kerkohet nga qeverite vendore dhe lojtaret nderkombetare.

Pra, do te thoja qe media ne Kosove sot eshte me mire se ne vitet 90, por nuk eshte aq e mire sa duhet persa i perket aftesise per t'iu pergjigjur problemet me te cilat perballet vete Kosova dhe problemet qe rrethojne realitetin kosovar si te tille.

Mendoj se ceshtja kryesore eshte qe media ne rajon do te duhet te ece perpara bashkerisht, sepse nuk mendoj qe ka kuptim te kesh disa gazeta, rrjete televizive ne disa vende ne rajon qe jane me te mira se sa te tjerat. Mendoj se jemi teper te ndervarur per te enderruar qe te kemi nje peizazh te suksesshem te medias ne menyre te izoluar. […]

Boshko Jakshiq

Kolumnist i gazetës së përditshme Politika (Serbi)

[…] Kryesisht e ndjej kete si mundesi per te diskutuar si gazetar, jo si perfaqesues i vendeve apo politikave, te pakten jo te politikave, pasi mendoj se ishin politikat ato qe i nisen keto konflikte. Ne media duhet te kete nje pergjegjesi ne konflikt, pasi fjala eshte nje shpate shume e rrezikshme nese perdoret aashtu si u perdor dhe fatkeqesisht ende po perdoret. […]

[…] Ndryshimet demokratike i sollen Serbise nje mundesi te jashtezakonshme. Une e quajta mundesia e Uotergejtit serb. Ashtu si ndodhi ne SHBA gjate eres se Niksonit pas se ciles media amerikane u be shume me e pavarur se me pare, ne e kemi pasur mundesine tone te Uotergejtit pasi politikanet e rinj nuk guxuan te ndikojne ne media pasi kjo do te ishte ne kundershtim me thelbin demokratik per te cilin ata flisnin. Per arsye te ndryshme, perfshire letargjine, qasjet e vjeteruara, mungesen e profesionalizmit etj, kjo hapesire qe u krijua nuk u mbush nga gazetaret. Ato muaj te fundit dhe besoj edhe me vone, kur ata qe ne i quanim politikane, te ashtuquajturit biznesmene te diskutueshem, te gjithe keta e mbushen kete hapesire dhe ne perseri u gjendem ne poziten e atyre qe duhet te kene marreveshje me partite politike, politikanet e veçante, biznesmenet dhe kjo mundesi u tret. Tashme na duhet te luftojme serish per hapesiren tone ne boten politike te Serbise. Duke humbur kete mundesi lejuam qe gazetaret te vihen nen presion dhe te gjithe e dime se nese gazetaret jane nen presion, nuk ka shtyp te lire dhe kesisoj s'mund te flitet per demokraci […]

[…] Nje nga sektoret kryesore per manipulimin ne media serbe ishte ceshtja e Kosoves. Duke paraqitur nje histori te re dhe romantike, duke paraqitur nacionalizem etik te gjitha keto instrumente u perdoren lehtesisht per manipulimin e medias dhe e dime sa e rrezikshme eshte kjo. Pra pati njelloj atmosfere qe i ngjante dhe ngjan edhe sot me eren e Millosheviqit, atmosfera e te ashtuquajturve tradhetare dhe patriote. Kjo beri qe shumica e partive ne Serbi te bashkoheshin ne nje platforme per problemin e Kosoves, duke mbrojtur cdo centimeter te tokes serbe. Per mediat dhe gazetaret u be e rrezikshme te perdornin ndonje mjet kritik apo analize tjeter per ceshtjen e Kosoves dhe kjo u kthye nga nje monopol i shtetit ne nje monopol te medias. Uniteti qe ekzistonte ne skenen politike kishte kopjen e vet ne media. E njejta atmosfere e bisedimeve per te ardhmen e Kosoves eshte edhe tani ne Serbi pas shpalles se pavaresise ne 17 shkurt. Fakti tjeter eshte qe serbet dine per Kosoven vetem ate qe duan politikanet serbe qe ata te dine. Nje nga arsyet qe konflikti mund te jete lehtesisht i manipulueshem eshte fakti qe ne ende nuk dime shume per ate qe ndodh ne Kosove. Ndonjehere mund te na japin ndonje shifer per papunesine e te rinjve, sepse kjo thjesht provon sa joefikase eshte kjo shoqeri, dhe serish informacioni vihet ne funksion, por jo ne funksion te te papuneve serbe, qe edhe ata te shohin se kane diçka te perbashket me te papunet shqiptare ne Kosove. Pasi nese nisim te promovojme ne media keto lloj çeshtjesh,

te flasim per problemet e jetes se perditshme, do t'i bashkojme popujt dhe politikanet nuk e duan kete gje. Ata ngulin kembe te dallimet, jo te diçka qe mund te lidhe popujt dhe kombet qe jetojne ne te njejten toke. Keshtu ajo qe shprehet qarte dhe besoj se ndodh dhe ne Prishtine, siç degjuam nga kolegu Bajrami, eshte se edhe qytetaret atje nuk kane njohuri per problemet e serbeve te thjeshte […]

[…] Keto probleme nuk jane ne vemendjen e gazetareve dhe ata nuk shkojne ne Kosove per te raportuar, madje me vjen keq ta them, por edhe korrespondentet lokale atje nuk jane te besueshem, pasi jane tejet te brishte. Ata nuk mund te shkruajne diçka kunder rrymes, pasi grate do t'iu pushohen nga puna dhe mund te shantazhohen lehtesisht. Ndersa flas per anen serbe mbi Kosoven, nuk ka gazetar qe do te shkonte ne Kosove dhe do t'i kushtonin vemendje kesaj ane, pasi ana njerezore nuk ben pjese ne funksionin e politikes se perditshme.

Ne nentor 2007, per shembull, media e shkruar serbe botoi 757 artikuj per Kosoven. Shumica e ketyre teksteve – me shume se 550 – thjesht diskutonin problemin e statusit dhe thjesht citonin ate qe thoshin diplomatet dhe politikanet. Kishte 19 artikuj per incidentet e perditshme, te cilave u jepej me shume rendesi se ç'meritonin. Nga keto 750 artikuj, vetem 62 tekste ishin per jeten e perditshme, qe eshte me pak se 10 perqind. Muajt ne vijim ishin te ngjashem. Kishte edhe nje lloj tendence ne rritje kur flasim per shifrat (numrat e artikujve ne media) per janarin dhe shkurtin e ketij viti. Pra, tendenca per te hequr dore nga temat e perditshme eshte mese e qarte, pasi nuk eshte efikase per politikanet.

[…] Po e perseris qe media duhet te mbaje pergjegjesi per shperfilljen e jetes se perditshme, pasi sipas politikaneve, nese shkruan per keto tema, nuk i kushton vemendje problemeve serioze te kufizimeve diplomatike apo zgjedhjeve politike. Kjo gje e zmadhon akoma me shume genjeshtren dhe nuk e ndihmon komunikimin. […]

[…] Pra ndjesia une kam eshte mjaft e thelle dhe nuk ka ndryshuar pasi nuk ka ende analiza te mira ne media qe te shtrojne pyetje provokative, te llojit cilat jane zgjidhjet afatgjata, a kemi ne Beograd nje mundesi per te takuar dike qe tha ne Prishtine: Po, do te me pelqente te shkoja ne Beograd pasi atje qendrat mjekesore jane me te mira se ne Prishtine? – nuk i gjen dot keto artikuj. Dhe artikuj te tille krijojne lidhje, por eshte e qarte, te pakten per momentin, qe mungon gatishmeria per te pasur kete marredhenie njerezore. Pra, Kosova ende perdoret dhe keqperdoret nga politikanet dhe shumica e mediave kane te njejten prirje. Sigurisht qe duhet ta dime se cfare eshte bere ne Keshillin e Sigurise, por ka edhe shume histori te tjera qe nuk i njohim dhe kjo eshte problem.

Ekzistojne te ashtuquajturat media patriotike qe ende drejtojne lojen. Kur flitet kaq shume per patriotizem, kjo kembengulje e tepruar tregon se diçka po kalbet dhe media po ndihmon ne kete drejtim. Nga ana tjeter edhe ne median

serioze mungojne analizat serioze. Tabloidet jane shume me keq. Tabloidet ne Beograd nuk jane ashtu si pritet, si ato ne Britani dhe Gjermani, qe pasqyrojne te gjitha lidhjet seksuale apo gjithçka te ketij lloji per yjet e kinemase. Tabloidet ne Beograd jane tejet te politizuara dhe krejtesisht te papergjegjshem. Keshtu, nje nga tabloidet gjithashtu ka perdorur Kosoven si nje nga temat e preferuara, duke e perdorur ne nje menyre qe nuk krijon asnje mundesi per mirekuptim. Fatkeqesisht do te duhet te arrijme ne perfundimin qe thjesht nuk e dime se cfare ndodh ne Kosove dhe kjo ka ndodhur edhe me ndihmen e medias. Cilat jane problemet e verteta te njerezve atje? Jam i bindur qe kosovaret nuk e dine cilat jane problemet e fqinjeve veriore, ne kete aspekt kjo mbledhje mund te jete e dobishme. Nese kthehemi ne Prishtine, Beograd apo dhe ketu ne Shkup dhe mendojme se cfare kemi humbur deri tani, ka nje mundesi me te madhe per te ndrequr gabimet. Por keto gabime jane mjaft serioze dhe duhet te pyesim veten nese jemi te gatshem te jetojme me marredhenie te ngrira, duke shperfillur realitetin, apo nese do te perpiqemi te kalojme pa probleme nepermjet Prishtines dhe te shkojme neper manastiret e Kosoves.

DISKUTIME

Mirjana Millosheviq

Drejtore e Qendrës së Medias Beograd (Serbi)

Shumicen e kohes media dhe politikanet nuk mendojne per qytetaret, por per mesazhet qe i dergojne njeri-tjetrit. Ne veçanti ato media qe kane ndikim te drejtperdrejte ne sektorin politik apo financiar dhe kete po thoshte dhe Boshko Jakshiq per tabloidet, te cilat jane, disa prej tyre, te lidhura me struktura te ndryshme politike. Per ne ishte interesante te ndiqnim çfare kishte ndodhur gjashte muajt e fundit jo vetem per ceshtjen e shpalljes se pavaresise se Kosoves, por edhe per zgjedhjet e rendesishme ne skenen politike serbe. Ne janar dhe shkurt, para se Kosova te deklaronte pavaresine, patem zgjedhje presidenciale dhe para disa javesh kishim zgjedhjet parlamentare dhe lokale. Ne monitoruam çfare po raportonte media dhe njeheresh koleget nga Qendra per Zgjedhje Demokratike kryen nje sondazh publik per te pare se si publiku i Serbise reagon ndaj temave te ndryshme. Ajo qe doli gjate javeve te fundit te fushates se zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare ishte se me ne fund çeshtja e Kosoves nuk eshte me nje çeshtje vendimtare per publikun serb. Aty e kuptuam qe publiku serb si i tille eshte pjekur akoma me shume dhe e ka pare gjendjen ne rajon me me shume realizem sesa media dhe sidomos sesa elita politike. Ajo qe del nga studimi eshte se Kosova eshte tema e katert ose e trete ne lajme sipas rendesise dhe frekuenca e raportimeve.

Ishte interesante te verehej qe tema si procesi i integrimit ne BE, ekonomia, ceshtjet sociale ishin te rendesishme per publikun. Sigurisht qe kjo ndryshoi ne shkurt, afer shpalljes se pavaresise se Kosoves, por edhe gjate

periudhes kur pati reagime te ashpra nga elita politike dhe publiku serb, patem disa media qe ishin te lidhura me struktura te caktuara politike qe u perpoqen t'i percillnin informacion te plote publikut serb. Ketu patem nje dimension te ndryshem te mediave te cilat ishin te lidhura me disa struktura politike, si tabloidet si "Pravda," etj., dhe dimension te atyre mediave te cilat u perpoqen te merrnin informacion te plote per publikun serb, i cili pati transmetime te drejtperdrejta per ate qe po ndodhte ne Prishtine diten e shpalljes se pavaresise. Pra gjate ketyre gjashte muajve kemi shembuj interesante se si media nisi te kuptoje qe publiku serb eshte i interesuar te dije me shume sesa deklaratat e zyrtareve te Beogradit. Pra, çfare ndodhi ne 1992? Ne gjithashtu paten raporte te ndryshme dhe kishim korrespondente atje (ne Kosove), por gjithashtu ne "Politika" kemi nje analize te ndryshme te raporteve per ate qe po ndodh ne pika te reja e te ndryshme. […]

[…] Ajo qe kemi pare para zgjedhjeve parlamentare ishte interesante per ne. u hetua qendrimi i qytetareve serbe si ndaj Kosoves ashtu dhe ndaj procesit te integrimit ne BE. Doli se vetem 25% e qytetareve serbe kishin qendrim negativ per pavaresine e Kosoves, ndersa shumica ishin indiferente. Kjo ndodhi vetem tre muaj pas shpalljes se pavaresise. Nga ana tjeter, persa i perket te ardhmes evropiane te Serbise, rreth 45% kane qendrim pozitiv.

Pra kjo u tregon politikaneve qe axhenda qe ata po promovonin ne fushatat e tyre ishte ne fakt shume me e rendesishme kur vjen puna te ekonomia, shume me e rendesishme kur vjen puna te korrupsioni, shume me e rendesishme kur vjen puna te drejtesia sociale. Dhe ne fakt ajo qe shohim sot – pas zgjedhjeve parlamentare- eshte qe keto ishin temat qe vendosen kush do punonte me ke dhe pavaresisht sesa radikale mund te ishte, nuk eshte se ata fituan vota per shkak te qendrimit te tyre per çeshtjen e Kosoves, por sepse po promovonin gjera te tilla si drejtesia sociale ose korrupsioni, te cilat ishin tema te perbashketa per te gjitha fushatat.

Kjo eshte interesante per te ardhmen pasi mendoj qe media ka nisur ta kuptoje se qytetaret jane grupi kryesor qe duhet te kene parasysh. Ata duhet t'i sherbejne publikut dhe te bejne me shume sesa te ndjekin axhenden politike. Sigurisht qe kjo kerkon qe elita politike te jete me transparente, ndryshe ne te ardhmen do te kemi probleme serioze me lirine e shprehjes ne media.

Gorazd Kovaçiç

Universiteti i Ljubljanes, Fakulteti i Arteve, Departmenti i Sociologjise (Sllovenia)

Ndersa degjoja Dubravka Valiq Nedeljkoviq, ajo arriti ne perfundimin se media serbe, sidomos Blic, raportoi per Kosoven si te ishte nje vend i huaj. Pyetja ime eshte: cili eshte mendimi juaj per kete dileme? Dhe nese

keto lajme ishin rastesore apo kjo ishte ne funksion te politikes editoriale, qe mund te interpretohet si realiste dhe e pergjegjshme. Me pas degjova nga Boshko Jakshiq, qe beri nje interpretim ndryshe te gjendjes se medias ne Serbi. Ai tha se politika ka nje axhende qe promovohet nga media dhe Kosova mbetet nje teme per manipulim. Pra, nga njera ane mund te shohim njelloj pasqyrimi qe mund te jete realist dhe nga ana tjeter zoti Jakshiq tha se Kosova ishte ende nje teme e manipuluar.

Dubravka Valiq-Nedeljkoviq

Presidente e Shkollës së Gazetarisë Novi Sad dhe autore e kërkimit për Serbinë (Serbia)

Mendoj se Kosova eshte ende nje teme manipuluese per median serbe, por shumica e pasqyrimit per Kosoven eshte per Kosoven si vend i pavarur dhe i huaj. Nuk ka histori njerezore per Kosoven dhe nuk e di nese kjo eshte rastesi apo politike editoriale. Magyar Soz eshte mjaft e varfer dhe nuk kishte para per te derguar dike ne Kosove. per Blic duhet te them se u habita nga keto te dhena, sepse mendoja qe ishte nje gazete me e pergjegjshme.

Bosko Jakshiq

Kolumnist i Gazetes se perditshme Politika (Serbia)

Te dyja pikepamjet jane te verteta keshtu qe nuk ka manipulim si tha Mirjana, por ka diçka me te madhe per te shitur, por politikanet he per he ende nuk mund te thone: ne kemi nje program shume te mire per ju, por nuk mund ta thone nje gje te tille dhe mbeten pengje te fitores se tyre […]

TITUJT E SEKSIONIT 2:

Fqinjët dhe Kosova – Ndikimi i politikës lokale lidhur me Kosovën në raportimin e mediave

Moderator: **Ognian Zlatev**, Drejtor i Qendrës për Zhvillimi e Medias (Bullgaria)

Folës:

Ilda Londo, Instituti Shqiptar i Medias dhe autore e kërkimit për Shqipërinë (Shqipëria)

Marko Troshanovski, Instituti për Demokraci dhe autor i kërkimit për Maqedoninë (Maqedonia)

Danijela Seferoviq, Instituti i Medias të Malit të Zi dhe autore e kërkimit për Malin e Zi (Mali i Zi)

DISKUTIME

Marko Troshanovski

Instituti për Demokraci dhe autor i kërkimit për Maqedoninë (Maqedonia)

[…] Çfare ndryshoi ne kontekstin politik te Maqedonise? Qe ne fillim qeveria e qendres maqedonase dhe elita politike kerkuan ndjese ne njefare menyre dhe deklaruan se do te mbeshtesnin gjithcka qe do te vendoste BE dhe OKB. Te ndergjegjshem qe plani Ahtisari nuk pranohej nga Keshilli i Sigurimit dhe ne mungese te nje qendrimi te unifikuar nga shtetet anetare te BE, qendrimi politik maqedonas ndryshoi nga mbeshtetja per aktet politike te BE dhe OKB ne deklarimin qe Maqedonia do te vepronte ne perputhje me interesat e saj kombetare. Siç raportuan Dnevnik dhe Utrinski Vesnik: Qeveria do te veproje sipas interesave kombetare te Maqedonise. Problemi qe po shtyn njohjen e Kosoves nga Maqedonia lidhet me qendrimet politike ne Serbi dhe me zgjatjen e afatit te caktimit te kufijve mes dy vendeve. […]

[…] Mund te them qe debati publik ne media per situaten ne Kosove ishte i pamjaftueshem. Kjo mund te thuhet per shumicen e vendeve ne rajon, pasi shumica e artikujve ishte permbledhje informacioni e marre nga agjencite e lajmeve, kendveshtrimet e politikaneve, apo deklaratat e organizatave nderkombetare. Shume pak analiza te situates u bene. Ne Maqedoni, vetem 10 analiza u shkruajten per çeshtjen e Kosoves dhe ky eshte nje kontribut i varfer per debatin publik. […]

[…] Pra, ne njefare menyre, pasqyrimi i pergjithshem i Kosoves ne median maqedone la pas dore qendrimin zyrtar politik ne vend. [1]

1 Raportimet e paraqitura ne kete sesion gjenden ne pjesen e pare te librit, prandaj paraqitjet e ketyre raporteve nuk jane pjese e transkriptit..

DISKUTIME

Daut Dauti

MCMK "Tolerance" dhe anëtar i Bordit të Komitetit të Helsinkit (Maqedonia)

Se si media ne Maqedoni reagoi ne fillim mund te shihet nga nje shembull qe po sjell. Ne vitin 2000 Ljubço Georgievski priti kryeministrin e Qeverise se Perkohshme Hashim Thaçi. Media maqedonase thuajse e kryqezoi kryeministrin per mikepritjen ndaj Thaçit dhe deklaraten se Kosova ishte fqinj i Maqedonise.

Kjo do te thote qe ne ate moment, media e shihte Kosoven si problem te Serbise dhe Maqedonia ishte ne kufi me Serbine dhe jo me Kosoven. Mendoj se ne dekaden e pare te pavaresise se Maqedonise, media ishte prane qendrimit te elites politike per problemin e Kosoves, d.m.th qe Kosova s'mund te ishte precedent pasi kjo do te destabilizonte rajonin dhe do te reflektohej edhe ne Maqedoni. Duhet te pranojme se kjo teze ishte realiste, pasi shume kriza politike dhe ushtarake kane prekur Maqedonine nga '90 e deri tani.

Maqedonia ishte nje mikpritese e deputeteve kosovare, te ish-presidentit Ibrahim Rugova, te refugjateve dhe madje edhe e mbeshtetesve te UCK. Pra qendrimi karakterizohej nga nje doze subjektiviteti ne lidhje me cdo gje qe vinte nga Kosova dhe qendrimi ndaj Kosoves evoluoi ne vite. Keshtu, dy qeverite e fundit te Maqedonise e pranuan me ne fund se do te ndodhte ajo qe do te ndodhte, por kjo s'duhet te demtonte Maqedonie. Qendrimi i medias ishte ne perputhje me kete linje.

Mendoj se media ne gjuhen maqedonase nuk ishin mjaftueshmerisht aktive ne lidhje me Marreveshjen per caktimin e kufijve 2001, pasi nuk arriten te shtrojne disa pyetje: si ka mundesi qe kjo çeshtje nuk u zgjidh per dhjete vjet dhe papritmas kur serbet u terhoqen nga Kosova, ata shprehen vullnetin e mire per te pranuar procesin e caktimit te kufirit dhe konceptet e lidhura me territorin e Kosoves. Ne ate periudhe Serbia nuk kishte autoritet mbi Kosoven dhe nuk kishte mundesi ta realizonte kete marreveshje. Media maqedonase nuk e komentoi kete problem, por krijoi probleme te reja.

Megjithate duhet te them se media ne gjuhen maqedonase ka bere nje pune te mire me disa artikuj per pjesen e diskutuar te kufirit, duke thene qe caktimi teknik i kufirit po krijonte probleme njerezore.

Perderisa fola per media ne maqedonisht, do te perfundoj me to. Dua te them se pas shpalljes se pavaresise se Kosoves ato jane bere me aktive, lidhur me njohjen e Kosoves nga Maqedonia dhe nuk jane thjesht ndjekese te politikes zyrtare. Pati disa artikuj qe kritikonin vonesen e njohjes te cilen media e konsideronte si nje akt te fqinjesise se mire dhe nje shenje qe pala kosovare te perfshihej ne caktimin e kufirit. Ne kete aspekt, media ne maqe-

donisht ka qene disa hapa para politikes.

Nuk pothyem se media qe i drejtohet 25% te popullsise dhe qe ka te njejtat rrenje me shumicen e popullsise ne Kosove nuk meriton te analizohet, por vetem se kjo media, ashtu si pritej, gjate gjithe kohes ishte me prane opsionit per pavaresine e Kosoves.

Nicolay Tsekov

Deutsche Welle, Sofije (Bullgaria)

[…] Pyetje per Marko Troshanovskin: A mund te tregoni dallimin me te ndjeshem ne pasqyrimin e medias per problemin e Kosoves ne Maqedoni, Serbi, dhe Mal te Zi?

Marko Troshanovski

Instituti për Demokraci dhe autor i kërkimit për Maqedoninë (Maqedonia)

Ajo qe kam vene re si nje tipar te perbashket per te gjitha mediat ne rajon ishte se politikanet dhe opinionberesit, me perjashtim te Kosoves, rrallehere perfshiheshin ne artikuj. E kam fjalen per politikanet dhe opinionistet vendas. Ne pergjithesi, mediat ne rajon e perfaqesonin ne menyre te pamjaftueshme diskutimin politik vendas. Perfundimi i dyte ishte se ne te gjitha mediat e rajonit, diskursi politik mbizoteronte mbi temat e tjera, si bashkeekzistenca multikulturore dhe problemet e perditshme ne Kosove.

Agnieszka Skieterska

Gazetare e se perditshmes Gazeta Wyborcza (Polonia)

Ju thate se te gjithe gazetaret ishin me te interesuar per politikanet, mendimet e tyre dhe te diplomateve dhe jo per qytetaret e Kosoves. Si shpjegohet kjo?

Marko Troshanovski

Instituti për Demokraci dhe autor i kërkimit për Maqedoninë (Maqedonia)

Ne Maqedoni ka munguar nje opinion i pavarur i gazetareve dhe gjendja eshte shume e ndjeshme. Siç e thashe, kemi nje skene politike maqedonase me interesat e shqiptareve etnike nga njera ane dhe presionin e Serbise dhe lidhjet tradicionale nga ana tjeter, perfshire pakicen serbe ne Maqedoni dhe qendrimet politike te qeverise maqedonase. Per pasoje, shume pak gazetare ishin te gatshem te turbullonin ujrat. Prandaj edhe qasja e gazetareve ishte me teper informuese sesa analitike. Mendoj se ketu ne rajon, politika ndikon

ne çdo aspekt te jetes dhe se njerezit ende nuk jane mesuar te mendojne per realitetin. Shume pak opinionberes mendojne per realitetin dhe aspektet e tjera. Pikepamja politike eshte ende mjaft mbizoteruese dhe ende jane nje kriter thelbesor per vleresimin e realitetit.

Willem Houwen

Drejtor i Institutit të Gazetarisë dhe Komunikimit të Kosovës (Kosova)

Ndoshta po pasojme perkufizimin e Titos per gazetaret. Nje gazetar ishte mbi te gjitha nje punetor social dhe politik. Kane kaluar 28 vjet nga koha e mendesise kolektive, por gazetaria protokollare qe shohim ne Kosove dhe Maqedoni karakterizohet edhe nga nje shitje e paket e gazetave te perditshme. Te gjitha keto tregojne, siç tha edhe Mirjana Millosheviq, qe njerezit jane perpara medias ne Serbi, madje edhe ne Kosove e Maqedoni, gje qe ia vlen ta debatojme ketu, shume me teper se keto matriksat e analizave, te cilat nuk shkojne shume thelle. Ndoshta keto jane nje sfond i mire per diskutimin tone, por keto gjera duhen konsideruar ne nje menyre me dinamike.

Zhaneta Trajkoska

Drejtore ekzekutive e Institutit Maqedonas për Media (Maqedonia)

Pas shperberjes se Jugosllavise, situata ne çdo vend ishte e ndryshme. Mendoj se kjo duket ne gazeta dhe media ne pergjithesi e paraqet kete aspekt social. Ne Maqedoni ky aspekt social eshte i pranishem, respektivisht pasqyron ate qe ndodh ne vend. Mediat mendojne se njerezit nuk duan te dine si jetojne fqinjet e tyre. Nje aspekt tjeter, dhe jo vetem ne Maqedoni, eshte qe ne si media pasqyrojme lajmet per vendin tone, shpesh shperfillim çka ndodh ne vendet fqinje dhe shkurtimisht paraqesim lajmet nga skena globale. Pra, ne aspektin social ne nuk e dime ç'behet ne rajon. Nuk e di nese kjo eshte e vertete per vendet e tjera, por kjo eshte prirja ne Maqedoni.

Dubravka Valiq-Nedeljkoviq

Presidente e Shkollës së Gazetarisë Novi Sad dhe autore e kërkimit për Serbinë (Serbia)

[…] Cilat ishin qendrimet e pakices shqiptare ne Maqedoni dhe Mal te Zi ne lidhje me pavaresine e Kosoves? a pati kriza apo komente qe u pasqyruan ne media? Nuk po pyes vetem per mediat qe keni monitoruar por per mendimin tuaj cili ishte reagimi i popullsise shqiptare ne vendet tuaja ne lidhje me Kosoven.

Zhaneta Trajkoska

Drejtore ekzekutive e Institutit Maqedonas për Media (Maqedonia)

Mund te flas per ate qe kuptoj, pasi nuk e njoh mire gjuhen shqipe. Ne pergjithesi nuk kishte krize ne kete aspekt. Media ne shqip, ashtu si shqiptaret e Maqedonise e mbeshtesnin pavaresine e Kosoves. I vetmi dallim, siç tha Dauti, eshte te kuptosh opsionin politik te gazetes, d.m.th cili eshte qendrimi prapa medias. Mendimi im personal eshte qe mediat ne shqip kane pasur me shume presion politik sesa mediat e tjera ne maqedonisht. Megjithate nuk mendoj se kishte ndonje ndryshim te madh lidhur me pozicionin e ketyre mediave per pavaresine e Kosoves.

Daut Dauti

MCMK "Tolerance" dhe anëtar i Bordit të Komitetit të Helsinkit (Maqedonia)

[…] ka nje pike interesante ne lidhje me opinionin publik. Para disa javesh u publikuan rezultatet e nje sondazhi, sipas te cilit shumica e maqedonasve mbeshtesnin pavaresine e Kosoves. Ky eshte evolucioni qe permenda me pare, d.m.th qe politikanet dhe media e kane ndryshuar pozicionin lidhur me Kosoven.

TITUJT E SEKSIONIT 3:

Kosova e pare me syrin e mediave rajonale dhe nderkombetare

Moderator: **Remzi Lani**, Drejtor i Institutit Shqiptar të Medias (Shqipëria)

Folës:

Gabriel Partos, Analist për Evropën Qendrore dhe Juglindore (Britani e Madhe)

Giuseppe Zaccaria, Korrespondent i Ballkanit për gazetën e përditshme La Stampa (Itali)

Gorazd Kovaçiç, Universiteti i Lubjanës, Fakulteti i Arteve, Departamenti i Sociologjisë (Sllovenia)

Teodora - Olivia Vasilescu, Autore e kërkimit për Rumaninë (Rumania)

Agnieszka Skieterska, Gazetare e të përditshmes Gazeta Wyborcza (Poloni)

Remzi Lani

Drejtor i Institutit Shqiptar te Medias (Shqipëria)

Mbaj mend se ne 1999, fill pas bombardimeve mbi Serbine, ANEM (Association of Independent Electronic Media), instituti im dhe IPI (International Press Institute) nisen nje projekt te madh qe solli si rezultat nje liber – Lajmet per Kosoven dhe Lufta e Propagandes. Libri jepte nje tablo se si media nga Shqiperia ne Indi, nga Kina ne Kosove, nga SHBA ne Mongoli, pasqyruan fushaten e bombardimeve. Mendoj se libri ishte dhe eshte nje produkt i dobishem.

Por nese krahasoj vitin 1999 me 2008, shoh se shume gjera kane ndryshuar, para se gjithash ka ndryshuar konteksti i medias ne Kosove por edhe ne Serbi. Serbia eshte nje vend me shtyp te lire, gjithashtu dhe Kosova. Ne 1999 mediat e Kosoves ishin nen trysnine e Millosheviqit por pyetja ime eshte ne nje kontekst te ndryshem, ne kontekstin e medias se lire. A ishin mediat ne Serbi dhe Kosove, ne Shqiperi dhe ne vendet e tjera, me te vertete te pavarura apo ishin pjese e nje konsensusi nacionalist? Druhem se vazhdojme te jemi pjese e nje konsensusi konformist dhe nacionalist, pasi dyshoj se media ne vendet tona nuk i ka bere disa pyetje te veshtira. P.sh, nuk e di nese media ne Serbi ka ngritur pyetje te veshtira si pse Serbia demokratike nuk i ka kerkuar falje Kosoves per krimet e Millosheviqit. E ka bere kete me Kroacine dhe Bosnjen, por asnjehere me Kosoven.

[…] Nuk jemi vetem reportere, por kemi edhe arkiva te mira se si media raporton ngjarjet, por ne lidhje me rolin e opinionberesve dyshoj se nuk

kemi bere nje pune te mire ne kete aspekt. Ne Shqiperi, psh, kryesisht perkthejme dhe botojme gjithcka per precedentin dhe implikimet rajonale nga shtypi perendimor, nga The Guardian, Le Monde, madje edhe nga gazetat ruse, po ku eshte mendimi yne? Po e veme veten ne rolin e njerezve qe regjistrojne dhe transmetojne, gjithsesi dhe kjo ishte thjesht per pak provokim, Kosova ishte nje ngjarje e rendesishme rajonale, por pa dyshim edhe nje ngjarje e rendesishme per punen tone.

Nese shohim pasqyrimin e perditshem te medias per pavaresine e Kosoves, mund te arrijme ne perfundimin se ishte e mahnitshme. Por ishte interesante te shihje se sa uniforme ishin lajmet e medias britanike dhe amerikane dhe se sa te perçara ishin mediat gjermane per kete ceshtje.ne ate kohe kisha mundesine te vizitoj vende si Armenia dhe Jemeni dhe eshte e habitshme se sa shume hapesire i ka kushtuar media ne keto vende zhvillimeve ne rajon dhe se si ato i shohin keto zhvillime nga kendveshtrimi i interesave dhe problemeve te tyre kombetare […]

Gabriel Partos

Analist për Evropën Qendrore dhe Juglindore (Britani e Madhe)

Prezantimi qe do te doja te nisja lidhur me mbulimin e Kosoves nga mediat britanike me kujton nje ndodhi qe ka ndodhur kater vjet me pare. Ne mars 2004 me kerkuan te bej nje interviste per BBC World Service dhe pyetjet qe me bene vazhdimisht ne disa intervista ishin: pse gjithçka shpertheu tani dhe me kaq dhune; pse politikanet ne Perendim nuk e paten mendjen dhe u zune ne befasi. Ne nje kuptim ishte mjaft zbavitese per mua sepse vetem nje jave me pare kisha qene ne nje seminar ne Ministrine e Jashtme ne Londer, te kryesuar nga Denis MacShane, Ministri per Europen, i cili u organizua per te diskutuar pikerisht te ardhmen e Kosoves, ate qe mund te dilte gjate bisedimeve per statusin, deri dhe ushtrimin e dhunes qe mund te ndodhte dhe ne fakt ndodhi nje jave me vone.

Ajo qe po perpiqesha t'iu parashtroja intervistuesve ishte qe nuk ishin diplomatet dhe politikanet qe kishin humbur vemendjen dhe qene fokuasuar ne tjeter gje. Sigurisht qe per ta kishte çeshtje me te rendesishme se Kosova, te tilla si pasojat e luftes se Irakut, kercenimi ne Afganistan, Lindja e Mesme dhe nje sere temash te tjera. Nuk do te flas edhe aq per politikanet, por per median, ate nderkombetare dhe britanike te cilat prireshin te fokusoheshin tek temat dhe titujt qe perbenin lajm ne ate kohe.

Prandaj arsyeja qe bera kete hyrje eshte qe te paraqes piken e pare te prezantimit tim, qe eshte se Kosova ne median britanike ka marre nje pasqyrim skematik pas luftes ne vitin 1999, mberritjes se trupave te KFOR, largimin dhe kthimin e shqiptareve dhe me pas te serbeve, ngjarjeve ne rajon perfshi konfliktin ne 2001 ne Maqedoni dhe pastaj arrestimin dhe gjyqin

ndaj Millosheviqit ne vitin 2002. Qe atehere, vemendja e medias britanike per Kosoven dhe rajonin eshte pakesuar. Ky pasqyrim, sipas meje, duke e krahasuar edhe me disa botime ne France, eshte se ka nje interes me te larte ne median franceze, gjermane dhe ndoshta edhe italiane sesa ne ate britanike. Kjo vemendje eshte sporadike dhe lind kur ka ndonje krize. Ndersa kjo vemendje ishte ne sfond ne Britanine e Madhe per shume vite, nga 2001, 2002 e tutje, ajo do te shperthente befas ne kohen e dhunes se 2004 dhe te rasteve te ngjashem qe atehere. Megjithate, edhe ato dy vite negociatash diplomatike e terhoqen median britanike ashtu si nje gjyq i vjeter, gjyqi i Millosheviqit. Ne termat e medias ekziston nje model i dukshem ku fillon ngjarja ose negociata dhe ka njelloj interesi; me tej ndersa negociatat ose gjyqi zvarriten, edhe vemendja e medias bie. Kjo ndodhi edhe me Ahtisarin dhe perpjekjet ne vazhdim per te zgjidhur statusin e Kosoves. ne te vertete ka shume pak interes.

Mendoj se perjashtime te pjesshme ne median britanike jane BBC, me sherbimin e saj ne bote dhe on-line dhe The Economist, qe ka nje audience globale. Mendoj se keto jane perjashtimet qe sollen nje pasqyrim perfshires te Kosoves. Persa i perket mediave te tjera, ato kane shume pak interes deri ne momentin kur Kosova u shfaq serish ne lajme, kryesisht per shkak te deshtimit te pritshem te negociatave midis Prishtines dhe Beogradit dhe sigurisht pas shpalljes se pavaresise, e cila me ne fund u be ne 17 shkurt. Qe atehere pati nje pasqyrim te zgjeruar ne median britanike, jo vetem per pergatitjet per pavaresi, por edhe per ngjarjet me vijim, si dhuna ne Mitrovice, ne Beograd dhe ne kufi.

Mendoj qe temat kyçe ishin pergatitjet per pavaresi, qendrueshmeria e shtetit te ri, festimet e pavaresise, roli i komunitetit nderkombetar, sidomos i BE. Them se shumica e raportimeve nuk ishin te mprehta, te pakten persa i perket parashikimit te veshtiresive qe jane shfaqur dhe per pozicionin e pakices serbe dhe demontratave ne Serbi. Si ishte ne praktike ky raportim dhe e kam fjalen per cilesine e mediave, gazetave, edicioneve on-line apo transmetuesit publike dhe jo per gazetat popullore, qe nuk i kushtojne vemendje pavaresise se Kosoves, me perjashtim te rasteve te dhunes dhe festimeve.

Pra mendoj se raportimi i lajmeve ishte mjaft i sakte, i balancuar, korrekt dhe disa mendojne edhe i plote ne shkurt dhe mars. […]

[…] Ne pergjithesi mendoj se pasqyrimi i lajmeve ishte i nje standarti te mire dhe te arsyeshem. Pikerisht sepse ka pasur hendek ne pasqyrimin e Kosoves vitet e fundit, disa nga gazetaret qe u derguan ne rajon dhe Kosove para pavaresise nuk e kishin pervojen duhur. Pra, pati disa gabime, kryesisht nga padija, keqkuptimi etj

Ka disa citime te nxjerra nga Telegraph dhe mendoj qe kjo gazete u entuziazmua nga qellimi shekullor per pavaresine e Kosoves dhe dha disa pritshmeri te tepruara. Flaasin shume per deklaraten e kryeministrit Thaçi, se si te pakten 100 vende do ta njihnin menjehere Kosoven. Kemi shifra te fryra

per numrin e serbeve qe u larguan nga vendi ne 2004. Besoj se shifra ishte me shume se 4.000 dhe ketu eshte bere 16.000. Mendova se kjo ilustron gabimet faktuale dhe ato te gjykimit qe mendohet se nje gazete cilesore si The Telegraph nuk do i lejonte. Por keto ishin perjashtime dhe raportimi pergjithesisht ishte cilesor.

Analizat u fokusuan ne te ardhmen e shtetit te ri, ne aspektin ekonomik dhe ne aspekte te tjera, ne natyren e kesaj pavaresie, e cila eshte e kufizuar, e me pas ne gjasat per rrezik, sipas perspektives, per nje ndarje apo per nje partneritet te bute te Kosoves sipas ndarjeve etnike ose te pakten pjeserisht, pasi veriu shperthen mbi pjesen tjeter te vendit, si dhe ne temat e njohjes nderkombetare dhe ne impaktin qe shpallja e njeanshme e pavaresise do te kishte ne ligjin nderkombetar.

Siç e permenda me pare, mendoj se analizat dhe raportimet nuk ishin mjaft te sakta apo te balancuara dhe me baza te forta. Mendoj se persa i takon nenvleresimit te perçarjeve brenda BE dhe per pasoje dhe pritshmerive, kjo do te duket ne disa citime qe kam nxjerre. Kete e kam marre nga The Observer, e cila mbivlereson numrin e shteteve qe do te njihnin Kosoven. Ka nje tjeter citim te ngjashem nga The Guardian, qe thote: 'çuditerisht vetem Qipro duket se do te jete e paperkulur ne refuzimin per te njohur vendin e ri.'

Eshte mjaft interesante, pasi raportimi u perqendrua ne nje shkalle te gjere te Kosova ne lidhje me pavaresine dhe njohjen e saj dhe nuk jam i sigurt nese edhe ne Bruksel ka pasur te njejten vemendje. Mendoj se shumica e mediave britanike nuk arriten te ishin te ndergjegjshem per problemet e medha ne Bruksel midis shteteve te BE, te cilat po i shohim sot. Sigurisht, refuzimi i Rusise per planin Ahtisari nxorri ne siperfaqe ndarjet brenda BE, te cilat mund te ishin sheshuar nese OKB do te kishte nje zgjedhje tjeter ne ate kohe.

Po te vazhdojme me komentet, kam gjetur nje sere lajmesh, sidomos ne letrat per gazetat dhe ne blogjet e tyre, si nga gazetaret, ashtu edhe nga publiku, nje game te gjere pikepamjesh pro dhe kundra. Persa i perket komentuesve aktuale, ku verehet nje game e gjere pikepamjesh, mendoj se kjo eshte e rendesishme duke konsideruar perfshirjen e Britanise ne luften e Kosoves ne 1999 dhe entuziazmin e qeverise Blair per kete nderhyrje humanitare. Te gjitha gazetat britanike ishin ne favor, me perjashtim te Sunday dhe publikut britanik. Mund te mendohej qe tete vjet me vone kjo mbeshtetje e forte per Kosoven do te kishte vazhduar, por nuk ishte keshtu.

Persa i perket gazetave dhe artikujve editoriale, ne pergjithesi kishte pak entuziazem. Mendoj se nje koment shume i mire u be nga Timothy Nash, i cili i referohej kesaj si zgjidhja me pak e keqe per te parandaluar paqendrueshmeri te metejshme ne Ballkan, pasi pavaresia ishte ndoshta nje zgjidhje e papranueshme ne lidhje me refuzimin e serbeve dhe natyres universale te deklarates dhe se do te vendoste nje precedent. Keshtu, ai i referohet: 'Kosova sigurisht qe eshte unike, ashtu siç eshte unike çdo situate, por po unike jane edhe te gjitha levizjet qe kerkojne pavaresi, dhe do te

kete nje impakt ne disa pjese te botes, duam apo s'duam ne. ky ishte artikull i menduar mire, i balancuar dhe reflektonte nje nje fare menyre pikepamjet e shprehura nga gazetat kryesore britanike.

The Guardian flet per problemet ne lidhje me rendin nderkombetar, zgjidhjen e konflikteve dhe nese kjo eshte menyre per te ecur perpara. Po ashtu The Independent ben nje shaka pa kripe dhe nenkupton ate qe The Daily Telegraph e tha shume me qarte. Artikujt e mirepriten pavaresine e Kosoves, por kur behej fjale per vetevendosjen, nje fjale qe diplomatet e shmangin, The Telegraph e pa kete si nje çeshtje te rendesishme, duke besuar se edhe serbet kane te njejten te drejte per vetevendosje. Gjithsesi analogjite jane pak te sforcuara por Telegraph ishte mjaft i dhene pas vetevendosjes, sepse ka nje qendrim skeptik dhe eshte nje gazete konservatore dhe perfaqeson publikun konservator ne Britani dhe idene e multietnicitetit mbi te cilen ndertohet Evropa. Prandaj gazetat bene thirrje per vetevendosje jo vetem per Kosoven por edhe per serbet brenda Kosoves.

Mendoj se kjo ishte nje pikepamje paksa periferike dhe jo fort e perhapur ne median britanike. Por eshte e rendesishme te shqyrtohet edhe kjo qasje. Te tjere mund te mendojne se ndarja ishte hapi i duhur, por persa i takon qeverise britanike kjo eshte e papranueshme […]

[…] Per te permbledhur ne nje fjali pasqyrimin ky ishte shume sporadik, por kur ka nje çeshtje apo histori te rendesishme mendoj se mediat britanike ia dalin me se miri. Raportimi eshte pergjithesisht i mire, por sigurisht jo i persosur.

Mendoj se mediat britanike shkelqyen ne pjesen e komenteve. Ndoshta nje pikepyetje e madhe ishin analizat per çeshtjen e njohjes ne bote dhe percarjet brenda BE, si dhe ne mungesen e pergjithshme te entuziazmit per pavaresine, e cila u pa si zgjidhja me pak e keqe. […]

Giuseppe Zaccaria

Korrespondent i Ballkanit për gazetën e përditshme La Stampa (Itali)

[…] Zoti Partos sapo dha perkufizmin sporadik per median britanike. Ne lidhje me median italiane, mund te them shume e varfer apo krejt e munguar. Shkurtin qe kaloi vetem kater gazeta perdoren korrespondente ne Kosove. keto ishin La Stampa, La Repubblica, the Corriere della Serra, por vetem per arsye ekonomike. Te tjerat i pasqyruan ngjarjet me agjencite e lajmeve dhe kronikat TV. Perse? Ka disa arsye – me e zakonshmja eshte se publiku mendohet te jete lodhur nga problemet e Ballkanit, gje qe eshte pjeserisht e vertete pas viteve me te keqija te Millosheviqit, te Kosoves, me pas te Malit te Zi etj. shume shpesh publiku instinktivisht i refuzon lajmet nga Ballkani.

Kjo ndodh edhe sepse, siç mund ta dini, jemi gazetare te dobet dhe vazhdojme te punojme me menyren e vjeter dhe publiku eshte krejtesisht i ndryshem. Po ky publik, por i lindur ne vitet '60 dhe '70 duke pare TV komercial e konsideronte jeten si nje serial: fillimi, problemi zgjidhja dhe fundi i lumtur. Me pas, pas fundit te lumtur, cilido qofte ai – fundi i Millosheviqit, fillimi i pavaresise se Kosoves – varet nga pikepamjet – publiku e konsideron historine te mbyllur.

Sipas perceptimit tim distanca midis Evropes Jug-Perendimore dhe Ballkanit nuk ka qene kurre kaq e madhe. Ekzistojne çeshtje me serioze dhe pyetja kryesore eshte se si njerezit e informacionit do ta ndryshojne Evropen. Per mendimin tim, eshte duke ndryshuar ne nje menyre te keqe, por askush nuk mund ta ndaloje kete proces. Siç mund ta dini gazetat me te mira ne Itali, France, Spanje dhe pjeserisht ne Britani jane me te merakosura per zbavitjen se sa per lajmet apo analizat. Ky eshte nje model i ri i njerezve, i motivuar kryesisht nga arsyet ekonomike. Psh, ne lidhje me Ballkanin, gazetat italiane kane shpenzuar nuk e di sa milione ne fillim lira dhe pastaj euro per te derguar korrespondente ne kete zone. Une vete kam kaluar 3 vjet ne Sarajeve gjate luftes. Kjo do te thote shume para, kosto te larta dhe sot kryeredaktoret dhe botuesit nuk jane me te gatshem te investojne ne kete gje […]

[…] Gazetat italiane i kane ulur 70-80% faqet per çeshtjet e jashtme. Dikur TV publik italian i jepte shume hapesire Ballkanit dhe rajoneve te tjera. Sot, hapesira per çeshtjet e jashtme eshte e paket dhe varet nga imazhet e perditshme te transmetuara nga rrjetet boterore tv si CNN etj. pasoja e ketij qendrimi eshte qe askush nuk eshte i gatshem te investoje ne gazetarine cilesore […]

[…] Ne Itali kemi edhe nje problem specifik: ne dy vitet e fundit jane rrembyer dy gazetare italiane, nje ne Irak dhe nje ne Afganistan, une gjendesha atje ne te dy rastet. Giuliana Sgrena, ndoshta mund te kujtoni qe ne fund te rrembimit nje ushtar amerikan vrau nje polic italian, pasi Giulliana u kthye ne shtepi e lire si dhe Daniele Mastrogiacomo vitin e kaluar ne Afganistan. Ne te dy rastet qeveria italiane shpenzoi shume para per te shpetuar gazetaret. Korrespondenti i jashtem eshte jo vetem i padobishem, por edhe i rrezikshem; prandaj eshte me mire qe korrespondentet e jashtem te kthehen ne atdhe dhe te vazhdojme punen me Internetin apo kujtimet tona. Kjo eshte gjendja e shtypit jo vetem ne Itali, por kudo. […]

[...] Gazetat si dhe rrjetet TV po perpiqen te ndryshojne permbajtjen e gazetarise eksperte, te perdorin bashkepunetore te jashtem, ndoshta ndonje gazetar ekspert mund te levize ne nje zone te caktuar, te jetoje atje dhe te pasqyroje zonen. E kam pasqyruar Ballkanin per 20 vjet, qe do te thote se jam mazokist, pasi i tille duhet te jesh qe te duash Ballkanin. Por endrra ime nuk eshte te shperngulem nga Prokuplje ne Tetove me qellim qe te mbuloj zonen. Kjo gjendje nuk eshte aspak premtuese […]

[…] Ne gazetaret ne Itali po perpiqemi, pa asnje sukses, te bindim

botuesit se kjo eshte menyra e gabuar dhe i ben gazetat me pak interesante, te rendesishme dhe te suksesshme. Pozicioni i botuesve eshte qe gazetat ne Itali jane shume te mira, keshtu qe duhet ta ulim cilesine. Ato jane shume te mira, shume te shtrenjta. Sa per informacion, ne Itali kemi shitur perdite rreth 5-5.5 milione kopje ne keto 50 vjet. Sot shtypi i lire ne Itali po shet rreth 4 milione kopje ne dite. Shtypi i lire eshte mjaft i gatshem te jete me i rendesishem sesa i ashtuquajturi shtyp cilesor. E njejta gje po ndodh ne Spanje dhe France. Nuk mendoj se do te shkojme shume larg me kete menyre.

Keto dite kam ndjekur nje diskutim dhe aktivitetin e disa shkollave te gazetarise ne Ballkan. Nuk di ç'te them. Ose keto shkolla jane pak te kushtueshme, ose gazetaret kenaqen me nje shperblim te ulet. Shpesh u kemi mesuar gazetareve te rinj diçka qe eshte jashte realitetit. Vazhdojme t'i mesojme si te jene serioze, si te citojne burimet, si te jene objektive etj. Ne te njejten kohe infromacioni leviz diku gjetiu. Kjo eshte edhe pikepamja ime per situaten e gazetarise dhe Ballkanin.

Ne mund te diskutojme gjate nese gazetaria e mire mund ta permiresoje shoqerine, apo nese duhet nje shoqeri e mire qe te kesh nje gazetari te mire. Ndoshta une jam me shume per zgjedhjen e dyte. Atehere ndoshta ato vende qe po ndertojne shoqeri te reja dhe gazetare te rinj nuk mund te jene te sigurt per gazetaret me te mire te mundshem, por ne te njejten kohe pjesa tjeter e Evropes po shkon diku tjeter dhe fatkeqesisht distancat mes nesh po rriten. […]

[…] Dje degjova z. Houwen qe citonte Haekkerup, ish te derguarin e OKB ne Kosove qe thoshte: 'Do ta konsideroj misionin tim te plotesuar kur Kosova te zhduket nga faqet e para te lajmeve ne bote'. Pra mund t'i themi z. Haekkerup se misioni i tij ka qene krejt i suksesshem pasi Kosova nuk eshte me ne titujt kryesore.

Gorazd Kovaçiç

Universiteti i Lubjanës, Fakulteti i Arteve, Departamenti i Sociologjisë (Sllovenia)

Do te nis me mendimin personal per ate qe eshte me te vertete e rendesishme ne rastin e Kosoves dhe besoj se nuk jam i vetmi ne kete dhome qe e mendon keshtu.

Perse mendimi im personal si pikenisje? Pasi mendoj se ka nje rendesi epistemologjike, pasi eshte baza per gjykimin e ketyre perspektivave, te atyre pak perspektivave, te cilat u promovuan nga media kryesore ne lidhje me çeshtjen e Kosoves. Mendimi im eshte mjaft i thjeshte – ajo qe eshte me te vertete e rendesishme ne rastin e Kosoves, ne kushtet e jeteses, ne dobesine e institucioneve dhe ne faktin se njerezit ne Kosove kane jetuar ne nje gjendje emergjence per dekada te tera. Te gjitha keto prodhojne nje model moszhvillimi. Pra, arsyeja kryesore se pse Kosova duhet te behet nje

lloj shteti eshte qe çdo qenie njerezore ka te drejten njerezore dhe nevojen themelore per te jetuar ne nje shtet. Nje pyetje tjeter eshte nese ky shtet duhet te jete i pavarur – Kosova, Serbia apo çdo shtet tjeter.

Pra, kur flas per shtetin, nuk po flas vetem per çeshtjen e simboleve apo njesise kombetare, por me teper per sherbimet qe nje shtet siguron per banoret e vet. Sherbime te tilla si siguria, shteti ligjor, siguria sociale, arsimi, sistemi shendetesor infrastruktura dhe sigurisht stimulimi i investimeve.

Por kur shohim pasqyrimin e medias per shembull ne Slloveni, mund te shohim se mediat perpiqen te jene neutrale, te paraqesin perspektiva te ndryshme, pikepamje te ndryshme per rastin, por te gjitha keto pikepamje vijne nga lojtare te medhenj ne rajon apo lojtare globale dhe ato perfshijne nevojat dhe perspektivat e njerezve te thjeshte qe jetojne ne Kosove.

Shume ndarje klasike te qendrimeve – shume nga artikujt qe kam lexuar per Kosoven ne gazetat sllovene ndaheshin ne dy pozicione, ate te politikaneve serbe dhe ate te politikaneve kosovare dhe ata qe i mbeshtetnin keta te fundit. Pala serbe u paraqit duke perseritur argumentin e ligjit nderkombetar, si argumentin ose me mire mitin e Kosoves si toka e shenjte serbe qe i perket vetem Serbise, por nga ana tjeter perspektiva e politikaneve shqiptare te Kosoves ishte nje i ashtuquajtur realizem politik – Kosova tashme ishte e pavarur nga Serbia dhe ajo qe eshte me e rendesishme ishte se Shtetet e Bashkuara te Amerikes vendosen qe Kosova do te ishte nje shtet i pavarur, keshtu qe nuk ka faktor per te ndaluar kete vendim dhe realizimin e tij. Por serish, te dyja perspektivat perjashtojne nevojat dhe deshirat e njerezve te zakonshem ne Kosove.

Mendoj se perzgjedhja e informacionit qe mendohet i rendesishem eshte edhe nje lloj interpretimi i kuptimeve te ngjarjeve dhe konstelacioneve. […]

[…] Mendoj se duhet te perfshijme nje perspektive ekonomike – kete e beri edhe z. Zacharia para meje – duhet te konsiderojme menyren e prodhimit te medias sot. Gazetat jane ne krize kudo dhe priren te prodhojne permbajtje me relativisht kosto te uleta, sidomos per ato nderkombetare. Keshtu, kemi arritur ne nje rreth vicioz – nga njera ane e ketij qarku mund te shohim ekonomiken e prodhimit te lajmeve dhe pastaj pasojat jane te informim i ngushte i botes dhe fitimin social dhe pasojat jane injoranca dhe pandjeshmeria e konsumatoreve te medias – dhe serish dalim ne ekonomi.

Pra ndoshta pyetja ime thelbesore eshte kjo: Si munden mediat, te cilat ne fakt organizohen si kompani private dhe duhet te ndjekin logjiken e kompanive private qe nxjerrin fitim, si mund ta kryejne ato funksionin e tyre publik? Ky eshte paradoks. Besoj se duhet te flasim per kete paradoks edhe ne termat e asaj qe mund te behet ne kete situate per te mos qene thjesht pesimiste dhe t'ia ngulim syte kesaj situate e cila po behet gjithnje e me e shemtuar.

Per mendimin tim, por une nuk jam gazetar, ajo qe eshte e rendesishme eshte qe gazetari duhet te jete nje analist i mire. Ai ose ajo duhet te kuptoje implikimet e punes rutine te gazetarit. Thjesht verifikimi dhe citimi i burimeve te ndryshme nuk eshte i mjaftueshem per mendimin tim. Ajo qe eshte me e rendesishme eshte te kemi nje sens per perspektivat qe fshihen prapa burimeve kryesore. Pra, nje gazetar duhet te kuptoje kompleksitetin e botes dhe ai apo ajo duhet te kete nje qendrim te shendoshe etik per te mos u perkulur para distances cinike ndaj gjithçkaje.

Agnieszka Skieterska

Gazetare e se përditshmes Gazeta Wyborcza (Poloni)

Do te doja te thosha diçka me teper per median polake ne raportimin mbi Kosoven ne periudhen 2006 – 2008. Si korrespondete e Ballkanit per gazeten polake Gazeta Wyborcza, e kam vizituar Kosoven vitet e fundit me shpesh seç kam vizituar familjen time te shperndare ne Poloni. Ne fakt, sa here shkoj ne Kosove di me shume, kuptoj me shume, por paradoksalisht po behet gjithnje e me e veshtire per mua te raportoj per konfliktin e Kosoves. Perse valle? Sepse behet perhere e me e veshtire qe te permblidhen gjithe permbajtja dhe nuancat e ndryshme shume domethenese ne konflikte etnike, ne nje çerek, gjysme apo edhe nje faqe te tere gazete. […]

[…] Pas vitit 1999 dhe fundit te luftes se Kosoves, rajoni nuk ngjallte me interes per median polake dhe nderkombetare. Sigurisht, informacioni per Kosoven ne Poloni botohej rastesisht, kryesisht duke raportuar per turbullirat si ato te marsit 2004, per ngjarje politike kyç, si padia ndaj Ramush Haradinajt dhe rotacioni i kontigjentit te ushtrise polake ne Kosove.

Kosova u kthye ne faqet e para te gazetave ne vitin 2006, pak pas fillimit te negociatave ne Vjene, te drejtuara nga Marti Ahtisari. Dhe deri sot te gjitha ceshtjet qe lidhen me Ballkanin jane pershkruar gjeresisht ne median polake. Do te doja t'iu thosha se kush dhe si informon per çeshtjen e Kosoves ne Poloni. Ndarjet e dukshme politike ne shtypin dhe median polake nuk kane ndonje rendesi per raportimin e lajmeve nderkombetare. Shtypi, TV dhe radiot, nuk mbajten qendrim as pro-shqiptar dhe as pro-serb. Megjithate kishte artikuj qe favorizonin dukshem njeren apo tjetren pale. Me shpesh opinione te tilla perfshiheshin ne komente, qe ne Poloni botohen kryesisht ne faqen e dyte dhe dallohen qarte nga artikujt informative. Simpatia politike e medias polake u duk qarte vetem nje here: kur Polonia si anetare e BE e njohu Kosoven ne shkurt 2008. Kush e sjell informacionin? Nder mediat kombetare qe ndikojne ne perceptimin e çeshtjes se Kosoves duhen permendur si vijon: Gazeta Wyborcza, Rzeczpospolita dhe Dziennik, tre revista javore Polityka, Wprost dhe Newsweek Polska, pese stacione TV, kater radio, Internet ueb faqe.

Gjate ngjarjeve me te rendesishme ne Kosove, te gjitha keto media, perveç disa revistave javore, kishin korrespondente dhe fotografe ne terren. Ne

Prishtine kishte rreth 40-5- gazetare polake, ne dhjetor 2007 dhe shkurt 2008. Megjithate numri nuk pasqyron cilesine. Vetem dy apo tre persona nga ky grup merren perhere me Ballkanin dhe kalojne me shume se tre apo kater dite ne Kosove, duke vajtur ne zona te tjera perveç Prishtines dhe Mitrovices. Dua ta theksoj kete fakt pasi rastesia e gazetareve te lajmeve te jashtme mendoj se po kthehet ne nje problem te madh te medias moderne.

Nje grup reporteresh qe vizitojne Irakun, Rusine, Gjeorgjine apo Kosoven, nuk kane kohe per perpjekje te medha. Pasojat e kesaj pune u duken qarte edhe ne pasqyrimin polak te gjendjes ne Kosove, te bere sidomos nga stacionet TV dhe reporteret. Ne fillim te gjithe transmetuan nga bulevardi Nene Tereza apo tarraca e Hotel Grand ne Prishtine dhe pastaj shtuan nje rrefim te shkurter nga ura e Mitrovices dhe nje deshmi nga ndonje murgeshe apo prift ortodoks ne Gracanice apo ndonje manastir tjeter, si dhe komentin e ndonje analisti politik. Ne kete menyre kronikat ishin gati. Nuk dua te kritikoj kete menyre raportimi duke pasur parasysh programet e shkurtera informative, ku nuk ka vend per analiza, apo pjese me te gjata informacioni. Problemi fillon kur media transmeton materiale gazetaresh qe pershkruajne vetem ngjarjet dhe shpesh anashkalojne arsyet qe fshihen pas tyre. Pas disa ditesh qe sheh apo lexon keto raportime, publiku e di saktesisht sa njerez moren pjese ne nje demonstrate apo sa ton fishekzjarre u hodhen gjate festimeve te pavaresise. Fatkeqesisht, ajo qe askush nuk e kupton eshte çfare duan te thone njerezit ne Kosove. Kjo duket me mire ne shtypin e shkruar ne Poloni. Shumica e vemendjes Kosoves iu dha ne fillim nga dy gazeta te perditshme Gazeta Wyborcza, qe ka cilesine me te larte ne Poloni – gjysem milion kopje shitje te perditshme – dhe gazeta e dyte ne kete grup Rzeczpospolita – shitjet e perditshme rreth 150,000 kopje. Keto ishin gazetat e vetme qe botuan jo vetem lajme, por edhe reportazhe nga Kosova. E perditshmja e trete u kufizua vetem me raportime te gjata. Disa artikuj u botuan edhe ne revista te perjavshme, shume prej te cilave dramatike. Ju thashe se po botojme jo vetem lajme te shkurtra, pra çfare beme? Nuk me pelqen ta perceptoj ne fillim vetem nga ana politike. Nuk ka kuptim te genjejme veten qe polaket apo francezet kane ndonje interes per nderrimin e qeverise ne Afganistan, Maqedoni, apo Kosove. E njejta gje vlen edhe per keto vende te cilave nuk u behet vone per doreheqjen e ministrave polake. […]

[...] Kjo dobesi eshte e pranishme jo vetem ne disa media serbe. Duhet ta pranoj se nje nga testet thelbesore per shtypin serb kosovar dhe shqiptar, gjate javeve te fundit, ishte nje lajmerim i Karla del Ponte ne lidhje me aludimet per tregti te organeve njerezore serbe te kryer nga shqiptaret e Kosoves. Nese nje histori e tille do te zbulohej ne Poloni, pa sjelle deshmi te mjaftueshme, si libri i Del Pontes, kjo ceshtje do te diskutohej ne faqet e para per jave te tera. Turma gazetaresh do te vinin ne vendin ku mendohej se qe kryer krimi. Mediat as ne Serbi dhe as ne Kosove nuk kane sjelle ndonje gje te re per kete çeshtje. Ata thjesht shkruan per te dhe kjo provon vetem dobesine e tyre. Duhet te pranoj qe edhe disa gazeta nderkombetare dhe polake raportuan pa asnje sens kritik, duke perfshire edhe Dziennik.

Sipas opinionit tim, shtypi polak ka raportuar per çeshtjen e Kosoves ne nje menyre objektive. Ne te njejten kohe kjo rezulton pjeserisht nga distanca qe ndjejme ne lidhje me konfliktin e Kosoves. Por nga ana tjeter, mediat polake nuk e mbajten dot kete objektivitet kur raportuan per revolucionin ne Ukraine, fqinjen tone. Shumica e mediave favorizuan kampin e presidentit Victor Yushchenko. Problemi me i madh me te cilin perballen gazetaret kur raportojne per Kosoven eshte mungesa e ideve per ta paraqitur ne menyre interesante dhe jo vetem per nje grup te vogel njerezish qe iu intereson Ballkani.

Ne mbyllje dua te citoj nje fjali nga Ne Mes te Lindjes dhe Perendimit te shkruajtur nga Anne Applebaum, fituese e çmimit Pulitzer per librin Gulag, qe nxjerr ne pah veshtiresite e raportimit te çeshtjeve te Ballkanit:

'Ate qe disa e quajne nacionalizem, te tjeret e quajne patriotizem, ndersa disa te tjere e quajne liri'. Nese e kemi parasysh kete kur dorezojme artikujt ne redaksi do te kemi nje mundesi ta bejme ndershmerisht punen tone.

DISKUTIME

Bela Ajzenberger

Shkolla e Gazetarise Novi Sad (Serbia)

Pyetje per z. Gabriel Partos. Ai permendi nje ndarje te bute te Kosoves. A mund ta shpjegoni ç'do te thote kjo dhe a eshte debatuaar kjo ide ne shtypin britanik? […]

Gabriel Partos

Analist per Evropen Qendrore dhe Jug-lindore (Britania e madhe)

[…] Ideja e ndarjes se bute eshte shqyrtuar dhe eshte pare si nje fakt qe eshte i veshtire te anashkalohet dhe mendoj se askush nuk e ka menduar seriozisht per momentin. Mendoj se nje element interesant ishte ky qendrim i marre nga Daily Telegraph shume euro-skeptik, i cili beri çmos te mirepriste Kosoven dhe nocionin e vetevendosjes per Kosoven dhe shumicen.

Eshte shume ironike pasi The Telegraph, ne ditet e mira te Perandorise Britanike ishte gazeta qe i rezistoi me shume pavaresise se kolonive britanike, por ketu perkrahu vetevendosjen e Kosoves dhe shkoi nje hap me tej, duke thene se e njejta gje duhet te vleje per serbet ne veri. Dhe citimi permendte, me shume pasaktesi, qe ky udheheqes i referohej kesaj si nje gje e lehte, pasi ishte e qarte qe udheheqesi nuk ishte i ndergjegjshem qe me shume se gjysma e komuniteteve serbe ne Kosove nuk jane ne veri. Pra, kjo do te perbente nje vetevendosje te pjesshme, vetem per ata qe kane nje komunitet serb kompakt ne veri.

Do te thosha se ishte nje pikepamje e pakices ne median britanike dhe mendoj se qendrimi i pergjithshem ishte per ate qe po ndodh ne kete situate informale, por se çfare mund te behet per kete mendoj se asnje nuk e ka gjetur pergjigjen.

Willem Houwen

Drejtor i Institutit te Gazetarisë dhe Komunikimit të Kosovës (Kosova)

Duhet te flasim per rolin ne rritje te informacionit, i cili eshte kthyer nga think-tank, si the International Crisis Group (ICG), the European Strategic Initiative (ESI), dhe kjo eshte diçka qe ka vazhduar ne SHBA per shume vite, por ne Kosove shihet se shtypi nderkombetar kur do opinione, siç e pershkroi Agnieszka, nuk shkon me te "Koha Ditore" por tek Alex Anderson, qe drejton zyren e ICG ne Prishtine dhe eshte i mireinformuar.

Pyetja ime eshte: a mund te pershkruani pjeset pro dhe kundra te ketij zhvillimi dhe a mund te kryhen ne gazetari ne ato periodha kur kishte dhune dhe po zhvilloheshin ngjarje negative?

Gabriel Partos

Analist për Evropën Qendrore dhe Jug-lindore (Britania e madhe)

Mendoj se eshte nje pyetje shume interesante dhe kam mendim shume te mire per think-tank-et e permendura per ekspertize. Natyrisht, mendoj qe çdo gazetar i mire duhet te jete i ndergjegjshem per axhendat e veçanta qe kane keto organizata. ICG ka folur para politikaneve dhe diplomateve ne lidhje me ate qe ata e quanin pavaresi te kushtezuar dhe qe eshte kthyer ne pavaresi te mbikqyrur ne zhargonin diplomatik. Pra, duhet te jeni te ndergjegjshem per pikepamjet e ndryshme, pasi ato nuk jane thjesht think-tank organizata ne kuptimin e sjelljes se mirekuptimit, njohurise dhe informacionit, ata jane organizata think-tank qe bejne avokaci per disa politika te caktuara dhe ky eshte edhe rasti i ESI, e cila eshte shume e mire ne qasjen provokuese dhe bashkepunon me organizata te ndryshme te BE dhe te tjera dhe nuk eshte krejtesisht e pavarur ne kendveshtrimin e saj.

Mbaj mend qe kater vjet me pare doli me nje politike te veçante dhe analize te vlefshme ne Bosnje, per ate se si kishte ardhur koha te hiqnim dore nga perfaqesuesi i larte nderkombetar qe e pengonte Bosnjen te arrinte pavaresine e keshtu me rradhe, qe perputhet me kohen kur une punova ne Ministrine e jashtme britanike dhe kur po beheshin perpjekje per ta hequr kete gje edhe gjashte vjet me pare. Me kujtohet qe pasi doli raporti i ESI per nevojen per t'i deleguar pushtet autoriteteve lokale dhe per te hequr kete strukture koloniale. Te nesermen kjo ishte ne faqen e pare te The Guardian, qe eshte nje

sukses i jashtezakonshem per nje think-tank. Keshtu qe mendoj se ka shume vertetesi ne ate qe po thua dhe them se gazetaret duhet te jene krejtesisht te ndergjegshem per menyren se si raportet e think-tank-eve me influence mund te mos jene teresisht te paanshem ne informacionin qe japin.

Shume interesant ne kete kontekst ishte fakti qe z. Ahtisaari ishte president i ICG para caktimit si negociator i zgjidhjes se statusit te Kosoves dhe vinte nga nje organizate qe kishte dhene opsionet per pavaresi te kushtezuar disa vjet me pare. Pra, mendoj se keto raporte jane shume te vlefshme, te mira dhe te rendesishme per gazetaret, por ashtu si çdo burim tjeter, duhet te trajtohen me kujdes.

Giuseppe Zaccaria

Korrespondent i Ballkanit për të përditshmen La Stampa (Itali)

[…] Si mund t'iu krijosh mundesi gazetareve qe te bejne nje gazetari te mire? Eshte ajo qe Kovaçiç tha me pare, si ta drejtosh nje gazete si ndermarrje dhe njeheresh te ruash funksionin publik te informacionit? Po e konsiderojme kete mundesi me shume vemendje. Nuk besoj se eshte pa mend te promovosh gazetat perderisa disa njerez shkojne ne banje per t'i lexuar ato. Te promovosh disa gazeta publike me shume garanci, jo te shtetit apo te qeverise, por gazeta qe aspirojne jo vetem per fitime, por edhe per misionin, per rolin publik te gazetarise dhe keshtu duhet te zhvillohemi edhe ne te ardhmen.

Remzi Lani

Drejtor i Institutit Shqiptar te Medias (Shqipëria)

[…] Do te doja te shtoja diçka per pyetjen lidhur me think-tank dhe mediat. Kam ndjesine se keto think-tank nderkombetare ICG, ESI, Carnegie, Balkan Policy Group, e perdorin median me mire nga se i perdor media ato, sepse po te shohesh ICG burimet e medias jane nder te parat dhe ata kane nje variacion mediash qe i quajne nga media serioze ne tabloide, gazeta nacionaliste dhe mendoj se kane te drejte. Me pas vijme te produkti i tyre, qe perdoret ne menyre siperfaqesore nga sinergjia e medias.

Daut Dauti

MCMK "Tolerance" dhe anetar i Bordit të Komitetit te Helsinkit (Maqedonia)

Ne jemi perfaqesues te medias dhe njerezve te lidhur me median ne Ballkan dhe me gjere. Do te doja qe shkurtimisht t'i referohesha nje pike, nje argumenti te planit Ahtisari qe thote se Kosova nuk duhet konsideruar si precedent. Dilema ime eshte nese media boterore e ka shpjeguar sa duhet kete pike te planit Ahtisari.

Jam gazetar qe i jep mesim gazetareve te rinj dhe ndonjehere me duket e veshtire te shpjegoj dhe te frymezoj ata qe duan te kene kete profesion, te shkruajne lajme me nje tekst te shkurter gazetarie qe do te perfshije gjithçka ne lidhje me ngjarje, perfshire edhe thelbin e problemit.

Giuseppe Zaccaria

Korrespondent i Ballkanit për të përditshmen La Stampa (Itali)

Sigurisht gazetaret nuk jane historiane. Ne te kaluaren u perpoqem te shpjegojme me cilesite tona te varfera situaten ne Kosove, por kemi shpjeguar edhe planin Ahtisari kur u be publik. Problemi eshte qe diçka shpjegohet dhe diçka eshte realitet dhe sot askush nuk e di si do te jete e ardhmja e Kosoves. te gjithe e njohin planin Ahtisari, por nuk e dime sa e veshtire eshte ta bejme realitet kete plan ne kete zone dhe ne kete moment. Them se raportimet per kete proces kane qene mjaft te mira kudo, por serish do te them se plani eshte nje gje dhe realiteti diçka tjeter.

Gorazd Kovaçiç

Universiteti i Lubjanës, Fakulteti i Arteve, Departamenti i Sociologjisë (Sllovenia)

Plani Ahtisari thote se Kosova nuk eshte precedent. Them se eshte e pakuptimte; Kosova eshte precedent dhe do te perdoret si e tille kur cdo grup tjeter do t'iu referohet ketyre ngjarjeve. Por duhet te konsiderojme qe historia nuk mund te ndalet me rezoluta nderkombetare, si ato te Keshillit te Sigurimit te OKB, pasi historia eshte nje zinxhir ngjarjesh qe thyejne disa situata te qendrueshme dhe rikonfigurojne marredheniet dhe kufijte. Kosova nuk eshte rasti i pare i ketij lloji ne histori dhe shume ngjarje te tjera do te ndodhin ne te ardhmen, por nuk mund te themi asgje konkrete per te ardhmen dhe se si njerezit reagojne ne keto procese.

Gabriel Partos

Analist për Evropën Qendrore dhe Jug-lindore (Britania e madhe)

[…] Media cilesore ne Britani e shpjegoi kete si nje aspekt te rendesishem te Planit Ahtisari pikerisht per arsyen se perndryshe do te shihet si shume e dyshimte ne terma ligjore dhe nderkombetare. Mendoj se ka tre probleme thelbesore ne kete gje: se pari, ne nje nivel praktik, me gjithe shpjegimet e sofistikuara diplomatike, per levizjet separatiste dhe nacionaliste ne bote, qe nuk e njohin mire situaten ne Kosove dhe historine, ata do te pretendojne se ky eshte precedent dhe se edhe ata duhet te kene te njejtat te drejta, siç eshte bere tashme ne Abkhazi dhe Oseti Jugore. Te tjere, Sri Lanka dhe

Tamili do te bejne te njejten gje. Problemi i dyte eshte qe edhe nese shohim disa nga menyrat se si historia e Kosoves eshte unike, nese do te kishte nje interpretim universal te historise ne bote dhe nese pala serbe ta pranonte kete, atehere te gjithe mund te thoshin: po, ne beme nje gje te tmerrshme, por shqiptaret e Kosoves e meritojne te jene te lire dhe te pavarur. Por kjo nuk behet dhe nuk ka interpretim universal te historise.

Se fundmi, ne termat ligjore nderkombetare mendoj se qeverisja ne Kosove eshte unike, duke qene subjekt i Rezolutes se OKB per Kosoven e vitit 1999, ka qene nen administrimin e OKB qe atehere, pra ndryshe nga konflikte te tjera ne bote, me perjashtimin e ish-konfliktit ne Timorin Lindor, aty ka nje autoritet te OKB qe mund te vendose. Sikur OKB te kishte qene e afte ta çonte perpara kete dhe Rusia te mos e kishte bllokuar, mendoj se ne terma ligjore kjo do te kishte perparuar dhe do te kishte pasur nje pranim ne bote qe ky eshte rast unik dhe nuk duhet te vendose nje precedent. Por per shkak se Rusia nuk e pranoi kete qasje, mendoj se kjo rruge eshte me e veshtire per t'u justifikuar, prandaj mendoj se eshte nje çeshtje e mbytur ne veshtiresi dhe se Kosova eshte unike, por eshte e veshtire per t'u shpjeguar, jo vetem per publikun britanik, por edhe per levizjet separatiste dhe nacionaliste ne bote. Kjo pikerisht per shkak te ketyre veshtiresive dhe me kryesorja sepse nuk ka pasur nje konsensus te pranuar ne OKB per shkak te vendosmerise se Rusise, arsyeve te politikave te pushtetit te vete Rusise per te bllokuar qasjen e BE dhe te Amerikes.

Mirjana Millosheviq

Qendra e Medias Beograd (Serbia)

Eshte nje baze shume e mire per dy çeshtje qe dua te ngre – njera ka te beje me ndryshimin e raportimit ne median nderkombetare nga koha e konfliktit 1998-1999 deri ne deklaraten e shpalljes se pavaresise se Kosoves. gjithashtu zoti Zacharia permendi stereotipet, paragjykimet, por a ka pasur me shume stereotipe dhe thjeshtezime ne 1999 apo sot ne vitin 2008? Ishte shume interesante per mua te shihja raportet e z. Partos per median britanike. Kishte disa qe thoshin se shqiptaret e Kosoves luftonin per pavaresi per shekuj me radhe dhe te tjere thoshin se serbet jane vene ne rresht per pastrim etnik, pasi ua kane bere kete gje te tjereve per dekada me radhe. Jane keto gjera te zakonshme, te perseritura, apo ishin thjesht shembuj te veçuar?

Pika e dyte eshte thjesht nje koment per ate qe po thoshit lidhur me The Guardian, qe eshte ne pronesi te nje trusti dhe eshte Associated Press qe funksionon mbi nje baze jofitimprurese. Ky eshte nje koncept qe po behet gjithnje e me i perhapur ne bote dhe diçka qe ka treguar se te ashtuquajturat ndermarrje sociale mund te punojne per perfitimin e grupeve te ndryshme sociale ne bote. Kjo eshte diçka qe ia vlen te merret ne shqyrtim ne kontekstin tone rajonal dhe ne rrjetin tone te SEENPM. Eshte e mundur te

kemi te dyja organizatat dhe media qe krijohen dhe zoterohen nga komunitetet e gazetareve? Sidomos duke pasur parasysh qe ne ne Serbi ende nuk kemi perfunduar procesin e privatizimit. Ishte nje koncept shume i veshtire per t'u perçuar, pra gazetaret qe mund ta blinin median e tyre, por asnje nuk bleu gje. Pra kjo eshte diçka qe ia vlen te mendohet ne te ardhmen ne rajon, kur eshte e mundur te kemi media dhe organizata te drejtuara nga gazetaret.

Giuseppe Zaccaria

Korrespondent i Ballkanit për të përditshmen La Stampa (Itali)

[…] Lidhur me pyetjen e pare – me falni qe serish po perdor te njejtat steriotipe. Gjate periudhes se luftes ne vitin 1999 kjo gje ishte e dobishme per te pasqyruar luften ne Ballkan. Por ne kete moment, po flas per gazeten si nje ndermarrje, pa iu referuar misionit te saj social. Menyra e vjeter e shitjes se shtypit te shkruar eshte dhe ka qene gjithmone e njejta: seks, gjak dhe pak futboll po pati mundesi. Dhe ne ate rast, me falni per cinizmin, pjesen e gjakut e mbuluan ne menyre te perkryer ngjarjet e Ballkanit. Tashme besoj se ne kete rast publiku ka nisur te lodhet nga tejngopja e ngjarjeve dhe duhet te merrni parasysh perceptimin e nje spanjolli apo italiani te thjeshte, qe sot ende nuk eshte i sigurt cilet jane kroatet, kosovaret etj. E vetmja pjese qe te gjithe e kane te qarte eshte qe serbet jane te keqinj. Kjo eshte e verteta, pasi eshte propaganda e vetme qe eshte perhapur per vite me radhe ne te njejten menyre. Kjo eshte arsyeja e thjeshte perse per momentin tensioni eshte shume me i ulet se me pare.

Nazim Rashidi,

BBC (Maqedonia)

Dua thjesht te bej disa komente, dua te them te ngre disa pyetje per te gjithe ne. […] duke degjuar te gjitha diskutimet, ajo qe mund te them nga perspektiva ime eshte se kur isha ne Londer, gjithe keto situata konflikti ne Ballkan raportoheshin nga gazetaret e huaj ndoshta jo me aq shume detaje, te pakten jo me detajet qe kerkonim ne gazetaret e rajonit.

Nga ana tjeter, kur lexojme gazetat tona, maqedonaset, per shembull per lajmet nderkombetare, verehet gjithmone qe artikujt jane te kufizuar. Per shembull, perveç shifrave te katastrofes ne Kine, sa dime per ate qe ngjau sot atje? Pra, çeshtja eshte qe kur flasim per gazetari profesionale duhet te pyesim veten se sa trima jemi per t'u bere pyetje te veshtira politikaneve tane apo shoqerise sone. Z. Lani permendi me pare nje konsensus kombetar per disa çeshtje, por a eshte kjo nje zgjedhje, per shembull, ne kontekstin e Kosoves? A po ben media serbe pyetje per pavaresine, pse ka ndodhur dhe a duhet te kishte ndodhur, apo duhet te ruaje konsensusin kombetar qe

Kosova duhet te jete pjese e Serbise dhe nga ana tjeter a bejne gazetaret kosovare pyetje te llojit a ka qene nje hap i mire deklarimi i njeanshem i pavaresise dhe se ku do te na shpjere kjo gje, pasi ne terma nderkombetare ka ende peshtjellim.

Pra, per te permbyllur kendveshtrimin tim do te thoja se eshte shume e rendesishme qe kur flasim per gazetare nderkombetare te kuptojme se ne si gazetare ketu nuk po raportojme hollesisht per artikujt nderkombetare, ashtu si ata nuk mund te raportojne ne menyre te plote per historite ne Ballkan. Por mendoj se si gazetare qe punojme ketu, duhet te shkruajme artikuj ku opinione te tjera perfaqesohen ndjeshem, qe te pakten te kemi nje pamje me te balancuar per te gjitha keto histori ballkanike.

Gabriel Partos

Analist për Evropën Qendrore dhe Jug-lindore (Britania e madhe)

[…] Pra, pyetja e dyte ne fillim – pati ilustrime te gabimeve nisur nga injoranca dhe e bera kete gje per te ilustruar faktin se kur ka periudha te gjata kur Kosova nuk eshte raportuar dhe se kur dergon ne vend dike pa njohurine e duhur, edhe kur ky i fundit vjen nga nje nga gazetat me ne ze– the Daily Telegraph – ne ato raste mund te behen gabime faktuale dhe ne vleresim, por mendoj se keto nuk ishin karakteristike e pasqyrimit ne pergjithesi, te pakten jo e gazetave qe kam pare une, gazetat cilesore dhe BBC.

Pika tjeter per ndryshimin e skemes se pasqyrimit ne Britani, deri ne 1998-99, kishte nje mbeshtetje te fuqishme per palen e shqiptareve te Kosoves, te cilet shiheshin si viktima, me te drejte, dhe sigurisht pas nderhyrjes se NATO, e nxitur mjaft nga Toni Bler – i cili atehere ishte ne majen e pushtetit dhe gezonte popullaritetin me te madh, duke qene nje politikan parimor, kerkonte nje nderhyrje humanitare dhe kishte mbeshtetje te jashtezakonshme per kete gje dhe ishte e qarte qe media i ra pas edhe publikut dhe qeverise ne kete aspekt. Sot situata eshte me komplekse dhe mbeshtetja per pavaresine nuk ka qene entuziaste. Mendoj se disa e kane pare si zgjedhjen me te mire per situaten, por nuk ekzistojne zgjidhjet e lehta dhe as plotesisht te kenaqshme, per shkak te nje lloj konflikti te ngrire ne kete moment midis Beogradit dhe Prishtines. Pra mendoj se eshte bere gjithnje e me e veshtire te raportosh per kete gje se fundmi, sidomos kur deshiron te nxjerresh minoritete brenda minoriteteve e keshtu me rradhe, mendoj se behet nje histori mjaft komplekse dhe mendoj se vete fakti qe eshte e veshtire kur nuk ka asnje rresht per shqiptaret ne Kosove qe ishin ne shenjester te pastrimit etnik ne mase ashtu si ndodhi ne 1998-99, atehere sigurisht pasqyrimi kthehet ne disa nuanca gri – ajo qe Agnieszka permendi me heret – dhe ngre dyshime per pikepamjet e ndryshme qe mediat reflektojne sot.

Gorazd Kovaçiç

Universiteti i Lubjanës, Fakulteti i Arteve, Departamenti i Sociologjisë (Sllovenia)

Do te doja te beja nje koment te shkurter per ate qe tha zj. Millosheviq. Ju vute ne dukje se gazetaret kishin nje mundesi per te blere median e tyre, por nuk e bene kete gje ne Serbi. Ne Sllovenі pati nje privatizim te brendshem, per shembull te gazetes 'Delo,' por me vone gazetaret i shiten aksionet, fituan disa para dhe i shpenzuan duke blere makina te bukura, varka, etj dhe pastaj hap pas hapi pronesia u perqendrua dhe sot nje biznesmen po kontrollon dy nga tre gazetat me serioze ne Sllovenі dhe nje tjeter po kontrollon te treten dhe te dy keta biznesmene i kane blere gazetat per te pasur fitime, por jo duke shitur kopje te gazetave apo reklame ne gazeta, por per t'i perdorur ato si instrumenta ne negocimet me qeverine per ndonje biznes te madh, i cili varet nga vullneti i qeverise. Keshtu, ky stil ekonomie eshte i tille qe pronaret e medhenj te gazetave ushtrojne presion mbi gazetaret sipas ngjyres se qeverise.

Njehere bera pyetjen se sa mund te mbeshtetem une si lexues te aftesite analitike dhe parashikuese te nje gazetari qe shet kushtet per autonomine e tij profesionale per te fituar disa para dhe per te blere nje makine te bukur?

LISTA E FOLËSVE DHE TË FTUARVE NË KONFERENCËN

MBULIMI NGA MEDIA I SITUATËS NË KOSOVË

Folës dhe moderatorë:

1. **Sulejman Rushiti**, Ministër i Arsimit dhe Shkencës në Qeverinë e RM (Maqedonia)
2. **Zhaneta Trajkoska**, Drejtore ekzekutive e Institutit Maqedonas për Media (Maqedonia)
3. **Sandor Orban**, Drejtor ekzekutiv i Rrjetit të Evropës Juglindore për Profesionalizimin e Medias - SEENPM (Hungaria)
4. **Boro Kontiq**, Drejtor i Mediacentar Sarajevo (Bosnje dhe Hercegovine)
5. **Willem Houwen**, Drejtor i Institutit të Gazetarisë dhe Komunikimit (Kosova)
6. **Dubravka Valiq-Nedeljkoviq**, Drejtore e Shkollës se Gazetarisë se Novi Sadit dhe autore e kerkimit per Serbinë (Serbia)
7. **Agron Bajrami**, Kryeredaktor i Koha Ditore (Kosova)
8. **Boshko Jakshiq**, Kolumnist i te përditshmes Politika (Serbia)
9. **Ognian Zlatev**, Drejtor i Qendrës se Zhvillimit te Medias (Bullgaria)
10. **Ilda Londo**, Instituti Shqiptar i Medias dhe autore e kërkimit për Shqipërinë (Shqipëria)
11. **Marko Troshanovski**, Instituti për Demokraci, autor i kerkimit per Maqedonine (Maqedonia)
12. **Danijela Seferoviq**, Instituti i Medias se Malit te Zi, autor i kërkimit për Malin e Zi (Mali i Zi)
13. **Remzi Lani**, Drejtor i Institutit Shqiptar te Medias (Shqipëria)
14. **Gabriel Partos**, Analist i Evropës Qendrore dhe Jug-lindore (Britania e Madhe)
15. **Giuseppe Zaccaria**, Korrespondent i Ballkanit për te perditshmen La Stampa (Italia)
16. **Gorazd Kovaçiç**, Universiteti i Lubjanës, Fakulteti i Arteve, Departamenti i Sociologjisë (Sllovenia)

17. **Teodora - Olivia Vasilescu**, autore e kërkimit për Rumaninë (Rumania)
18. **Agnieszka Skieterska**, gazetare e se përditshmes Gazeta Wyborcza (Polonia)

Pjesëmarrësit:

19. **Maria Janeva**, Qendra e Zhvillimit te Medias (Bullgaria)
20. **Mirjana Milosheviq**, Qendra e Medias Beograd (Serbia)
21. **Amer Dzihana**, Mediacentar Sarajevo (Bosnja dhe Hercegovina)
22. **Lutfi Dervishi**, RTV Shqiptar (Shqipëria)
23. **Dirk Foerger**, Konrad-Adenauer-Stiftung (Bullgaria)
24. **Dragana Stojanoviq**, Qendra e Medias Nish (Serbia)
25. **Nicolay Tsekov**, Deutsche Welle (Bullgaria)
26. **Aleksandra Ostojiq-Matiq**, Media Plan Instituti (Bosnja dhe Hercegovina)
27. **Radojica Bulatoviq**, Instituti i Medias (Mali i Zi)
28. **Miodrag Miljkoviq**, Qendra e Medias Nish (Serbia)
29. **Yana Pelovska**, Media Development Center (Bullgaria)
30. **Hajnal Vernes**, SEENPM (Hungaria)
31. **Bela Ajzenberger**, Shkolla e Gazetarisë Novi Sad (Serbia)
32. **Nadine Gogu**, Qendra e Pavarur e Medias (Moldavia)
33. **Syzana Bytyçi**, Instituti i Gazetarisë dhe Komunikimit të Kosovës (Kosova)
34. **Sanja Dragojeviq**, ICEJ, Zagreb (Kroacia)
35. **Mihaela Danga**, Qendra e Gazetarisë së Pavarur, Bukuresht (Rumania)
36. **Ilona Moricz**, Qendra e Gazetarisë se Pavarur, Budapest (Hungaria)
37. **Naser Miftari**, Instituti i Gazetarisë dhe Komunikimit të Kosovës (Kosova)
38. **Christiana Christova**, Konrad-Adenauer-Stiftung (Bullgaria)
39. **Stephanie Rust**, Instituti për Komunitete të Qëndrueshme, Shkup (Sh.B.A)

40. **Zhenet Mujic**, Misioni OSBE Kosovë (Kosova)
41. **Arben Hajredinaj**, Misioni OSBE Kosove (Kosova)
42. **Budimir Vidiq**, Media Center Chaglavica (Kosova)
43. **Danijela Mitiq**, Media Center Chaglavica (Kosova)
44. **Dejan Andonoviq**, TV Sitel (Maqedonia)
45. **Drita Mamuti**, Ministria e Arsimit dhe Shkencës në Qeverinë e RM (Maqedonia)
46. **Natasa Dokovska**, gazetare, (Maqedonia)
47. **Kokan Stojçev**, Makedonsko Sonce (Maqedonia)
48. **Erdem Amet**, MTV-redaksia turke (Maqedonia)
49. **Fares Ahmed**, Radio Free Europe (Maqedonia)
50. **Jana Ivanovska**, New York University-Shkup (Maqedonia)
51. **Elizabeta Veljanovska**, MIA – Agjencia Informative e Maqedonisë (Maqedonia)
52. **Mirjana Mateva**, MTV (Maqedonia)
53. **Laura Papraniku**, Lajm (Maqedonia)
54. **Slagjana Dimishkova**, Veçer (Maqedonia)
55. **Jordanka Ivanovska**, Dnevnik (Maqedonia)
56. **Milan Strezovski**, Forum (Maqedonia)
57. **Sanja Vasiq**, TV Telma (Maqedonia)
58. **Jasmina Mironski**, France Press (Maqedonia)
59. **Bedri Rexha**, TV Alsat (Maqedonia)
60. **Janko Nikolovski**, Komisioni i Aksesit të Lirë në Informacionin Publik (Maqedonia)
61. **Sabina Muriq**, MTV- redaksia boshnjake (Maqedonia)
62. **Vlatko Misev**, Instituti për Demokraci (Maqedonia)
63. **Husamedin Gina**, MTV-redaksia turke (Maqedonia)
64. **Gorazd Çomovski**, TV A1 (Maqedonia)
65. **Mefail Ismaili**, TV ERA (Maqedonia)

66. **Jovanka Caruleska**, Radio Kanal 77 (Maqedonia)
67. **Zhaklina Haxhi-Zafirova**, Utrinski vesnik (Maqedonia)
68. **Dragan Ilievski**, / (Maqedonia)
69. **Ljupka Siljanovska**, Konrad-Adenauer-Stiftung, Shkup (Maqedonia)
70. **Eftoska Jasmina**, Konrad-Adenauer-Stiftung, Shkup (Maqedonia)
71. **German Fillkov**, Qendra për Komunikim Civil (Maqedonia)
72. **Nazim Rashidi**, BBC (Maqedonia)
73. **Aleksandar Dimitrievski**, TV ALFA (Maqedonia)
74. **Marija Milloshevska**, Ministria e Arsimit dhe Shkencës së RM (Maqedonia)
75. **Fisnik Pasholli**, TV Era (Maqedonia)
76. **Bukurie Avdi**, TV Era (Maqedonia)
77. **Slagan Penev**, Forum (Maqedonia)
78. **Snezhana Saviq-Dimovska**, Zyra e avokaturës"Saviq"(Maqedonia)
79. **Dorothea Gieselmann**, Ambasada Gjermane ne Maqedoni (Maqedonia)
80. **David Hilke**, Ambasada Gjermane ne Maqedoni (Maqedonia)
81. **Ekrem Kadri**, Radio Vat (Maqedonia)
82. **Naim Vrenezi**, TV Alsat-M (Maqedonia)
83. **Kadrije Zejneli**, MTV-redaksia shqipe (Maqedonia)
84. **Cvetin Çilimanov**, Nova Makedonija (Maqedonia)
85. **Daut Dauti**, MCMK "Tolerance" dhe anëtar i Bordit drejtues të Komitetit të Helsinkit (Maqedonia)
86. **Anila Disha**, Lajm (Maqedonia)
87. **Tamara Grnçaroska**, Utrinski Vesnik (Maqedonia)
88. **Driton Dikena**, Fakti (Maqedonia)
89. **Emilija Tuxharovska**, Konrad-Adenauer-Stiftung, Shkup (Maqedonia)
90. **Meri Karanfillovska**, Instituti Maqedonas për Media (Maqedonia)

91. **Jane Stefanov**, Instituti Maqedonas për Media (Maqedonia)
92. **Lejla Shaban**, Instituti Maqedonas për Media (Maqedonia)
93. **Ivona Eftimova**, Instituti Maqedonas për Media (Maqedonia)
94. **Mihajlo Llahtov**, Instituti Maqedonas për Media (Maqedonia)



SEENPM

MACEDONIAN INSTITUTE FOR MEDIA